

BIBLIOTEKA
SHTETIT

390

E 33.

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPSSH
INSTITUTI I KULTURËS POPULLORE

ETNOGRAFIA SHQIPTARE

X

1981

390
CP3

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPSSH
INSTITUTI I KULTURES POPULLORE

Sektori i kulturës materiale
Sektori i kulturës shoqërore

ETNOGRAFIA SHQIPTARE

X



TIRANE, 1979

Abaz DOJAKA

ZGJIDHJA E MARTESËS NË SHQIPËRI

(Fundi i shek. XIX deri në ditët tona)

Institucioni i zgjidhjes së martesës është shumë i lashtë, pothuaj aq sa edhe vetë martesa.

Zgjidhja e martesës në të gjitha formacionet ekonomiko-shoqërore me klasa antagoniste ka qenë dhe mbetet një institucion vetëm në shërbim të burrit. Kjo e drejtë nuk është gjë tjetër, veçse pjellë e pushtetit të tij ekonomik. Ajo i ka shërbyer burrit si një mjet për të kënaqur interesat e tij personale dhe, në të njëjtën kohë, është përdorur nga burri si armë shtrënguese, si një dënim për gruan, kur ajo nuk i është nënshtruar vullnetit të tij. Prandaj edhe sot në vendet ku sundon kapitali, megjithëse gruas i njihet e drejta e shkurorëzimit, kjo e drejtë mbetet formale. Gruaja në ato vende, përderisa është e varur ekonomikisht nga burri, nuk mund ta ushtrojë lirisht këtë të drejtë.

Përkundrazi, në shoqërinë tonë socialiste, ku çlirimi ekonomik i gruas është arritur plotësisht, e drejta e saj për të kërkuar zgjidhjen e martesës jo vetëm që garantohet me ligj, por është, siç ka thënë shoku Enver Hoxha, «një armë lirie kundër skllavërimit të vet»¹. Sigurisht kjo armë e kryen këtë funksion kur ushtrohet në drejtim të çlirimit të gruas, të ruajtjes dhe të rritjes së personalitetit, për emancipimin e plotë të saj.

Në këtë punim do të flasim për zgjidhjen e martesës në Shqipëri në fund të shekullit XIX deri në kohën tonë, duke mos hyrë në veçoritë krahinore. Siç do të shohim nga materiali, edhe te ne zgjidhja e martesës para Çlirimt ka qenë përdorur kryesisht nga burri si një e drejtë që ka pasqyruar sundimin ekonomik të tij në familje e në shoqëri. Meqenëse praktika e këtij institucioni nuk mund të përputhej me parimet themelore të ndërtimit të shoqërisë e të familjes socialiste, materialet e Partisë dhe mësimet e shokut Enver i kanë kushtuar edhe këtij problemi vëmendje të veçantë. Me qëllim që të njihet praktika e institucionit të zgjidhjes së martesës në të kaluarën e popullit tonë, ne do të parashtrojmë si pasqyrohej ajo në të drejtën zakonore, në të drejtën kanonike e të shariatit, si dhe në kodin civil, për të parë konkretisht padrejtësinë shoqërore në dëm të gruas dhe nevojën për të luftuar mbeturinat e tyre si pengesa të rëndësishme për krijimin e familjeve të reja dhe për zgjidhjen e atyre martesave, që e kanë humbur funksionin e tyre shoqëror.

1) E. Hoxha, *Mbi problemin e gruas*, Tiranë 1967, f. 197.

*

* *

Zgjidhja e martesës në Shqipëri në fund të shekullit XIX e gjer në vitin 1929, kur hyri në fuqi Kodi Civil i Mbretërisë së Zogut, nuk trajtohej nga Kodi Civil Otoman. Në pjesën më të madhe të vendit kjo çështje trajtohej sipas së drejtës kanonike dhe së drejtës së Sheriatit, ndërsa në malësitë tona sipas së drejtës sonë zakonore, Kanunit të Lekë Dukagjinit, Kanunit të Skënderbeut, Sharteve të Idriz Sulit. Kjo ndodhë sepse në malësitë e Shqipërisë, që nga Kosova gjer në Çamëri, pavarësisht nga krahina dhe feja e banorëve, administrata turke nuk mundi të stabilizohej dhe të vendoste ligjet e veta. Në zonat e ulëta, ku u vendos pushteti osman, hyri ndikimi i fortë i fesë, veçanërisht në jetën intime të familjes, të cilën ligjet shtetërore nuk e preknin drejt-përdrejt. Ndërsa kristianizmi përpinqej të impononte martesën fetare me kurorë duke e ndaluar zgjidhjen e saj, islamizmi, nga ana e tij, i dha liri të shumta burrit për të lëshuar gruan kur të donte. Në thelb të dyja fetë kishin për qëllim nënshtrimin e plotë të gruas nga burri.

ZGJIDHJA E MARTESËS SIPAS SË DREJTËS KANONIKE (KATOLIKE DHE ORTODOKSE).

Sipas fesë katolike shkurorëzimi ndalohej. Njihej vetëm instituti i veçimit personal, domethënë i veçimit nga tryeza dhe nga shtrati. Por, në fakt, në zonat malore të Shqipërisë së Veriut me popullsi katolike, me gjithë luftën e madhe që bënte kleri dhe me gjithë kërcënimet për shkishërim dhe gjabitje, nuk u arrit kurër që të ndalohej shkurorëzimi.

Ndarjet dhe ikjet e grave nga burrat e tyre, siç na dëshmojnë burimet e ndryshme, kanë qenë të vazhdueshme, veçanërisht në zonat e malësive të Shqipërisë Veriore. Duke filluar nga **fundi i shekullit XII** në vendin tonë janë organizuar disa koncile për këto probleme dhe janë dërguar relacione të shumta në Romë për «**shkolljet**» e ndryshme që bënorët e këtyre anëve vënë lidhur me martesat, sidomos me dëbimin e **shekullit e grave**.

- 2) Në aktet e koncilit kishtar të Tivarit të vitit 1199 thuhet: «Çkishërojmë të tè atë që kanë zbuar gratë e tyre ose që do t'i zbojnë këtej e tutje pa gjyqin e kishës deri sa të kthehen prap tek ato.» (D. Farlati, *Iuricum sacrum*, vell. VII, f. 29. *Aktet e koncilit kishtar në Tivar 1199* në: «Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë» vell. II shek. VIII-XV). Në relacionin që Marin Bici i dërgon papa Palit V lexojmë: «Në se ikë ndonjë grue prej burrit të vet me anë të divorcit, ose me u martue me tjetër, le të mundet ai ipeshkev të ndërrhyjë në këtë çështje për shumën (gjobën) sipas ritit latin (*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vell. I, f. 71). Nga koncili shqiptar i vitit 1703 marrim vesh se «n'baft vaki që gruaja e kshten me ik prej burrit t'kshten... i kshteni nuk ka izën me marr nji grue tjetër, pse ligja e tenzot nuk i ep si u prish ajo martes tuj ken gjall burri e grueja... Ai pra që merr për fat një tjetër në kam të asaj... kurvnon me të e në mos u daft asht për tu lanë pa sakramente (*Concilium Albanum 1703*, f. 105). Ndërsa në një dokument shqip të vitit 1744 lexojmë: Kjoftshin mallkue ata chi dain graat dhe marrin chiera» (Kolë Kamsi, *Një dokument gjuhë-sor shqip (1744)*. «Buletin i USHT, seria shkencat shoqërore», 1958, nr. 2.

Ndryshe ndodhët në popullsinë qytetare dhe të fshatrave afër tyre, ku feja katolike ushtronë një ndikim të madh. Në këto vende, veçanërisht në popullsinë katolike të qytetit të Shkodrës, ndarjet dhe ikjet e grave ishin shumë të rralla.

E drejta familjare e fesë ortodokse e lejonte shkurorëzimin, por kjo bëhej gjithmonë me anë të kishës. Shkaqet për shkurorëzim kanë qenë të caktuara dhe të kufizuara: shkelje kurore, atentat kundër jetës, mundime të rënda, sëmundje mendore të pashërueshme etj. Megjithatë, ndarjet në popullsinë ortodokse të Shqipërisë kanë qenë të rralla, veçanërisht në fshat. Dhe, po të ndodhnin, marrëdhëniet në mes dy familjeve prisheshin, por nuk arrinin deri në atë shkallë sa të kalonin në hasmëri³.

Është me vend të përmendim se në disa zona të Labërisë me popullsi ortodokse, ku e drejta zakonore (Shartet e Idriz Sulit) ka pasur një ndikim më të madh, si në fshatrat e Bregdetit, në Senicë të Rrëzomes (Delvinë) etj., në shumicën e rasteve, ndarja bëhej sipas zakonit të vendit dhe jo sipas së drejtës kanonike. Kështu p.sh., në Senicë, e drejta e burrit për të ndarë në mënyrë të njëanshme gruan, kufizohej vetëm kur ajo akuzohej për shkelje të besnikërisë bashkëshortore, për kusari dhe për të qelburit e frymës ashtu si parashikoheshin në Shartet e Idriz Sulit. Në rastet e tjera, burri nuk merrte parasysh shkaqet e së drejtës familjare të fesë ortodokse, por do t'u paraqiste ankesat e tij pleqve të çetës, të cilët, në prani të të parëve të shtëpisë, të burrit e të gruas, do të vendosnin për ndarjen ose jo, duke zbatuar të drejtën zakonore.

Pra, megjithëse me besime fetare të ndryshme, fshatarët e Senicës, sikurse ata të Nivicë-Bubarit, Shën-Vasilit, Lukovës etj., duke qenë vazhdimisht në kontakt të ngushtë me blegtoret e Kurveleshit e të Zhulatit, të cilët kishin përqafuar fenë myslimanë, nuk u larguan nga zakonet e vendit. Pikërisht në këto zona, kleri i cilësdo fe qoftë, nuk ka mundur të ushtronë ndonjë ndikim aq të rëndësishëm në masat e popullsisë së Labërisë⁴. Prandaj edhe banorët e këtyre fshatrave çështjet dhe konfliktet e ndryshme familjare i zgjidhni duke zbatuar Shartet e Idriz Sulit.

ZGJIDHJA E MARTESES SIPAS SE DREJTES SE SHERIATIT

Islamizimi i një numri krahinash të vendit tonë bëri që në to, veçanërisht në qytetet, fshatrat në afersi të tyre dhe në fshatrat fushore të zbatuhej e drejta e Sheriatit.

Sipas së drejtës së shenjtë myslimanë (Sheriatit), që karakterizohej nga rregulla çnjerëzore në trajtimin e grave, shkurorëzimi, kur kërkohej nga burri, mund të sigurohej fare lehtë. Ishte një e drejtë e padis-kutueshme e burrit, që, kur t'i tekej, ta dëbonte gruan. Dëbimi i gruas

3) Ll. Mitrushi, *Dasma në lalët e Myzeqesë*, «Etnografia shqiptare» II, Tiranë 1963, f. 186.

4) K. Nova, *Forcimi i mëtejshëm i familjes dhe lufta kundër zakoneve prapanike. «Drejtësia popullore»*, 1967, nr. 3, f. 108.

bëhej me anën e një deklarimi «të kam lëshuar» (të kam bërë hasha). Ky deklarim i njëanshëm ishte i prerë dhe kishte efekt të menjëherëshëm. Burri nuk ishte i detyruar të tregonte shkaqet dhe askush, as nga familja e burrit, nuk mund të vinte në diskutim vendimin e tij.

Sipas shariatit, edhe gruas i lejohej të kërkonte shkurorëzimin, por vetëm për dy shkaqe: për impotencën e burrit dhe për shkak të vesit të bixhozit e të pijes. Për shkakun e dytë shkurorëzimi i lejohej vetëm në rast se ishte parashikuar si kusht në kontratën e lidhjes së martesës.

Pra, ndryshe nga e drejta zakonore dhe ajo kanonike, e drejta e gruas, sipas shariatit, për të kërkuar shkurorëzim ka ekzistuar, pavarësisht se ka qenë e kufizuar. Ajo nuk mund të bëhej me anë të një deklarimi të thjeshtë dhe të njëanshëm, siç vepronë burri, përkundrazi, kërkësen e saj, gruaja duhej ta bënte me padi të rregullt duke thirrur si të paditur edhe burrin. Në këtë rast padia e shkurorëzimit shqyrtohej nga gjykata e Sherisë, gjykata fetare, që përbëhej vetëm prej kadiut.

Në anë tjetër, gruaja rrallëherë ka kërkuar shkurorëzimin dhe kjo ndodhë vetëm atëherë kur ajo torturohej në mënyrë çnjerëzore nga i shoqi dhe njerëzit e tij. Por duhet pasur parasysh se, në kësi rastesh, gruaja bënte padinë kur ajo kishte shtytjen e prindërvë të saj.

Edhe pse e drejta islame e lejonte shkurorëzimin në gjithë besimtarët e tij, kjo e drejtë nuk u shtrit dhe nuk u zbatua njëloj në të gjithë shqiptarët e islamizuar. Në qytetet dhe në fshatrat në afërsi të tyre e drejta e shariatit ndihej më shumë dhe në përgjithësi ndarjet bëhen në shtresat e varfra të popullsisë, ndarjet, për shkaqe jo të rëndësishme, opinioni shoqëror i dënontë dhe në fakt, në këto shtresa, shkurorëzimet kanë qenë mjafë rralla.

Në zonat malore me popullsi myslimanë ndarjet ndodhnin akoma më rrallë dhe, në përgjithësi, këtë të drejtë e kishin vetëm burrat. Madje ato ngjisin për shkaqe shumë të forta, përndryshe, lënia e gruas apo lëshimi i vajzës do të lahej vetëm me gjak. Kuptohet pastaj që ikja e gruas shkaktonte një armiqësi akoma më të madhe.

LËSHIMI I VAJZËS SË ZËNË DHE ZGJIDHJA E MARTESES

SIPAS SË DREJTËS ZAKONORE

Sipas së drejtës sonë zakonore djali kishte të drejtë të lëshonte vajzën e zënë dhe burri të ndante gruan. Burri ishte titullar i pushtetit në familje, prandaj gëzonte një të drejtë të gjerë për të lëshuar dhe përzënë gruan. Në të drejtën tonë zakonore epërsia e mashkullit mbi femrën legalizohej me norma të veçanta, që i jepnin të drejtë vetëm burrit për të ndarë gruan⁵.

- 5) Në qytetet Shkodër, Burrel, Tiranë, Kavajë, Elbasan, Korçë, Gjirokastër etj. dhe fshatrat përreth ndikimi i së drejtës së shariatit lidhur me ndarjet ka qenë më i madh. AE, 783/67; AE 475/18, f. 26; AE 805/89 pika 87; AE 481/24, f. 153; AE 462/2 f. 74; AE pika 87; A. Dojaka, *Dasma Çame*, «Studime historike», 1966, nr. 2 f. 138; AE 547/20, f. 78.
- 6) Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD) nyje 31; Kanuni i Skënderbeut (KS) parag. 765; Rr. Zojzi, *Materiale nga ekspedita në Labëri* 1956, AE, 44/7, f. 31.

Por, pavarësisht nga e drejta e padiskutueshme e burrit për të përzënë gruan, në të vërtetë, ndarjet te shqiptarët kanë qenë të kufizuara dhe për lëshimin e vajzës së zënë dhe zgjidhjen e martesës kërko-heshin shkaqe të forta. Nyja 31 e Kanunit të Lekë Dukagjinit merret me fajt e grave, për të cilat burri mund ta zbonte gruan nga shtëpia. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit burri ka të drejtë për të ndjekur gruan «po s'u pru si duhet gruaja te burri... për bracni e cubni». «Gjithashtu, për dy punë e ka fishekun në shpinë gruaja dhe për një punë i pritet theku e lëshohet: a) për kurvni dhe b) për mik të premë»⁷. Grueja lëshohet, thuhet në Kanunin e Skënderbeut, për: 1) kurvni, 2) mik të premë (po s'u vra), 3) hajni»⁸. Ndërsa, sipas Sharteve të Idriz Sulit, burri mund ta lëshonte gruan për tri arsy: për kurvni, për kusari dhe kur nuk shkon mirë me shtëpinë e burrit»⁹. Të njëjtat norma janë edhe për lëshimin e vajzës së zënë. Siç shihet, shkaqet për lëshimin e gruas janë të përafërtë për të gjitha ato krahina ku vepronë e drejta zakonore.

Një nga shkaqet kryesore, që sillte si pasojë ndarjen e gruas, ishte shkelja e besnikërisë bashkëshortore. E drejta jonë zakonore e dënonë rëndë një gjë të tillë dhe përvèç së drejtës të burrit për të ndjekur gruan, duke u treguar shkaqet vetëm prindërve të saj, ai ndaj së shqes dhe mikut të saj merrte edhe masa të tjera shumë të rrepta.

«Ata, që kanë shtat e dhunë bashkë, — thuhet në KLD, — po u vranë të dy në punë të keqe, shkojnë gjak hupës»¹⁰. Por edhe në një rast të tillë të turpëruarit duhet të vriten «me pushkë»¹¹ ndryshe, po u vranë veg e veg, familjet e të vrarëve kërkojnë hakun. «Gjete bashkë kësule e shami, nënvizon Kanuni i Skënderbeut, bjeru pushkë e shkojnë si qeni në rrush»¹². Norma të tillë shënohen edhe në kanune të tjerë që vepronin në krahina të vëçanta. Por, siç e vumë në dukje edhe më lart, vrasja mund të bëhej atëherë kur mashkulli me femrën ziheshin në flagrancë. Bile në Labëri, sipas Sharteve të Idriz Sulit, vrasja mund të kryhej kur gruaja dhe burri ziheshin në punë të keqe sipër rrugës, përndryshe, po të gjendeshin poshtë rrugës, lindte dyshimi se ndaj gruas mund të ishte përdorur forcë¹³.

Por më vonë, duke filluar nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shekullit tonë, në disa krahina, vëçanërisht në zonat ku vepronin Shartet e Idriz Sulit, burri nuk lejohej ta vriste të shoqen, por e përzinte duke e çuar në derë të babait të saj. Babai ose e mbante turpin, ose i vriste të dy. Por, në të vërtetë nuk ka pasur raste që të mbahej turpi në derë; këtë gjë e dënonë opinioni shoqëror. Ajo familje, që nuk tre-guhej e zonja për të dënuar fajtorët, përbuzej nga shoqëria, nuk i fliste njeri, nuk i hynte as nuk i dilte kush, nuk lidhët ndonjë krushqi me

7) KLD, nyje 31.

8) KS, parag. 763.

9) Rr. Zojzi, AE, 44/7, f. 31.

10) KLD, paragr. 920.

11) KLD, paragr. 923.

12) KS, paragr. 798.

13) Populli e shpjegon kështu këtë: në qoftë se gruaja gjendej sipër rrugës, atëherë ajo ka dashur të shkojë vetë, sepse, sado i fuqishëm të ishte burri, nuk mund ta tërhoqte me forcë, ndërsa poshtë rrugës ushtrimi i forcës është më i lehtë.

të etj. Prandaj të afërmit e gruas së lëshuar do t'i vrisnin të dy, atë dhe mikun e saj. Dhe nëse ndodhë që të vritej vetëm njeriu i huaj, atëherë do të ishte borxh gjaku, po të vritej vetëm gruaja, do të quhenëshin të dobët dhe përbuzeshin nga shoqëria. Por, pavarësisht nga këto, heqja e normës që dënonte fajtorët me vrasje ishte një hap përpara.

Gjithashtu, një seri normash zakonore synonin të ruanin edhe nderin e vajzave. Këto norma parashikonin edhe vrasjen e vajzës që bëhej me barrë, ose si thuhet në Kanunin e Lekës «del' me marre». Dhe kjo është një nga normat më të rëndësishme të së drejtës sonë zakonore, që shërbente si shkak pér lëshimin e vajzës së zënë. «Vajza me turp, — thuhet në Shartet e Idriz Sulit, — turpëron derën e babait»¹⁴. Dhe në rastet kur vajza e zënë dilte me turp, djali kishte të drejtë vetëm ta lëshonte, ndërsa familja e saj merrte masa të rrepta ndaj vajzës që arrinin edhe gjer në vrasje.

Lidhur me vrasjet pér çështje nderi nuk ka ndodhur ndonjë rast që prindërit e të vrarëve të kërkonin gjakun e tyre, përkundrazi, në shumicën e krahinave ku vepronte e drejta zakonore, kjo më e theksuar në Shqipërinë e Veriut, do t'i thoshin atij «të lumtë dora»¹⁵. Dhe kjo gjë ka gjetur shprehje në kanun me dorëzimin gjoja të «fishekut» si kompensim pér atë që ka harxhuan.

Sipas së drejtës zakonore, sidomos sipas Kanunit të Lekës dhe të Skënderbeut, gruaja bënte faj të rëndë kur ruk priste mikun në shtëpi të saj, veçanërisht kur mungonin meshkujt e shtëpisë, dhe, pér «premjë të mikut», domethënë, kur gruaja bëhej bashkëpunëtore pér vrasjen e mikut apo e tradhtonte mikun në hasmët e tij. Në rastin e parë burri e ndante gruan, në të dytin ai e vriste.

Djali i zënë ose burri kishte të drejtë ta lëshonte gruan edhe atëherë kur gruaja zihej duke vjedhur. Vjedhja ishte turp i madh dhe këtë ves nuk e duronin jo vetëm ana e djalit, por edhe prindërit dhe farefisi i vajzës. Madje, në rastin kur martesa ende nuk ishte bërë, prindërit e vajzës i thoshin dhëndrit «merre vajzën dhe fishekun», që do të thoshte: po të zihej nusja duke vjedhur të vritej dhe pér këtë vepër gjak e detyrim tjetër nuk i ka palës së vajzës. Shprehja «fisheku në pajë», nganjëherë është keqinterpretuar. Në të vërtetë, shtëpia e vajzës asnjëherë nuk i ka dhënë shtëpisë së djalit fishek jo vetëm pér këtë rast, por edhe pér rastet e tjera që përmenden në kanun. Madje, në një kohë më të largët, në Mirditë nuk përdorej fare emri «fishek» por «shëngjetë» (shigjetë – A.D.). Kjo është një shprehje figurative që tregonte premtimin, garancinë, që prindët e vajzës bënin ndaj prindërvë të djalit. Dhe në rast se nuk dilte ashtu siç premtionin ata, atëherë merreshin masat e parashikuara në kanun.

E drejta zakonore pér ndarjen e gruas nuk njihte shkaqe të tjera, veç atyre që përmendëm më lart. Por pavarësisht se këto norma, në vë-shtrimin e parë të duken të drejta, ato drejtoheshin kundër grave dhe përligjinë shtypjen e tyre. Ndaj burrit edhe po të zihej në faj në të gjitha rastet që përmendëm, nuk merrej asnjë masë nga ana e gruas, përkundrazi ajo do të ishte nën pushtetin absolut të tij.

14) Rr. Zojzi, AE 40/3, f. 39.

15) KLD, paragr. 924.

Edhe pse ekzistonin gjithë këto të drejta, shtresat e bezlerëve e të agallarëve të vendit kërkuant të largoheshin nga këto rregulla dhe t'i jepnin liri të pakufizuar burrit, për të lëshuar gruan kur t'i tekej. Për këtë qëllim ata shfrytëzuan normat e shariatit, bazën ideologjike të fesë islame. Këto rregulla të «reja», u sanksionuan në të drejtë zakonore në ato krahina ku ndikimi i fesë islame ishte më i madh, si në Labëri, në Shqipëri të Mesme (në Malësi të Tiranës, në Malësi të Krujës e në Mat).

Kështu p.sh. Idriz Suli, një përfaqësues i shtresës së agallarëve të Labërisë, në fillim të shek. XIX, u bëri ndryshime të ndjeshme normave të vjetruara të Kanunit të Papa Zhulit, lidhur me martesën, në mënyrë të veçantë me zgjidhjen e saj.

Ndarja e gruas, sipas reformës së Idriz Sulit, bëhej me anën e dëbimit të njëanshëm të gruas nga burri. Idriz Suli, për t'i dhënë më tepër fuqi bindëse këtij ndryshimi të kanunit, e vuri në jetë i pari, duke detyruar dhëndrin e tij të përzinte të bijën, e cila ishte sakate dhe nuk shkonte mirë me të shoqin. Dhe, për të përligjur këtë veprim, mbodhi pleqtë e vilajetit, të cilët edhe e miratuan.

Norma të veçanta iu shtuan edhe Kanunit të Skënderbeut, me anën e të cilave lejohej ndarja edhe për shkaqe të tjera, veç atyre që përmendëm¹⁶.

Largimi nga rregullat zakonore të zgjidhjes së martesës u bë sipas interesave të bezlerëve dhe të agallarëve vendas, të tuxharit e të esnafit mysliman, pra të klasës sunduese. Por ai u bë i mundshëm për arsy se ideologjia fetare islamike, që ishte ideologjia zyrtare e feudalizmit osman, me rregullat e egra të shariatit, e pranonte si të drejtë trajtimin çnjerëzor të gruas. Ishte kjo ideologji që i njihte burrit të drejtëtë absolute ta bënte «hash» gruan, domethënë ta dëbonte atë dhe të merrte një tjetër¹⁷.

Është me vend të shënojmë se, pavarësisht nga normat e reja që iu shtuan së drejtës sonë zakonore lidhur me zgjidhjen e martesës, në disa krahina, si rezultat i opinionit të shëndoshë shoqëror, mbizotëroi përsëri mendimi, i cili nuk e lejonte shkurorëzimin për tekat e burrit e as për faje të zakonshme. Në raste fajesh të tillë gruaja nuk lëshohej, por këshillohej dhe qortohej. Dhe, në qoftë se ndokush dëbon te gruan pa ndonjë arsy të rëndë, ai jo vetëm që do të qe i përbuzur dhe i dënuar nga opinioni shoqëror, por do të binte edhe në hasmëri me prindërit e gruas. Prindërit e një gruaje të tillë fatkeqe thoshnin: «Ma lype binë për miqësi, ta dhashë. Nuk kam rob për dhunë dhe as për t'u tall me të»¹⁸.

Sipas së drejtës zakonore vajzës së zënë nuk i lejohej të lëshonte djalin. Këtë të drejtë nuk e kishin as prindërit dhe të afërmitt e saj. «Vajza e xanun nuk mundet me e lëshue djalin, edhe në mos e pastë

16) KS, Parag. 768.

17) Pohimi që thotë se normat e reja që iu shtuan Sharteve të Idriz Sulit lidhur me zgjidhjen e martesës ishin «një hap përpara», nuk na duket i drejtë, sepse, në të vërtetë këto ndryshime u bënë për përligjen e interesave të shtresave të pasura e të shariatit. (K. Nova, art. cit., f. 107).

18) KS, parag. 775.

për sy»¹⁹, thuhet në Kanunin e Lekë Dukagjinit. «Vajza e xanun nuk ka të drejtë, për asnjë arsy, më e lëshue, të fejuarin e vet»²⁰, udhëzën Kanuni i Skënderbeut. «Ma fejove çupën e nuk ma dhe, fyerje e mëdhe, vetëm dyfeku e zbardh»²¹, nënvízohet në Shartet e Idriz Sulit.

E njëjtë gjë mund të thuhet edhe pér gruan lidhur me zgjidhjen e martesës. E drejta zakoncre nuk i lejonte gruas të kërkonte ndarje dhe të largohej nga banesa bashkëshortore. Kjo ka qenë më e theksuar në popullsinë me besim katolik. Por edhe në popullsinë me besim mysliman, megjithëse sheriati e pranonte zgjidhjen e martesës, në zonat ku vepronte Kanuni i Lekë Dukagjinit nuk kishte vlerë pér gruan. Edhe sipas Sharteve të Idriz Sulit gruas nuk i njihej e drejta e largimit nga burri. Në këtë mënyrë pabarazia e gruas në martesë e familje shpalley si e vazhdueshme, ndërsa kufizimi i të drejtave shfaqejej në mënyrë të qartë në pozitën e saj të vështirë në martesë. Këtu del qartë karakteri reaksionar i së drejtës zakonore, e cila sanksiononte pushtetin patriarkal të burrit në familje.

Lënia e djalit nga ana e vajzës dhe ikja e gruas nga shtëpia e burrit sillte me vete pasoja të rënda. Dhe, në ato raste kur ky veprim gjente përkrahjen e prindërve, pala e vajzës ose e gruas merrnin mbi vete një përgjegjësi të rrezikshme, sepse, jo vetëm që shkaktonin prishjen e miqësisë midis dy familjeve, por në mes tyre shkaktohej një armiqësi aq e madhe, sa vetëm pushka e ndante. Pér këtë arsy edhe rastet e refuzimit të martesave dhe të largimit të grave nga shtëpia e burrit kanë qenë të rralla, sepse, sipas konceptit të gabuar të përhapur te njerëzit, vajza martohet me atë që i pëlqen shtëpisë dhe jo pér veten e saj. Dhe po të ndodhë ndonjë rast që vajza të refuzonte martesën me burrin e zgjedhur nga shtëpia, prindërët dhe të afërmët e saj do ta martonin me zor, me fishek në shpinë»²², që i jepte të drejtë palës së dhëndrit ta vriste, në qoftë se nusja largohej nga shtëpia e burrit.

Përveç përgjegjësisë së rëndë që mbante mbi vete, vajza që linte djalin nuk mund të martohej me tjetër njeri. Vajza që lëshonte djalin, «s'mund të martoher ma pér të gjallët e dhëndrit me tjetër kend»²³. Madje, edhe në qoftë se djali i zënë martohej me grua tjetër, vajza e zënë më parë mbetej e lidhur. Kjo sepse «sheji as ndrohet as kthehet pér të gjallë të atij që e xen vajzën»²⁴, thuhet në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Edhe sipas Kanunit të Skënderbeut familja e vajzës së zënë nuk mund të pranonte shenjë tjetër pa u tërhequr e para, se pér ndryshe binte në gjak me shtëpinë e dhëndrit. Bile familja e djalit gëzonte të drejtën pér të mbajtur peng vajzën përgjithmonë, duke u lënë prindërve të saj shenjën në derë²⁵. Vetëm në rastet kur familja e vajzës ka patur arsyet e fortë pér lënien e djalit, ndërhynët me anë të shokëve dhe të miqve pér të tërhequr nga pala e djalit shenjën, ndryshtë vajza nuk mund të jepej në tjetër vend, sepse, «vajza jet e lindhun, e vec me leje të dhandrit që e pat xanë e pér në hjkët dorë ky,

19) KLD, parag. 43.

20) KS, parag. 340.

21) Rr. Zojzi, AE, 40/3, f. 47.

22) KLD, parag. 43.

23) Po aty.

24) Po aty.

25) KS, parag. 327.

se s'mund të martohej, e s'a kanu që të shkojë tjetër kush me e lypë, si të dijë se gjindet e pengueme»²⁶. Këtu del shumë qartë sanksionimi i pabarazisë së vajzës në krahasim me djalin si dhe marrja nëpër këmbë e dinjitetit të saj.

Lënia e djalit nga vajza mund të mos kishte pasoja të rënda, vetëm atëherë kur ajo betohej solemnisht se nuk do të martohej kurrrë, do të qëndronte virgjér. Sipas së drejtës zakonore, vajza që të qëndronte virgjëreshë duhet të gjente dorëzënës që të garantonin mbajtjen e premtimit²⁷. Dhe, në rast se do të prishej betimi, njihet nderi i dorëzënësve dhe kundër familjes së vajzës fillonte një armiqësi e madhe. Zakoni i qëndrimit virgjér të një vajze në fund të shek. XIX deri në prag të Çlirimtë vendit tonë ka qenë e përhapur më shumë në Shqipërinë e Veriut.

Pavarësisht se institucioni i virgjërisë e ka zanafillën e vet në shqipërinë e komunitetit primitiv, gjurmët e tij i kemi gjetur edhe në çerekun e parë të shekullit tonë²⁸. Në Shqipëri, kur një vajzë donte t'i shërbente shtëpisë dhe vëllazërisë së saj dhe ndiente në veten e vet energji të mjafta për t'i shërbyer vendit si të ishte djalë (kjo ka qenë më e theksuar kur shtëpia e prindit nuk kishte djalë), ajo, duke mos e quajtur më veten «tepricë» në shtëpi dhe në fis të vet, mbetej virgjëreshë, nuk martohej dhe vepronë e vishej si burrë.

Dhe, megjithëse e drejta jonë zakonore nuk i njihet të drejtë tjetër veçse «lirinë me ndejë ndër burra»²⁹ dhe të merrte pjesë në «ku-vende burrash»³⁰, gruaja shqiptare ka dhënë edhe ajo kontributin e saj. Ajo ka ngritur zërin e protestës përmes shekujve, ka treguar vullnetin dhe aspiratat e veta për ideale të larta shoqërore, ka rrokur armët dhe ka luftuar krahas burrit në lëvizjet populllore për liri e pavarësi.

Ndërsa virgjëria e përhershme ka qenë më shumë një ndikim i virgjërisë asketike kristiane³¹, feja e krishterë, duke shfrytëzuar institucionin e virgjërisë për të mbajtur të nënshtruara vajzat, hapi rrugën për ti bërë murgesha. Ky zakon i ri hyri me anën e predikimit të misionarëve katolikë të dërguar nga Propaganda Fide në gjysmën e parë të shek. XVII. Të nisur nga këta misionarë, disa nga vajzat malësore dhe fushore nisën të praktikonin virgjërinë kristiane. Dhe këndeje përfituan shpeshherë disa vajza të lëshonin djemtë e zënë, sepse, në raste të virgjërisë së përhershme, nuk shkaktoheshin gjaqet që zakonisht sillnin me vete prishjet e fejesave. Dhe pikërisht, që në atë kohë kur nisi të predikohej praktika e virgjërisë kristiane nga këto misionarë, kjo praktikë u përligj edhe me kanun³². Gjithashtu mendojmë se të asaj kohe janë edhe normat e Kanunit të Skënderbeut që bëjnë fjalë për këtë çështje dhe që vazhduan të praktikoheshin edhe në pjesën myslimanë të popullsisë.

26) KLD, parag. 43.

27) KS, parag. 273; K. Ulqini, *art. cit.* f. 179.

28) Për gjurmë të institucionit të virgjërisë në vendin tonë shih. A. Gjergji; *Gjurmë matriarkati «BUSHT»*, seria shk. shoq. 1963, 2, f. 284-292. K. Ulqini, *art i cit.*, f. 179-180.

29) I. Zamputi, *Pozita shoqërore e gruas malësore shqiptare sipas kanunit*, «Buletin USHT», Seria Shk. Shoq. 1961, nr. 2, f. 120.

30) K. Ulqini, *art. cit.*, f. 180.

31) I. Zamputi, *art. cit.*, f. 120.

32) Po aty. f. 120.

Në Shqipëri shenja që tregonte lëshimin e gruas ka qenë e ndryshme për krahina të veçanta të vendit tonë. Në zonat ku vepronte Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe ai i Skënderbeut, burri që ndante gruan priste thekët e përparëses së saj, ose brezin përgjysmë; në zonat me pullsi myslimanë gruas i priteshin një pjesë flokësh. Lëshimi quhej i përfunduar, kur burri e bënte veprimin në sy të dy dëshmitarëve ose publikisht. Në Labëri burri që kishte ndër mend të dëbonte gruan e çonte me leje në shtëpi të babait dhe të nesërmen i dërgonte sepeten me rrobat e saj. Kjo ishte shenja e lëshimit.

Gjithashtu, sipas së drejtës zakonore, me përjashtime të rasteve flagrante, shkaqet për ndarjen e një gruaje nuk shpalleshin botërisht. Bile në këtë çështje nuk përziheshin as fisi i burrit dhe as ai i gruas. Përndryshe një grua e lëshuar me bujë, rrallë mund të martohej edhe një herë, sepse secili i ruhej turpit.

ZGJIDHJA E MARTESES SIPAS KODIT CIVIL TE VITIT 1929

Sipas kodit civil të vitit 1929 lejohej shkurorëzimi për shkelje të kurorës, për atentat kundër jetës, për sjellje shnderuese, për lënje ligësht, për sëmundje mendore të pashërueshme, për mospasje të fëmijëve të gjallë ose shterpësi natyrore, ashtu edhe për shkaqe të përgjithshme (tronditje e thellë e raporteve bashkëshortore)³³. Dhe kjo e drejtë i njihej si burrit ashtu dhe gruas. Duke lënë mënjanë shkaqet e ndryshme të ndarjes së gruas, po ndalem shkurtimisht në ndarjen për shkak të shterpësisë natyrore. Moslindja e fëmijëve ishte një nga arsyet kryesore të ndarjes së njëanëshme të gruas nga burri. Raste të tillë ka pasur në të gjitha krahinat e vendit tonë. Dhe jo vetëm kaq, vetë gruaja, duke qenë nën peshën e këtij zakoni, e ndiente si detyrë të saj që t'i gjente një grua tjetër të shoqit për të lindur fëmijë, kryesisht djem.

Por duhet të shënojmë se, pavarësisht nga të drejtat e «barabarta» para ligjit për të kërkuar zgjidhjen e marthesës, në fakt, gjendja vazhdoi të mbetej si më parë. Kodi civil ruante parimet e pushtetit të burrit mbi gruan. Si rrjedhim, edhe ato të drejta që i njihezin gruas mbeshteshin formale, sepse shumica dërrmuese e tyre nuk mund t'i ushtronin, mbasi ato nuk merrnin pjesë në prodhimin shoqëror dhe mbeshteshin gjithmonë skllave të shtëpisë³⁴. Pra, pabarazia ekonomike që ekzistonte në shoqëri sillte si pasojë dhe pabarazinë në familje.

PASOJAT E LËNIES SË VAJZËS DHE ZGJIDHJES SË MARTESES

Lëshimi i vajzës së zënë apo i gruas do të sillnin me vete një seri çështjesh të rëndësishme, që kishin të bënin më shumë me të drejtat e bashkëshortëve për pasurinë personale, si dhe e drejta për fëmijët.

Duke mos u ndalur hollësishët për mënyrat e ndryshme që përdorenë për zgjidhjen e këtyre çështjeve në krahina të veçanta të Shqipërisë, po përmendim ato më kryesoret dhe vetëm ato raste që ishin përfshirë në normat e së drejtës zakonore.

33) K. Begeja, *E drejta familjare në RP të Shqipërisë I*, Tiranë 1973, f. 31.

34) Po aty, f. 38.

Në përgjithësi, kur vajza lëshohej pér fajet e saj, shtëpia e vajzës ishte e detyruar t'i kthente shtëpisë së dhëndrit të gjitha të hollat që ishin paguar pér shenjën e fejesës dhe përgatitjen e pajës³⁵. Por, në rastet kur faji nuk vërtetohej plotësisht, atëherë shtëpia e vajzës do të mbante gjysmën e të hollave të shejit. Kjo zgjidhje ka qenë zbatuat më shumë në zonat ku vepronë Kanuni i Lekës dhe ai i Skënderbeut, ndonëse edhe këtu ka pasur ndonjë dallim në mes tyre dhe brendapër-brenda tyre. Kjo varej jo vetëm nga shtresat e ndryshme të shoqërisë, por edhe sipas besimit të popullsisë, në të cilët ushtronte ndikim e drejta fetare. Shtëpia e vajzës, që lëshohej pér shkaqe të paparashikuara në të drejtën zakonore, do të mbante të gjitha të hollat e shenjës dhe të pajës. Në krahinat që nuk përfshiheshin në ndikimin e kanuneve, veçanërisht në Jug të Shqipërisë, do të mbaheshin peshqeshet dérguar vajzës nga pala e dhëndrit.

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe Kanunit të Skënderbeut, gruaja nuk kishte të drejtë mbi pajën e saj, kur ajo lëshohej pér faje të parashikuara në kanun. «Gruaja qi lshohet, tuj dalë prej shpijet të burrit, kur nji send s'ka tagër me marrë me wedi pose' petkash, qi ka në shtat»³⁶. «Po u lshue gruaja pér faje të saja ajo nuk ka të drejtë të marri kurgja prej pajës së vet, por niset me ato petka që të ket në shtat»³⁷. Si na rezulton nga materialet e mbledhura në terren, e njëjta zgjidhje ndodhë edhe në disa zona të tjera që, megjithëse kanë qenë jashtë ndikimit të kanuneve, ekzistonin mbeturina të këtyre zakoneve³⁸.

Gjithashtu, në rastet kur gruaja ikte vetë nga shtëpia e burrit, pajën e saj nuk kishte të drejtë ta merrte me vete.³⁹ Por kjo nuk zbatohej njëloj në gjithë krahinat e vendit tonë, madje kishte zona ku, edhe pse gruaja ishte me faj, ajo e merrte pajën⁴⁰.

Kur gruaja ndahej pér faje të paparashikuara në kanun, paja i takonte asaj⁴¹. Megjithatë, edhe në kësi rastesh, sipas Kanunit të Skënderbeut, gruaja muhamedane, që linte fëmijë në shtëpi të burrit, nuk gëzonte përfitim pér pajën⁴². Po të ndodhë që burri të merrte një grua tjetër dhe gruaja e ligjshme të ikte nga shtëpia, ajo e merrte krejt pajën e vet, pavarësisht nga fëmijët⁴³.

Shartet e Idriz Sulit i jepnin të drejtë gruas mbi pajën, pavarësisht nga shkaqet e ndarjes. «Po u ndoq gruaja, pajën e saj. jo vetëm

35) Një vend të rëndësishëm në lidhjet martesore zinin edhe marrëveshjet që bënin të dyja palët (pala e djalit dhe ajo e vajzës) lidhur me shumën që duhet t'i paguante ana e djalit anës së vajzës ose e kundërtë, sasinë e plaçkave që do të bënte secila palë etj.

36) KLD, nyja 35.

37) KS, parag. 771.

38) Sipas përgjigjeve dhënë nga bashkëpunëtorët e jashtëm pér pyetSORIN «Doke familjare, Martesa» gruaja nuk kishte të drejtë mbi pajën në Shelcan (Elbasan), Divjakë (Lushnjë), Kurjan (Fier), Çezëm (Pogradec).

39) KS parag. 772. Radomirë (Peshkopij), Mat, Shelcan, Bërzeshëtë (Librazhd), Divjakë, Kurjan, Roshnik (Berat), Potom (Skrapar), Çezëm, Sukë (Përmet), Ramicë (Vlorë), Dhëmban (Tepelenë), Lekdush (Kurvelesh), Luzat (Tepelenë), Zhulat (Gjirokastër), Senicë (Delvinë)

40) Prezë (Tiranë), Synej (Kavajë), Belsh (Elbasan), Lukovë (Sarandë).

41) KS, parag. 772.

42) Po aty. 773.

43) Po aty., parag. 774.

çfarë ka bërë vet, por edhe atë që i ka bërë burri e merr me vete, janë punuar për të»⁴⁴.

Nuk mungonin edhe rastet që paja të ndahej përgjysmë, pavarësisht nga shkaqet e ndarjes⁴⁵. Siç duket, ky do të jetë një ndikim i së drejtës së shariatit.

Norma të veçanta të së drejtës zakonore zgjidhnin edhe çështjet kur gruaj e lëshuar do të qe me barrë, ose do të kishte fëmijë në gji.

Në malësitë e Shqipërisë së Veriut, gruaja me barrë, edhe po të lëshohej, do të qëndronte në shtëpinë e të shoqit, gjersa të lindte fëmijën. Ishte turp i madh të lindte gruaja gjetkë ose në shtëpi të prindërve të saj. Këtë gjë do ta zgjidhte vetëm pushka me shtëpinë e dhëndrit⁴⁶. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, gruaja me fëmijë në gji nuk mund të dëbohej nga shtëpia e të shoqit, përkundrazi ai «asht në detyrë me ia shenjue një vend rreth plangut të vet, me ia dhanë djanunit të Skënderbeut, burri nuk mund të detyronte gruan e lëshuar, pavarësisht nga faji, «t'i rrisë fëminë jashtë shtëpisë së vet»⁴⁷.

Në Labëri, sipas Sharteve të Idriz Sulit, burri kishte të drejtë të lëshonte gruan me barrë, vetëm se ai do ta ushqente duke i dérguar nga e ëma vetëm 40 ditë dhe pas kësaj do ta merrte i ati, sepse fëmija «është i babait».

ZGJIDHJA E MARTESES PAS CLIRIMIT

Pas Clirimit, si rezultat i ndryshimeve të mëdha të bëra në venja e re socialiste. Për familjen e shoqërisë sonë janë të huaja karakteristikat e familjes patriarchale që mbështeten në pronën private. Familja e re ndërtohet duke u mbështetur në dashurinë e burrit e të gruas, në respektin reciprok të bashkëshortëve, në ndihmën e bashkëpunimin në mes tyre dhe në plotësimin e të gjitha detyrave familjare.

Megjithëse në përgjithësi këto tipare karakterizojnë familjen e re në Shqipëri, edhe brenda saj janë vënë re mosmarrëveshje e grumburrit dhe e gruasështë bërë e padurueshme dhe martesa ka humbur bishme zgjidhjen e martesës.

Duke ndjekur dinamikën e martesave të zgjidhura në Shqipëri në periudhën e pasclirimtit jemi ndalur në tri periudha kryesore (1946-1955, 1956-1965, 1966-1975) dhe kemi marrë për secilën fazë tri vite, të fitikore⁴⁸) u jemi referuar edhe viteve të tjera.

44) Rr. Zojzi, *Lugina e Drinit të Gjirokastrës*, AE 45/8, f. 54.

45) Xibër, Gur të Bardhë (Mat), Bicaj (Kukës).

46) F. Nopça, *Vep. cit.*, f. 430.

47) KLD, nyje 35.

48) KS, parag. 777.

49) Të dhënët statistikore janë marrë nga vjetorët statistikorë, botim i Komisionit të Planit të Shtetit, Drejtoria e Statistikës.

Në pasqyrën 1 janë paraqitur disa të dhëna që tregojnë numrin e martesave të zgjidhura në raport me martesat.

Zgjidhja e martesës në raport me martesat

Pasqyra 1

| | Vitet | | | | | | | | |
|--|-------|------|------|------|------|------|------|-------|------|
| | 1946 | 1950 | 1955 | 1956 | 1960 | 1965 | 1966 | 1970 | 1975 |
| Numri i martesave të zgjidhura për 1000 martesa. | 63,6 | 79,0 | 93,8 | 93,0 | 67,6 | 74,0 | 93,8 | 112,4 | 98,9 |


Të dhënat e kësaj tabele tregojnë se në vendin tonë sasia e ndarjeve është nga më të ulëtat në botë. Me gjithë ngritjen e shkallës së emancipimit të marrëdhënieve martesore, numri i martesave të zgjidhura, në raport me sasinë e martesave në tre vjetët e dy dhjetëvjeçarëve të parë 1946-1955 dhe 1956-1965, është gati e barabartë: 78,8 përkundrejt 78,2 ndarjeve për 1000 martesa. Sasia e vogël e ndarjeve ka ardhur si rezultat i ndikimit të madh të mbeturinave dhe zakoneve prapanike të së kaluarës lidhur me martesën dhe me zgjidhjen e saj, ku kjo shihet si një e drejtë vetëm e burrave. Përkundrazi në tre vjetët e dhjetëvjeçarit 1966-1975 vihet re një rritje e ndjeshme e numrit të martesave të zgjidhura, 101,7 për 1000 martesa. Kjo rritje u shfaq menjëherë pas Kongresit VI të PPSH dhe sidomos pas fjalimit të 6 shkurtit 1967 të shokut Enver Hoxha. Gjatë kësaj periudhe u zgjidhën shumë martesa të lidhura mbi baza jo të shëndosha dhe, në këtë drejtim, gruaja filloj ta përdorë më lirshëm të drejtën e saj për të kërkuar zgjidhjen e martesës.

Por, duke iu referuar të dhënavë statistikore, vihet re një ndryshim i ndjeshëm midis numrit të martesave të zgjidhura në qytet dhe në fshat.

Zgjidhjet e martesave sipas vendbaneve të palëve

Pasqyra 2

| Vitet | Martesa të lidhura | | Martesa të zgjidhura | Nga këto të popullsisë | |
|-------|--------------------|--------|----------------------|------------------------|----------|
| | Qytet | Fshat | | Qytetarë | Fshatarë |
| 1950 | 2767 | 9574 | 976 | 405 | 571 |
| 1955 | 2279 | 8979 | 1057 | 488 | 569 |
| 1956 | 2232 | 8157 | 957 | 415 | 542 |
| 1960 | 3339 | 9232 | 850 | 449 | 401 |
| 1961 | 4241 | 14.482 | 1314 | 686 | 628 |
| 1965 | 4531 | 9390 | 1041 | 565 | 476 |
| 1966 | 4199 | 8769 | 1217 | 756 | 460 |
| 1970 | 5171 | 9278 | 1625 | 946 | 679 |
| 1971 | 5694 | 9606 | 1758 | 1002 | 756 |
| 1975 | 6667 | 12.062 | 1853 | 1165 | 688 |



Duke analizuar pasqyrën e mësipërme, shihet qartë se numri i martesave të zgjidhura në qytete është më i lartë se në fshatra. Kështu p.sh., në vitin 1975 nga 1853 shkurorëzime, 1165 ose 63,2% i përkisnin qytetit dhe 688 ose 36,8% fshatit. Sigurisht kjo gjendje nuk është e njëjtë për të gjitha rrëthet e vendit. Madje, edhe brenda rrëthit ka ndryshime midis zonave të veçanta. Për ta parë më mirë këtë, po paraqesim pasqyrën 3 dhe 4, ku kemi marrë zgjidhjet e martesave në vitet 1970 dhe 1975 sipas rrëtheve.

Zgjidhja e martesave sipas rrëtheve për vitet 1970, 1975

Pasqyra 3

| Rrëthet | 1970 | | | 1975 | | |
|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| | Gjithsej | Qytetarë | Fshatarë | Gjithsej | Qytetarë | Fshatarë |
| Gjithsej | 1.625 | 946 | 769 | 1.853 | 1.165 | 688 |

| | | | | | | |
|-------------|-----|-----|----|-----|-----|----|
| Berat | 98 | 40 | 58 | 93 | 68 | 25 |
| Dibër | 42 | 9 | 33 | 45 | 9 | 36 |
| Durrës | 145 | 98 | 47 | 163 | 119 | 44 |
| Elbasan | 107 | 64 | 43 | 136 | 94 | 42 |
| Fier | 108 | 42 | 66 | 121 | 46 | 75 |
| Gramsh | 16 | 2 | 14 | 22 | 10 | 12 |
| Gjirokastër | 34 | 12 | 22 | 35 | 20 | 15 |
| Kolonjë | 4 | 2 | 2 | 9 | 3 | 6 |
| Korçë | 154 | 75 | 79 | 169 | 88 | 81 |
| Krujë | 32 | 20 | 12 | 53 | 34 | 19 |
| Kukës | 12 | 2 | 10 | 16 | 9 | 7 |
| Lezhë | 18 | 6 | 12 | 17 | 8 | 9 |
| Librazhd | 22 | 3 | 19 | 20 | 5 | 15 |
| Lushnjë | 61 | 29 | 32 | 69 | 20 | 49 |
| Mat | 12 | 5 | 7 | 18 | 7 | 11 |
| Mirditë | 12 | 12 | — | 16 | 8 | 8 |
| Përmet | 14 | 6 | 8 | 16 | 6 | 10 |
| Pogradec | 23 | 12 | 11 | 38 | 19 | 19 |
| Pukë | 12 | 6 | 6 | 17 | 4 | 13 |
| Sarandë | 43 | 30 | 13 | 49 | 18 | 31 |
| Skrapar | 10 | 8 | 2 | 17 | 8 | 9 |
| Shkodër | 134 | 89 | 45 | 160 | 113 | 47 |
| Tepelenë | 25 | 3 | 22 | 24 | 14 | 10 |
| Tiranë | 345 | 298 | 47 | 375 | 338 | 37 |
| Tropojë | 18 | 3 | 15 | 18 | 5 | 13 |
| Vlorë | 124 | 70 | 54 | 137 | 92 | 45 |

Pasqyra 'Nr. 4

Numri i shkurorëzimeve për 1000 banorë

| Rrethet | 1970 | | | 1975 | | |
|-------------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| | Gjithsej | Qytetarë | Fshatarë | Gjithsej | Qytetarë | Fshatarë |
| Gjithsej | 0,7 | 1,4 | 0,4 | 0,7 | 1,5 | 0,4 |
| Berat | 0,8 | 1,0 | 0,8 | 0,7 | 1,4 | 0,2 |
| Dibër | 0,4 | 1,1 | 0,3 | 0,4 | 0,9 | 0,3 |
| Durrës | 0,8 | 1,3 | 0,5 | 0,8 | 1,4 | 0,4 |
| Elbasan | 0,7 | 1,2 | 0,5 | 0,8 | 1,5 | 0,4 |
| Fier | 0,7 | 1,1 | 0,5 | 0,6 | 1,0 | 0,5 |
| Gramsh | 0,6 | 0,6 | 0,6 | 0,7 | 2,1 | 0,4 |
| Gjirokastër | 0,6 | 0,6 | 0,6 | 0,6 | 1,0 | 0,4 |
| Kolonjë | 0,2 | 0,4 | 0,1 | 0,4 | 0,6 | 0,4 |
| Korçë | 0,9 | 1,4 | 0,7 | 0,9 | 1,5 | 0,7 |
| Krujë | 0,5 | 0,6 | 0,2 | 0,6 | 1,3 | 0,3 |
| Kukës | 0,2 | 0,3 | 0,2 | 0,2 | 0,9 | 0,1 |
| Lezhë | 0,5 | 1,0 | 0,4 | 0,4 | 1,1 | 0,2 |
| Librazhd | 0,5 | 0,7 | 0,4 | 0,3 | 0,9 | 0,3 |
| Lushnjë | 0,7 | 1,5 | 0,4 | 0,7 | 1,0 | 0,7 |
| Mat | 0,2 | 1,1 | 0,2 | 0,3 | 1,2 | 0,2 |
| Mirditë | 0,4 | 0,9 | — | 0,5 | 1,3 | 0,3 |
| Përmet | 0,4 | 1,1 | 0,3 | 0,4 | 1,0 | 0,3 |
| Pogradec | 0,5 | 1,2 | 0,3 | 0,7 | 1,7 | 0,4 |
| Pukë | 0,4 | 1,6 | 0,2 | 0,5 | 0,9 | 0,4 |
| Sarandë | 0,7 | 2,0 | 0,3 | 0,7 | 1,0 | 0,6 |
| Skrapar | 0,3 | 1,3 | 0,1 | 0,5 | 0,8 | 0,3 |
| Shkodër | 0,8 | 1,7 | 0,4 | 0,9 | 1,9 | 0,4 |
| Tiranë | 1,4 | 1,9 | 0,6 | 1,4 | 1,9 | 0,4 |
| Tropoje | 0,6 | 1,0 | 0,6 | 0,5 | 1,3 | 0,4 |
| Vlorë | 1,0 | 1,2 | 0,8 | 0,9 | 1,4 | 0,5 |

Duke iu referuar pasqyrave 3 dhe 4, mund të bëjmë këtë grupim të shkurorëzimeve sipas rretheve:

Në grupin e parë hyjnë ato rrethe ku, në përgjithësi, zhvillimi i fshatit është më përparrë dhe ndryshimi në mes të fshatit e qytetit është më i vogël. Si rrjedhim, edhe familjet e këtyre zonave janë më të emancipuara se familjet e fshatrave të zonave të tjera. Në rrethin e Gjirokastrës nga 34 dhe 35 zgjidhje martese që janë bërë respektivisht në vitet 1970 dhe 1975, 22 dhe 15 i përkasin fshatit kundrejt 12 dhe 20 të qytetit; në Korçë nga 154 dhe 196 zgjidhje martese, 79 dhe 81 i përkasin fshatit kundrejt 75 dhe 88 të qytetit. Dhe duke ndjekur pasqyrën 3 në këtë grup kemi vënë edhe rrethet: Fier, Vlorë, Kolonjë, Berat, Lushnjë dhe Sarandë.

Në grupin e dytë janë përfshirë ato rrethe ku raporti i zgjidhjes së martesave është më i madh në qytete sesa në fshatra. Mendojmë se ky ndryshim rrjedh nga një prapambetje më e madhe e fshatrave të këtyre rretheve. Sipas pasqyrës 3 shohim se në rrethin e Shkodrës nga 134 dhe 160 zgjidhje martese për vitet 1970 dhe 1975, 89 dhe 113 i përkasin qytetit ndërsa fshatit 45 dhe 47; në rrethin e Tiranës nga 345 dhe 375 zgjidhje martese, 298 dhe 338 janë kësia më qytet dhe 47



e 37 në fshat; në rrëthim e Durrësit nga 154 dhe 163 zgjidhje martese, 98 dhe 119 u përkasin qytetit dhe 47 dhe 44 fshatit. Rrethe të tjera që mund të hyjnë në këtë grup janë edhe Elbasani, Përmeti, Pogradeci.

Në grupin e tretë përfshihen ato rrethe me qendra qyteti të vogla, ku shumicën e popullsisë së qendrës e bëjnë fshatarë të zbritur në qytet, ose banorë të ardhur nga rrethe të tjera të Republikës. Rrethe të tilla janë p.sh. Tropoja, Kukësi, Puka, Dibra, Lezha, Mirdita, Mati, Kruja, Librazhdi, Gramshi, Skrapari, Tepelena. Sipas pasqyrave 3 dhe 4 shihet se në këto rrethe numri i përgjithshëm i zgjidhjes së martesave për 1000 frymë të popullsisë është i vogël. Gjithashtu raporti i zgjidhjes së martesave qytet-fshat anon në mënyrë të konsiderueshme nga qyteti. Ky ndryshim vjen sepse në fshatrat e këtyre rretheve zakonet prapanike në fushën e marrëdhënieve martesore, me gjithë luftën e madhe që ka bërë Partia dhe organizatat e tjera të masave, paraqiten më të forta dhe nga ana tjetër ushtrimi i së drejtës për të kërkuar zgjidhen e martesës është në një shkallë më të ulët.

Në një vështrim tërësor që mund t'i bëhet materialit tonë dne të dhënavë të ndryshme statistikore, pavarësisht nga ndarja që u bëmë rretheve në tri grupe, duke hyrë në karakteristikat e veçanta të krahinave dhe zonave të ndryshme, vëmë re se, në përgjithësi, në zonat ku ndikimi i fesë islamë ka qenë i madh, numri i martesave të zgjidhura është më i lartë. Kështu p.sh. duke bërë krahasim në mes dy rrethesh ku shumica e popullsisë ka qenë e besimit mysliman dhe tjetri i besimit katolik, me një zhvillim ekonomik e shoqëror pak a shumë të barabartë siç janë Dibra dhe Mirdita, për vitet 1960, 1970 dhe 1975 kemi këto të dhëna: Për Dibrën respektivisht për vitet e sipërme janë bërë 28,42 dhe 45 zgjidhje martese, ndërsa për Mirditën janë bërë 3,12 dhe 16. Megjithëse në të dy rrethet numri i zgjidhjes së martesave është i vogël, në zonat e ish-besimit mysliman është më i lartë.

Duke u kthyer përsëri në të dhënat statistikore, shohim se në vendin tonë, kemi një numër të vogël martesash të zgjidhura, pavarësisht se në dhjetëvjeçarin 1966-1975 vihet re një rritje e numrit të zgjidhjeve të martesës. Sasia e vogël e ndarjeve, veçanërisht në dy dhjetëvjeçarët e parë 1946-1955 dhe 1956-1965, është rezultat i dy faktoreve me natyrë të kundërt. Nga njëra anë ky proces është rezultat i prapambetjes së marrëdhënieve martesore familjare që vihet re në ambiente të caktuara sociale, sidomos në fshat dhe, që e kufizon përdorimin e së drejtës për të kërkuar zgjidhjen e martesës e nga ana tjetër, ky proces është rezultat edhe i kushteve të reja social-ekonomike të socializmit, sidomos i politikës së drejtë të ndjekur nga Partia që synon në forcimin e familjes dhe në pastrimin e jetës së saj, gjë që përsëri e kufizon numrin e zgjidhjes së martesave⁵⁰. Kjo është më e dukshme veçanërisht në dhjetëvjeçarin 1966-1975. Prandaj del detyrë për të bërë një luftë më këmbëngulëse kundër mbeturinave që pengojnë lidhjet e reja martesore, duke fuqizuar kështu martesat që lidhen në baza të shëndosha dhe që i përgjigjen realitetit tonë socialist.

PPSH, duke u udhëhequr nga teoria marksiste-leniniste, e ka bërë të qartë politikën që duhet të ndiqet për zgjidhjen e martesës. Partia

50) «Materializmi dialektik dhe historik», Tiranë 1974, f. 523-524.

51) F. Engels, «Origjina e familjes, e pronës private dhe shtetit», Tiranë 1970, f. 122.

është shprehur e shprehët kundër së ashtuquajturës teori e «dashurisë së lirë» që predikon lirinë absolute të divorcit, që aq shumë është përhapur në vendet borgjeze e revizioniste. Sipas kësaj teorie njeriu, gjersa ka të drejtë për lumturi në jetë, duhet të jetë i lirë ta lidhë e ta zgjidhë martesën kur të dojë e sa herë të dojë. Shoqëria jonë socialiste nuk mund të lejojë arbitraritet në zgjidhjen e martesës, sepse kjo ka të bëjë me interesha shumë të rëndësishme shoqërore. Engelsi thoshte se «duhen shpëtuar njerëzit nga bredhja nëpër llumin e panevojshëm të një procesi për ndarje»⁵¹.

Liria e vërtetë e martesës, sipas marksizëm-leninizmit, nuk ka asnjë të përbashkët me qëndrimin mendjelehtë ndaj saj, me të drejtën për ta zgjidhur martesën edhe për shkakun më të vogël. Shoqëria jonë është për një qëndrim serioz e të ndërgjegjshëm ndaj martesës, në kuptimin e domosdoshmërisë shoqërore për lidhje të fortë e të qëndrueshme familjare në interes të edukimit të brezit të ri, të lumturisë së familjes. Prandaj klasikët e marksizëm-leninizmit kanë argumentuar domosdoshmërinë e rregullimit shoqëror-shtetëror të martesës e të zgjidhjes së saj dhe kanë kundërshtuar për kushtet e socializmit, lirinë absolute të zgjidhjes së martesës. «Askush nuk është i detyruar të lidhë martesën, — thoshte Marks, — por secili duhet të detyrohet t'u nënshtrohet ligjeve të martesës»⁵².

PPSH, duke luftuar kundër shfaqjeve të liberalizmit borgjezo-revisionist, ka zhvilluar e po zhvillon një luftë të ashpër edhe kundër shfaqjeve të konservatorizmit, që shprehën kundër zgjidhjes së martesës. Në shoqërinë socialiste liria e martesës shoqërohet edhe me të drejtën e zgjidhjes së saj. V.I. Lenini i quante obskurantiste pikëpamjet e atyre njerëzve që e konsideronin të drejtën e ndarjes si burim të dobësimit të familjes. «Reaksionarët, — thoshte Lenini, — janë kundër lirisë së shkurorëzimit. Ata dëshmojnë që të përdoret me kujdes dhe thérresin se shkurorëzim do të thotë «shkatërrim i familjes». Kurse demokracia mendon. . . . se në të vërtetë liri e shkurorëzimit nuk do të thotë aspak «shkatërrim» i lidhjeve familjare, por vërkundrazi forcimi i tyre mbi baza demokratike që janë të vetmet baza të mundshme dhe të qëndrueshme në një shoqëri të qytetëruar»⁵³.» Pra në shoqërinë tonë socialiste e drejta e zgjidhjes së martesës siguron kushte për forcimin e familjes, për zhvillimin e barazisë midis burrit e gruas. Dhe duke u nisur nga kjo dhe nga puna e madhe sqaruese që ka bërë e po bën Partia lidhur me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të zgjidhjes së martesës, në vendin tonë, veçanërisht në dhjetëvjeçarin 1966-1975, kemi njëfarë rritjeje të numrit të martesave të zgjidhura.

Pa dyshim një nga faktorët kryesorë që ka ushtruar një ndikim të mëtejshëm në shtimin e numrit të përgjithshëm të zgjidhjeve të martesës, ka qenë fitimi i pavarësisë ekonomike të gruas nga burri dhe e fëmijëve të rritur nga prindërit. Rritja e pavarësisë ekonomike, veçanërisht për gruan, ka dhënë mundësi për t'u realizuar e drejta e barabartë, si për të vendosur lidhjet e martesës, ashtu edhe për të kërkuar zgjidhjen e saj. Duke iu referuar të dhënavë statistikore, shohim se nga viti në vit kemi një rritje të numrit të padive të ngritura nga

52) K. Marks, F. Engels, *Veprat*, vëll. 1, f. 169.

53) V. I. Lenin, *Veprat*, vëll. 20, Tiranë 1964, f. 2.

gratë. Kjo tregon se vetëdija e grave për të përdorur këtë të drejtë po rritet. Në pasqyrën 5 kemi paraqitur martesat e zgjidhura mbi paditë e grave dhe të burrave.

Pasqyra Nr. 5

| Viti | Nr. i zgjidhjes së martesave | Padi të ngritura nga: | |
|------|------------------------------|-----------------------|--------|
| | | Burri | Gruaja |
| 1950 | 976 | 509 | 467 |
| 1951 | 1114 | 591 | 523 |
| 1955 | 1057 | 495 | 562 |
| 1956 | 957 | 309 | 207 |
| 1960 | 850 | 418 | 432 |
| 1961 | 1314 | 648 | 666 |
| 1965 | 1041 | 524 | 517 |
| 1966 | 1217 | 593 | 624 |
| 1970 | 1625 | 785 | 840 |
| 1971 | 1758 | 801 | 957 |
| 1975 | 1853 | 870 | 983 |

Rritja që vihet re në zgjidhjen e martesave përfaqëson luftën e madhe të Partisë kundër gjithë koncepteve dhe zakoneve prapanike në fushën e marrëdhënieve familjare, luftën për emancipimin e plotë të gruas dhe për ushtrimin e së drejtës së zgjidhjes së martesës nga ana e saj.

Pa rënë në pozitat e përkrahjes së pikëpamjeve liberale mbi zgjidhjen e martesës, mendojmë se rritja e numrit të padive të ngritura nga ana e grave përfaqëson një dukuri pozitive. Ajo dëshmon për ngritjen e vetëdijes së grave të pavarura politikisht dhe ekonomikisht, për luftën e drejtë e parimore që bëjnë ato kundër të gjitha mbeturinave, që i pengojnë për të kërkuar zgjidhjen e martesës.

Gjithashtu vlen të theksojmë se gruaja, në kërkësën e saj për zgjidhjen e martesës, ka qenë më e matur. Këtë e tregon edhe pasqyra 6.

Pasqyra Nr. 6

| Viti | Nr. i zgjidhjes së martesës. | Për faj të burrit | Për faj të gruas | Për faj të të dy palëve | Për faj të asnjërit |
|------|------------------------------|-------------------|------------------|-------------------------|---------------------|
| 1950 | 976 | 287 | 265 | 292 | 132 |
| 1951 | 1114 | 401 | 296 | 263 | 154 |
| 1955 | 1057 | 336 | 251 | 330 | 110 |
| 1956 | 957 | 309 | 207 | 348 | 93 |
| 1960 | 850 | 281 | 215 | 350 | 54 |
| 1961 | 1314 | 340 | 260 | 653 | 61 |
| 1965 | 1041 | 291 | 262 | 431 | 57 |
| 1966 | 1217 | 309 | 291 | 548 | 69 |
| 1970 | 1625 | 729 | 350 | 345 | 199 |
| 1971 | 1758 | 791 | 428 | 357 | 192 |
| 1975 | 1853 | 797 | 532 | 407 | 117 |

Duke analizuar këtë pasqyrë, vëmë re se në të gjitha vitet e marranë shqyrtim numri i zgjidhjes së martesave përfaj të gruas është më i vogël se ai përfaj të burrit. Përveç kësaj shumë martesa janë zgjedhur edhe përfaj të të dy palëve ose të asnjërit.

Shoqëria jonë ka për detyrë dhe përpinqet të mënjanjojë në një masë të madhe zgjidhjen e martesave, sidomos të atyre që lindin nga motive të paqëndrueshme. Nga ana tjetër shoqëria është e interesuar të zgjidhë të gjitha ato martesa që në të vërtetë kanë humbur funksionin e tyre shoqëror. Prandaj është e domosdoshme që të zbulohen shkaket kryesore që cojnë ose jo në zgjidhjen e martesës.

Duke njojur veçoritë krahinore të vendit tonë, sidomos ndikimi i fe së dëshirave të tjerë, e fesojnë që jetesës dhe në zakonet familjare, arrijmë në përfundim se në zonat ku deri në prag të Çlirimt zhvillimi ekonomik e shoqëror i tyre ka qenë më prapa se shumë krahina të tjera, ku problemet e ndryshme familjare zgjidheshin sipas së drejtës zakonore etj., vihet re një konservatorizëm më i madh në zgjide dhjen e martesave. Por edhe brenda krahinave vihen re ndryshime të pullsi të ish-besimit mysliman numri i zgjidhjes së martesave është më i lartë. Të japim vetëm një shembull: Sipas të dhënave që kemi përvitin 1965 nga 1041 martesa të zgjidhura, 1640 ishin persona të ish-besimit mysliman, 366 të ish-besimit ortodoks dhe vetëm 76 të ish-besimit katolik. Sigurisht këtu duhet pasur parasysh edhe numri më i madh i banorëve të ish-besimit mysliman në vendin tonë, megjithatë edhe në raport me këtë ndarjet në banorët e ish-besimit mysliman ishin më të shumta.

Një element i rëndësishëm i së drejtës zakonore shqiptare, që ka ndikuar negativisht në përdorimin e së drejtës së gruas për të kërkuar zgjjidhjen e martesës ka qenë koncepti i inferioritetit të gruas, nën-vleftësimi i aftësive të saj. Këtu e ka rrënjen edhe mentaliteti se «burri është burrë» dhe se ai ka shumë të drejta mbi gruan. Mendimi i inferioritetit të gruas ndaj burrit është përvetësuar edhe nga vetë gratë. Sikurse e ka vënë në dukje shoku Enver Hoxha, kjo ndodh sepse «gruaja ka frikë nga divorci... se po e ndau burri gruan, ajo hyri automatikisht në atë kategori grash që për t'u rirmartuar gjejnë burrë me zor, ose nuk gjejnë dot fare, kurse burri gjen gruan me lehtësi»⁵⁴. Kjo është një nga arsyet e shumta, por të rëndësishme, që gruaja, pa e ditur dhe pa e arsyetuar, i nënshtrohet këtij ligji që nuk është askund i shkruar, por që është e vështirë për t'u zhdukur. Në të vërtetë harmonia dhe uniteti i familjes janë elemente bazë për marrëdhënie të mira bashkëshortore, por ato nuk forcohen duke iu nënshtruar paragjykimeve dhe zakoneve prapanike, të familjes ndaj burrit, por duke i luftuar ato me guxim. Prandaj, thotë shoku Enver «... duhet që vetë gratë të bëjnë një kthesë të madhe, sepse ... aktualisht nuk ka më vend frika e gruas ndaj burrit, frikë që e kishte burimin në skllavërimin ekonomik, se mos mbetej pa bukë, ose në skllavërimin moral, se mos e ndante dhe e linte të turpëruar para shoqërisë»⁵⁵. Dhe në këtë drejtim, siç e pamë në pasqyrën 5, nga viti në vit janë bërë ndryshime të dukshme.

⁵⁴⁾ E. Hoxha, *Mbi problemin e gruas*, f. 182.

55) *Po aty*, f. 233.

Të shohim tani cilët kanë qenë faktorët kryesorë që kanë çuar në zgjidhjen e martesave.

Një nga faktorët kryesorë që ka sjellë tronditjen e marrëdhënieve bashkëshortore ka qenë mosnjohja e thellë e të rinxjeve para se të lidhej martesa. Dhe kjo të bie më tepër në sy në ato krahina ku shumica e martesave janë lidhur me shkuesi, pa u njohur fare të rinxjtë me njëri-tjetrin. Sigurisht në krahina të tilla, sundimi patriarkal i prindërve ndaj fëmijës dhe sidomos koncepti prapanik i së drejtës së prindërve për të vendosur mbi martesën e fëmijëve të tyre, veçanërisht mbi fatin e vajzave, ka qenë më i theksuar. Madje edhe tani nuk janë të rralla rastet që të rinxjtë përfundojnë në martesë, vetëm për tu mos u prishur qejfin prindërve.

Faktor tjetër që ka ndikuar në zgjidhjen e martesave ka qenë edhe botëkuptimi patriarkal i burrit mbi pozitën e gruas në familje e shoqëri. Meqë burri në të kaluarën gjëzonte të drejtën e pronës ndërsa gruaja nuk kishte asnje bazë ekonomike, ajo ishte e detyruar t'i nënshtrohej burrit. Ky mendim është i përcjellë deri në kohën tonë dhe, me gjithë ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur, prapë gjenden burra, që keqtrajtojnë gruan, nënçmojnë aftësitë e saj dhe, në rastet kur hasin në kundërshtim, zgjidhin martesën. Por në anë tjetër edhe gruaja, duke kuptuar drejt liritë e saj, kur ndeshet me mendime të tilla patriarkale dhe jeta i bëhet e padurueshme, kërkon vetë zgjidhjen e martesës.

Edhe menjëra patriarkale e jetesës në familjen e burrit është një nga faktorët që ndikon në prishjen e familjes. Kjo vihet re më shumë në familjet ku jetohet së bashku me prindërit, me vëllezërit dhe me motrat e pamartuara të burrit, të cilët e shikojnë nusen si njeri të huaj në familje, që duhet tu nënshrohet të gjitha kërkessave të tyre.

Arsye tjetër që ka shkaktuar tronditjen e marrëdhënieve bashkëshortore ka qenë edhe veprimi i zakoneve prapanike lidhur me plotësimin e detyrimeve të dhëndrit ose të nuses për pajë. Në shumicën e këtyre rasteve martesa zgjidhet pa u konsumuar.

Sigurisht faktorët e mësipërm nuk janë të vetmit, sepse në tronditjen e marrëdhënieve bashkëshortore ndikojnë edhe faktorë të tjera si diferenca e theksuar e moshës midis burrit e gruas etj.

Duke përbledhur sa thamë më sipër, konstatojmë se në vendin tonë marrëdhëniet familjare e martesore ndërtohen mbi baza të shëndosha. Masat punonjëse, duke studiuar e përvetësuar materialet e Partisë e mësimet e shokut Enver, kanë krijuar një koncept të qarië për familjen dhe martesën. Këtë gjë e tregon edhe kuptimi i drejtë që ka marrë te ne zgjidhja e martesës.

Zgjidhja e martesës është një e drejtë e madhe, por shoqëria jonë, sipas mësimive marksiste-leniniste të Partisë sonë, lufton në të dy krahët si kundër konservatorizmit, ashtu edhe kundër liberalizmit borgjezo-revisionist. Shoqëria nuk qëndron indiferente ndaj atyre familjeve që e kanë humbur funksionin e tyre shoqëror dhe, për shkak të forcës së zakonit, nuk kërkojnë zgjidhjen e një martese të tillë; në anë tjetër martesën për tekat e tyre prej mëndjelehti. Prandaj, duke i njohur mirë të rëndësishme të marrëdhënieve shoqërore, do të bëjmë që lufta jonë për krijimin dhe forcimin e familjes socialiste të ketë sukses.

Mark KRASNIQI
(PRISHTINË)

FAMILJA E MADHE PATRIARKALE SHQIPTARE NË KOSOVË*

Familja e madhe patriarkale i ka interesuar shkencës botërore si-domos gjatë shekullit XIX, por edhe në dhjetëvjetëshat e parë të shekullit tonë, si një formë shumë karakteristike e bashkimit të njerëzve që rrjedhin nga një paraardhës i tyre i përbashkët. Në kohët e fundit, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, shkencat shoqërore po i kushtojnë kujdes të madh studimit të gjithanshëm të njeriut si individ, por një kujdes i posaçëm po i kushtohet në këtë pikëpamje jetës shoqërore e ekonomike të bashkësive të vogla e më të mëdha të njerëzve, duke filluar nga familja, vendbanimet, regjionet e deri te krahinat më të mëdha, të hapësirave më të gjera gjeografike dhe të grupeve etnike. Në kuadrin e këtyre studimeve i është kushtuar kujdes edhe familjes së madhe patriarkale. Por, në shumicën e vendeve të Evropës për këtë mund të flitet vetëm si për një institucion që i takon së kaluarës, kështu që nuk mund të trajtohet si një problem i shoqërisë bashkëkohore. Ndër popujt jugosllavë, në mes të të cilëve familja e madhe patriarkale deri nga fundi i shekullit të kaluar ka qenë mjaft prezente, sot vetëm aty-këtu i gjejmë rudimentet e saj. Përkundrazi, pakica kombëtare shqiptare në Jugosllavi edhe sot ka një numër shumë të madh familjesh të mëdha patriarkale. Ato, në disa raste, përbëhen edhe nga më se 80 pjesëtarë, kështu që paraqesin një problem në vete në studimin e jetës shoqërore të këtij grupi etnik në Jugosllavi. Ky institucion patriarkal, që ndër shqiptarët është ruajtur deri më sot me një freski të rrallë, paraqet një interes të madh për shkencën në përgjithësi.

Me këtë rast do të merremi me shqyrtimin e funksionit shoqëror-historik dhe ekonomik të familjes së madhe patriarkale vetëm në Krahinën e Kosovës, ku ajo paraqitet me një numër të madh. Organizimi i saj i brendshëm dhe roli në jetën shoqërore i kësaj është kryesisht njësoj me familjen e tillë shqiptare në Maqedoni e në Mal të Zi. Kjo në këtë Krahinë deri më sot nuk është studiuar si një problem i tërësisë, por janë botuar vetëm disa të dhëna fragmentare të disa udhë-përshkruesve ose hulumtuesve dhe disa përshkrime etnografike të disa

*) Ky studim është marrë nga: «Gjurmë e gjurmime» (Prishtinë 1979) i të njëjtë autor. Botohet me shkurtim.

familjeve të mëdha patriarkale në Rrafshin e Dukagjinit¹. Vrojtimet tona për familjen e madhe shqiptare po i paraqesim këtu, në bazë të materialit të mbledhur nga terreni në Krahinën Autonome të Kosovës kohë pas kohe, prej vitit 1950 deri në fund të vitit 1959. Me këtë rast po shfrytëzojmë edhe përvojën personale nga koha e mëparshme dhe nga fëmijëria e kaluar në një familje të këtillë më të vogël në një katund të Rrafshit të Dukagjinit, afër Pejës.

Jemi të mendimit se studimi i këtij problemi në këtë terren nuk do të ishte vetëm një kontribut shkencor, por do të mund të kontribuonte edhe për zgjidhjen e disa problemeve praktike në jetën shoqërore. Sipas të dhënave statistikore të vitit 1948, në këtë Krahinë ka pasur më se 5230 familje me nga 15 e më shumë pjesëtarë.

ORIGJINA, SHTRIRJA GJEOGRAFIKE DHE LLOJET E FAMILJEVE TË MËDHA

Në literaturën shkencore është diskutuar për një kohë të gjatë për origjinën dhe shtrirjen gjeografike të familjes së madhe patriarkale, prandaj ka pasur mendime e supozime të ndryshme e të kundërta, sidomos përsa i përket çështjes së përhapjes së saj gjeografike, kështu që shpeshherë ky institucion patriarchal është përcaktuar vetëm në mesin e disa popujve dhe regjioneve gjeografike. Por, ky problem është sraquar më vonë, sidomos pas botimit të librit të Engelsit për origjinën e familjes, në të cilin vihet në dukje, përvëç të tjerash, se familjet e mëdha patriarkale kanë ekzistuar shumë kohë më parë ndër popuj të ndryshëm antikë, grekë, romakë, gjermanë etj. Engelsi thotë se familja patriarkale është një shkallë kaluese ndërmjet familjes matriarkale, që ka dalë nga martesa në grupe, dhe familjes së ngushtë. Familja bashkëkohore ka në thelbin e saj jo vetëm skllavërimin (servitus), por edhe bujkrobërinë, sepse ajo qysh nga fillimi ka të bëjë me detyrat në bujqësi. Ajo përbanë në vëtvete, në miniatyrë, të gjitha ato kundërthënie që më vonë do të zhvillohen plotësisht në shoqëri dhe në shtetin e saj². Familja e madhe në realitet është bashkësi gjaku e lidhur me origjinën, jetën dhe pasurinë e përbashkët³. Hulumtimet e shumanshme të këtij problemi kanë treguar se familja e madhe patriarkale ekziston ndër shumë popuj arianë e joarianë, prandaj nuk mund të merret si një karakteristikë e posaçme e një populli ose e një fisi⁴. Qëndrimi e zhvillimi i familjes së madhe patriarkale ka lidhje të ngushtë me sistemin ekonomik të një shteti, i cili mund ta përkrahë ose

1) Jovan Cvijić, *Balkansko Poluostrvo*, I, Zagreb 1922, 262; T. Stanković, *Putne beleške po Staroj Srbiji 1871-1898*, Beograd 1910, 145; M. Bajraktorović, «Zbornik radova Etnografskog instituta SAN», I, Beograd 1950, 197; Po ai: «Glasnik Muzeja Kosova i Metohije», I, Priština 1956, 278; M. Krasniqi, *Organizimi i jetës shoqërore në një familje të madhe në rrëthin e Pejës*, «Përparimi», nr. 5, Prishtinë 1959, 303-312; revista «Duga», 8.II.1959, Beograd.

2) F. Engels, «Porijeklo porodice, privatnog vlasništva i države», Zagreb 1950, 59.

3) B. M. Nedeljković, «Istorijske bavštinske svojine u novoj Srbiji od kraja XVIII veka do 1931», Beograd 1936, 55.

4) G. Cohn, «Gemeinderschaft und Hausgenossenschaft», Sipas «Glasnik Zemaljog muzeja Bosne i Hercegovine», XXXIII-XXXIV, Sarajevo 1922, 75.

të marrë qëndrim jo të volitshëm ndaj saj, por kjo ka lidhje edhe me botëkuptimin kulturor, moral e juridik të një populli⁵.

Familja e madhe patriarkale ka qëndruar për një kohë të gjatë gati ndër të gjithë popujt e Ballkanit deri në fund të shekullit të kaluar⁶, madje edhe më tej. Ndër bullgarët përmenden disa lloje të familjeve të mëdha patriarkale⁷, ndërsa ndër serbët, malazezëtë kroatët e myslimanët e Bosnjës numri i tyre ka qenë mjaft i madh. Cvijiqi thotë se kjo formë e jetës familjare nuk ekziston ndër turq cincarë e grekë⁸. Familja e madhe patriarkale përmendet ndër shqiptarët qysh në mesjetë: familja e njohur bujare e Dukagjinëve, që ka jetuar, siç dihet, edhe në Rrafshin e Dukagjininit, përmendet qysh më 1281 si familje e madhe patriarkale, e cila është rritur, kështu që ka formuar një vëllazëri të tërë. Kjo familje e madhe e Dukagjinëve (prej së cilës ka qenë edhe ligjvënësi i njohur Lekë Dukagjini) quhej edhe «shtëpia e fortë»⁹.

Të dhënat nga e kaluara e afërme tregojnë se familja e madhe ka luajtur rol të rëndësishëm në jetën shoqërore edhe në disa vise që ku-fizohen me Krahinën e Kosovës, ose janë në afërsinë e saj. Sipas re-gjistrimit të vitit 1890, në Kroaci e Slloveni ka pasur 219 familje të mëdha me nga më se 30 pjesëtarë, ndërsa 981 me nga 26 deri 30 pjesëtarë¹⁰. Rovinski shkruan se më 1883 në fisin Vasojeviq të Malit të Zi çdo familje (shtëpi) kishte mesatarisht 6,32 pjesëtarë, në fisin Kuç 5,56, ndërsa në fshatrat shqiptare në rrëthinan e Ulqinit në 133 shtëpi ka pasur 886 banorë, d.m.th. 6,66 pjesëtarë për shtëpi. Në Mal të Zi populli ka pasur mendim të mirë për familjet e mëdha, gjë që shihet e�e nga një proverb i tyre: «Shtëpia e madhe — pasuria e madhe, punëtorë shumë — hambarët përplot», ndërsa «shtëpia e vetmuar — shtëpia e varfëruar».»¹¹ Megjithatë, familjet e mëdha në Mal të Zi kanë qenë mjaft të rralla¹² Jovan Cvijiqi ka shënuar se familjet e mëdha serbe janë më të shumta në regjionet që shtrihen në veri të malit të Sharrit, sidomos në disa katunde të Rrafshit të Dukagjinit. Këtij i kanë dërguar informatorët nga terreni të dhëna mjaft të gabuara. në bazë të të cilave ai bën një konkludim jo të saktë se «në shtëpitë serbe jeton numri më i madh i pjesëtarëve sesa në shtëpitë shqiptare, të cilat zakonisht përbëhen nga familjet e vogla»¹³ Cvijiqi shpeshherë edhe vetë shpreh dyshim ndaj të dhënave që ia dërgonin mësuesit e priftërinj-

5) S. Novaković, «Selo, Glas Srpske kraljevske akademije», XXIV, Beograd 1891, 212.

6) V. Bonač, «Tipovi jugoslovenske porodice», Beograd 1957, 31.

7) E. S. Bohčev, *Blgarskata čeljadna zadruga v segašno i minalo vreme*, «Zbornik Blgarske akademije nauk», XXII-XXIII, Sofija 1906-7.

V. Bogićić, «Zbornik sadašnjih pravnih običaja u Južnih Slovena», I Zagreb 1878, 312.

8) J. Cvijić, «Balkansko Poluostrvo», I. Zagreb 1922, 262, 263.

9) M. Šufflay, «Srbi i Arbanasi», Beograd 1925, 123; «Istoriski zapisi», I, sv. 3-4, 176; «Naselja», XV, Beograd 1923, 175.

10) I. Strohal, *Zadruga u Južnih Slovjeni*, «Glasnik Zemaljskog muzeja Bosne i Hercegovine», XXI, Sarajevo, 1909, 215.

11) P. Rovinski, «Cernogorija», Sanktpeterburg 1897, 191-195.

12) V. Bogićić, «O obliku nazvanom inokoština u seoskoj porodici Srba i Hrvata», Beograd 1884, 35.

13) J. Cvijić, «Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije», Beograd 1911, 1172.

të, në librin e tretë të veprës së tij të njojur «Bazat për gjeografi e gjeologji të Maqedonisë e Serbisë së Vjetër». Por, deri në pragun e Luftës së Dytë Botërore, në këtë Krahinë, sidomos në Siriniq, në Sreckë e në Podgurin e Pejës kanë ekzistuar disa familje të mëdha serbe, ndërsa disa më të vogla mund të gjenden edhe sot¹⁴.

Siq shihet, bashkësitë e mëdha familjare janë ruajtur kryesisht në regjione më të varfër të territorit të Jugosllavisë. Këto bashkësi, me mënyrën e tyre të posaçme të prodhimit, e cila edhe sot i mbani disa tipare të marrëdhënieve në prodhim të bashkësisë së lashtë, me organizimin e posaçëm ekonomik e me zakone të veçanta, kanë ndikuar në popullsinë në mesin e së cilës kanë qëndruar. Në Jugosllavinë e paraluftës ka pasur 114 000 familje fshatare me nga 11 e më shumë pjesëtarë. Në Bosnje, Hercegovinë, në Mal të Zi, në Serbi e në Maqedoni gjendet një numër i madh familjesh me shumë pjesëtarë¹⁵.

Shumë hulumtues që kanë qëndruar në Shqipérinë e Veriut shkrujnë se në këto vise malësorët shpeshherë jetojnë në familje të mëdha, të cilat në disa raste kanë edhe nga 50 pjesëtarë. Tani, thonë ata, familjet e tillë janë shumë të rralla¹⁶. Përtej Qafës së Prushit në Shqipëri, në fshatrat Qarr i Madh e Qarr i Vogël deri vonë kanë ekzistuar dy familje të mëdha me nga më se 60 pjesëtarë. Gjithashtu në fshatin Topojan (Shqipëri), në regjionin e Lumës, deri para disa dhjetëvjetëshash, ka qenë familja e madhe Monallar me rreth 100 pjesëtarë. Gjendja e saj ekonomike ka qenë e mirë: ka pasur në rrethin e oborrit 12 ndërtesa banimi, 1500 dele, 30 kuaj, 600 koshere bletësh, një numër të madh gjedhësh etj. Kjo familje është ndarë para Luftës së Dytë Botërore. Një pjesë e saj është vendosur qysh atëherë në Prizren, ku jeton edhe sot (Monallar Osman Haliti, në Muhamxherr-mahallë, prej të cilit i kemi marrë këto të dhëna). Përjashta Kosovës familja e madhe shqiptare është e përhapur në Maqedoni, në Mal të Zi, në Sanxhak (Peshter), pastaj në Jabllanicë të Leskovcit, në rrethinat e Preshevës e të Bujanovcit, por në përmasa më të vogla dhe me më pak pjesëtarë se në Kosovë.

Në krahinën e Kosovës familja e madhe shqiptare është e përhapur në të gjitha viset e saj, kështu që mund të themi se nuk ka fshatku jetojnë shqiptarët, që të mos ketë disa familje të këtilla. Për ta ilustruar dhe dokumentuar këtë punim, do të përmendim vetëm disa familje më të mëdha dhe disa fshatra ku jetojnë ato.

Rrafshi i Dukagjinit, sidomos rrethinat e Pejës e të Gjakovës, pa dyshim sot është regjioni më interesant për sa i përket numrit e mëdhisë së familjeve patriarkale. Këtu disa nga këto kanë më se 80 pjesëtarë, që jetojnë nën një kulm dhe përbëjnë një bashkësi familjare.

14) «Godišen zbornik», I, Skopje 1948, 165; «Glasnik Skopskog naučnog društva», XIV, Skoplje 1935, 212; «Glasnik Etnografskog instituta SAN», VII., Beograd 1958, 109.

15) O. Mandić, *Klasni karakter buržoaskih teorija o postanku zadruge*, «Istorijsko-pravni zbornik», knj 3-4, Sarajevo 1950, 113.

16) K. Stajnmec, «Severna Albanija», I, Skopje 1910 (prevod), 18; A. Jovićević, *Malesija*, «Naselja», knj 15, Beograd 1923, 79; C. S. Coon, «The mountains of giants, a racial and cultural study of the North Albanian mountain Ghëgs», Cambridge, Massachusetts, USA, 1950 (sipas «Glasnik Etnografskog instituta SAN», II-III, Beograd 1957, 1033); A. Boué, «La Turquie d'Europe», II, Paris 1840, 16.

Kështu p.sh., në katundin Gjurakovic (Pejë) jeton familja e madhe Osmanaj, e cila në muajin qershor 1959 (kur e kemi vizituar) ka pasur 85 pjesëtarë. Në krye të kësaj familjeje qëndron i zoti i shtëpisë, Selimi, dhe ndihmësi i tij, Muharremi. Kjo familje ka ardhur më 1900 nga fshati Isniq dhe është vendosur në fshatin Prekallë në Podgurin e Pejës, e më vonë në Gjurakoc; i takon fisis Shalë, si i gjithë katundi Isniq. Gjendja ekonomike e kësaj familjeje është relativisht e mirë: 56 ha tokë (prej së cilës 27 ha pyll), 170 dele e qengja, 53 gjedhë, 3 pendë kuaj e 2 pendë qe; përveç kësaj ka edhe një mulli, në të cilin bluajnë edhe katundarët e tjerë. Po në këtë fshat është familja e madhe Bashori, e cila është ndarë (dekompozuar) para disa vjetësh. Familja Bashori (sot shtëpia e Sokol Gegë Bashorit) në vitin 1955 ka pasur 82 pjesëtarë. Në këtë vit ajo është ndarë në tri pjesë. Ndarja e saj është bërë sipas së drejtës zakonore shqiptare, në bazë të Kanunit të Lekë Dukagjinit, në tri pjesë të njëjtë në tre vëllezër (trashëgimtarë). Arsyet e ndarjes kanë qenë kushtet ekonomike. Me ndarjen e kësaj familjeje të madhe janë krijuar tri familje të reja të mëdha, prej të cilave ajo më e vogla ka 20 pjesëtarë, e mesmja 27, më e madhja 50. Pra, sikur kjo familje të mos ishte ndarë, ajo në qershorin e vitit 1959 (kur e vizituam do t'i kishte 97 pjesëtarë. Familja e Bajram Haxhisë, po nga Gjurakoci, ka 30 pjesëtarë. Këtu ka pasur edhe disa familje më të vogla patriarkale të kombësisë serbe, por ato janë ndarë (dekompozuar); ka mbetur vetëm familja Pejçinoviq me rreth 15 pjesëtarë, e cila ka ardhur këtu nga fshati Petkovice (ndërmjet Malit të Zi e Bosnjës)¹⁷.

Në fshatin Raushiq, afër Pejës, janë disa familje të mëdha patriarkale, ndër të cilat më e madhe është ajo Fetahaj, e cila në janarin e vitit 1959 ka pasur 83 pjesëtarë. Në këtë familje jetojnë 16 çifte bashkëshortore me shumë fëmijë, dy vejusha e një vejan. Familja Fetahaj është me origjinë nga fshati Drezgë afër Gjakovës, me fis Krasniqe, ka 35 ha tokë pjellore, 150 dele, 30 gjedhë, 14 kuaj, prej të cilëve 3 pendë të punës. Zot shtëpie është Sadrija, ndërsa ndihmësi i tij Rrustemi. Organizimi i brendshëm i kësaj familjeje deri diku ndryshon nga ai në familje të tjera të këtij regjioni¹⁸. Familja e Zekë Nimanit, mjeshtër i njobur për gdhendjen artistike të drurit, ka rreth 30 pjesëtarë¹⁹. Në fshatin Loxhë, afër Raushiqit, gjithashtu ka shumë familje të mëdha patriarkale, prej të cilave më e madhe është ajo e Rrustem Ukës me 45 pjesëtarë (1959). Në fshatin Nabërgjan (Pejë) ka qenë familja Pepaj me 80 pjesëtarë, por kjo është ndarë pas Luftës së Dytë Botërore, në tri pjesë. Një pjesë e saj tani është në Shtupelin e Vogël në Rugovë, tjetra ka mbetur në Nabërgjan, ndërsa pjesa e tretë është shpërndarë për në Turqi. Shpërndarja për në Turqi ka qenë arsyeta e ndarjes (dekompozimit) të kësaj familjeje. Familja e Hasan Kocit në fshatin Gllogjan (Pejë) sot nuk është aq e madhe, por në fillimin e shek XX ka pasur 90 pjesëtarë, prej të cilëve «25 meshkuj me 25 manzerre». Në

17) Mbi familjen e madhe Osmanaj nga Gjurakoci (Pejë) ka të dhëna në revistën e ilustruar «Duga», Beograd, 8.III.1959, në revistën «Sociologija» nr. 2, Beograd 1960 dhe në gazeten e përditshme «Politika», Beograd, 1.III.1959.

18) Mark Krasniqi, *Organizimi i jetës shoqërore në një familje të madhe në rrethin e Pejës*, «Përparrim», nr. 5, Prishtinë 1959, 303-312.

19) M. Krasniçi, *Duborez u Metohiji*, «Glasnik Muzeja Kosova i Metohije», knj. III, Priština, 1950, 230.

fshatin Trubhoc (Podguri i Pejës) familja e Ramë Idriz Mehmetajt, me fis Shalë, ka pasur më 1955 më se 30 pjesëtarë, ndërsa në fshatin Radave (afër burimit të Drinit të (Bardhë), ka qenë e njojur familja e Tahir Lush Berdynajt me më se 80 pjesëtarë, që është ndarë para disa vjetësh. Të gjitha këto familje edhe sot, mbas ndarjes, përsëri përbëjnë kolektiva të mëdha familjare.

Vokshi është një tërësi e vogël etnografike, e deri diku edhe gjeografike, në Rrafshin e Dukagjinit, ndërmjet fshatit Deçan e Junik, rrëzë Bjeshkëve të Nemuna. Vokshi përbëhet nga 8 fshatra. Të gjitha këto fshatra përbëhen kryesisht nga familje të mëdha. Në të vërtetë Vokshi është krijuar vetëm nga disa familje të mëdha, që rrjedhin nga një paraardhës i përbashkët. Të gjitha familjet, kuptohet, janë të një fisi: Thaç, e deri vonë kanë pasur edhe kreun e fisit («kreni i Vokshit»), që i zgjidhte ngatërrresat që lindnin ndërmjet pjesëtarëve, në bazë të së drejtës zakonore, ndërsa në kohët e mëparshme ai e përfaqësonte fisin e vet para fiseve të tjera. Vokshi është regjion i varfër; në jetën e tij ekonomike rolin kryesor e ka pasur blegtoria dhe fruta e gështenjës. Secili fshat, përkatësisht secila familje, ka poseduari një pjesë të caktuar të pyllit të madh të gështenjave, që shtrihet aty afër rrëzë Bjeshkëve të Nemuna dhe në shpatet e tyre. Nga numri i madh i familjeve patriarkale të këtij regjioni po cekim vetëm disa, para së gjithash me qëllim që ta ilustrojmë gjendjen e tyre ekonomike, që është më e vështirë nga ajo e familjeve të tjera në Rrafshin e Dukagjinit, ndërsa numri i pjesëtarëve të tyre nuk ka ndonjë rëndësi të posaçme. Në fshatin Prilep familja e Sylë Beqirit ka 35 pjesëtarë, por vetëm 8 ha tokë dhe një numër fare të vogël kafshësh. Po në këtë fshat familja e Smaji Sylës ka 26 pjesëtarë, 7 ha tokë, 50 dele e 13 gjedhë. Në fshatin Pobërgjë familja e Bajram Tahirit ka më se 40 pjesëtarë, por gjendja ekonomike e saj është mjaft e vështirë; familja e Bajram Sejdisë, po nga ky vend, ka 35 pjesëtarë, 3 ha tokë të kualitetit të dobët, vetëm 5 dele, 1 lopë e 1 pendë kuaj²⁰.

Në Deçan dhe në fshatrat përreth tij ekziston një numër i konsiderueshëm familjesh të mëdha patriarkale. Kështu p.sh., familja e Adem Rexhës nga Deçani ka 40 pjesëtarë, 4 ha tokë, 70 dele e 10 gjedhë ndërsa ajo e Salih Rrustës 36 pjesëtarë, 5 ha tokë, 10 gjedhë e 70 dele. Familja e Salih Rrustës është e njojur si shtëpi e «vojvodëve të kishës» së Deçanit, e cila për një kohë të gjatë në të kaluarën, me ndihmën e shqiptarëve nga fshatrat e tjera, e ka ruajtur e mbrojtur këtë monument historik të kulturës.

Në fshatin Shtupel i Madh, në Rugovë, përmbi Pejë, ka jetuar gjithashtu familja e madhe e Zhuj Veselit me më se 50 pjesëtarë. Edhe Rugovës, e ka mbrojtur e ruajtur manastirin e vjetër, patrikanën e Pejës, kështu që disa pjesëtarë të kësaj familjeje, dhe të asaj në Deçan, janë vrarë në të kaluarën, duke i mbrojtur këto manastire nga sulmuesit e ndryshëm²¹.

20) Të dhënët mbi regjionin e Vokshit i kam mbledhur në terren gjatë ko-rrikut 1957.

21) M. Krasniçi, *Manastirske vojvode u Kosovsko-Metohijskoj Oblasti*, «Glasnik Muzeja Kosova i Metohije», III, Priština 1950, 117.

Në rrethin e Gjakovës në të gjitha fshatrat ka familje të mëdha patriarkale. Një prift katolik, Cyril Fabjan, me origjinë slloven nga Novo Mesto, i cili ka shërbyer disa vjet në këtë regjion si famullitar,është interesuar, përvèç të tjerash, edhe për jetën familjare të shqiptarëve katolikë në këtë terren, kështu që ka shënuar një numër të madh familjesh patriarkale. Sipas shënimive të tij për famullinë katolike të Gjakovës, bazuar në regjistrin kishtar «Status animarum», gjendja familjare nga fundi i vitit 1948 ka qenë kështu nëpër fshatra të ndryshme: në fshatin Zhub familja e Mhill Markut ka pasur 42 pjesëtarë, Mark Uka 45, Dedë Pjetri 60, Bekë Hyseni 35, Zejnel Uka 35, etj. Për familjen e Miftar Demës, po nga ky fshat, në shënimet e këtij famullitari (i cili ka vdekur para dhjetë vjetësh) janë këto të dhëna: 60 pjesëtarë, fisi Shkrel (Kelmend), 28 ha tokë (12 000 kg. grurë, 500 kg. misër), 3000 kg. i blen në vit. Ai mandej thotë se në fshatin Vraniq familja e Nikollë Nushit ka 37 pjesëtarë, 16 ha tokë, e në fshatin Guskë familja e Dedë Ndout 39 pjesëtarë. Në fshatin Brekoc familja e Frrok Ndrecës 36, e ajo e Zejnel Ukës 35 pjesëtarë, ndërsa e Mhill Tanushit nga Novosella, fisi Spaç, 31. Sipas një informate indirekte, duket se familja më e madhe në territorin e Jugosllavisë, ndoshta edhe në mbarë Evropën, në vitin 1959, ka qenë ajo e Zhel Hasanit nga fshati Rakoc (Duhkajë, rrathi i Gjakovës), e cila në dhjetorin e këtij viti ka pasur 92 pjesëtarë. Në krye të kësaj familjeje qëndronte i zoti i shtëpisë dhe ndihmësi i tij, ndërsa baçica kishte tri ndihmëse të veta. Një nga veçoritë e kësaj familjeje, me të cilën dallohej nga familjet e tilla të tjera ka qenë çështja e ushqimit të përbashkët. Kështu, këtu nuk ushqeheshin së bashku të gjithë pjesëtarët e saj, por çdo familje e ngushtë (burrë e grua me fëmijët e tyre) merrte ushqimin e veçantë nga kazani i përbashkët. Në kohën e shuejtës (darkë, drekë, mëngjes) çdo grua shkonte në kuzhinë te baçica ku merrte aq porcione, sa pjesëtarë kishte familja e saj e ngushtë. Ushqimin e conte secila në qilerin e vet²²⁾. Ky është, ndoshta, i vetmi rast ndër shqiptarët, sepse ushqimi i përbashkët ka aq shumë rëndësi, saqë, nëse ndonjë nga pjesëtarët e familjes, në zemërim e sipër, e merr nga sofa pjesën e vet të ushqimit dhe skajohet në një anë për të ngrënë vetëm, kjo mjafton për të treguar se ky prej asaj dite nuk dëshiron të jetë më pjesëtar i atij kolektivi familjar. Por kjo familje ka organizuar edhe mënyrën e ndarjes së ushqimit nëpër njësi më të vogla, me qëllim që jeta e përbashkët të funksionojë më mirë.

Në rrethinat e Prizrenit, dhe në viset për qark, ekziston gjithashtu një numër i madh familjesh të mëdha patriarkale.

Në Has është e përmendur familja e Imer Dervishit nga fshati Lipovec, me 60 pjesëtarë; edhe familja e Halil Rexhepit ka gati po kaq pjesëtarë. Në fshatin Pllanejë familja e Sheh Tahir Ramës, fisi Gash, gjithashtu ka rrëth 60 pjesëtarë, 80 dele, 30 lopë e fare pak tokë, e cila në Has edhe ashtu është e kualitetit shumë të dobët; prandaj disa nga pjesëtarët e kësaj familjeje punojnë si bukëpjekës në Podujevë, larg vendlindjes së tyre.

Në Podrime gati në çdo fshat ka familje të mëdha shqiptare. Ato ekzistojnë edhe në qytetën e Podrimes, në Rahovec. Para pak kohe ato kanë qenë më shumë, por edhe tanë, mbas ndarjes së familjeve të

22) Sipas kallëzimit të Nexhat Begollit, profesor nga Peja, dhjetor, 59.

mëdha, ka familje edhe me nga 60 pjesëtarë²³. Një nga familjet më të mëdha ka qenë familja e Kabashit në fshatin Zojqishtë, me 90 pjesëtarë, që është ndarë (dekompozuar) para disa vjetësh. Në fshatin Krushë e Madhe, familja Durakaj ka pasur më 1954 më se 50 pjesëtarë; ajo është ndarë në katër pjesë. Po në këtë fshat familja e Din Bajramit në vitin 1956 ka pasur 56 pjesëtarë; ndërsa, sipas informatave indirekte, në fshatin Mrasor, familja e Shaban Mrasorit ka 70 pjesëtarë²⁴. Afër Prizrenit, në fshatin Hoçë, përvèç të tjerave, ekziston familja e Hazë Pajazit Krasniqit me 32 pjesëtarë (1959). Detyrën e zotit të shtëpisë e kryen Osman Hazëri, por për çdo gjë pyetet babai i tij tetëdhjetëvjeçar Hazëri. Kjo familje ka 6 çifte bashkëshortore, 7 ha tokë, 30 dele e 15 gjedhë.

Në Opojë, në fshatin Blaç, familja e Jashar Daut Blaçit ka 47 pjesëtarë 200 dhen, 12 ha tokë dhe 20 gjedhë (1959). Në fshatin Kapërfamilja e Rizvan Jusufit ka 27 pjesëtarë, 4 ha tokë (prej këtyre 2 ha pyll), 50 dhen, 10 lopë e 2 kuaj. Një pjesë e kësaj familjeje jeton në Prizren (ëmbëltor), e një pjesë tjetër në Haxhiqi afër Sarajevës (rrobaqepës).

Në Podgurin e Prizrenit familjet e mëdha shqiptare gjithashtu paraqiten me numër të madh. Familja më e madhe e më karakteristike e kësaj ane është ajo e Bajram Bujarit (i quajtur edhe Bajram Dula), nga fshati Duhël, mu në qafën e Carralevës, përkatësisht në Qafën e Duhlës, e cila në vitin 1953 (kur e kemi vizituar) ka pasur më se 50 pjesëtarë. Kjo familje është e fisisit Helshan dhe e ka origjinën nga fshati Toplica në Kosovë²⁵.

Në Prekorupë (Llapushë) familja e Sefer Ramadanit ka 50 pjesëtarë, 27 ha, 50 dhen e 22 gjedhë.

Në Drenicë, e cila është një trevë kodrinore midis Rrafshit të Dukagjinit e pllajës së Kosovës, gjithashtu ka një numër të madh familjesh të mëdha. Kështu, p.sh. të tillë janë familja Rrecaj dhe Vojvodët (që e kanë ruajtur kishën e Devicit) nga fshati Llaushë etj.

Në pllajën e Kosovës familjet e mëdha janë shumë më të rralla se në Rrafshin e Dukagjinit. Por edhe këtu ka familje shqiptare me më shumë pjesëtarë. Po jepim disa shembuj nga ky regjion. Në fshatin Pestovë familja e Muhamrem Kasumit ka pasur 20 pjesëtarë e 6 ha tokë (1954); këtu familja Zekolli dikur ka jetuar në bashkësi të madhe familiare, por janë ndarë, kështu që në vitin 1954 nga këto familje të ndara, ajo e Haxhi Metës ka pasur 12 pjesëtarë, ndërsa të tjerat më pak. Po në këtë vit, në fshatin Dobërçan, familja e Jusuf Sadikut ka pasur 18 pjesëtarë, ndërsa në fshatin Sojevë një familje e vogël katolike, në krye të së cilës ishte Gjergj Seba, kishte 11 pjesëtarë. Në fshatin Gra-35 pjesëtarë.

Në rrithinat e Vuçiternës (Vushtrrisë) hulumtuesit kanë shënuar një

23) M. Krasnić, *Orahovac-antropogeografska monografija varošice*, «Glasnik Muzeja Kosova i Metohije», II, Prishtina, 1957, 130.

24) Të dhënat mbi disa familje të mëdha të Podrimës i kam marrë nga arkësimtarët Nijazi Hamza e Halil Jupa nga Rahoveci.

25) M. Krasnić, *Dulje – naselje u Prizrenskom Podgoru*, «Glasnik Etnograf-skog instituta Srpske akademije nauka», I-II, Beograd 1957, 360.

numër të madh familjesh patriarkale shqiptare. Kështu, p.sh. në Sudimën e Poshtme, afër Prokupës, rrëzë Jastrecit: familja e Nazif Deli Rashicës ka pasur 37 pjesëtarë (7 vëllezër të martuar dhe fëmijët e tyre), Shaban Neziri 25 pjesëtarë (Shabani me grua e 5 djem të tij të martuar), Shaban Bajram Rashica me 25 pjesëtarë, Rrahman Rashica me 25 pjesëtarë etj. në fshatin Baralevë (Prokupje): Selim Ibrahim me 38 pjesëtarë, Hazir Hasani 25, Avdullah Suma 28, Hasan Kurti 25, Osman Sulejmani 26; etj. Në fshatin Dubnicë e Poshtme: Azem Gjeka 25, Halil Azemi 24 pjesëtarë etj. Në fshatin Rozhan (mali Kopaonik) Sahit Abazi ka pasur më 1936 një familje të madhe prej 48 pjesëtarësh, fisi Shalë, vëllazëria Malet; nga pasuria kjo kishte 150 dhen, 80 dhi, 50 gjedhë e 15 kuaj²⁶. Në fshatin Bivolak, rrethi i Mitrovicës, familja e Ajet Klimak Krasniqit ka pasur më 1959 37 pjesëtarë e familja e Ajriz Cekë Pronajt nga Stankovci afër Vuçiternës, 39 pjesëtarë. Familje të mëdha patriarkale shqiptare ka gjithashtu edhe në Moravë (rrethinat e Gjilanit) e në rrethinat e Preshevës, por ato janë shumë më të vogla se familjet patriarkale në Rrafshin e Dukagjinit.

LLOJET E FAMILJEVE TË MËDHA SHQIPTARE

Kategorizimi i familjeve të mëdha mund të bëhet në mënyrë të ndryshme, varësisht nga cili aspekt shqyrtohet ky problem. Në shkencë, ndër ne, familja është shqyrtuar e kategorizuar kryesisht nga aspekti i jetës ekonomike dhe rregullimi i saj i brendshëm, d.m.th. a jetojnë të gjithë pjesëtarët e saj së bashku, apo kjo bashkësi është vetëm formale; pastaj ndahen tipa të veçantë të familjeve të bashkuara jo në bazë të gjinisë së gjakut dhe të atyre familjeve që jetojnë të ndara në disa vende, por përbëjnë një bashkësi familjare ekonomike. Kategorizimi i familjes bëhet edhe në bazë të madhësisë së tyre (të numrit të pjesëtarëve), sipas regjioneve gjeografike, konfesionit, strukturës sociale, kcmbësisë, vendit të qëndrimit të përhershëm (familje qytetare e fshatare) etj. Edhe familja e madhe shqiptare mund të përfshihet dhe të ndahet sipas këtyre grupeve dhe në disa të tjera. Mirëpo, me këtë rast, këtu do të vëmë në dukje vetëm disa tipa më karakteristikë të kësaj organizate familjare.

Sipas mënyrës së jetesës dhe punës, familja e madhe shqiptare mund të kategorizohet në disa varietete, gjë që varet shumë nga pozita gjeografike e vendbanimit ku jetojnë këto familje. Familja e madhe shqiptare, para së gjithash, është një bashkësi njerëzish të lidhur me gjini gjaku, që kanë pasuri të përbashkët, në të cilën jetojnë e punojnë së bashku dhe i ndajnë frytet e punës së tyre. Por, të shtrënguar nga kushtet ekonomike, pjesëtarët e familjes shpesherë nuk jetojnë në shtëpinë e përbashkët, të paktën gjatë një pjese të vitit. Kështu ngjan rregullisht me ato familje të mëdha që jetojnë në pjesët periferike të Rrafshit të Dukagjinit, sidomos në perëndim, rrëzë dhe në shpatet e Bjeshtëve të Nemuna. Meqenëse në fshatrat e tyre nuk kanë mjaft kullota, ato gjatë verës dalin me bagëtinë e tyre në bjeshkë. Përveç barinjve, në

26) Të dhënët përfamiljet shqiptare në Kopaonik, rrëzë Jastrecit dhe në rrethinat e Vuçiternës i ka shënuar në terren Radoslav Pavloviq.

bjeshkë dalin shumica e grave dhe të gjithë fëmijët, ndërsa mbesin në fshat për të punuar fushën meshkujt e aftë për punë dhe disa gra. Megjithëse në këtë mënyrë familja ndahet për një kohë, ajo gjithnjë mbetet një bashkësi kompakte, e cila në vjeshtë bashkohet përsëri. Në fshatrat malore, p.sh. në Rugovë, ngjan e kundërta. Barinjtë e Rugovës, pjesëtarë të familjeve të mëdha, shpeshherë zbresin dimrit në Rrafshin e Dukagjinit për të dimëruar me grigjet e tyre, sepse malet e tyre në Rugovë për një kohë të gjatë i mbulon bora dhe u mungon ushqimi për dele. Kjo deri diku u përgjan familjeve nomade, të cilat gjithnjë ndërrojnë vend, për arsy se bagëtia e tyre nuk gjen ushqim për një kohë më të gjatë në fushat e vendbanimit të tyre. Kjo mënyrë e jetësës bën që këto familje të hyjnë në grupin e familjeve përkohësisht të ndara.

Në regionet e brendshme të pllajës së Rrafshit të Dukagjinit dhe në pllajën e Kosovës, fshatarët kanë më pak bagëti sesa fshatarët në periferinë e këtyre, rrëzë Bjeshkëve të Nemuna e në shpatet e maleve të Sharrit. Në këto vise as numri i familjeve të mëdha nuk është aq i madh, siç është rrëzë Bjeshkëve të Nemuna. Nga ana tjetër, deri vonë pjesët e brendshme të Rrafshit të Dukagjinit kanë qenë të mbuluara me pyje të vogla e me ledina. Pas Luftës së Dytë Botërore këto pyje janë prerë dhe në vend të tyre kanë mbjellë hardhi rrushi e fidanë të tjerë. Por fshatarët e këtyre anëve edhe tanë i kullotin bagëtitë e tyre në truallin e fshatit, kështu që nuk kanë nevojë të madhe të dalin me to në bjeshkë. Në këtë mënyrë pjesëtarët e familjeve të mëdha mbesin gjatë gjithë vitit të bashku. Kështu qëndron puna të paktën ndër familje të mëdha në pllajën e Kosovës e në pjesët e brendshme të Rrafshit të Dukagjinit. Në qoftë se familjet e grupit të parë që përmendëm këtu mund t'i krahasojmë me ato që kalojnë një jetë nomade dhe i fuzim në kategorinë e familjeve përkohësisht të ndara, atëherë këto të tjerat mund t'i quajmë familje të përhershme ose të palëvizshme. Kuptohet se të dyja këto nocione këtu janë të përgjithësuara (e gjuhësish jo aq adekuat), sepse edhe në grupin e parë ka familje, pjesëtarët e të cilave kurrë nuk dalin në bjeshkë (sepse nuk kanë shumë kafshë), siç ka edhe të tillë, pjesëtarët e të cilave rregullisht e kalojnë një pjesë të vitit në bjeshkë.

Pas Luftës së Dytë Botërore janë krijuar kushtet që edhe një numër i fshatarëve shqiptarë, që kanë ndonjë shkollë, të merren me ndonjë punë jobujqësore. Në këtë mënyrë është krijuar një lloj i posaçëm i familjeve të mëdha, në të cilat një ose më shumë pjesëtar të saj nuk merren me bujqësi. Ky është një tip i posaçëm i familjes por ky është ende mjaft i rrallë, sepse mundësitet për punë janë të vogla në Krahinën e Kosovës, për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit industrial. Megjithatë, tipi i familjes me profesion të përzier (bujqësi, nëpunësi, industri etj.) është në rritje e sipër, në lidhje me ndërtimin gjithnjë më të madh të industrisë dhe të numrit gjithashtu gjithnjë më të madh të fëmijëve të shkolluar nga fshati.

Familja patriarkale e ndarë është një tip i posaçëm i familjes së madhe. Një pjesë e familjeve të tillë jeton gjithnjë e ndarë nga pjesa tjetër e familjes, zakonisht larg njëra-tjetrës. Ky tip i familjeve të mëdha është krijuar kryesisht nga nevojat ekonomike: kur rritet numri i pjesëtarëve të familjes, dhe ajo nuk është në gjendje t'i mbajë këta nga

fryti i pasurisë që ka, atëherë familjet e tilla blejnë tokë në ndonjë katund tjetër. Atje kalon një pjesë e familjes së madhe, kështu që krijohen dy njësi ekonomike. Mirëpo, megjithatë, të dyja këto pjesë të familjes përbëjnë një kolektiv familjar e ekonomik dhe e kanë të përbashkët të zotin e shtëpisë, i cili shpeshherë e viziton edhe pasurinë e re, ku qëndron një kohë të gjatë. Në të dy pjesët e familjes ky ka zëvendësin e vet. Nëse në pasurinë e re janë kushtet më të mira përmajtjen e bagëtisë, atëherë pjesa më e madhe e saj dërgohet atje, prej kah furnizohen me bulmet të dy pjesët e familjes. Kështu ngjan edhe me prodhimet e tjera bujqësore; ajo pjesë e familjes që prodhon më tepër e furnizon pjesën tjetër të saj që ka më pak. Kështu pra, në pikëpamje ekonomike këto dy pjesë të familjes plotësohen në çdo rast dhe përbëjnë një tërësi, edhe atëherë kur janë të ndara me një distancë të madhe. Familjet e ndara kanë ekzistuar edhe ndër popujt të tjerë²⁷.

Familje të ndara ka më shumë në Rrafshin e Dukagjinit, sepse këtu numri i pjesëtarëve të tyre është shumë i madh. Relativisht më shumë ka familje të tilla në regjionin e Vokshit, për të cilin u bë fjalë më parë, sepse të gjitha fshatrat e tij janë mjaft të vafra, siç u pa edhe nga disa shembuj që dhamë këtu, ndërsa gati çdo shtëpi e Vokshit është një familje e madhe. Kështu, p.sh., në fshatin Pobërgjë është familja e Hamëz Zejnel Panxhës me 60 pjesëtarë; një pjesë e kësaj familjeje jeton në fshatin Kosuriq, ku qysh me kohë kanë blerë një tokë pjetiore. Në të dyja pjesët e kësaj familjeje zot shtëpie është Hamza; ky ka dy gra, njérën e mban në Kosuriq e tjetrën në Pobërgjë. Familja e Kamber Metës nga fshati Voksh i Madh gjithashtu jeton e ndarë, një pjesë e anëtarëve të saj jeton në pasurinë që e kanë blerë me kohë në fshatin Prekollukë (Podguri i Pejës). Në fshatin Carrabreg jeton një pjesë e familjes së madhe të Shaban Rexhës, ndërsa pjesa tjetër e saj në fshatin Qyshk afër Pejës. Në fshatin e madh Isniq (Pejë) deri vonë ka pasur shumë familje të ndara, kështu një numër i pjesëtarëve të tyre jetonte në Podgurin e Pejës (sidomos në fshatin Prekallë) ku kanë blerë tokë. Edhe tash ekzistonjë familje të tilla (p.sh. familja Tishuku) në këtë fshat; madje edhe familja e madhe Osmanaj nga Gjurakovci është me origjinë nga Isniqi. Gjatë kohës familjet e tilla të ndara janë ndarë në dy ose më shumë familje të pavarura.

Të gjitha këto familje merren me bujqësi e blegtori, si ato të tjerat që nuk janë të ndara në këtë mënyrë. Por, në grupin e familjeve të ndara ekziston një varietet i posaçëm, që është shumë më karakteristik nga ky që përmendëm më sipër, sepse në këto ndryshon në mënyrë të dukshme struktura sociale e mbarë familjes. Fjala është për familjet patriarchale të ndara, te të cilat një numër i pjesëtarëve të tyre qëndron në fshat e merret me bujqësi, ndërsa pjesa tjetër kalon në qytet e merret me zejtari, ose punë të tjera jobujqësore. Me gjithë diferençimin e tillë të madh social të pjesëtarëve të familjes, ajo prapë-serapë shpeashherë mbetet një bashkësi ekonomike, ashtu siç është rasti me familje të ndara ku të dy pjesët e saj merren me bujqësi. Familje të tilla ka më shumë sidomos në regjionet pasive, siç janë Hasi, Opoja, Gora, por edhe disa vise të tjera të Kosovës, ku njerëzit nuk kanë mundësi t'uua

27) M. S. Filipović, «Nesrdonička i predvojena zadruga», Beograd 1945, 37.



sigurojnë ekzistencën pjesëtarëve të shumtë të familjeve të mëdha në vendlindjen e tyre nga pasuria që posedojnë. Por këta nuk janë kurbetçinj sezonalë, të cilët shkojnë në qytet për të punuar një kohë dhe fitimin ua dërgojnë familjeve të tyre në fshat. Këto janë familje të mëdha, të ndara, që janë vendosur përherë në qytet, ku zakonisht merren me zejtari, dhe një sasi të fitimit ia dërgojnë pjesës tjetër të familjes që jeton në fshat, ndërsa nga fshati këto familje, tanimë qytetare, gjëzojnë përkrahjen e pjesës së familjes fshatare, e cila u dërgon zakonisht gjëra ushqimore (mish, bulmet, sidomos tëlyn, e, nëse nuk janë larg, edhe dru zjarri). Sa për ilustrim të kësaj dukurie, po japim këtu disa shembuj përkatës.

Në fshatin Kapër (Opojë) familja e Rizvan Isufit ka 27 pjesëtarë, siç u tha edhe më parë. Mirëpo, kjo familje përbëhet nga tri familje të ndara: një pjesë e saj jeton në fshatin Kapër dhe merret me bujqësi e blegtori, një pjesë tjetër jeton në Prishtinë dhe merret me zejtari (ëmbëltorë), ndërsa pjesa e tretë jeton në Haxhiq afér Sarajevës, ku gjithashtu merret me zejtari (ëmbëltorë e rrobaqepës). Këta janë katër djem të Rizvanit me familje të tyre të ngushta. Rizvani është zot shtëpie në tri pjesët e familjes, por ky më tepër jeton në Haxhiq; ky vendos për çdo gjë më të rëndësishme edhe në familjet që jetojnë në Kapër e Prishtinë, të cilat i viziton kohë pas kohe. Në Gorrë e Opojë ka shumë shembuj të tillë ku një pjesë e familjes jeton në fshat, ndërsa pjesa tjetër në Prizren, Prishtinë, Beograd ejt. Në Has gjithashtu është një numër i madh bukëpjekësish, të cilët me familjen e tyre të ngushtë vendosen në qytet ku formojnë shtëpi më vete, por megjithatë ato përbëjnë një bashkësi ekonomike me trungun e familjes në Has, duke i dërguar kësaj ndihmë materiale. Kështu është rasti, p.sh., edhe me familjen e madhe të Sheh Tahir Ramës nga Pllaneja, një pjesë e së cilës jeton në Podujevë (ku e kanë furrën e bukës). Dihet se slumica e bukëpjekësve është nga Hasi në mbarë Kosovën, por shumë sish e ushtrojnë këtë zeje edhe në vise të tjera larg kësaj krahine.

Po këto konstatime mund të bëhen edhe për ato familje, pjesëtarët e të cilave janë punësuar në administratë e gjetiu në qytet, por që nuk e këpusin lidhjen familjare me pjesën tjetër të familjes që mbetet në fshat. Familje të tillë ka shumë në të gjitha qytetet e Kosovës, prandaj nuk ka nevojë të japim këtu shembuj të veçuar. Ky, pra, është një lloj i veçantë i familjeve të ndara, që dallohen me strukturën e përzier sociale të profesionit të tyre, kjo është familja fshatare-qytetare. Ky tip i familjes, siç u pa, është i kushtëzuar mjaft edhe nga faktorët gjeografikë, përvèç atyre shoqërorë, të cilët në midiset e caktuara janë të tillë saqë nuk ofrojnë mundësi për plotësimin e nevojave elementare të familjeve me numër më të madh pjesëtarësh, siç janë familjet e mëdha patriarchale në viset pasive që i përmendëm këtu.

Një kategori tjetër e familjeve të mëdha, krijimi i të cilave është kushtëzuar vetëm nga faktorët ekonomikë, është familja patriarchale pa gjini gjaku²⁸. Kjo formë e familjes së madhe, e cila përbëhet nga familje të tjera më të vogla, ose nga individët, por që nuk kanë origjinë të përbashkët, ka ekzistuar edhe ndër popuj të tjerë. Mirëpo, ndërsa shqiptarë kjo formë e bashkimit të njerëzve haset shumë rrallë. Në

Kosovë mund të jenë ndoshta vetëm disa raste, ndër të cilat një i tillë ka ekzistuar edhe në Has afér Gjakovës. Në përgjithësi familje të tilla krijohen zakonisht në viset e kolonizuara, ku njerëzit që gjenden në një ambient të ri gjeografik, në një vend të panjohur, me qëllim që të jetojnë më lehtë e të njihen e të bashkohen më shpejt, formojnë edhe familje të përbëra pa gjini gjaku, familje me përbërje heterogjene. Por kjo ndodh më shpesh kur ndonjë familje e vogël mbetet pa fuqi punëtore, kur p.sh. i zoti i shtëpisë plaket, ose kur familja mbetet vetëm me gra e fëmijë. Në raste të tilla familja pranon në shtëpi ndonjë njeri të patokë, ose ndonjë fshatar të varfër, i cili kështu bëhet pjesëtar i kësaj shtëpie me të drejta të barabarta, bashkë me familjen e tij të ngushtë, nëse e ka.

Në Kosovë raste të tilla ka pak, para së gjithash për arsyet se edhe familjet e zakonshme, familjet e vogla, kanë një numër jo të vogël pjesëtarësh e, përvëç kësaj, numri më i madh i tyre zakonisht janë meshkuj. Pra, këtu nuk është problem fuga punëtore, por, përkundrazi, problem është mungesa e tokës pjellore. Ky problem në Kosovë paraqitet në formë shumë të ashpër, sepse bujqësia e kësaj krahine është shumë e prapambetur, ndërsa teprica e fuqisë punëtore në fshat është shumë e madhe, sepse tokë ka pak e industria nuk është e zhvilluar sa duhet. Familjet e përbëra pa gjini gjaku mund të hasen rrallë, siç u tha, në Kosovë. Këto krijohen zakonisht kur ndonjë familje e madhe e merr ndonjë të varfër për të punuar në shtëpi, në fushë, ose për të ruajtur bagëtinë. Gjatë kohës, me këtë njeri mësohen të gjithë pjesëtarët e familjes, kështu që nuk e ndajnë me asnjë gjë prej veti, dhe në këtë mënyrë ky ardhacak adaptohet si në shtëpinë e vet. Më në fund ky kolektiv familjar e pranon këtë si pjesëtar të vetin e shpeshherë edhe e marton. Por në rast të ndarjes së familjes, ai nuk ka të drejtë trashëgimi. Një rast të tillë e kam shënuar në fshatin Ramoc afér Gjakovës, në shtëpinë e Vuksan Nikës. Në këtë familje jeton me dhjetëra vjet një njeri i vetëm e i varfër, që quhet Lukë. Ai ka ardhur në këtë shtëpi si djalë i ri dhe ka qëndruar këtu deri në pleqëri, si pjesëtar i barabartë i këtij kolektivi familjar, duke ruajtur bagëtinë.

Një lloj tjetër i familjes së bashkuar pa gjini gjaku formohej në bazë të vëllamisë (probatinisë). Ky lloj i familjes ka qenë në të kalluarën mjaft i përhapur në Mal të Zi e Serbi. Familjet e tilla janë krijuar kryesisht për arsyet të ngjashme, për të cilat krijoheshin edhe familjet që përmendëm më parë. Por në këto raste njerëzit lidhnin ndërmjet tyre vëllaminë, bëheshin «probatinë», d.m.th. krijonin njëfarë gjinie gjaku në mënyrë artificiale, me qëllim që ky bashkim i ri të jetë një lloj i familjes së vërtetë patriarkale. Një rast i tillë është shënuar në fisin Kuç (Mal i Zi), ku janë bashkuar një familje shqiptare e një malazeze²⁹. Në Kosovë këto janë raste të rralla, por atykëtu kanë ekzistuar. Kështu, në shënimet e famullitarit Cyril Fabijan, që e përmendëm këtu edhe më parë, kemi gjetur kopjen e një kontrate të lidhur më 1930 ndërmjet dy familjeve që bashkoheshin. Kontrata

29) St. Dučić, *Život i običaji plemena Kuča*, «Srpski etnografski zbornik», XLVIII, Beograd 1931, 235-236.

është lidhur në kishën katolike, në fshatin Bec, afër Gjakovës, para famullitarit të atëhershëm. Në këtë janë përcaktuar të gjitha të drejtat e palëve kontraktuese, madje me një pedantëri e stil të thukët e të qartë, saqë menjëherë shihet në të fryma e Kanunit të Lekë Dukagjinit, i cili atëherë ende ishte në fuqi ndër shqiptarët e këtyre anëve, si edhe në vise të tjera. Ngase përbajtja e kësaj kontrate është shumë karakterist, po e botojmë këtu në tërsi. (Mjerisht, tanë nuk e kemi më në dorë tekstin shqip, prandaj po e përkthejmë këtë nga serbishtja, meqenëse në këtë gjuhë është botuar së pari ky punim më 1960 në Buletinin nr. IV-V të Muzeut të Kosovës. Përkthimin po ia përshtatim sa të jetë e mundur gjuhës së origjinalit.):

«Prej sodit e deri tash shtatë vjet Zef Gjoni e Mon Miftari janë bashkue e vllaznue. Kur të dahan, një pend kije, pllugu, kerri e një lopë, të cilën ta zgjedhin, kanë me i ra Zef Gjonit. Prej gjasë tjetër që ta jep Zoti, secilit i bje gjysa. Në koftë se Zef Gjoni e ngucë Mon Miftarin e don me u da pa u mbushë shtatë vjet, të gjitha gjatë, përveç asaj që u përmend ma para, kanë me u da përgjysë.

Në koftë se Mon Miftari lyp me u da para shtatë vjetëve, përveç bukës së gojës për robt e familjes së vet dhe teshave të veta, asgja tjetër nuk mundet me marrë.

Pesëmëdhetë qese që Mon Miftari i ka dhanë peng, në koftë se asht i zoti me i nxjerrë para shtatë vjetësh, kanë me hi në mallin e përbashkët të shpisë. Në koftë se Moni para shtatë vjetësh i merr prej Hajdar Kamerit tetë qese që ja ka borxh, edhe këto hinë në gjanë e përbashkët të shpisë. Tri qese që i ka borxh Isuf Gjini, edhe ato, në koftë se kthehen para shtatë vjetëve, hinë në gjanë e përbashkët të shpisë.

Në koftë se nuk blehet toka e begut, ajo mbetet e begut, e mbas begut, e Zef Gjonit. Në koftë se blehet toka, kanë m' da përgjysë.

Landët që janë në Ledinagji janë të Monit.

Pesë qese që ja ka dhanë Miftari, janë të tij, edhe në u bashin prej tyne njiqind qese.

Zef Gjoni asht zot shpije, e kudo që të hinë borxh Zefi ka me i kallxue Monit. Kur t'i blenë diçka djalit të vet, ka me ia ble edhe djalit të Monit, kështu edhe grues. Tezen nuk e përfshinë ky sull.

Çka të fiton Zef Gjoni përjashta pasunisë së shpisë, e mban përveti. Kështu edhe Moni.

Dishmitarë për përbajtjen e këtij sulli janë:

Asllan Hajdari, Vuksan Nika, Pjetër Bala e Demush Ndoja.» Këta e kanë «firmuar» këtë kontratë duke vënë gishtin.

Sic shihet, kjo është një bashkësi shtëpiake, ose familjare, e krijuar për një periudhë të caktuar, kuptohet, për interes ekonomik. Ka mundësi që një bashkësi e tillë të qëndrojë edhe më gjatë, por meqenëse ato në Kosovë janë shumë të rralla, nuk mund të merremi me trajtimin më të thellë të organizimit të jetës së tyre.

Këto ishin tipat e familjeve të mëdha patriarkale të krijuara e të ndara në kategori përkatëse, në bazë të kritereve ekonomike. Kuptohet se mund të trajtohet edhe një sërë e tërë tipash e kategorish të tillë, ose të ngjashme (p.sh. sipas rolit ekonomik të pjesëtarëve të moshës së ndryshme, të strukturës gjinore etj.), por këtu vumë në dukje vetëm atë që është më karakteristike dhe që në një formë të ngjashme është konsta-

tuar edhe te familjet e mëdha ndër popuj të tjerë. Megjithatë, nga materialet, që i shënuam këtu dhe nga përvoja e njohuria që kemi qysh më parë për familjet e mëdha në këtë terren, mund të konkludojmë se familja e madhe shqiptare kryesisht bazohet në gjini gjaku dhe se kohezioni i saj para së gjithash rrjedh nga lidhja familjare, farefisnore, e më pak nga ajo ekonomike. Këtë e vërteton edhe fakti se familjet pa gjini gjaku ndër shqiptarë janë shumë të rralla, ndër të cilët jeta në bashkësi familjare është më shumë e zhvilluar se ndër popuj të tjerë fqinjë.

Nëse bëjmë një kategorizim të mëtejshëm të familjes shqiptare sipas parimeve të tjera, e jo vetëm nga aspekti ekonomik dhe organizativ, p.sh. sipas madhësisë së tyre, atëherë do të detyroheshim të shfrytëzojmë të dhënrat statistikore, të cilat mjerisht na mungojnë, sepse në shërbimin statistikor familjet janë paraqitur vetëm globalisht sipas numrit të pjesëtarëve të tyre, duke mos i ndarë edhe sipas kombësisë. Megjithatë, familjet e mëdha shqiptare në Kosovë, sipas numrit të pjesëtarëve, mund të ndahanë në tri grupe: familjet e vogla, të mesme dhe ato të mëdha. Familjet e vogla patriarkale mund të përbëhen nga dy ose më shumë çifte bashkëshortore, me 10 deri 20 pjesëtarë, ato të mesme me 20 deri 40 pjesëtarë, ndërsa familjet me më se 40 pjesëtarë mund të përbënë kategorinë e tretë. Kuptohet, një kategorizim kësijoi mund të bëhet vetëm në ato regjione ku ka shumë familje të mëdha. me shumë pjesëtarë, sepse në vise të tjera, edhe familjet me 20 pjesëtarë, mund të konsiderohen si kolektive të mëdha familjare.

Familje të vogla patriarkale ka, siç e thamë edhe më parë, gati në çdo fshat të Kosovës me një numër të madh, ndërsa të mesme më shumë ka në pllajën e Rrafshit të Dukagjinit, ndërmjet Pejës e Gjakovës, në Podgurin e Pejës, në Drenicë, Podrimë, në përgjithësi në rrithinat e Prizrenit, në fshatrat e Gorës e të Opojës, por edhe në Kosovë (më pak), në fshatrat e Kaçanikut, të Vuçiternës, të Shalës së Bajgorës, Llapit, Gollakut, Moravës, Karadakut të Shkupit etj. Familjet e mëdha me më se 40 pjesëtarë sot janë më të rralla e numri i tyre zvogëlohet gjithnjë. Ato gjenden kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit, si e cekëm më sipër, ndërsa në pllajën e Kosovës vështirë se mund të gjejmë raste të tilla.

Këtu po trajtojmë familjen e madhe shqiptare në fshatrat e Kosovës. Mirëpo edhe në qytetet e kësaj Krahine ekziston një numër jo i vogël familjesh të këtilla që jetojnë ndryshe nga ato në fshat. Prandaj edhe nga ky aspekt mund të bëhet kategorizimi i familjes së madhe: në familjen fshatare dhe në atë qytetare.

Për sa i përket konfesionit, familjet shqiptare në Kosovë mund të ndahanë në familje myslimanë dhe në ato katolike. Siç dihet, pjesa më e madhe e shqiptarëve në këto vise janë myslimanë, ndërsa një numër i vogël katolikë. Mirëpo në organizimin e jetës familjare nuk ka kurrrfarë dallimi në mes tyre. Për studimin e familjes ka rëndësi më të madhe numri i çifteve bashkëshortore sesa numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të saj.

ORGANIZIMI I BRENDSHËM NË FAMILJET E MËDHA

Nga ajo që është botuar deri më sot shihet se ekziston një ngjashëmëri e madhe në organizimin e jetës së brendshme në familjet e mëdha jo vetëm në kuadrin e një krahine, vendi ose populli, por edhe ndërmjet grupeve të ndryshme etnike, ku ekziston ky lloj i bashkësisë familiare. Kjo është e kuptueshme, sepse një kolektiv i këtij lloji ua përshtat, para së gjithash, kushteve ekonomike mënyrën e jetës së tij, brenda mundësive objektive, si dhe zakoneve të vendit, në mes të cilave ka shumë gjëra të ngjashme, ose ka pasur në të kaluarën, në mes grupeve të ndryshme etnike në Ballkan. Ndër shqiptarët mënyra e jetës patriarkale u është përshtatur normave të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Në këtë çdo gjë është përcaktuar, çdo detaj dhe çdo situatë ka zgjidhjen e vet, kështu që edhe familjes, d.m.th. familjes së madhe, i është kushtuar një kapitull i tërë. Gjatë kohës kanë ndryshuar disa norma kanunore, sepse njerëzit këto ua kanë përshtatur kushteve të reja jetësore, derisa më në fund janë zhdukur fare dhe janë zëvendësuar me ligje bashkëkohore civile. Por në realitet disa nga normat e këtij Kanuni mesjetar deri diku edhe sot jetojnë në marrëdhëni reciproke ndërmjet fshatarëve shqiptarë, megjithëse të gjitha këto i ka shkelur koha qëmoti. Duket se fryma e Kanunit të Lekë Dukagjinit edhe sot më tepër përfshin pikërisht familjet e mëdha shqiptare. Për këtë dëshmojnë disa dukuri negative, ose pozitive, të cilat edhe si të tilla, janë mjaft anakronike (p.sh. mikpritja tradicionale shqiptare është ruajtur më tepër ndër familje të mëdha patriarkale).

Në krye të familjes së madhe qëndron i zoti i shtëpisë, i cili ka një ose dy ndihmës. Zakonisht, më i vjetri duhet të jetë zot shtëpie, por shpeshherë këtë detyrë e mban ndonjë më i ri, më i zgjuar e më i shkathët. I zoti i shtëpisë zgjidhet për një kohë të pacaktuar. Ai çdo gjë e punon duke u konsultuar me këshillin e shtëpisë, që përbëhet nga të gjithë meshkujt e rritur, me moshë të pjekur, të familjes. Por para botës së jashtme (fshatit etj.) familjen e përfaqëson e i mbrojn interesat e saj i zoti i shtëpisë, përkatësisht ndihmësi i tij. Të drejtat dhe detyrat e të zotit të shtëpisë janë mjaft të gjera.

Kryefamiljari në Kosovë quhet «zot shpije», kështu që edhe vetë termi tregon mjaft qartë se të drejtat e tij për udhëheqjen e shtëpisë janë të mëdha. Këto të drejta mund të ndahen në dy grupe: në të drejtat e nderit dhe në ato materiale. Të drejtat e nderit dikur kanë qenë më të mëdha: me emrin e të zotit të shtëpisë quhej e gjithë familja, ai në dhomën e miqve zë vendin e nderit, në njëren anë të ballit të oxhakut; para se të hyjnë në këtë dhomë, mysafirët e thérresin të zotin e shtëpisë me emër, para se ta hapin derën (sepse në fshatrat shqiptare mysafirët nuk trokasin në derë, por me zë e shqiptojnë emrin e kryefamiljarit. Në këtë rast dikush përgjigjet nga dhoma dhe pas kësaj miku hyn brenda; kështu veprohet edhe kur mysafiri e di se kryefamiljari nuk gjendet fare në shtëpi). Në të drejtat materiale që i ka pasur kryefamiljari përfshihej edhe blerja e armëve me shpenzime të familjes, po kështu blehej edhe kali i shalës për të; nga fondi i përbashkët këtij i bliheshin edhe «teshat e shtratit» dhe takëmi i kafes. Megjithëse këto janë vlera materiale, ato në këtë rast kanë edhe domethënien e nderit, sepse një njeri, i cili para botës e përfaqëson një

kolektiv të nderuar, duhet të ketë edhe pamjen e paraqitjen e jashtme në një nivel të caktuar, si brenda në shtëpi, ashtu edhe jashtë saj. Me rastin e ndarjes së familjes, kryefamiljarit i takonin gjérat e përmendura më sipër, kështu që ato nuk llogariteshin në vlerën e pjesës që i takonte këtij³⁰⁾.

Por, ndër të drejtat materiale të kryefamiljarit, më të rëndësishme janë ato që kanë të bëjnë me anën ekonomike të familjes së madhe. Kështu ai ka të drejtë të shesë e të blejë pasurinë e tundshme e të patundshme të familjes, përkatësisht për familjen; ka të drejtë të hyjë borxh e të japë hua e t'i bëhet garant kujt të dojë. Kryefamiljari mban arkën e shtëpisë; të gjitha të ardhurat në të holla të pjesëtarëve të familjes duhet t'i dorëzohen këtij, përvèç të ardhurave që kanë gratë nga prodhimet e punës së dorës. Askush prej pjesëtarëve të tjerrë nuk mund të shesë e as të blejë ndonjë gjë pa lejen e kryefamiljarit, as të marrë hua ose të bëhet garant. Kanuni lejonte që meshkujt e familjes së madhe mund të bëheshin garant për ndonjë mik të tyre, vetëm për një shumë që nuk e kalonte vlerën e armëve të tyre.

Kryefamiljari në mbërëmje u cakton detyrat veçmas pjesëtarëve të familjes për ditën e nesërme, përvèç atyre që kanë detyrë të përherëshme (barinjtë etj). Ai ka të drejtë gjithashtu të ndëshkojë atë që me sjelljet e veta e mëriton këtë. Kanuni përcakton këto dënimë: të mos i jepet të dënuarit ushqimi, t'i merren armët e gjata ose të shkurtrat për një ose dy javë, të lidhet e të mbahet i burgosur në shtëpi dhe më në fund të përjashtohet nga shtëpia, nëse ka refuzuar t'u nënshtronhet urdhra e kryefamiljarit; por edhe në raste të tillë i zoti i shtëpisë këtij ia jep pjesën e pasurisë që i takon. Koha ka ndryshuar shumë gjëra edhe në këtë lëmë, kështu që kryefamiljari tashti dënon vetëm fëmijët, por edhe këtë të drejtë ai shpeshherë ua lë prindërve të tyre. Kur vjen puna deri te dënimini i pjesëtarëve të rritur, atëherë zakonisht familja ndahet, (shthuret, dekompozohet). Kryefamiljari ka të drejtë të rrijë në shtëpi edhe gjatë sezonit të punëve të fushës, të presë miqtë e të ruajë shtëpinë. Këtë të drejtë nuk e shfrytëzon kurrikush, sidomos nëse kryefamiljari është ende i ri, i aftë për punë, por ai zakonisht lë në shtëpi ndonjë plak e vetë u prin të tjerëve.

Detyrat e kryefamiljarit janë të shumta e të rënda, por të gjitha kanë vetëm një qëllim: interesin e familjes. Në Kanunin e Lekë Dukagjininit theksohet se kryefamiljari, para së gjithash, duhet të kujdeset që të mos shkatërrohet familja, prandaj e ka për të detyrë «me punue me mend e urti mbrenda e jashta shpijet e të mos ta çojë kah rrenimi e fika shpinë». Ai duhet «me mbajtë në fre gjinden e shpisë të mos t'i sjellin ndoj dam a rrenim», të kujdeset që toka të mos mbesë pa punuar dhe tufa e bagëtisë të mos dëmtohet e prapësohet. Me një paragraf të posaçëm Kanuni obligon kryefamiljarin «me mbajtë udhën e drejtësisë në shpi e mos me ia mbajtë krahun ma tepër njenit se tjetrit». Në të vërtetë drejtësia e kryefamiljarit është një nga shyllat kryesore që e mban këtë bashkësi familjare.

Baçica, d.m.th. gruaja që kujdeset për bulmetin e udhëheq punët e përgatitjes dhe të ndarjes së ushqimit, paraqet, pas kryefamiljarit,

30) Shih: Shtj. K. Gjeçovi, «Kanuni i Lekë Dukagjinit», Shkodër, 1933, 7-8.

personin më të rëndësishëm udhëheqës në familje. Në të vërtetë kjo është e lidhur vetëm me sektorin e saj të caktuar (kuzhina e bulmeti), sepse në punët e tjera që i kryejnë meshkuj ajo nuk ka të drejtë të përzihet. Edhe baçicën e zgjedhin gjithashtu meshkujt. Kjo zakonisht është një nga gratë më të vjetra në shtëpi, por mund të jetë edhe ndonjë tjetër më e shkathët e më e re. Baçica quhet edhe «zonjë shpije». Ajo i ka edhe ndihmëset e veta, numri i të cilave varet nga madhësia e familjes, përkatësisht nga numri i bagëtisë. Detyra e saj është të mjelë bagëtinë dhe të përgatisë bulmentin. Baçica kryesore, zonja e shtëpisë, vendos çfarë do të përgatitet pér drekë ose pér darkë dhe kujdeset pér vegshin e gjellës. Në qoftë se përgatitet ndonjë gjellë në tepsi, këtë punë e kryen ndonjë grua tjetër, ndërsa baçica i jep bulmetin pér të (gjalpin, mazën, mishin). Kur kanë mysafirë, atëherë kryefamiljari i thotë baçicës çfarë duhet të ketë pér darkë, përkatësisht pér drekë. Në disa familje të mëdha është e caktuar lista e gjellëve pér mysafirë, sipas rëndësisë së tyre.

Detyrat e të drejtat e pjesëtarëve të tjerë janë të përcaktuara, në mënyrë që të gjitha punët në familjen e madhe partitarkale zhvillohen e kryhen normalisht, kështu që kurrgjë nuk shkon dëm. Çdo mashkull i pjekur nga mosha e ka detyrën e caktuar: barinjtë kujdesen vetëm pér bagëtinë që u është besuar; në qoftë se ka më shumë pendë qesh ose kujash, gjë që është e zakonshme në këto kolektiva të mëdha, atëherë pér çdo pendë caktohet vozitësi i posaçëm. Dikush kujdeset pér kopshtin e pemëve, tjetri pér kopshtin e perimeve, të tjerët pér ara e livadhe e kështu me radhë. Në një familje të madhe në Raushiq, afër Pejës, ekziston një çoban i posaçëm edhe pér shpesë shtëpiake. Çdonjëri kujdeset pér sektorin e vet të punës, kështu që, kur ka nevojë të punohet diçka bashkërisht, ai këtë ia thotë kryefamiljarit e ky pasdarke ua kumton të gjithëve.

Në disa familje të mëdha, ku kryefamiljari ka shumë detyra, ekziston një njeri i posaçëm që kujdeset pér ndarjen e punës. Përveç punës në fushë, të cilën në kohën e sezonit e bëjnë të gjithë së bashku, disa pjesëtarë të kolektivit familjar kanë edhe detyra të posaçme; kryejnë punë të ndryshme pér të cilat kanë dashuri e talent. Kështu në familjen e madhe Fetahaj në Raushiq ekzistojnë disa mjeshtër që punojnë gjëra të ndryshme të mjeshtërisë që i nevojiten këtij kolektivi të madh. Njëri nga këta është qerrendërtues, tjetri farkëtar, njëri mbathtar, tjetri murator, pastaj ka këtu zdrukthëtarë, rrobaqepës etj. Kështu në këtë kolektiv mbretëron njëfarë autarkie, sepse, përvèç disa prodhimeve industriale (kripë, sheqer, vajguri, opinga gome, fije pambuku pér pëlhirë etj.), të gjitha gjërat e tjera i prodhojnë vetë. Kulla e tyre është e stolisur brenda me dru të gdhendur në mënyrë artistike, gjithashtu edhe koshi e hambari në oborr, si edhe një pjesë e orendive e veglave të punës. Fëmijët, kur nuk janë në shkollë, ndihmojnë në shtëpi, bëjnë ndonjë punë të lehtë, ose ruajnë bagëtinë bashkë me barinjtë më të mëdhenj, ndërsa kur mbushin 16-17 vjet, fillojnë të merren edhe me punë të rënda.

Detyrat e grave nuk janë të njëjta në çdo familje të madhe, por, përsa u përket punëve kryesore, nuk ka ndonjë dallim të madh. Familja e madhe shqiptare ka një rregullim të brendshëm, që i përrngjan atij në kolektiva të tjerë të popujve fqinjë, mirëpo, pér sa i përket pozitës

së gruas, ajo ka dallime të mëdha me këto. Në familjen e madhe shqiptare meshkujt punojnë vetëm pér kolektivin, ndërsa gratë bëjnë të kundërtën; ato punojnë kryesisht pér familjen e tyre të ngushtë, pér burrin e fëmijët, pér kolektivin punojnë vetëm disa ditë në muaj. Detyra kryesore e tyre ndaj kolektivit është që të gatuajnë bukën, të ziejnë dhe të mbajnë në rregull dhomën e miqve. Bukën e gatuajnë me rend «magjetoret» (dy ose tri ditë, varësisht nga numri i grave në familje) e, mbasi kanë kryer rendin e vet, secila ka pér detyrë të kujdeset disa ditë pér odën e mysafirëve. Në disa familje gratë kanë vetëm këto detyra. Mirëpo në shumë sosh ato bëjnë edhe punët e fushës, ato më të lehat: korrin, vjelin groshët, mbledhin barin (sanën) dhe bëjnë punë të ndryshme në kopsht. Gratë në Kosovë zakonisht nuk bëjnë punë të rënda fizike, siç janë mihja, prashitja, ujitja, kositja etj. Disa familje nuk i nxjerrin fare gratë në punë të fushës, pér arsyetetarë dhe të zakoneve prapanike të trashëguara nga turqit, me qëllim që të mos i shohë syri i huaj gratë e tyre. Në qoftë se fshati është heterogjen, me shumë fise, atëherë ky zakon prapanik respektohet më shumë, ndërsa në qoftë se fshati përbëhet prej një fisi, atëherë gratë dalin në punë edhe në fushë. Kjo pér arsyetetarë e një fisë janë gjini gjaku, me të vërtetë shumë e largët, por prapë e ndiejnë veten si një kolektiv i madh që rrjedh nga një trung, kështu që nuk ka nevojë të fshihen gratë nga meshkujt e fshatit. Mirëpo nuk qëndron puna kështu në të gjitha regjionet e Kosovës, sepse diku edhe gratë bëjnë punë të rënda në fushë e nuk fshihen nga të huajt. Rastet të tilla ka shumë në disa vise malore dhe atje ku nuk ka mjaft meshkuj pér punët e fushës. Sidoqoftë koha bën të vetën, kështu që edhe disa zakone prapanike në lidhje me pozitën e gruas në familje dita-ditës po ndryshojnë dhe po përfillen gjithnjë e më pak.

Të drejtat e pjesëtarëve të familjeve të mëdha, në krahasim me detyrat dhe angazhimin e tyre në punë, janë mjaft të vogla e të kufizuara. Këtu intereset i individëve vjen në planin e dytë në krahasim me interesin e kolektivit. Megjithatë, çdo pjesëtarë i sigurohet ajo që është më e nevojshme pér jetë banimi e ushqimi, ndërsa veshmbathja vetëm pjesërisht. Çdo mashkull ka të drejtë të martohet me shpenzimet e familjes. Martohen me radhë sipas moshës, edhe vajzat fejohen e martohen në këtë ményrë. Këtu bëhet përjashtim vetëm pér jetimët që nuk i kanë gjallë njërin ose të dy prindërit. Në disa familje atyre që pinë duhan, duhanin ua siguron kolektivi prej mjetave të veta (ose, në qoftë se familja mbjell duhan, secili nga këta merr një pjesë të caktuar nga prodhimi). Ushtari, udhëtari, i sëmuri, ose eventualisht i burgosuri, të gjithë këta gëzojnë ndihmën nga mjetet e përbashkëta të kolektivit. Çdo çift bashkëshortor ka dhomën e vet të fjetjes (që quhet «qiler», në të cilën mban gjërat personale).

Për sa i përket furnizimit me veshmbathje nuk qëndron çështja njësoj ndër të gjitha familjet e mëdha, sepse kjo varet kryesisht nga gjendja e tyre ekonomike. Megjithatë, të gjithë meshkujt kanë në vit aq palë opinga sa u nevojiten, ndërsa grave u jepen vetëm një, ose jo më shumë se dy palë. Meshkujve ua blen kryefamiljari edhe kapuçin (plisin, qeleshen, qylafin) nga mjetet e kolektivit. Për të gjitha gjërat e tjera të veshmbathjes kujdeset çdo familje e vogël, individuale, pér pjesëtarët e saj. Në realitet, pas të vjelave, një pjesë e leshtit në pjesëtarët e saj.

treg, ndërsa pjesa tjetër u ndahet për krye pjesëtarëve të familjeve individuale që përbëjnë kolektivin e madh familjar, kështu pastaj gratë nga ky lesh mbarojnë rroba zhguni, çorape etj. për fëmijët, burrin dhe për vete. Dikur nga fondi i përbashkët bliheshin edhe fijet e pambukut, të cilin kryefamiljari ua ndante familjeve individuale sipas numrit të pjesëtarëve, prej të cilave gratë mbaronin pëlhirë dhe rroba të ndryshme. Në kohët e fundit, në vend të fijeve të pambukut, blejnë pëlhirë të gatshme, «amerikan», të cilën e ndajnë gjithashtu për kokë. Në vjetë, pas vjetes së pemëve, çdo familjeje i jepet një sasi e caktuar (për kokë) e frutave që ta ruajë për dimër, ndërsa pjesa më e madhe shitet në treg, ose e ziejnë reçel. Bariut i blejnë hërkën, ose japanxhën, e, kur shkon verës pa familjen e tij në bjeshkë me bagëti, këtij i takojt në edhe «teshat e shtratit» nga fondi i shtëpisë.

Dasma e varrimi bëhen me shpenzimet e familjes. Secila grua ka të drejtë të marrë një muaj pushim në vit, të cilin e kalon me fëmijët e vet të vegjël në gjini (te prindërit, ose vëllezërit). Vajzat e fejuara kanë të drejtë të punojnë vetëm për përgatitjen e pajës së tyre, ato nuk i ngarkojnë me punë të tjera pa ndonjë nevojë të madhe. Fëmijëve familja duhet t'ua sigurojë librat dhe mjetet mësimore, kur të fillojnë të shkojnë në shkollë. Në rast sëmundjeje, çdo pjesëtar i familjes ka të drejtë të mjekohet me shpenzimet e saj.

Organizimi i brendshëm i familjes së madhe shqiptare në Kosovë është i ngjashëm me atë që kanë pasur dikur familjet e mëdha edhe ndër disa popuj të tjerë të Ballkanit, ku gjithashtu ekzistonte parimi i pasurisë së përbashkët, i ndarjes së drejtë të punës dhe frytit të saj.

Familja e madhe shqiptare ka veçoritë e saj, siç u tha edhe më sipër, por ajo që e dallon më tepër nga kolektivat e ngjashëm ndër popuj të tjerë fqinjë është pozita e gruas në familje. Dihet se gruaja shqiptare në fshat ndër ne ende është në një pozitë nënshtuese ndaj burrit, e ngarkuar me barrën e rendë të paragjykimeve fetare e të edukatës patriarkale, megjithëse në kushtet e reja shoqërore pas Luftës së Dytë Botërore, me ligj, i është garantuar barazia e plotë me meshkujt. Në familjet e vogla individuale pozita e saj vështirësitet edhe më tepër me punë të ndryshme fizike, me angazhimin e madh për mbajtjen e familjes, shtëpisë, pasurisë etj. Në familjet e mëdha gruaja myslimanë në këtë pikëpamje ka një pozitë më të lëhtë, sepse ajo, siç e thamë edhe më parë, nuk angazhohet shumë në punët e kolektivit përjashta oborrit të shtëpisë, kështu që kohën dhe punën ia kushton familjes së vet të ngushtë (burrit e fëmijëve) duke u kujdesur zakonisht edhe këtu vetëm për veshjen dhe pastërtinë e tyre. Gati e gjithëjeta e saj, përvëç larjes së rrobave, është brënda në qilerin e vogël ku merret me punë dore. Diçka më e rendë është pozita e gruas në familjet katolike, sepse disa paragjykime fetare etj. këtu paraqiten në formë pak më të butë në lidhje me të, sesa ç'është rasti me myslimanët. Prandaj gratë katolike edhe në familje të mëdha punojnë në fushë dhe i kanë të gjitha angazhimet e tjera në shtëpi. Por këto dallime mund të janë vetëm regjionale, paraqiten aty-këtu e jo përgjithësisht.

Nusja shqiptare sjell me vete pajë të madhe për vete e për burrin e saj, të cilën e blen, përkatësisht e punon, nga të hollat që i ka dërguar familja e të fejuarit. Ajo sjell për vete veshmbathje për disa vjet,

kështu që në familjen e burrit ajo merr vetëm një palë opinga në vit. Kjo për arsyen se familja e burrit kësaj i ka dhënë mjaft të holla, me qëllim që të përgatisë për vete dhe familjen e saj të ardhshme jo vetëm shumë rroba të gatshme, por edhe sasi të madhe pëlzure, penj le-tëm shumë rroba të gatshme, por edhe sasi të madhe pëlzure, penj leshi etj., si rezervë me të cilën siguron veshmbathjen për një kohë të gjatë. Nga ky zakon, në shkrimet e shumë autorëve, janë dhënë përfundime të gabuara, se gjoja ndër shqiptarët ekziston shitblerja e vajzave. Në realitet, ka raste kur prindërit e vajzës kërkojnë nga miku një shumë të hollash (përveç asaj që ai e jep për pajë), si njëfarë dëmshpërbolini që po humbin një fuqi punëtore, ose si kompensim për shpenzimet që bëjnë me rastin e festimit të fejesës e të përcjelljes së vajzës; por ky nuk është «çmimi i vajzës». Shumë prindërit nuk kërkojnë asgjë, por të gjitha të hollat që i sjell miku harxhohen për pajë, të cilën vajza e tyre ditën e martesës ia çon burrit të vet. Prandaj familja, sidomos familja e madhe, nuk kujdeset për veshmbathjen e grave.

NDIKIMI I DISA FAKTORËVE NË MBAJTJEN E FAMILJEVE TË MËDHA

Ekzistojnë shumë faktorë që kanë ndikuar deri më sot në mbajtjen e familjeve të mëdha patriarkale në Kosovë. Këta faktorë mund të katégorizohen në disa grupe, mirëpo këta gati të gjithë janë të natyrës ekonomike, shoqërore-historike dhe etnopsikologjike, prandaj këtu po i shqyrtojmë në kuadrin e këtij aspekti të gjitha këto arsyen me radhë.

Arsyeja ekonomike për ekzistimin e familjeve të mëdha shqiptare në Kosovë, në një numër shumë të madh deri më sot, shihet mjaft qartë nga ajo që u trajtua në këtë punim. Kjo arsyen ka luajtur rolin kryesor në familjet e mëdha edhe të popujt e tjerë, siç shihet nga një literaturë mjaft e pasur për këtë problem. Në fshatrat e Kosovës familjet e mëdha e kanë tokën më të mirë, sipërfaqet më të mëdha të fushave pjellore. Këto kanë gjithashtu një numër më të madh kafshësh, janë të pajisura relativisht mirë me vegla ose makina bujqësore, kanë një numër të madh punëtorësh dhe gati të gjitha ato elemente që i nevojiten një ekonomie bujqësore të përparuar për kushtet tona. Por, menjithatë, këto familje në asnjë rast nuk kanë aq tokë, sa është e nevojshme për të siguruar një standard pak më të lartë për një numër aq të madh pjesëtarësh të kolektivit. Prandaj termi «shpi e pasun», që shpesherë përdoret në lidhje me familjet e mëdha, ka kuptim relativ, në kuadrin e kushteve ekonomike të Kosovës, ku standarti jetësor është në nivelin më të ulët në Jugosllavi, gjë që rrjedh nga prapambetja e përgjithshme ekonomike e trashëguar nga e kaluara dhe nga zhvillimi i ngadalshëm i industriës e i degëve të tjera ekonomike pas Luftës së Dytë Botërore. Por, sikur këto familje të ndaheshin, të dekompozoheshin, ato do të zbrisnin në një nivel edhe më të ulët ekonomik. Kjo, pra, është arsyja kryesore që ato edhe sot mbahen në këmbë. Këtu duhet të kemi parasysh faktin se pjesa më e madhe e tyre jeton ekskluzivisht nga bujqësia. Nga ana tjetër duhet të theksohet se në familjet e mëdha ekziston një nga faktorët e rëndësishëm ekonomikë, që nuk shkon në favor të mbajtjes në jetë të këtyre kolektivave të mëdha. Ky është numri i madh i fëmijëve, pleqve e grave që marrin pjesë fare pak në punë prodhuuese të bashkësive të këtilla

familjare. E gjithë kjo paraqet një barrë të rëndë për to. Por, megjithatë, këto qëndrojnë ende, sepse kërkesat materiale të pjesëtarëve të tyre janë minimale. Nga ana tjetër, veprimtaria e tyre ekonomike është e njëanshme, e thjeshtë, merren vetëm me bujqësi e bagëti, në prona shumë të vogla. Kështu zakonisht nuk ndihet mungesa e fuqisë punëtore, sepse ka mjaft meshkuj të rritur për kryerjen e të gjitha punëve, edhe pa pjesëmarrjen e kategorive të pjesëtarëve të tjerë joaktivë, ose me aktivitet ekonomik relativisht të vogël. Ndarja e familjes do t'i sillte në pozitë të vështirë ekonomike të gjithë pjesëtarët e saj, e sidomos ato familje të reja individuale, që zakonisht kanë shumë fëmijë të vegjël e pak fuqi punëtore (vetëm prindërit, përkatësisht babai). Pasuria e tyre e patundshme do të ishte gjithashtu fare e vogël, sepse, siç e cekëm më parë, edhe prona e familjes së madhe është fare e vogël në krahasim me numrin e pjesëtarëve të saj.

Faktorët historikë, që kanë ndikuar në mbajtjen e familjeve të mëdha në Kosovë, kanë pasur arsyetimin e vet për një periudhë shumë të gjatë, deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore, sepse gjatë sundimit turk, kur pushteti ka qenë i dobët, në këto vise shpeshherë mbretëronte gjendje pasigurie, e cila në disa raste kufizohej edhe me anarki. Në kushte të tillë çdo shtëpi duhej të mbrohej vetë nga sulmi eventual kundër pjesëtarëve ose pasurisë së saj. Në Kosovë nuk ekziston organizimi fisnor në mënyrë të tërësishme, kompakte, sepse fshatrat zakonisht përbëhen nga pjesëtarët e fiseve të ndryshme. Siç dihet, fisi ka luajtur rol të rëndësishëm ekonomik e shoqëror në territorin e tij; çdo fistar e ndiente veten të sigurt, sepse pas tij qëndronte i gjithë fisi. Prandaj, përvëç arsyeve të tjera, në viset malore të Shqipërisë së Veriut e në Mal të Zi numri i familjeve të mëdha nuk ka qenë i madh, sepse atje fisi ka qenë shumë i fortë. Në Kosovë ka ekzistuar organizimi i popullsisë në «bajraqe» (që përfshinte disa fise, përkatësisht pjesëtarë të fiseve të ndryshme), por bajraku nuk kishte atë dome dhje të fortë të gjinisë së gjakut, e bazuar edhe në lidhjet ekonomike të kësaj bashkësie. Ky pra është një nga faktorët e rëndësishëm që kanë kushtëzuar rritjen dhe mbajtjen në jetë të familjeve të mëdha shqiptare në Kosovë dhe në vise të tjera, para së gjithash në Maqedoni e gjetiu. Në periudhën e sundimit osman plot shqetësimë, trazira e turbullira në këto anë, vetëm familja e madhe, me shumë pjesëtarë të saj të aftë për luftë, ka qenë në gjendje të mbrohej me sukses dhe ta ndiente veten më të sigurt. Kullat e forta shqiptare në të gjitha fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit, nga frëngjité e të cilave qitnin flakë edhe nga 20 pushkë të trimave të vendosur të një familjeje, kanë qenë kësh-tjella të vërteta, mbrojtja e sigurt e familjes dhe e fshatit. Familjet e mëdha në Rrafshin e Dukagjinit, sidomos ato më të mëdhatë, edhe sot e kanë kullën e gurit ose me tulla, pranë shtëpisë së gjatë më të ulët, të ndërtuar në shekullin e kaluar, që dëshmon për kohën e vështirë në të kaluarën e këtyre viseve³¹⁾.

Fshatrat e Kosovës në pjesën më të madhe kanë qenë çifçinj, kanë punuar tokën e bejlerëve e të agallarëve dhe këtyre ua kanë dhënë të

31) M. Krasnić, *Kula u Metohiji*, «Glasnik Etnografskog instituta Srpske akademije nauka», VII, Beograd 1958, 47-68.

tretën, ose të katertën e prodhimit bujqësor. Bejlerët më me qejf ua kanë dhënë tokën për ta punuar familjeve të mëdha. Kjo për arsyen se ato kanë qenë në gjendje ta punojnë më mirë e, nga ana tjetër, ato ishin mbështetje e fortë e feudalëve të vendit në rast nevoje. Kur kishin grindje e ngatërresa të mëdha ndërmjet tyre, dhe përgjithësisht në kohën e trazirave e të turbullirave, bejlerët në Pejë, Gjakovë etj. mbanin në kullat e tyre të forta çeta të tëra fshatarësh të armatosur. Kuptohet se këta mbanin marrëdhënie shumë miqësore me familjet e mëdha, në të cilat mbështeteshin. Kështu, në një rast të vështirë në kohën e sundimit turk, një feudal nga Peja e ka furnizuar me arkë municioni familjen e madhe të Hasan Kocit në fshatin Gllogjan afër Pejës (e cila atëherë kishte rrëth 25 pjesëtarë të armatosur). Aty nga fundi i shekullit të kaluar shpërthen një grindje e rëndë ndërmjet myslimanëve e katolikëve në rrëthinan e Gjakovës, për shkak se dikush kishte hedhur natën kokën e derrit në xhami dhe kishte lyer dyert e saj me gjakun e kësaj kafshe. Kjo shkaktoi revoltë ndër myslimanët e kësaj ane dhe, duke menduar se këtë gjë e kishin bërë katolikët, u mblohdhën e filluan t'ua digjinin këtyre shtëpitë në të gjitha fshatrat ku ishin, deri në Pejë. Por me këtë rast kjo hajkë nuk guxoi t'i sulmojë shtëpitë e familjeve të mëdha. Fshatarët katolikë që kishin familje të vogla, i qortonin sulmuesit duke u thënë se nuk ishte kurrfarë trimërie të sulmonin shtëpitë e varfra e të vogla, por, nëse ishin trima, le të sulmonin Zhel Hasanin nga Rakoci (Gjakovë), Hasan Kocin në Gllogjan, ose Prend Palokën në Gjurakoç, d.m.th. të gjitha këto familje të mëdha e të forta që i përmendëm këtu më parë. Me intervenimin e të parëve të fisit u ndërpren kjo dhunë e paarsyeshme ndaj katolikëve, me të cilët myslimanët gjithmonë kanë jetuar si vëllezër. Por me këtë rast këta kanë qenë të mashtruar e të nxitur nga hoxhallarët fanatikë e të shitur, sepse më vonë u vërtetua se dhunimi i xhamisë ishte vepër e kurdisur nga konsulli serb në Prishtinë, me qëllim që të futej grindja ndërmjet shqiptarëve, sepse kjo çonte ujë në mullirin e politikës së borgjezisë së atëhershme serbomadhe.

Këto raste, por edhe shumë të tjera të llojeve të ndryshme, dëshmojnë sa edhe kushtet shoqërore-politike kanë ndikuar dukshëm që të mbahen familjet e mëdha për një kohë të gjatë në Kosovë. Në të kluarën ka pasur familje të tillë, edhe ndër serbë, në ekzistimin e mbajtjen e të cilave kanë ndikuar po këta faktorë.

Faktori demografik gjithashtu luan rol të rëndësishëm në rritjen e mbajtjen e familjeve të mëdha shqiptare. Dihet se nataliteti e rritja e popullsisë ndër shqiptarë në Jugosllavi është më e madhe se kudo në Evropë. Nataliteti në këtë Krahanë është më i madh edhe se në Egjipt; ai është baras me natalitetin në disa vende të Azisë, ku ka mbërritur shkallën më të lartë në botë. Kështu, në Kosovë mesatarja e shkallës së natalitetit në periudhën 1947-1954 ka qenë 41,9 për mijë, ndërsa në vitin 1954 ishte 56,0 për mijë (mesatarja jugosllave në këtë vit ka qenë 28,4, në Serbi 25,4, në Vojvodinë 21,4 e në Slloveni 19,8 për mijë). Por edhe mortaliteti është më i madh në Kosovë (në vitin 1954 ai ishte 15,6, në Jugosllavi 10,8, në Serbi 9,9, në Vojvodinë 10,2 e në Slloveni 9,6 për mijë)³². Me gjithë mortalitetin e lartë, në Kosovë me-

32) Z. Pjanić, «Problem stanovništva u ekonomskoj teoriji», Beograd 1957, 146.

satarja e rritjes vjetore të popullsisë është prej 25 deri 31 për mijë. Që të kemi një pasqyrë më të qartë, duhej të shihej sa është shkalla e rritjes së popullsisë në grupet e ndryshme etnike në Kosovë, para së gjithash ndër shqiptarët. Sipas regjistrimit të popullsisë të 31.III. 1953 Krahina Autonome e Kosovës ka pasur 808 000 banorë (këtu po i rrumbullakojmë numrat) prej të cilëve 525 000 shqiptarë (prej 755 000 që sipas këtij regjistrimi kishte atëherë në Jugosllavi), 19 000 serbë, 31 000 malazez, 35 000 turq, 12 000 jevgj dhe një numër më i vogël i të tjerëve³³. Regjistimet e bëra më vonë treguan se përqindja e shqiptarëve në Kosovë e në vise të tjera, në realitet, është shumë më e madhe. Sikur të analizohej indeksi i rritjes së popullsisë veçmas për çdo grup etnik (për këtë nuk disponojmë të dhëna statistikore), do të shihej se ky ndër shqiptarët është më i lartë, sepse për këtë dëshmon fakti se ky indeks është shumë më i madh se mesatarja e Krahinës në komunitat ku përqindja e shqiptarëve është 90% e më tepër.

Një shkallë kaq e lartë e natalitetit, përkatësisht e rritjes së popullsisë, ndër shqiptarët është e kushtëzuar nga faktorë shoqërorë-historikë, para së gjithash nga shkalla e zhvillimit ekonomik e kulturor, por ajo mund të ketë lidhje ndoshta edhe me strukturën biologjike, sepse kjo shkallë është e lartë në të gjitha viset ku jetojnë ata. Kjo shihet edhe nga të dhënat statistikore për Shqipërinë, e cila indeksin e rritjes natyrore të popullsisë e ka të lartë. Kështu, nga të dhënat për vitin 1957, shihet se rritja natyrore e popullsisë në çdo 1000 banorë në Jugosllavi ka qenë 130, në Gjermani 57, në Itali 83, në Bullgari 101, në Greqi 116, ndërsa në Shqipëri 394. Nga të gjitha vendet e botës vetëm 7 kanë pasur këtë rritje më të madhe se Shqipëria (Malaja, Sudani, Guatemala, Kosta Rika, Meksika, Venezuela dhe Ekuadori)³⁴.

Një nga arsyet e natalitetit kaq të madh ndër shqiptarët është edhe botékuptimi i tyre ndaj martesës. Shqiptarët në katund martohen shumë të rinj (vajzat 16-18 vjeçë, edhe më të reja kur këtë e lejon ligji; meshkujt 18 vjeç e tutje, ose mbasi kthehen nga shërbimi ushtarak). Një rol të posaçëm këtu luan edhe botékuptimi në lidhje me fëmijët, sipas të cilës ata janë «bekim i perëndisë», kështu që duhet të lindin sa më shumë, aq «sa jep zoti». Kësaj duhet ti shtohet fakti se në fshat ndarja e çiftëve bashkëshortore, prishja e martesës, është një gjë shumë e rrallë. Edhe kur gruaja nuk mund të lindë fëmijë, gjë që është një nga arsyet kryesore për ta ndarë burri, martesa nuk prishet aq shpesh, por gruaja pranonte që ky të sjellë edhe një grua tjetër për t'i lindur fëmijë. Tani bigamia është e ndaluar me ligj, prandaj martesa mund të prishet më shpesh, për të lidhur martesë tjetër nga e cila priten fëmijët.

Është provuar shkencërisht se një çift bashkëshortor po qe se, gruaja në fillim të martesës do të ishte 15-vjeçare, sikur të jetonte në kushte normale, deri në fund të jetës së tyre do t'i kishte 12 fëmijë; po qe se gruaja që në fillim të martesës do të ishte 20-vjeçare do të kishte 9,9 fëmijë, 25-vjeçare 7,7; 30-vjeçare 5,7 dhe kështu me radhë deri në 45 vjet, kur martesa do të ishte 0,8 fëmijë. Një popullsi e tillë, ku martesa do të zgjaste mesatarisht 30 vjet do të dyfishohej për çdo

33) «Statistički godišnjak FNRJ», Beograd 1959, 301.

34) «Statistički kalendar FNRJ», Beograd 1959, 139-140.

16 ose 17 vjet. Por në realitet një fertilitet i tillë, një rritje kësosoj, nuk arrihet, veçse në raste shumë të rralla. Llogaritet se rreth vitit 1850 kanadezet me origjinë franceze, në moshën 15 deri 50-vjeçare kanë lindur mesatarisht 7,96 fëmijë. Për këtë arsy familjet kanë qenë shumë të mëdha, kështu që ato me nga 30 pjesëtarë nuk paraqisin kurrrfarë përjashtimi³⁵.

Ajo që në lidhje me fertilitetin (pjellshmërinë) e grave kanadeze me origjinë franceze është shënuar në gjysmën e parë të shekullit të kaluar si fenomen në demografinë botërore, me një formë pak më të zbutur, mund ta shohim ndër shqiptarët në përgjithësi, pra edhe në Kosovë. Në lidhje me rritjen e këtillë natyrore kuptohet se këtu edhe familjet kanë një numër më të madh pjesëtarësh nga popujt e tjerë, ose regjionet e tjera fqinje. Sipas regjistrimit të popullsisë më 1948, çdo familje në Kosovë ka pasur mesatarisht 6,35 pjesëtarë, mesatarja jugosllave ka qenë 4,37 (Serbia 4,54, Vojvodina 3,62, Sllovenia 3,77 etj.), ndërsa në vitin 1958 kjo mesatare për Kosovën ka qenë 6,42, që do të thotë se është rritur për 0,07, (kjo mesatare në këtë vit ka qenë në Jugoslavi 4,29, në Serbi 4,45, në Vojvodinë 3,51, në Slloveni 3,68 etj.)³⁶. Një nga faktorët demografikë që ndikon në fertilitetin ndër shqiptarët mund të ketë lidhje me faktin se numri i meshkujve është më i madh se ai i femrave, kështu që teorikisht nuk mbetet vajzë pa u martuar (më 1953 në Kosovë në 1000 meshkuj ka pasur 985 femra)³⁷. Sikur të dispononim të dhëna statistikore vetëm për shqiptarët, do të shihnin se kjo diferençë është shumë më e madhe në favor të numrit të meshkujve. Ndoshta, përvëç faktorëve shoqërorë-ekonomikë, në këtë ndikojnë edhe ata fiziologjikë, por, kuptohet, standardi jetësor, struktura sociale dhe pozita e gruas në familje e shoqëri luajnë rol të rëndësishëm edhe në këtë rast. Sot nuk është asgjë e jashtëzakonshme, nëse prindërit në fshat kanë dhjetë fëmijë. Nuk paraqet rast të vetmuar fshatari i varfér Kamer Qerimi e gruaja e tij Faza, nga rrethi i Mitrovicës, të cilët gjatë 28 vjetëve të jetës bashkëshortore kanë pasur 14 fëmijë, prej të cilëve 10 janë gjallë (8 djem e 2 vajza)³⁸.

Faktori demografik, siç shihet, luan rol të madh në formimin e mbajtjen e familjeve të mëdha shqiptare. Edhe atëherë kur këto familje ndahen në dy ose më shumë pjesë, ekzistojnë kushtet demografike (nataliteti i lartë, mortaliteti gjithnjë më i vogël, rritja e madhe natyrore e popullsisë) që të krijohen përsëri, brenda një kohe relativisht të shkurtër, kolektiva të rindërtuar kanë mëdhenj familjarë.

Faktori etnopsikologjik luan rol të rëndësishëm në jetën shoqërore të njeriut patriarchal. Robëria shekulllore nën sundimin turk, pastaj gjendja shumë e vështirë nën sundimin e Jugosllavisë borgjeze, kur shqiptarët nuk kanë gëzuar as të drejtat qytetare më elementare, kanë ndikuar që këta të myllen në vetvete në rrethin e tyre etnik e të vazhdojnë të jetojnë sipas parimeve të vjetra fisnore, duke mos iu nënshtruar, sa ka qenë e mundur, ndikimit të ligjeve shtetërore dhe ren-

35) Reinhard, Histoire de la population mondiale», (cituar sipas veprës shënuar në fusnotën 32, f. 98-99).

36) «Statistički godišnjak FNRJ», 1959, 292.

37) «Statistički godišnjak FNRJ» — 1953.

38) Gazeta e përditshme «Rilindja», Prishtinë, 18.V.1959.

dit shoqëror që ka qenë kundër tyre në çdo pikëpamje. Kështu i kanë ruajtur me xhelazi traditat e tyre kombëtare, d.m.th. të gjitha ato karakteristika të jetës shoqërore e tiparet nacionale, me të cilat ata dalojhen edhe sot nga popujt e tjerë të Ballkanit. Pra, në mbajtjen e familjeve të mëdha, deri më sot ka luajtur rol të rëndësishëm edhe faktori etnopsikologjik, d.m.th. ruajtja e traditës me kujdes shumë të madh.

Në psikologjinë e shqiptarit gjinia e gjakut luan rol të madh. Kjo lidhje është aq e fortë, saqe dhe pjesëtarët e një fisi shumë të madh mbahen si farefis, sepse besohet se i gjithë fisi rrjedh prej një trungu të përbashkët familjar. Në këtë pikëpamje tradita mbahej me aq rigorozitet, saqë deri vonë (e në disa raste edhe sot) brenda fisit mbretëronte ekzogamia, kështu që vajza e djali që ishin të një fisi nuk mund të martoheshin as atëherë kur dihej se as ata, as të parët e largët të tyre nuk kanë, as nuk kanë pasur, kurrfarë lidhjesh familjare në bazë të gjinisë së gjakut. Kur ekzistonte një lidhje e tillë brenda fisit, atëherë është i kuptueshëm kohëzioni aq i fortë në strukturën e familjeve të mëdha, e cila është bashkësi e ngushtë e gjinisë së gjakut.

Fshatari shqiptar është i lidhur tepër me shtëpinë e tokën e tij. Ai këto nuk i braktis lehtë as atëherë kur gjen diku, në ndonjë vend tjetër, kushte më të volitshme pér jetë. Por edhe nëse e bën këtë, gjithmonë do të përpinqet që dikur përséri të kthehet në vendlindjen e vet, përkatesisht në rrëthin e njerëzve të vet. Shqiptari me vështirësi i ndërron e i braktis veset e traditat e trashëguara nga të parët, i mësuar të jetojë shekuj me radhë me to. Madje, shpeshherë, ai këto i ruan edhe atëherë kur e sheh se nuk janë të dobishme pér të, madje edhe atëherë kur ato janë edhe të dëmshme. Shqiptarët janë të sinqertë dhe të shoqërueshëm, sidomos në rrëthin e njerëzve që u përshtatet, që kanë veti e tradita të ngjashme me ta. Të gjitha këto ata i gjejnë në rrëthin e tyre familjar, te më të affërmit e tyre, e sidomos në gjirin e familjeve të mëdha. Ata kanë një lidhje të fortë dhe karakteristike me familjen, të cilën e braktisin, nga e cila ndahan qoftë edhe përkohësisht, vetëm atëherë kur janë tepër të shtrënguar ta bëjnë këtë. Përveç kësaj, drejtësia e kryefamiljarit dhe kujdesi i tij i përhershëm pér të gjithë pjesëtarët e kolektivit, u jep një domethënë të posaçme edhe elementeve të tjera psikologjike, kështu që të gjitha këto e arsyetojnë dhe e përkrahin dëshirën e njerëzve patriarkalë pér të jetuar në një bashkësi të tillë familjare. Kuptohet se këtu duhet të kemi parasysh edhe rolin e atyre faktorëve, pér të cilët folëm më parë, sidomos rolin e faktorëve ekonomikë. Këtu, para së gjithash, duhet përmendur ndjenja e sigurisë së çdo individi, në çdo vend e në çdo situatë, si pjesëtar i një kolektivi të fortë dhe ndjenja e sigurisë ekonomike pér vete dhe familjen e ngushtë të tyre.

Në vargun e gjatë të faktorëve etnopsikologjike, që ndikojnë në mbajtjen e familjeve të mëdha, duhet të përmendim edhe faktin se bashkësitet e tillë familjare gjëzojnë një respekt të madh në popull. Familjeve të mëdha populli u jep atribute të ndryshme pozitive, edhe atëherë kur këto janë të paarsyeshme, si p.sh.; shtëpi të pasura, të ndershme, me harmoni të madhe familjare, me burrëri, mikpritëse etj. Kjo rrjedh edhe nga fakti se çdo pjesëtar i këtyre familjeve, edhe kur është jashtë shtëpisë, në rrëthin e njerëzve të tjerë, përpinqet që sjelljet e tij të jenë sa më korrekte, sepse ai përfaqëson një kolektiv të madh.

para të cilit duhet të përgjigjet, nëse me sjelljet e veta e cenon emrin e zërin e mirë që gjëzon shtëpia para botës. Për sa i përket mikpritjes, që është një zakon i përgjithshëm te shqiptarët, kjo vjen në shprehje më tepër në familjet e mëdha, për arsyen se këto kanë shumë lidhje miqësore (shumë martesa, kumbarë etj.), e nga ana tjetër, ato qëndrojnë zakonisht më mirë në pikëpamje ekonomike, kështu që kanë më shumë mundësi ta mbajnë gjallë mikpritjen tradicionale shqiptare. Kuptohet se në të kaluarën, edhe në lidhje me trimërinë, disa familje të mëdha kanë qenë në zë, sepse, siç e thamë më parë, ato dispononin çëta të tëra njerëzish të shtëpisë së armatosur, të cilët ishin të gatshëm që, në rast nevoje, të mbronin edhe mbarë fshatin e jo vetëm shtëpinë e tyre. Dihet se njeriu patriarchal e çmon trimërinë si një nga virtyetet më të larta. Në të kaluarën në këto shtëpi të mëdha shkoni shpesh si mysafirë njerëz të ndryshëm të pushtetit, bejlerë, bajraktarë dhe njerëz të tjerë më të dalluar. I zoti i shtëpisë i familjes së madhe zakonisht ka qenë edhe kryeplak i fshatit, ose këshilltar në komunë. Kështu familja e madhe në çdo pikëpamje ka pasur pozitën dominuese në katund. Të gjitha këto shprehen edhe në terminologjinë populllore, në të cilën familja e madhe quhet «shpi e madhe, shpi e fortë, derë e fortë, oxhak, odë, shpi e zoja, shpi në za, shpi bujare, madje «kallabllak», shpi me shumë rob» etj.

Se sa i çmon populli familjet e mëdha, shihet edhe nga proverbat: «Ku asht razija – asht perëndija» dhe «Ku asht kallabllaku-asht itifaku», (harmonia, marrëveshja).

Në lidhje me këtë po japim edhe një shembull që e ka shënuar në rrëthim e Gjakovës Ciril Fabijan, i cili ka treguar interesim edhe për jetën e traditat e shqiptarëve, në mesin e të cilëve jetonte, prej të cilëve ka mësuar edhe gjuhën shqipe (ai vetë, siç e thamë më parë, ka qenë slloven). Kur, me një rast, bisedonte në fshatin Novosellë me fshatarë, në lidhje me familjet e mëdha, ai u tha se në vendin e tij (Slloveni) njerëzit as që dinë se ç'është familja e madhe, sepse edhe djemtë ndahen nga prindërit e tyre posa të martohen, madje edhe më parë, katundarët iu përgjigjën: «Ata qenkan njerëz të mbrapsht.» Pra, sipas mendimit të tyre, të mos jetosh në familje të madhe, në rrëthim më të gjerë familjar, do të thotë të bësh një lloj krimi, një gabim të madh, kështu që njerëzit e tillë nuk çmohen në mesin e tyre. Të gjitha këto tregojnë se familjet e mëdha kanë një vend dhe rol të posaçëm në psikologjinë e fshatarit shqiptar. Kuptohet se edhe kjo ka peshën e vet në psikologjinë e pjesëtarëve të kolektivave të këtillë të mëdhenj, kështu që ndikon në vullnetin për të jetuar në rrëthim e tyre.

PËRFUNDIM

Familja e madhe shqiptare në Kosovë, siç shihet nga kjo që thamë këtu, është një bashkësi ekonomike e gjini gjaku, pjesëtarët e së cilës jetojnë nën një kulm të përbashkët, numri i të cilëve zakonisht është i madh, shpeshherë më se 20, e në disa raste edhe më se 80. Kjo organizatë familjare ekziston ndër shqiptarët në të gjitha viset e Krahinës së Kosovës, por më tepër në Rrafshin e Dukagjinit. Ajo mund të rreshitet në disa kategori, varësisht nga aspekti nga i cili studiohet (familja e thjeshtë bujqësore, familja e përzier-bujqësore-punëtore (jobujqë-

sore), familja fshatare, qytetare etj. — të gjitha këto në kuadrin e aspektit social; nga aspekti organizativ ajo është e përbashkët, e ndarë, e një gjinie gjaku, e përbërë nga familjet jo të një gjinie gjaku; sipas madhësisë familjet janë të vogla (relativisht), të mesme e të mëdha, kjo ndarje mund të bëhet edhe nga aspekte të tjera-regjonale, fetare kohore etj.

Organizimi i brendshëm i familjes së madhe shqiptare me shumë elemente i ngjan familjes së këtillë të dikurshme ndër popujt fqinjë, por ajo, megjithatë, ka disa veçori të vetat, të cilat rrjedhin nga rregullimi patriarkal shoqëror në të kaluarën, kështu që disa elemente të lashta edhe sot ekzistojnë në këta kolektiva të mëdhenj familjarë. Në lidhje me këtë qëndron pozita specifike e gruas në familje, megjithëse ndër të gjitha këto nuk është njësoj pozita e saj. Por vijat kryesore që e përcaktojnë këtë bashkësi familjare janë të përbashkëta, sidomos për sa i përket rregullimit të brendshëm. Këto, para së gjithash, janë parimet e pronës së përbashkët dhe të ndarjes së punës. Përsa i përket qeverisjes (administrimit) këtu mbretëron një lloj centralizmi demokratik: i gjithë pushteti i takon kryefamiljarit, të cilin e zgjedhin pjesëtarët e kolektivit, ndërsa ky vendimet më të rëndësishme i merr me pëlqimin e tyre.

Mbajtja (qëndrimi) e familjeve të mëdha shqiptare në Kosovë deri në ditët tona shpjegohet me ndikimin e shumë faktorëve, që i kemi rreshtuar në katër grupe, që kanë domethënie: ekonomike, shoqërore-historike, demografike e etnopsikologjike.

Familjet e mëdha zakonisht janë më të forta në fshat nga aspekti ekonomik (kanë më shumë tokë, kafshë e fuqi punëtore), kështu që pjesëtarët e tyre kanë leverdi ekonomike të jetojnë në këto bashkësi. Sipas së drejtës zakonore, në rast se ndahet familja, vetëm vëllezërit kanë të drejtën e trashëgimit, ata kanë të drejtë të barabartë, pa marrë parasysh numrin e pjesëtarëve të familjeve të tyre të ngushta (i cili zakonisht është i madh).

Faktorët shoqërore-historikë kanë luajtur gjithashtu rol të rëndësishëm për mbajtjen në jetë të familjeve të mëdha në Kosovë, ku, gjatë sundimit turk, shpeshherë ka pasur trazira të mëdha dhe anarki, kështu që në kushte të tillë njerëzit kanë qenë më të sigurtë kur kanë jetuar në kolektiva të mëdha familjarë. Sistemi tatimor dhe i takorre zbatohet sipas numrit të shtëpive («për shpi», «për tim»), gjithashtu ka ndikuar në mbajtjen e familjeve të mëdha patriarkale.

Nataliteti ndër shqiptarët është i një shkalle shumë të lartë, kështu që rritja e populsisë është më e madhe se ndër popujt e tjerë në Evropë. Kjo ndikon në numrin e pjesëtarëve të familjes, prandaj edhe kjo mesatare është shumë më e madhe ndër shqiptarët se ndër grupet e tjera etnike fqinje. Kështu, me ndarjen e një familjeje të madhe, krijohen disa familje të tjera, edhe ato relativisht të mëdha, të cilat për një kohë të shkurtër, përsëri rriten në kolektiva të mëdha.

Faktori etnopsikologjik luan gjithashtu rol të rëndësishëm në mbajtjen e familjeve të mëdha ndër shqiptarët. Ky faktor përbëhet nga një varg i tërë komponentesh e detajesh, nga të cilat disa i vu-më në dukje në këtë punim.

Mark TIRTA

ASPEKTE TË KULTIT TË TË PARËVE E TË TË VDEKURVE NDËR SHQIPTARË

Fenomenet me karakter mitologjik e religjioz kanë lindur, janë zhvilluar e janë ndryshuar në varësi nga kushte të caktuara historike të jetës shoqërore, pra, në një kuptim të caktuar, ato janë pasqyrim i raporteve të njeriut me natyrën dhe me shoqërinë, por ky pasqyrim nuk është real, është i shtrembëuar, është pasqyrim fantastik, pasqyrim ku forcat tokësore marrin formë të mbinatyrshme.

Duke folur për metodën me të vërtetë materialiste historike të studimit të religionit, K. Marks shkruan: «Natyrisht është më lehtë që me anën e analizës të gjendet thelbi tokësor i përfytyrimeve religjioze të mjegullta, sesa, në të kundërtën, nga marrëdhëniet e caktuara të jetës reale të nxirren format religjioze që u përkasin atyre»¹. Natyrisht, ky thelb tokësor i përfytyrimeve religjioze e mitologjike përfshin në vetvete gjurmë të lashtësisë, gjurmë të stadeve të ndryshme të zhvillimit shoqëror.

Analiza e fenomeneve të ndryshme mitologjike, që kanë lënë gjurmë të ngurosura në zakone, në rite e në besime të popullit, në zbulime të objekteve të ndryshme të kulturës materiale, në krijimtarinë gojore e kështu me radhë, ka rëndësi nga pikëpamja historike për të nxjerrë në dukje dukuritë unitare gjithshqiptare e tiparet etnike të veçanta të popullit tonë ndërmjet popujve të tjerë fqinjë në periudha të ndryshme historike: Ballkan, Evropë, Mesdhe, e parë kjo në kuadrin e mitologjisë krahasuese indoevropiane.

Analiza e fenomeneve të tilla ka rëndësi të posaçme për të zbërthyer kuptimin historik e botëkuptimor të miteve, riteve e besimeve në lidhje me kultin e të parëve e të të vdekurve, për të bërë të qartë lidhjen e tyre me mbeturina të dokeve, zakoneve e organizimit patriarchal të familjes shqiptare në disa zona fshatare të vendit tonë. Duke njobur këtë përbajtje e lidhje botëkuptimore fenomenesh të ndryshme në jetën familjare, bëhet më e lehtë dhe lufta për të çrrënjosur mbeturina të këtij lloji ngajeta e njerëzve, mbeturina që bëhen pëngesë në ecjen e shoqërisë sonë përpara.

Vendi ku manifestohen më tepër mbeturina botëkuptimesh e praktikash të vjetra prapanike është familja. Kjo ka arsyet e saj. Jeta familjare me elementet e saj përbërëse është shumë e komplikuar. Kë-

1) K. Marks — F. Engels, *Vepra*, vell. 23, Moskë, 1962, fq. 383, shënim 89.

tu ekzistojnë rrethanat për t'u ruajtur më me forcë zakone, rite e mënyra të organizimit tradicional të saj. Në krahasim me zhvillimin e përgjithshëm shoqëror kjo është e prirur të ecë më ngadalë, të qëndrojë më e palëvizshme. Tradita këtu tërheq më me forcë.

Në familjen shqiptare të disa zonave fshatare, sidomos ndër male, janë ruajtur deri në Çlirim disa mite, rite, doke e zakone të karakterit patriarchal, që kishin të bënин me kultin e të parëve e të të vdekurve. Në disa raste janë ruajtur mite e legjenda pa ndonjë kuptim të posaçëm për treguesit e tyre e në disa të tjera ruheshin të lidhura me rite e besime e që përbën aspekët botëkuptimore të jetës familjare.

Disa rite e besime, që në origjinë ishin shprehje e kultit të të parëve, kishin në vetvete, në gjendjen e tyre «etnografike», një seri funksionesh të lidhura me pjellorinë e tokës, me mbarësi në prodhime bujqësore e blegtoriale, në mirëqenie, shtesë e përparim në jetën familjare. Me një fjalë kryhesin rite drejtuar të parëve a të vdekurve, me qëllim që nën ndikimin e tyre të siguronin prodhime të bollshme e të ruheshin nga fatkeqësiteti njerëzit, bagëtitë, bereqeti, pasuria në tërësi.

Termi «kult i të parëve» do të përdoret në kuptimin e gjerë që i japid mitologët e ndryshëm. Për sa i përket kultit të të vdekurve, dhe ky do të merret në lidhje të ngushtë me kultin e të parëve dhe vetëm në këtë drejtim do të analizohet, prandaj edhe u përfshinë bashkë në një titull.

Në këtë punim do të analizohen, pra, fenomene të mitologjisë shqiptare që kanë të bëjnë me totemizmin e kultin e gjinisë, me kultin e fisit e me kultin e të vdekurve, me një fjalë me kulte që lidhen me marrëdhëniet e me organizimin shoqëror të gjinisë e të fisit dhe me mbeturina të ngurosura e të transformuara në stade të mëvonshme të zhvillimit shoqëror².

Fenomenet mitologjike në gjendjen që i kemi sot, kur analizojmë thelbin, përbajtjen dhe prejardhjen e tyrë, përbajnjë në vetvete gjurmë të kohës e të rrethanave shoqërore kur kanë lindur mbi bazën e veprimtarisë reale konkrete të njerëzve, gjurmë të kohës dhe të rrethanave shoqërore kur ato janë zhvilluar si mite, rite e besime në formën më të plotë në përputhje me kushte të veçanta (dhe në këtë fazë duhet të gjejmë përbajtjen kryesore të tyre), dhe së fundi, gjurmë të kohëve kur ato janë ndryshuar, duke kaluar në formën e mbeturinave. Gjatë rrugës së tij historike një fenomen mitologjik, veçanërisht në kohën kur ai jeton si mbeturinë, ndërthuret me fenomene të tjera të këtij lloji, nganjëherë dy, tri o më shumë fenomene të këtilla shkrihen në «një», por ai «njësh» ruan disa tipare të origjinës të tij nga disa fenomene të ndryshme mitologjike. Shpeshherë ato ruajnë formën e vjetër, por ndryshojnë në përbajtje, ka raste që ato të janë të shkriра në fenomene të natyrës, të personifikuara. Në shqyrtimin e fakteve për rite, besime, për figura mitologjike, analiza jonë do të përqendrohet më tepër në ato tipare të tyre që kanë të bëjnë me objektin, pra

2) Termi «gjini» do të përdoret me kuptimin e matrarkatit, ndërsa termi «fis» me kuptimin e patriarkatit dhe të mbeturinave të tij, në stade të mëvonshme të zhvillimit shoqëror.

në kultin e të parëve e të të vdekurve te shqiptarët, duke mos lënë në harresë dhe tipare të tjera, kur ato janë të kapshme për shqyrtim.

Materialet që do të paraqiten këtu për analizë janë nga mbledhjet e bëra nga autorët në ekspeditat e tij në këta dhjetë vjetët e fundit në Labëri, Tomoricë, Berat (në fshatrat e Beratit rrëzë Tomorit), në Mertanesh, Mat, Mirditë, Lezhë, Kelmend, Dukagjin, Nikaj-Mertur, Kukës, Lurë, në Rrafsh të Dukagjinit (Kosovë) e vende të tjera. Është shfrytëzuar material nga arkivi i etnografisë që përfshin gjithë rrethet e Shqipërisë; është shfrytëzuar dhe material nga literatura e botuar përmitologjinë shqiptare nga autorë të huaj e vendës që nga shekulli i kaluar e deri në ditët e sotme.³

本章

Ritet, besimet, kultet e ndryshme, figurat mitologjike (hyjnité) kanë karakter të dyfishtë. Ato tregojnë pafuqishmérinë e njeriut ndaj forcave të natyrës, për t'i sunduar e për t'i shpjeguar ato, po nga ana tjetër janë dhe shprehje e raporteve shoqërore. Njeriu të panjohurën gjithnjë e ka shpjeguar me anën e së njohurës. Njeriu primitiv nuk kishte si t'i shpjegonte ndryshe natyrën dhe fenomenet e pakuptueshme të saj, veçse me anën e së njohurës e dihet se kjo njohje nuk arrinte më tej se toka e gjinisë a e fisit dhe marrëdhënet me kolektivin e njerezve ku ai jetonte e me të cilët kishte të bënte për së afërmij në jetën e tij të përditshme, me kafshët, bimët e objektet e tjera të natyrës. Pra, njeriu primitiv marrëdhënet në gjini a fis i hodhi në natyrë në përfytyrimet e tij fantastike. Në lidhje me simbolizimin e dyfishtë të fenomeneve të ndryshme të mitologjisë (forca të natyrës dhe forca shoqërore) Engelsi thekson: «Në fillim të historisë objektet e këtij pasqyrimi janë para së gjithash forcat e natyrës, të cilat gjatë zhvillimit të mëtejshëm kalojnë nëpër popuj të ndryshëm përmes lloj-lloj personifikimesh të ndryshme. *Mitologja krahasuese* ka mundur të ndjekë këtë proces primitiv së paku ndër popujt indoevropianë që kur u shfaq për herë të parë në «*Vedat*» indiane dhe ta studiojë imtësisht zhvillimin e tij të mëtejshëm ndër indutë, persët, grekët, romakët, gjermanët dhe, sa lejojnë materialet, edhe ndër keltët, lituanët dhe sllavët. Por fill pas kësaj, krahas me forcat e natyrës, dalin dhe forcat shoqërore, forca që ngrihen përballë njeriut dhe që janë po aq të huaja dhe në fillim po aq të pashpjegueshme për të, sa edhe forcat e natyrës, dhe tamam si këto të fundit në dukje e sundojnë atë me të njëjtën domosdoshmëri natyrore. *Figurat fantastike*, të cilat pasqyronin në fillim vëtëm forcat misterioze të natyrës, tanë marrin edhe tiparet shoqërore dhe bëhen përfaqësuese të forcave historike».⁴ Që nga koha e Engelsit e deri në ditët e sotme janë kryer studime të shumta rrënjesore në plan krahasues, si për popujt indoevropianë të pastudiuar ose të studiuar pak, ashtu edhe për popuj të tjerë të botës. Si çelës mjaft i sigurt në shpjegimin e fenomeneve të ndryshme mitologjike si prejardhja, thel-

3) Materialet e mbledhura nga autori në ekspeditat e tij nuk do të citohen, ndërsa materialet e tjera do të citohen në çdo rast. Arkivi i etnografisë pranë Institutit të Kulturës Popullore do të citohet shkurtimisht A.E.

4) F. Engels, «Anti-Dyring», Tiranë, 1958, f. 313-314.

bi dhe përmbajtja e tyre në përgjithësi, ka shërbyer studimi i mitologjisë e i besimeve të popujve primitivë, ku të tilla fenomene na kanë arritur të gjalla e jo në formë mbeturinash. Në këtë drejtim në plan krahasimtar janë studiuar nga mitologjia krahasuese popujt primitivë të Amerikës, të Australisë, të ishujve të Paqësorit (popujt vendas të arkipelagëve të Polinezisë, Mikronezisë e Melanezisë), popuj të prapabetur të Azisë e kështu me radhë.

Në analizën e bërit këtu poshtë, duke pasur për bazë klasikët e marksizëm-leninizmit në interpretimin materialist të fenomeneve, janë pasur parasysh rezultatet që ka arritur mitologjia krahasuese botërore, veçanërisht për popujt me origjinë idoevropiane.

Elementet mitologjike që do të paraqiten në këtë parashtrim,⁵ si material faktik bazë i përkasin gjendjes së tyre në shek. XIX e fillimin e shek. XX, pra të ruajtura në formë mbeturinash, në formë ritesh e besimesh të ngurosura, në formë legjendash e tregimesh populllore. Kjo gjendje e materialit, natyrisht, e bën të vështirë edhe analizën. Por nga ana tjetër duhet të shënojmë këtu, së pari, se materiali për shqyrtimin në fjalë është i bollshëm dhe i mbledhur në mënyrë të dokumentuar, në krahina të ndryshme të Shqipërisë, aq sa në kuadrin e këtij punimi vetëm një pjesë shumë të vogël të tij mund ta japim për ilustrim faktik; së dyti, ky material është mbledhur kryesisht në zona malore të vendit tonë, në krahina blegtoreale e bujqësore, të cilat përmungesë të rrugëve të komunikacionit kanë qënë disi të veçuara nga qyteti deri në vitet pas Çlirimt. Në këto krahina janë ruajtur deri vonë në formë mbeturinash disa tipare të marrëdhënieve patriarkale, pra këtu është ruajtur jo keq dhe mitologjia, ashtu siç është ruajtur dhe në vende të tjera të Ballkanit dhe të Evropës në përgjithësi.

Faktet mitologjike në lidhje me kultin e gjinisë janë të pakta, të zbehta dhe shpeshherë të veshura me tipare të stadeve të mëvonshme të zhvillimit shoqëror, sidomos me tipare të kultit të fisit. Ato janë ndryshuar e shndërruar shumë, por megjithatë i ruajnë disa tipare të kohës së gjinisë. Të tilla janë disa figura mitologjike të seksit femëror si nëna e vatrës, vitorja, zana etj., tiparet e të cilave na bëjnë të mendojmë se këtu kemi të bëjmë me gjurmë të hyjnive të një kohe shumë të lashtë. Sigurisht që të tilla figura kanë marrë edhe një seri funksionesh të periudhave historike të mëvonshme dhe bile në themel kanë marrë funksione të mbrojtësve të botëkuptimit patriarkal, por ruajnë diku më shumë e diku më pak dhe tipare të rendit të gjinisë. Këtu nuk nisemi aq shumë nga sekzi i figurës së dhënë nëpërmjet emrit, sesa nga ana funksionale e saj, gjëra këto që do të dalin gjatë shqyrtimit.

NËNA E VATRËS

Në Shqipëri ruhen mbeturina të kultit të vatrës e këto kanë të bëjnë nga një anë me kultin e zjarrit, përdorimi i të cilit i pruri aq shumë shërbime njerëzimit në zhvillimin e përparimin e tij dhe nga

⁵⁾ Me kultin e të parëve kanë të bëjnë, në disa tipare të tyre, dhe ora, kuden, dragoi, sado që janë figura mitologjike shumë të ndërlikuara. Këto figura nuk do t'i shqyrtojmë këtu, po në një punim tjetër të veçantë.

ana tjetër kulti i vatrës është i lidhur dhe me kultin e së parës së gjinisë, zotëruesen kryesore të vatrës familjare në kohë të lashta. Një figurë e tillë që ka të bëjë me vatrën quhet «nënë e vatrës». Kjo është një figurë e mbarë truallit shqiptar që nga Kosova e deri në Çamëri; na paraqitet me emra të ndryshëm, herë në njëjës dhe herë në shumës; ka raste që në të njëjtën krahinë na paraqitet me emra të ndryshëm.

Në vise të ndryshme emërtohet: «nëna e vatrës», «eëma e vatrës», «shtriga e vatrës», «buba» (Mirditë), «plaka e vatrës» (Mat), «shtriga», «nëna e votrës» (Malësi e Tiranës), «nënënat e vatrës», «xhuxhet e vatrës (Myzeqe), «shtriga» a «shtrigat», «nëna e vatrës» (Tomoricë), «mëma e vatrës» (në fshatra të Vlorës). Pak a shumë me të tillë emra i gjejmë dhe në vise të tjera të Shqipërisë, në Jug e në Veri, në Kosovë e në Çamëri.

Kjo figurë na paraqitet më shumë si një plakë e vogël, me sy të zgurdulluar e të skuqur, me flokë të gjatë e të thinjur, të lëshuar deri poshtë, në shumë raste, duke tjerrë li a lesh ose duke krehur flokët. Thuhej se vatra duhet pastruar në mbrëmje, se, po ta lësh pa pastruar, zemërohet «nëna e vatrës». «Nëna e vatrës» a «shtriga e vatrës» në shumicën e rasteve na jepet me tipare pozitive dhe më rrallë me tipare negative për njerëzit; atë e dallojnë nga «gratë shtriga», të «gjalla» që, sipas përfytyrimeve popullore, dalin natën e shkojnë së bashku për të ngrënë njerëz. Nganjëherë «nënënat e vatrës» thirren dhe «të mirat» ose «të tretat e vatrës». Ato barazohen me caktueset e fatit të fëmijës natën e tretë pas lindjes; kemi në këtë rast një shkrirje të dy figurave me origjinë të ndryshme. «Nuk duhet të rrish në darkë ke urët e zjarrit, se rrinë ato «të mirat» ose «të tretat e natës», thuhet në Myzeqe⁶. «Mëmat e vatrës» besohej se hanin bukë e gjellë si gjithë njerëzit, duheshin marrë me të mirë, duhej bërë një kulaç pa brumë në vatrën e re, që do të piqej për herë të parë si dhuratë për «mëmat e vatrës»⁷. Siç u përmend këtu lart, ato në një shumicë rastesh na dalin me cilësi vetëm pozitive. Kështu ndodh për krahina të ndryshme të vendit tonë, kështu ndodh dhe pas disa të dhënavë, për shembull, në Tomoricë ku tregonin se «në vatér të shtëpisë vijnë e rrinë natën shtrigat e nuk shihen». Ato nuk i bëjnë asnjjeriu të keq, por veç të mira. Ato janë të veçanta (të tjera: M.T) e nuk janë si gratë shtriga që dalin e bëjnë prapësi. Kur bien në mbrëmje për të fjetur, plakat e shtëpisë i thonë nuses së re: «Fshije vatrën e mos e len kështu, se vjen e rri shtriga». Këto vijnë natën, rrinë atje e nuk i bëjnë keq kujt. Shtrigat e vatrës quhen edhe «nëna e vatrës». Përfytyrimi i kësaj figure në mënyrë të ndryshme, në krahina të ndryshme edhe nga e njëjta trevë, kuptohet, ka të bëjë me fazë të ndryshme të evolucionit dhe të kësaj në stade të ndryshme të zhvillimit historik të shoqërisë. Ja edhe dy dëshmi nga Malësia e Tiranës: «Nëna e vatrës», ose shtriga i rrëfëhet plakës që rri shumë vonë natën dhe tjerr li ose lesh. Forma e saj është një plakë flokëthinjur afër vatrës; shumë herë, kur ngrihet nusja në mëngjes për të ngrohur ujë, sheh në vatér një plakë që kreh flokët me krëhër lini ose

6) J. Nushi, *Mitologji e besime në Myzeqe*, «Etnografia shqiptare», V 1974, f. 316.

7) J. Nushi, *art. cit.* f. 316.

tjerr; kujton se është e vjehrë; i flet, po ajo nuk përgjigjet. Në këtë mënyrë kuptohet se qenka «nëna e votrës».⁸⁾

Por «nënë e vatrës» e përfytyrojnë dhe me tipare negative, siç na paraqitet në shembullin që po paraqesim këtu: «Nëna e vatrës», një figurë kjo e besimit popullor që përfytyrohet si një plakë shtrigë e keqe, «gjasme se kjo, posa gjindët e shtëpisë largohen dhe shkojnë të flejnë, menjëherë vjen e ulet pranë caranit të vatrës, duke i krehur flokët e saj me një krëhër të madh, të hekurt dhe, po të gjejë ose të shohë ndonjë kalamë aty, ajo menjëherë e kap atë dhe ia nxjerr sytë me atë krëhërin e saj».⁹⁾

«Nënë e vatrës» e gjejmë dhe në një formë shumë të zhvilluar dhe të shkrirë me figura mitologjike të tjera. Kështu, sipas një versioni të Beratit, ajo e ka ndenjën në mal të Tomorit dhe në shtëpi të fshatarëve vjen vetem natën pér të ngrënë fémijët, pra kështu ka marrë tamam tiparet funksionale të një gruaje shtrigë në formën e një qenieje mitologjike të pyllit, ose të malit. Të vësh kokën në vatër, është gjynah se del nëna e vatrës (zonjë e vatrës). Mos krih kokën natën afér vatrës, se të del nëna e vatrës. Nëna e vatrës është «gjindje» dhe flet në mënyrë të llahtarshme. Nëna e vatrës kridhet nga oxhaku kur të gjithë pjesëtarët e familjes bien poshtë (ulen pér të fjetur)¹⁰⁾.

Ndërsa një grua po krihte (Inurte) lesh natën, i doli «nëna e vatrës» sikur të ishte një fqinjë dhe e pyeti se ç'po bënte: «E jëm'e vatrës është si një shtrigë me thonj të gjatë, me sy të kuq, flokët i katë bardhë. Ajo donte të gënjeni këtë grua që, posa të ikte ajo nga dhoma, t'i hante fémijët e saj. Prandaj i tha gruas:

— Shko e merr kazanin e fqinjës që të lajmë velenxën.

Mirëpo gruaja, para se të dilte, i dha pér të bërë një punë dhe, si ia pa thonjtë, e kuptoi se kjo ishte «nënë e vatrës» e çfarë donte t'i kurdiste duke e larguar nga shtëpia. Fémijët po flinin dhe gruaja, pér t'i shpëtuar, doli gjoja të shkonte te fqinja dhe, me të dalë te porta, tha duke shikuar nga Tomori:

— Po digjet mali i Tomorit, me laçkë e me plaçkë, me shtëpi e me fémijë.

Nëna e vatrës, që thuhet se e ka shtëpinë në Tomor, dhe atje ka dhe fémijët e vet. i la fémijët e gruas dhe muar të dilte. Posa doli në portë, zonja e shtëpisë tha: Bismilahi! — dhe atëhere nëna e vatrës foli: — Ah, ç'ma le, pa do të të kisha mbytur ty dhe fémijën tënd bashkë! dhe iku¹¹⁾.

Synimi pér të ngrënë fémijët e shtëpisë (të gruas me burrë të caktuar) nga «nëna e vatrës», siç është rasti i legjendës së Beratit e shembuj të tjerë, ka mundësi të jetë shprehje e kontradiktës midis stadesh të ndryshme të zhvillimit shoqëror. «Nëna e vatrës» duke qenë shprehje e veçantë e rendit të gjinisë, fémijët nuk i ka me burrë të caktuar e pra, në kundërshtim me normat e monogamisë, ku fémijët e kanë të caktuar babën. Ata do t'i zhdukë si të paligjshëm pér të (e pér normat e sistemit të gjinisë). Ka mundësi që këtu të jetë gér-

8) Besime të popullit të Tiranës, «Diturija», 1927, Nr. 2 f. 68.

9) Xh. Kusi, Bestytni e paragjykime, 1970, f. 136-AE.

10) F. Ndocij — Bestytni, Berat, 1963, f. 8 AE. Inr. 257/15.

11) F. Ndocij, Si më sipër, AE, f. 8-9.

shetuar dhe një fenomen tjeter që i takon atij stadi: fenomeni i kanibalizmit, dukuritë e të cilit i gjëjmë dendur në mitologjinë indoevropiane.

Në krahinat malore të Shqipërisë, në Veri e në Jug, duke përfshirë këtu dhe disa vende fushore, kur bënин gostira, hidhnin në zjarr a në anë të zjarrit të vatrës diçka nga ushqimi që bënин për të ngrënë. Në Vlorë e në krahina të tjera ku përdorej hallva, hidhnin hallvë dhe thoshin se këtë e hidhnin për shpirrat; diku-diku thuhej se e hidhnin «për shpirrat e të parëve tanë», në vende të tjera thuhej se e hidhnin për të tretat e natës, a për «nënën e vatrës». Është me interes të theksohet këtu se përvëç tipareve të tjera dhe si punuese të lirit a të lesshit, ashtu siç del dhe «nëna e vatrës» dalin dhe «të tretat e natës», sado që ato janë të një natyre tjeter¹².

Etnografët të tillë përfytyrime të ndryshme për «nënën e zjarrit» i shpjegojnë si mbeturinë të kultit të nënës, të lindur që në kohën e sistemit të gjinisë. Përfytyrimet e disa popujve për «nënën e zjarrit», thonë etnografë të ndryshëm, s'janë gjë tjeter veçse oshëtima të largëta që kanë lindur në epokën e paleolitit të epërm, në epokën e lindjes së kultit amëtar, kultit të personifikimit të vatrës në pamje gruaje. Kjo lidhet dhe me faktin se në kohë të lashta varrimet e të vdekurve bë-heshin pranë vatrës a në prag të derës. Nga të tillë varrime, thekson Shternbergu, e ka origjinën dhe kulti i vatrës e kulti i pragut të derës¹³. Është shprehur mendimi se figurinat në skulpturë të grave të zhveshura të epokës së orinjakut, të gjetura në shumë stacione të Evropës e të Azisë në një afersi të pandarë nga vatra shtëpiake, janë përfytyrime të «nënave të zjarrit» a «hyjni të zjarrit». Hestia e Greqisë së lashtë dhe Vesta e lashtë romake ishin personifikime të flakës së zjarrit. Në Romën e lashtë çdo ditë i hidhnin zjarrit një pjesë nga ushqimi që hanin vetë; në ditë të caktuara të muajit hënori i bënini dhe lutje zjarrit dhe i hidhnin lule, duke përfytyruar si të pranishme aty hyjnité e vatrës e të familjes¹⁴.

Si rrjedhim i të gjitha atyre që u thanë më lart, del se «nëna e vatrës» si figurë mitologjike është mbeturinë e zbehtë e një hyjnie shumë të lashtë të vatrës, që e ka origjinën që nga koha e matriarkatit. Tiparet e saj si një qenie e mirë, që i duhet dhënë ushqim, që i duhet pastruar vatra, që duhet t'i sillemi me respekt, janë më të lashta e më origjinalë; ato tipare që na e paraqesin si një shtrigë të keqe e të shëmtuar, që ha fëmijë e që bën prapësi, janë shtresa të një kohe të mëvonshme, janë si një shprehje e fitores së fisit mbi gjininë, shprehje e ideologjisë së rendit të fisit që poshtëron rolin e gruas në bashkësi. Shkrirja me figura të tjera, si me fatet (të mirat a të tretat e natës), duke qenë edhe këto të fundit me një origjinë të afërt me «nënën e vatrës», me shtrigat dhe gratë shtrigës në përgjithësi, shkrirja me qenie të tjera mitologjike të malit, siç është rasti i Beratit, ku thuhet se

12) Të tillë figura mitologjike si personifikimi i zjarrit e vatrës familjare në pamjen e një plake gjendet dhe në popuj të ndryshëm të botës; besohej se në çdo vatër rri «shpirti i zjarrit». Disa popuj e quajnë zjarrin «gruaja e madhe»; prandaj burrat e kanë të ndaluar të zhvishen lakuriq përparrë zjarrit.

13) L. J. Shternberg, *Pjervobitnaja religija v svjete etnografii*, Moskë 1936, f. 336.

14) N. Turchi, *La religione di Roma antica*, Bologna, 1939, f. 12-13.

«nëna e vatrës» jeton në Tomor, janë shtresa edhe më të vona, kur hyjnitë e vjetra të fisit fillojnë e kalojnë në qënie përralllore. Pra, kur të tilla figura zbehen shumë, fillojnë e marrin emrat e funksionet e njëra-tjetrës, ku disa zhduken e ndonjëra me tiparet e të tjerave vazhdon të jetojë edhe më tej, siç është rasti i «nënës së vatrës».

Në gjysmën e parë të këtij shekulli me këtë figurë mitologjike nënëat trembnin fëmijët e tyre për t'i vënë lehtë në gjumë, duke u thënë: «Fli, mos bëj zë, se të ha nën'e vatrës», «Mos qaj, se të dëgjon nën'e vatrës e të ha»; «Mos lëviz, se të ha buba». Por në kohë më të hershme e sidomos në kohë të lashta, nuk ka pasur aspak këtë funksion. Në kohën e gjinisë e si mbeturinë edhe në fis, ajo është respektuar tamam si një hyjneshë e vatrës, që ka të bëjë me kultin e së parës së bashkësisë. Në disa popuj, me fitoren e plotë të rendit fisnor mbi atë gjinor, hyjneshën femër e gjejmë të bërë hyjni burrë, figurë që jeton dhe në stade të mëvonshme të shoqërisë me klasa, ndërsa ndër shqiptarë këtë nuk e kemi ndeshur. Të ruajturit e mbeturinave të hyjnissë së vatrës familjare është e lidhur në një farë mase me mbeturina të ndryshme të marrëdhënieve patriarkale në popullin tonë. Kultin e të parëve në lidhje me vatrën familjare e kemi ndeshur në respektimin e shpirtit të vatrës, të shpirtrave të të parëve, të cilave u bë-heshin flujim ushqime në zjarr, ose ushqime që për ditë festash bë-heshin në vatér natën e mendohej sikur në to vijnë e hanë shpirtrat e të parëve. Këtë e ndeshim dhe në kultin e bollës së shtëpisë a të vitores së shtëpisë (kulti gjarprit), për të cilin do të flasim më poshtë.

GJARPRI I SHTËPISË

Një dukuri e qartë e gjurmëve të totemizmit e në lidhje me këtë dhe e kultit të të parave a të të parëve të shtëpisë është kompleksi i besimeve në lidhje me gjarprin e shtëpisë. Ai në të gjithë krahinat e Shqipërisë, dhe me sa kemi të dhëna, edhe te të gjithë shqiptarët, që banojnë jashtë Shqipërisë, si në Kosovë, Mal të Zi, Itali etj., konsiderohej si kafshë «e shenjtë», si rojë e shtëpisë, si fatdhënës për shtëpinë, si sjellës mbarësie në njerëz e pasuri¹⁵⁾. Ruajtja e këtij kulti është shprehje e disa tipareve të botëkuptimit popullor në mjedise ku janë ruajtur tipare të theksuara të marrëdhënieve patriarkale, është shprehje e atyre rr Ethanave shoqërore, ku njerëzit nuk mundeshin t'i kapërcenin vështirësitë e jetës me mjete reale e prandaj drejtosheshin te këto mite e besime të lashtësisë, te të parët mitikë, për të kërkuar «ndihmë» prej tyre. Kemi të bëjmë këtu me njërin nga aspektet e shprehjes së dobësisë së njeriut para forcave shkatërruese natyrore e shoqërore, me një mpirje të energjive të tij krijuese e transformuese, me «një pajtim» me gjendjen e tij si i «mundur».

15) Është me interes të shënohet këtu se me të njëjtat vlera si kulti i gjarprit, si përfaqësues totemik i të parëve, ruhet dhe kulti i nuselalës (buklës) në Ma-lësi të Madhe dhe në Labëri. Edhe në këto krahina besohet se nuselala është e pranishme në çdo shtëpi e është roje e shtëpisë. Për Malësinë e Madhe kemi materiale të mbledhura në terren dhe të dhëna me rëndësi nga arsimtari Mark Vuji që është me origjinë nga ajo krahinë e që e njeh mirë atë. Për Labërinë, shih: K. Kamsi, Besime të popullit në Labëri, «Diturija», Tiranë, 1928, Nr. 8, f. 316.

Në vise të ndryshme të Shqipërisë gjarpri i shtëpisë është quajtur me emra të ndryshëm. Në Jug të Shqipërisë si në Rrëzë të Tepele-nës, në Brataj të Vlorës, në Dardhë të Beratit, në Myzeqe, e quajnë vitore. Edhe në Shqipërinë e Mesme, gjarpri i shtëpisë, krahas emrit bollë quhej dhe vitore e shtëpisë¹⁶.

Në këtë drejtim është me interes të shënohet fakti që fjala «vitore», si emër vetjak për njerëz të seksit femër, përdoret në vise të ndryshme të Shqipërisë, në Veri, në Shqipëri të Mesme e në Jug; në Jug me vitoren gjarpër perifrazohet një grua e shkathëtë dhe e bukur, që është mbarësi e shtëpisë. Këtë na e sqaron shumë mirë frazeologja popullore dhe këngët popullore tradicionale, njérën prej të cilave, nga Rrëza e Përmetit, po e sjellim këtu poshtë:

«I hoqe kyçet e brezit,
si trimi armët e mezit,
emrin e keshe grua,
po jeshe trim e fajkuia
vërje pëqin ndër bres,
mbaje punën me erz
O vitorja ndë mur,
Tek rrije lëshoje nur,
Gjithë jetën me nder
të buron goja sheqer¹⁷.»

Fjala «vitore» në Elbasan përdorej për gruan që lind shumë fëmi-jë, pra një grua e lumtur¹⁸. Në folklorin shqiptar i jepen këto kuptime popullore fjalës «vitore»; «roja e shtëpisë që besohej se ishte një gjarpër i shkurtër e i trashë; një grua që ka lindur shumë fëmijë, fatitë për përfundim të cilat besohej se i vinin foshnjës te djepi natën e tretë për t'i caktuar fatin.»¹⁹. Hahni fjalën vitore e nxjerr me kuptim «plakë e vogël»²⁰. E. Çabej, mbi bazën e një shqyrtimi të thelluar, ia nxjerr kuptimin nga një «vejtore», «ajo që end pëlhurë, endëse»²¹. Sidoqoftë, si në njërin kuptim, si në tjetrin kemi të bëjmë me një plakë që rri në vatë e të dy rastet na e afrojnë me «nënët e vatrës», por na duket më i drejtë mendimi i E. Çabejt. Shpjegimi i E. Çabejt e aftron më shumë me «nënët e vatrës», përfundimisht këtu kemi një lili ose lesh, ashtu si «nënët e vatrës». Rrjedhimisht këtu kemi një lidhje me kultin e së parës së gjinisë të shprehur në trajtë gjarpri, por që ruan lidhje me përfytyrime antropomorfe.

Te shqiptarët e Greqisë, sipas H. Pedersenit, vitoret janë tri fatitë a të mirat, që mendohej se i vinin foshnjës te djepi natën e tretë

16) Arkivi historik i Institutit të Historisë (AHIH): F. Nopça, *Albanien* (vepër dorëshkrim, dërguar N. Joklit nga autori pak kohë para se të vdiste, është zbuluar tanë vonë në arkivin e Joklit në Vjenë), f. 17-18.

17) *Këngë popullore lirike*, Tiranë, 1955, f. 242.

18) I. G. Hahn, «Albanesische Studien», Jena, 1854, f. 162.

19) *Këngë popullore lirike*, f. 326.

20) J. G. Hahn, *vep. cit.*; f. 162 dhe shënimin 80: f. 201.

21) E. Çabej, *Disa figura të besimeve popullore shqiptare* në «Gjurmime Albnologjike» — Folklor e etnologji, II, 1972, Prishtinë, 1974, f. 13.

të lindjes e i caktonin fatin që do të kishte në jetë²². Këtu pra, në disa kuptime «vitorja» na afrohet me «nënën e vatrës», ashtu si na jepet në Myzeqe e ndonjë krahinë tjetër.

Në Shqipérinë e Mesme në përgjithësi e gjejmë me emrin «bolla e shtëpisë», edhe në Kukës e Mirditë më tepër përmendet me emrin «bolla e shtëpisë». Në Nikaj-Mertur, Dukagjin e Malësi të Madhe quhet më tepër me emrin «itoksi» a «toksi», por edhe thjesht «gjarpri i shtëpisë». Thuhet «toksi» se, sipas popullit, «është e tij toka, është i tij vendi ku rri,» është, si të thuash, personifikimi i vendit ku banon. Në krahinat e Alpeve të Shqipërisë quhet dhe me emrin «breva e shtëpisë», emër i një lloj gjarpri që besohet se duhet ta ketë çdo shtëpi e që është roja e shtëpisë.

Në Shqipérinë e Veriut, të Mesme e në Kosovë quhet dhe «ora e shtëpisë» me kuptimin se si gjarpri, ashtu edhe ora e shtëpisë janë dy figura që kryejnë në shumë drejtime të njëjtin funksion, si mbrojtës të shtëpisë në njerëz e pasuri, sado që në tiparet e tyre kanë dallime të theksuara.

Sipas informatave në terren konsiderohej si gjarpër i shtëpisë vetëm një lloj gjarpri. Në Jug (Labëri, Tomoricë etj. thonë se ai është një gjarpër i zi, me një tufë qimesh (tufë leshi) mbi kokë. Në disa raste thuhet për gjarprin me qime mbi krye, se ai është gjarpër me brirë të artë. Që gjarpri i shtëpisë është me brirë apo me lesh, këtë e thonë dhe në Veri të Shqipërisë; në disa raste, ashtu si edhe në Jug, thonë se jo gjithmonë është me brirë apo me lesh në kokë (a në shpinë). Në krahinat shqiptare përmbi Drin thonë se e tillë (gjarpër i shtëpisë) është breva por jo grabovçi; në Shqipëri të Mesme dhe në disa krahina të Veriut ai quhet «bollë e shtëpisë», por në këtë rast nuk jepin kuptim të quartë për bollë të tillë që dallon nga gjarpérinjtë e tjerë. Këtu bolla merr kuptimin e një gjarpri në përgjithësi. Kjo për arsyen se një kult i tillë ruhej si mbeturinë e në rrjedhë të shekujve ka pësuar ndryshime.

Mendojmë se ky dallim midis gjarprit të shtëpisë që është ora e shtëpisë, roja e shtëpisë, mbrojtës i shtëpisë dhe gjarpérinjve të tjerë, që nuk mund të janë të tillë, bëhet për disa arsyen: së pari, ndoshta jo çdo lloj gjarpri ka pasur të bëjë me këtë kult që në lashtësi. Së dyti, me kalimin e shekujve është zbehur dhe, për të justifikuar mbytjen e gjarpérinjve jashtë shtëpisë duhej gjetur arsyaja e kjo arsyen është gjetur duke thënë se ky nuk është nga lloji i gjarprit të shtëpisë. Së terti, të këtij zvarraniku në dy të kundërta: gjapri si kafshë «e shenjtë» dhe gjarpri që bëhet kuçedër, pra personifikues i forcave negative të natyrës dhe të jetës shoqërore. Nga gjurmimet në terren vërejmë se bolla ishte gjarpër «e shenjtë» i shtëpisë, po bolla bëhej edhe Kuçedër, megjithatë, kur i pyet për këtë pleqtë, të thonë se tjetër lloj ishte bolla e shtëpisë e tjetër lloj ishte bolla që bëhej kuçedër. Dihet se në muret e shtëpisë me vrime mund të qëndrojë çfarëdo lloj gjarpri dhe kjo vërtetohet nga të pyeturit e personave të ndryshëm që kanë parë gjarpérinj në vrime të mureve të shtëpive a të kasolleve, a në afërsi

22) E. Çabej, *po aty*, f. 13.

të shtëpive. Nga të gjitha ekspeditat e bëra, në asnjë rast nuk kam mundur të nxjerr, qoftë edhe vetëm një shembull, ku të thuhet se një gjarpër është mbytur në filan vend në shtëpi a në afërsi të shtëpisë, se nuk ishte i llojit të gjarprit që quhet vitorja e shtëpisë (bolla e shtëpisë), itoksi i shtëpisë, breva e shtëpisë. Pra, çdo lloj gjarpri që shihet ose së paku që besohej se banonte në vrima të mureve të shtëpisë, në çati të shtëpisë, në kasolle të bagëtive, kudo në afërsi të shtëpisë, konsiderohej si rojë, si mbrojtës i shtëpisë dhe në asnjë rast nuk mbytej, se një veprim i tillë konsiderohej mëkat i rëndë. Thonë se, edhe kur gjarpéri është gjetur kulaç në djep të fëmijës që ishte duke fjetur, nuk e ka ngarë njeri se «ai është ora e shtëpisë dhe e fëmijës».

Si përfytyrohej në mënyrën më tipike gjarpri (bolla, vitorja, itoksi, breva) i shtëpisë në vise të ndryshme të malësive shqiptare? Mendohej se çdo shtëpi, pa përjashtim, e kishte gjarprin e vet; pa gjarpër shtëpia nuk mund të kishte përparim as në njerëz e as në pasuri. Gjarpri zakonisht rrinte në një vrimë muri në dhomën kryesore të zjarrit (aty ku rrinin gratë); se ku ishte ky gjarpër, e dinte vetëm gruaja më plakë e shtëpisë a gruaja, që ishte zonjë shtëpie, por jo më shumë se dy gra. Ajo e ushqente zakonisht tri herë në ditë me qumësht, me thërrmija buke e me ushqime të tjera, me ç'ti ndodhej. Gjarpri dilte prej vrimës së murit, hante ushqimet e pinte ujin dhe hynte përsëri në vendin e tij. Ali Çufja nga Kuçi i Kurveleshit, 74 vjeç, më 1971 më jep një informatë të tillë: «Në çdo shtëpi të fshatit ka pasur dikur gjarpër përmbarësi; ishte një lloj gjarpri me leshra në kurriz, me xhufkë, rrinte në vërat e murit të shtëpisë, e atë e ushqenin me ç'tu ndodhej. Mbaj mend kur jesh i vogël që nëna e ushqente një gjarpër të tillë. Ai dilte nga një vërë muri dhe aty i hidhej ushqim: bukë, djathë, lëngëra etj. Hante e pastaj futej përsëri në vërë».

Në shumicën e rasteve, sipas besimit populor dhe sipas praktikës, asnjë pjesëtar i familjes, i shtëpisë nuk e dinte se ku rrinte gjarpri i shtëpisë dhe as e shihnin ndonjëherë me sy, po qenia e tij në shtëpi merrej me mend, pavarësisht nga fakti real, që në shumicën e shtëpive të fshatit s'kishte gjarpérinj. Ai që e dinte dhe e kishte parë, qoftë edhe rastësish, vitorën e shtëpisë së tij, nuk duhej t'i tregonte njeriu; një veprim i tillë konsiderohej mëkat, vitorja e shtëpisë mund të ikte apo mund të bëhej e paaptë për t'i sjellë mbarësi shtëpisë në njerëz e pasuri. Në Jug e në Veri tregojnë se kur ndonjëri ka vrarë ndonjë gjarpër në shtëpi, aty kanë ndodhur fatkeqësira, ka vdekur i zoti i shtëpisë, u është djegur shtëpia, ka ngordhur kau i hullisë (i lë-vrimit të tokës), e ndonjë fatkeqësi tjetër.

Besohej se pasuria dhe mbarësia në shtëpi varej nga aftësia ndikuese e vitores a e bollës. Ndodhë vitorja e mirë, me aftësi të mëdha demoniake e shtëpia bënte përpara, toka prodhonte, shtoheshin bagëtitë e shtëpisë; shtëpia bëhej me shumë meshkuj, nuk kishte vdekje, as të natyrshme as të panatyrshme. Kur kishte ndonjë shtëpi me mbarësi e përparim në njerëz e pasuri e që dilte përmbi të tjerat në fshat, thuhej: «C'vitore që ka kjo shtëpi!» «U ç'bollë (a ç'orë) që ka kjo shtëpi!». Kur ndonjë shtëpie i ndodhnin fatkeqësi në njerëz e në kafshë e varfërohej nga ana ekonomike, thuhej se asaj shtëpie i ishte ligështuar vitorja (a bolla). Kështu prà në këtë rast fenomenet e jetës familjare shpjegohen me shkaqe të mbinatyrshme, që kanë të bëjnë

me gjendjen e gjarprit të shtëpisë, e jo me kushtet e jetës shoqërore reale.

Vitorja a bolla e shtëpisë thuhej se ishte e truallit, ishte e shtëpisë. Edhe kur shtëpia braktisej, thuhej se në muret e shembura të saj rrinte vitorja, rrinte gjarpëri i shtëpisë; ai ishte ruajtës, ishte mbrojtës i truallit; një truall pa gjarprin e vet nuk ishte për banim. Besimi që edhe në muret e shembura kishte gjarpër të shtëpisë, shpjegohej me faktin se në vende të tilla të braktisura shihen shpeshherë gjarpérinj që ngrohen në diell, e kjo ndodh nga fakti se në vende të tilla gjenden banesa të qeta e të përshtatshme për ta, për t'u mbrojtur nga të nxeh-tët e verës. nga të ftohtët e dimrit dhe nga armiqtë e mundshëm; këtu gjejnë me lehtësi ushqim, duke ngrënë gjallesa të ndryshme të vogla që shkojnë të strehohen aty.

Në disa raste besohej se, kur njeriu ndërtonte një shtëpi të re, gjarpri i shtëpisë dilte nga shtëpia e vjetër e hynte në shtëpinë e re. Ja një shembull nga malësitë e Tiranës: «Në Bendë e Tomadhe të Tiranës kanë besim shenjtërie «për bollat». Këto nuk i vrissnin e as nuk i mallkonin, se e kishin për keq vrasjen e mallkimin e tyre, përkundrazi, kur i shihnin, u flisnin fjalë ledhatuese... kur kanë shitë shtëpinë e parë e kanë shpërndalë plaçkat në një shtëpi tjetër, po në këtë lagje, ku banon edhe sot ajo familje, janë parë dy bolla të mëdha që kanë dalë nga shtëpia e parë, dhe, mbasi kanë kaluar nëpër kopshitet e familjes Zina, janë futë në atë shtëpi ku është vendosur kjo familje. Plaka e shtëpisë, Malja, kur i ka parë, u ka dalë përpëra dhe i ka ledhatuar me fjalë. Dy bollat janë futë në një brimë muri brenda hajatit të shtëpisë së re. Në Shëngjergj është besimi se bollat janë rojë e shtëpisë e sjellin mbarësi në familje.»²³

Në mënyrë të dukshme deri vonë ruheshin mbeturinat e kultit të gjarprit të shtëpisë, ashtu siç del dhe nga sa është shqyrtuar më lart, por aty-këtu, ndonëse në një mënyrë më të zbehtë e të transformuar, ruhej dhe kulti i gjarprit në përgjithësi. Nga të dhënët e ekspeditatave të autorit dhe të materialit arkival del se në vise të ndryshme të Shqipërisë, në Veri e në Jug, jeton kujtimi i tabusë (i ndalimit): të shihen gjarpérinjtë, të preken gjarpérinjtë, të mbyten gjarpérinjtë²⁴, duke e konsideruar një veprim të tillë mëkat e me pasoja të rënda fatkeqësish për atë që prek a mbyt gjarprin. Dihet se në përgjithësi i mbytnin gjarpérinjtë që takoheshin në natyrë e si tabu mbytja e tyre ruhej vetëm në pak njerëz me moshë të vjetër, ose vetëm në kujtimet e tyre.

Që kulti i gjarprit të shuhej shpejt, si shfaqje e përgjithshme, ka ndikuar dhe propaganda e klerikëve kristianë që dënonte çdo rit e kult pagan, që nuk i shkonte përshtat dogmës kristiane. Informuesit (fshatarë të moshuar) tregojnë se fretrit e jezuitët u thoshnin: «Gjarprin kudo që ta gjeni, duhet ta mbytni, qoftë në shtëpi, qoftë jashtë (larg saj)». Kristianizmi dihet se gjarprin e ka si personifikim të shejtanit, pra, kulti i gjarprit në malësorë binte në kundërshtim me dogmën kristiane. Me-

23) A. Keta, *Besime të kota*, AE, f. 14-15.

24) Në Mirditë e në disa krahina të tjera thonë se, po të mbytësh një gjarpr, të nesërmën të dalin tre përpëra e të zenë rrugën. Thonë se, po të mbytësh një gjarpër, nuk mund të flesh rehat natën, se të del në èndërr. Diku e shpjegojnë mbytjen e gjarprit me fatkeqësi në prodhimtari bujqësore e në bagëti.

gjithatë kulti i gjarprit është ruajtur, se për jetën e fshatarit, me sa duket, ky kult, duke qenë i përbashkët për gjithë shqiptarët, ishte më i padëmshëm se dogma kristiane që i skllavëronte shpirrat e njerëzve, që fuste përçarje midis njerëzve me besime të ndryshme, ose dhe veçime e persekutime të njerëzve që nuk respektonin dogmën fetare.

Besa me gjarpërinxjtë është një aspekt i veçantë i këtij kulti. Në Malësitë e Veriut, sidomos në Malësi të Madhe, në Dukagjin e në Nikaj-Mertur etj. ekzistonte zakoni që në pranverë të kryhej një rit i lidhjes së besës me gjarpërinxjtë. «Me i pa tre toksa bashkë në Dukagjin, nuk të lanë pleqtë me i mbytë, pse ashtë keq. Në ma të parin gjarpër që ndeshim në ditë të pranverës, duhet me lidhë besë tuj thanë këto fjalë: Tosk, po lidhim besë ndër vedi, t'i mos me më xanë mue askurnji rob shtëpijet, e unë, kudo të ndeshi ty, mos me të mbytë». Kostari para se të shtjerë kosën në livadh, do t'u flasë toksave këto fjalë: «Në kjoshtoks, në këtë livadh, prapou sa të kosit barin, pse kem besë ndër vedi, mos më të mbytë unë ty, as mos me më zanë ti mue.» Në këtë rast kemi të bëjmë me gjarprin si personifikim, si zotërues e mbrojtës i tokës dhe i pjellorisë së saj. Ruajtja e këtij kulti bashkë me ritet përkatëse ka të bëjë dhe me frikën nga të kafshuarit e gjarprit, kur e ndesh gjatë punës.

Me interes është besimi, sipas të cilit koka e gjarprit si hajmali i mbron fëmijët nga sëmundjet e nga syri i keq. Nganjëherë si hajmali bëjnë jo kokën e gjarprit, por lëkurën që e lëshon vetë gjarpri kur e ndërron. Në Myzeqe, në Tomoricë e krahina të tjera, thuhet se kokën apo «bririn» e gjarprit ua varin në qafë fëmijëve, për të mos u ngrënë nga syri i keq dhe trimave të pushkës, për të mos u kapur nga plumbat e armikut²⁵. Në Myzeqe dhe Tiranë e përdorim lëkurën e gjarprit, gjakun e gjarprit e diku kokën si hajmali kundër sëmundjes së tokës (epilepsisë)²⁶. Në Malësi të Tiranës ekzistonte një rit interesant, sipas të cilit me anën e gjarpërit i jepej mençuri fëmijës. Riti ishte ky: Merrnin një kakzogëz të vogël (gjarpër nga ata të padëmshmit, bullar) dhe ia fusnin fëmijës në gojë. Mbasit e mbante pak, ia qisnin dhe e hidhnin në tokë. Kakzogëza sipas besimit popullor, hynte në punë edhe për t'i bërë të mënçura si zonja shtëpie e nikoqire të mira vajzat, kjo si shprehje e një botëkuptimi patriarchal. Për qëllimin e fundit e merrnin kakëzogëzën dhe ia sjellin vajzës përqark mesit tre herë²⁷.

Në disa raste ritet e besimet në lidhje me gjarprin kishin të bënnin me mbarësi në shtëpi, në jetën familjare e prodhimtari bujqësore e blektorale. Bile kishte dhe ndalesa në lidhje me ngarjen e gjarpërinjve me arsyen se një veprim i tillë shkaktonte dëm në bagëti a në bereqete. Në lidhje me këtë të fundit kishte dhe shumë eufemizma të lindura nga frika që kishin besimtarët për të zënë në gojë emrin e gjarprit, prandaj dhe e kanë quajtur «toka», «dheu», «ai i dheut» e kështu me radhë²⁸. Malësorët, kur mbjellin misrin, thonë: «O i zoti i

25) J. Nushi, *art. cit.* fq. 324; shih dhe «Besime të popullit të Tiranës» në «Diturija», 1928, Nr. 4; f. 146.

26) J. Nushi, *art. cit.*, fq. 324. Material në lidhje me kokën, bririn, lëkurën e gjarprit të përdorur si hajmali kemi mbledhur dhe në ekspeditat tonë në vise të ndryshme.

27) Besime të popullit të Tiranës, «Diturija», 1920, Nr. 4, f. 148.

28) E. Çabej, *Disa eufemizma...*, f. 75-76.

arës, lëshoja tokën farës.²⁹ Pra, i luteshin gjarprit, që konsiderohej si i zoti i tokës, që t'ua lëshonte tokën për ta punuar. Mendojmë se këtu kemi të bëjmë me një kult të lashtë të tokës, demon i së cilës është gjarpri, fenomen që e ndeshim dhe në popuj të tjerë të botës. Në këtë rast demonit i bëhej lutje për pjellori toke, si zotërues i së cilës ishte ai.

Besohej se për mbarësi në njerëz, në shtëpi e prodhimitari të mirë bujqësore e blektorale është mirë të kesh në shtëpi «brirë» gjarpri a kokë gjarpri. Këtë besim e ndeshim në Myzeqe³⁰, në Tomoricë e në krahina të tjera të vendit tonë.

Është me rëndësi të shënohet fakti se kudo te shqiptarët bëheshin rite në disa festa tradicionale të vitit, si për Ditën e Verës (një mars) ku lidheshin gjarpérinjtë, për llazore ku dëboheshin gjarpérinjtë, ose për Shëngjergj, ku bëheshin rite magjike të ndryshme me kokë gjarpri, me lëkurën gjarpri, apo shqiptoheshin formula të ndryshme magjike drejtuar gjarpérinjve. Në Prizren shumë elemente të llazoreve kanë të bëjnë me rite magjike lidhur me gjarpérinjtë, si djegien e tyre etj. Mendohet në përgjithësi se këto kanë origjinë totemike, ashtu siç e ndeshim dhe në popuj të tjerë indoevropianë, ku gjarpri na del si kafshë kulti dhe me të tilla tipare³¹.

Rite me gjarprin për pjellori e mbarësi në festa të ndryshme të stinës së pranverës gjejmë në vise të ndryshme të banuara nga shqiptarët. Në Rrafsh të Dukagjinit (Kosovë), kulti i gjarprit të shtëpisë është ruajtur i fortë. Gjurmë interesante të kultit të gjarprit gjejmë në rrethet e Shkupit³². Më 22 mars bëhen pelegrinazhe (si festë pranvere) ku ngjiten në Malin Zmijarnik (afër Shkupit), aty kapin gjarpérinj dhe i bëjnë të rrëshqasin mbi rroba dhe, duke kryer këtë rit, shpresojnë të kenë fëmijë. Pra, këtu kemi lidhje midis kultit të gjarprit dhe pjellorisë së gruas, rit ky shumë i lashtë dhe me origjinë të qartë totemike.

Gjarpri në besimet popullore në gjithë truallin e banuar nga shqiptarët na del si mbrojtës thesarësh të fshehura nën tokë. Në Veri ky shpeshherë na paraqitet këtu dhe me emrin e orës, duke e quajtur «orë rojë» e thesarëve që, sipas besimit populor, gjenden në gërmadha. Është me interes të përmëndim një thënie të Hahnit, sipas të cilit «toskët besojnë se thesarët i ruajnë gjarpérinj me fletë, të cilët nxjerrin zjarr nga goja»³³. Mendojmë se kjo thënie është një fosile e ardhur nga lashtësia, për të cilën do të flasim kur të bëjmë fjalë për kuçedrën, meqënëse në këtë formë na paraqitet përbindëshi i lashtë në formë kuçedre, që e ndeshim në popuj të ndryshëm të botës. Duhet vënë në dukje se në këto raste na del me atribute të një hyjnie të tokës; është zotëruesi i saj, prandaj ruan dhe vlerat e futura në të.

29) E. Çabej, *po aty*, f. 75-76.

30) J. Nushi, *art. cit.*, f. 324.

31) S. Zečević, *Kult zmije kao komponent lazariće*, «Glasnik Muzeja Kosova i Metohije», X, 1970, f. 137-138.

32) M. S. Filipović *Kult zmije u okolini Skoplja*, «Miscellana», Beograd, 1937, f. 138-149.

33) J. G. Hahn, *vep. cit.*, f. 162.

Paraqitjen e orës në pamje të gjarprit e ndeshim në shumë raste në folklorin popullor shqiptar, në përralla, në legjenda e më shumë në rapsoditë e ciklit të kreshnikëve. Aty gjarpri prej të cilat kreshniku kishte shumë frikë kthehet menjëherë në një vajzë e nga kjo ai kupton se ajo kishte qenë ora. Gjarpri na paraqitet si shëruar plagësh, si këngëtar e në forma të tjera në shërbim të kreshnikëve³⁴. Siç del nga materiali i shqyrtuar më lart, kryesor është kulti i gjarprit të shtëpisë dhe më i zbehtë është kulti i gjarprit në përgjithësi. Megjithatë mendojmë se në këto aspekte e dëshmi të ndryshme duhet të gjejmë shtresa të ndryshme në lidhje me këtë kult, që nga ato më të lashtat e deri te shtresat e ndryshimet më «të reja».

Në popull ndeshet edhe besimi se gjarpri është personifikimi i shejtanit. Dihet se një besim i tillë është interpretim i kristianizmit, që është përdorur për dy qëllime në propagandën e klerikëve: së pari, për të shpjeguar me gjëra konkrete kundërvënien e perëndisë kristiane, shejtanin, dhe së dyti, për të zhdukur mbeturinat e atyre kulteve me origjinë të lashtë, që ruante populli ynë e që binin në kundërshtim me dogmën kristiane.

Në kisha të ndryshme të Shqipërisë, në Jug e në Veri, që nga ato mesjetare e deri tek ato të shek. tonë, në piktura të ndryshme ndeshim këtë pamje: Shën Gjergji në kalë mbyt përbindëshin-gjarpër me heshtë a me shpatë. Dihet që kjo figurë është simbol i fitores së kristianizmit kundër kulteve vendase. Megjithatë në shumë raste kultet vendase vetëm sa janë mbuluar me një cipë kristiane; ndërsa në brendi kanë mbetur, sigurisht duke u transformuar e ndryshuar në përshtatje me kushtet e reja historike, ashtu siç ka ndodhur dhe në popuj të tjerë të Ballkanit e të Evropës në përgjithësi³⁵.

Me interes për shqyrtimin tonë është dhe legjenda mbi djalin-gjarpër. Këtë legjendë e gjejmë në forma të ndryshme në vise të ndryshme të Shqipërisë, por ne po e tregojmë ashtu siç na paraqitet në një legjendë në vargje të mbledhura në breg të Matës e nga banorë me origjinë nga Malësia e Madhe. Një grua, pas 9 vjetësh martese, bën një fëmijë-gjarpër. Kur rritet, ky fëmijë i çuditshëm kërkon të martohet me të bijën e mbretit. Prindërit e tij detyrohen ta lypin këtë vajzë për djalin, por mbreti ua jep vetëm, po të shtrojnë me florinj një rrugë 7 sahat të gjatë. Rruga u bë ashtu siç deshi mbreti. E éma e djalit çuditej se si e bija e mbretit tregohej e kënaqur nga martesa me një gjarpër. Po, në të vërtetë, ai s'ishte i tillë; natën kthehej në një djalë të bukur të pashoq. E éma i zë një natë papandehur cipën e gjarprit-djalë dhe ia djeg që të mos kthehej në gjarpër, por djali me t'u djegur cipa vdes³⁶. Siç na del nga këto dëshmi (si kjo që u paraqit më lart ka dhe të tjera), këtu kemi të bëjmë me një nga format e paraqitjes së totemit si shndërrim nga gjarpër në njeri e nga

34) Q. Haxhihasani, *Këngë popullore legjendare*, Tiranë 1955, f. 191 dhe f. 302-303. Këtu nuk u zgjata shumë në analizën e orës së kthyer në gjarpër, meqenëse për këtë figurë flitet në mënyrë të veçantë në një punim tjetër.

35) Shih në lidhje me këtë dhe R. Ferri: *Prilog poznavnja ilirske mitologije*. «Analji god», Il Dubrovnik 1953, f. 419-429.

36) Q. Haxhihasani, *Këngë popullore legjendare*, f. 99-103.

njeri në gjarpër, elementë që i ndeshim dhe në fenomenet totemike të popujve të tjerë.

Shënojmë këtu se variante apo motërzime të legjendës në lidhje me «djalin-gjarpër» gjemjë dhe në territorin e Kosovës³⁷, në arbëreshët e Greqisë e arbëreshët e Italisë, gjemjë dhe në krahina të ndryshme të territorit shqiptar, gjë që dëshmon për një shtrirje të gjerë të këtij riti.

Për kultin e gjarprit të shtëpisë dhe gjarprit në përgjithësi na flet qartë dhe ornamentika popullore. Gjarpérinj ose vija spirale të lakuara në formë gjarpri i gjemjë të gdhendura në objekte prej druri, në gur, në baltë; në dru më tepër në zonat malore, ku është e zhvilluar blegtoria e malësorët blegtore banojnë afër tyre. Kështu gjarprin të gdhendur në lahitë e gjemjë në Kuç, Hot e Triepsh të Malit të Zi, në Kelmend, në Kastrat, në Dukagjin, në Nikaj-Mertur e në Malësinë e Gjakovës; në këto krahina e gjemjë të gdhendur gjarprin dhe në shkopinj (kërraba), në furka, në djepa e në objekte të tjera të jetës familjare. Gjarprin e gjemjë të qëndisur në disa raste në xhubletën e gruas së Malësisë së Madhe dhe në mbeturinat e xhubletës të ruajtura në Nikaj-Mertur, në Mertur të Gurit e deri në Iballë të Pukës. Edhe në krahina të tjera të Shqipërisë së Veriut e të Mesme e gjemjë të gdhedur gjarprin në objekte të ndryshme të jetës familjare. Në Jug gjarprin e gjemjë të gdhendur në shkopinj (kërraba) në furka, në pipa duhani dhe në cyle dyjare të barinjve në Labëri, në Therepel të Skraparit, në Tomoricë etj. Në Dukagjin e Mirditë gjemjë të gdhendur har-kun spiral në dyert e shtëpive, që në origjinë është simbol i gjarprit. Gjarpérinjtë i gjemjë të gdhendur dhe në muret e shtëpive në Përmet, ku zakonisht dyert bëheshin me hark të gdhendur rrëth derës dhe midis zbukurimesh të tjera dhe dy gjarpérinj në të dyja anët e derës³⁸. (Për të tilla zbukurime me gjarpérinj shih dhe figurat dhe skicat përkatëse 1,2,3,4,5,6,7).*

Duhet të shtojmë këtu se dhe në qëndisje të tjera përveç xhubletës, ndeshim jorrallë gjarpérinj të bërë në to, ose spirale në formë gjarpërinjsh³⁹. Mendojmë se edhe këto zbukurime në origjinë kanë të bëjnë me kultin e gjarprit në përfytyrimet mitike në lidhje me të. Pra, fillimisht, këto figura kanë qenë me karakter mbrojtës dobiprurës. Ta zëmë gjarpri në shkop, gjarpri në djep është përfytyruar si një shpirt-mbrojtës përmes mbartësin e tij. Në kohë të vona këto zbukurime kanë kaluar në funksione thjesht artistike, duke humbur kuptimin e tyre të vjetër.

Në lidhje me këtë le të kujtojmë etnografin e parë shqiptar, patriotin Shtjefën Gjeçovi, i cili shkopin që mbajti me vete për 30-vjet me radhë e kishte të gdhendur në formën e një gjarpri dhe këtë e kishtë bërë, natyrisht, i frysmezuar nga simbolika e mitologjisë popullore shqiptare përmes gjarprin⁴⁰: ishte një imitim i shkopinjve me gjarpër që mbanin malësorët tanë.

37) D. Shala, *Martesa e gjarprit në letërsinë popullore shqipe*, «Dituria», 1, Prishtinë, 1971, f. 93-106.

38) Pano Tase, *Legjendë...*, AE, f. 141-142.

* Të gjitha skicat janë punuar nga skicografi Gjergji Martini.

39) Për këtë shih dhe M. E. Durham, *vep. cit.*, f. 127.

40) Shkopi i Shtjefën Gjeçovit ruhet në Muzeun Popullor të Shkodrës.




FIG. Nr. 1

DORZË E KËRRABËS SË
BARIUT TË JUGUT




FIG. Nr. 2

DORZË E KËRRABËS SË
BARIUT TË JUGUT.

FIG. Nr. 3

ÇIBUKU NGA FSHATRAT
E KORÇËS.




FIG. NO. 4

BASTUN NGA SHQIPERIA Ë VETIUT
TARTANIS



FIG. NO. 5

BASTUN NGA SHQIPERIA Ë MESME




Fig. Nr. 6.



FIG. Nr 7 GJARPËR NË DERË TË SHTËPISË NË NJË KULLË NË RRAFSH TË DUKAGJINIT—KOSOVË

Në Dukagjin dhe në Labëri⁴¹ gjarprin e kemi ndeshur dhe në tatuazhet që bënin burrat, në krah. Për trevën Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi, Shkup etj. të dhëna me rëndësi pér mbeturinat e kultit të gjarprit na jep dhe Ferri⁴². Meriton të vihet në dukje se ky autor na jep disa toponime pér maja malesh që quhen dhe *Maja e Shëngjergjit* dhe *Maja e Gjarpérinje*, ose që në mesjetë janë quajtur Maja e Gjarprit e më vonë janë ndryshuar në Maja e Shëngjergjit. Të tilla maja e kodra të Shëngjergjit a të gjarprit kemi dhe në Shqipëri; në këto toponime kemi dy shtresa me ide krejt të kundërtë; paganizmi i përfaqësuar me gjarprin dhe Shëngjergji, që në mitologjinë kristiane është mbytësi i gjarprit, veprim që simbolizon mundjen e paganizmit e zëvendësimin e tij nga kristianizmi. Ferri, duke përdorur dëshmi gjuhësore, historike e etnografike, bën përpjekje pér të bërë lidhje midis ilirëve e shqiptarëve pér sa i përket këtij kulti.

Për kultin e gjarprit tek ilirët kemi disa dëshmi historike e arkeologjike, kemi dhe mendime nga autorë të ndryshëm në lidhje me të. Ky kult tek ilirët ishte shumë i përhapur e, aq më tepër, si një kult që kishte të bënte me vatrën familjare si kafshë ktonike shumë e rëndësi-shme e lidhur me kultin e të parëve të familjes, e lidhur me pjellorinë e tokës e të gruas. Të përmendim këtu legjendën e fenikasit Kadim dhe gruas së tij Armonia, të cilët, pasi erdhën tek ilirët, ku dhe vdiqën, vazhduan të jetonin pas vdekjes në formë gjarpérinjsh. Djali i tyre Iliriosi, heroi eponim i etnosit ilir, na del në trajtën e gjarprit; e pra, këtu lehtësisht mund të mendojmë se kemi të bëjmë me një totëm më të përgjithshëm të ilirëve, ashtu siç na del nga kjo legjendë mitike⁴³. Le të sjellim këtu edhe një legjendë tjetër të afërt me të parën, të dhënë nga Plutarku. Aleksandri i Madh ishte i biri i Olympias, (kishte lindur në Epir, pra në një trevë që i përket etnosit ilir) dhe i një gjarpri⁴⁴. Duke u mbështetur në faktin e këtij riti, që na thotë se Aleksandri kishte si babë të tij një gjarpër, mendojmë se kemi të bëjmë me një element totemik të trevës ilire.

Në arkeologji dëshmitë në lidhje me kultin e gjarprit janë të shumta në gjithë trevën e banuar nga ilirët, ndonëse ndonjë studim përgjithësues në lidhje me objektet me figura gjarpri në to nuk është bërë, por në lidhje me këtë janë dhënë mendime të shkëputura, ku mbizoteron mendimi se ato figura (të gjarpérinjëve) kanë të bëjnë me kultin e gjarprit si mbrojtës i vatrës familjare, si mbrojtës i njerëzve, si simbol i pjellorisë. Po sjellim disa prej këtyre dëshmive. Një nga më interesantet është paraqitura e një gjarpri në një brez të gjetur në varrin monumental të Selcës së Poshtme (afér Pogradecit) nga arkeologu Neritan Ceka⁴⁵. Aty na paraqitet një luftëtar ilir mbi kalë duke u ndeshur me armiqtë, pas shpinës së tij ndodhet një gjarpër. Ky na kujton orën (engjëllin mbrojtës) në mitologjinë shqiptare, që i rri gjithnjë mbas njeriut, bile ngadonjëherë e paraqitur dhe në pamjen e gjarprit, dhe e

41) Për Labërinë shih dhe: Rr. Zojzi, *Ditari i terrenit*, 1952, AE, f. 375-377.

42) R. Ferri, *art. cit.*, f. 419-429.

43) S. Lisicar, *Legenda o Kadmu i veze Libnida s Egejom i Jadranom*, «Ziva antika», 1953, Nr. 3, fq. 245-261. Ilirët dhe Iliria, Tiranë 1965, fq. 75:

44) CH. Picard, *Aigle et serpent*, «Starinar», n.s. 13-14, 1963, f. 4-6.

45) *Shqipëria arkeologjike*, Tiranë, 1971, f. 47 e shënimi përkatës 47.

mbron atë gjatë veprimeve të tij të vështira. Një objekt i tillë me gjarpër eshtë gjetur dhe në nekropolin e Gostiljes, pranë liqenit të Shkodrës në Mal të Zi nga arkeologu Basler⁴⁶. Në qytetin ilir Dimal eshtë zbuluar nga arkeologu B. Dauti një kokë gjarpri dhe këtu duhet menduar se kemi të bëjmë me një objekt kulti⁴⁷. Në kalanë e Hollmit në Kolonjë eshtë gjetur në një skulpturë qeramike, Armilla, me kokën e gjarprit⁴⁸. Në lokalitetin e Qesaratit eshtë gjetur truproja e një hyjneshe lokale të bollëkut. Kjo hyjneshë mban në dorën e majtë një shportë, rreth së cilës eshtë mbështjellë një gjarpër⁴⁹. Gjarprin e ndeshim dhe në monedhat e Labeatëve të zbuluara në Çinamak të Kukësit. Aty kemi të bëjmë me gjarpérinj të përfytyruar në anjet ilire; këtu gjarpri na del si shpirt mbrojtës i njerëzve në udhëtime detare. Me interes për mitologjinë ilire janë dhe përfytyrimet e gjarprit në monedhat e Bylisit, Apolonisë, Dyrrahut, Olympias dhe Amantias⁵⁰.

Dëshmitë për gjarprin në trevën e banuar nga ilirët dhe krahasi-mi i tyre me dëshmitë etnografike shqiptare flasin në të mirë të një vazhdimesie iliro-shqiptare të kësaj dukurie. Këtë mendim e përforcon dhe fakti se ultësirat bregdetare të trevës ilire⁵¹ dhe të trevës shqiptare mesjetare kanë qenë shumë të pasura me gjarpérinj, dhe, ashtu si edhe në lashtësi, dhe gjatë mesjetës, kulti i gjarprit ka pasur një bazë shumë të fortë në këto anë, bile jo vetëm në ultësira por dhe në male të trevës shqiptare të mesjetës. Për periudhën e mesjetës dëshmi me shumë interes na sjellin R. Ferri, Kulishiç i autorë të tjere.

Më duket se eshtë i drejtë, për sa japid faktet, mendimi i autorëve të ndryshëm që e konsiderojnë këtë kult (për traditën ballkanike) paleoballkanik. Një nga studiuesit e këtij fenomeni eshtë Kulishiç, i cili të dhënat etnografike i ka krahasuar me të dhënat nga ilirët dhe këtë fenomen na e bie si paleoballkanik dhe që ndeshet dendur tek ilirët⁵². Duhet theksuar se për ruajtjen e këtij kulti nga lashtësia e deri në këta shekujt e fundit kanë ndihmuar në rolin e përforcuesit dhe huazimet reciproke në lidhje me këtë kult, siç ka ngjarë dhe për shumë fenomene të tjera. Bile, ndoshta, tipare të veçanta të këtij kulti janë të huajtura nga një popull fqinj te tjetri. Kjo eshtë krejt e natyrshme dhe ë shpjegueshme për popujt e Ballkanit që gjatë rrjedhës së historisë kanë qenë në kontakte të vazhdueshme midis tyre, bile shumë të dukshme kanë qenë dhe imigrimet e emigrimet e këtyre popujve brenda trevës ballkanike.

Çnxjerrim si rrjedhim nga studimi i kultit të gjarprit të shtëpisë?

Kulti i gjarprit në funksion të të parëve mitikë, ose dhe në tipare të një hyjnje të pjellorisë së tokës, në njerëz, me të gjitha këto veti

46) D. Basler, *Nekropoïna velim ledinama u Gostilju*, «Glasnik Zemaljskog muzeja», Arkeologija, n. s. 24 – 1969, f. 9. Tab: XXV:

47) B. Dautaj, *La découverte de la cité illyrienne de Dimale*, «*Studia Albaniaca*», 1965, Nr. 2, f. 98, fig. c.

48) S. Aliu «Një qytezë e re ilire në Shqipërinë Juglindore, në «Konf. II St. Alb». Tiranë, 1969, vëll. 2, fq. 355, Tab. IV.

49) S. Anamali — H. Ceka, *Disa skulptura të pabotuara të muzeut arkeologjik-etnografik të Tiranës*, «B.U.SH.T.», 3, 1959, f. 83, fig. 11.

50) H. Ceka — Probleme të numismatikës ilire, Tiranë, 1967, kapitujt, sythët e tabelat përkatëse për Bylysin, Apoloninë, Dyrrahun, Olimpian dhe Amantian.

51) S. Kulisić, *Is stare srpske religije*, Beograd, 1971, f. 12.

52) S. Kulisić, *vep. cit.*, Beograd, 1970, f. 137-139 dhe 156.

me të cilat shfaqet te ne, ka të bëjë me mjedise ku mbeturinat e organizimit patriarkal të shoqërisë kanë qenë ruajtur të forta dhe kjo është shprehje e një botëkuptimi të tillë. Në qoftë se në një anë është shprehje e një qëndrese kundër asimilimit nga të huajt, në anë tjetër është shprehje e atyre rrethanave historike ku ka jetuar e është zhvilluar populli ynë, shprehje e pafuqishmërisë së tij, e një niveli të ulët të zhvillimit të forcave prodhuase të shoqërisë shqiptare, që ishte akoma e pafuqishme për të përballuar me mjete reale kushtet e vështira të jetesës.

Kulti i gjarprit të shtëpisë shtrihet, në mënyrë të barabartë në të gjitha trevat shqiptare, dhe në trevat jashtë Shqipërisë, të banuara nga shqiptarët, për aq sa janë dëshmitë e mbledhura (duke marrë për bazë gjithë të dhënë faktike nga shek. XIX e fillimi i shek XX. dhe kryesisht të dhëna nga fshatra e krahina të caktuara); shtrihet në gjithë trevën e banuar nga ilirët.

Emrat më tradicionalë të gjarprit të shtëpisë në treva të ndryshme të banuara nga shqiptarët na dalin: *vitorja* në Jug të Shqipërisë dhe deri në Shqipërinë e Mesme dhe te shqiptarët e Greqisë; *bolla*, emër më i rëndomtë i gjarprit të shtëpisë në Shqipëri të Mesme e në Veri deri në Kosovë. Në Veri përdoreshin dhe emrat *toksi* e *breva*.

Ky kult totemic ruan disa tipare që i takojnë rendit të gjinisë, vëçanërisht duke u përfytyruar nganjëherë dhe si i afërt me një plakë, gjarpri i shtëpisë; qenia e tij në shtëpi duhet të dihet nga gratë; në veri emri i bollës është i rëndomtë dhe si emër gruaje ose si epitet që u vënë femrave, gjithashtu me personifikimin e saj në kuçedër, ashtu siç ndodh dhe për gruan, ruan tiparet që kanë të bëjnë me pjetorinë e gruas dhe në lidhje me këtë dhe shumë tipare totemike.

Por duhet thënë se ky kult në tiparet e tij më thelbësore ka kaluar në kult të fisit dhe kjo e gjen shprehjen e vet në besimin se bolla e shtëpisë a vitorja është faktor i rëndësishëm në shtimin e mashkulisë, shtim në prodhimtari bujqësore e blegtorale. Kjo gjen shprehjen e vet dhe në thënien se, po të mbytet gjarpri i shtëpisë, vdes i zoti i shtëpisë; një shprehje të tillë e gjen dhe në identifikimin e tij me orën e me draguan, dy figura të tjera mitologjike që janë mbrojtëse të familjes patriarkale të fisit dhe vazhdimësisë së tyre, mbarësisë në njerëz dhe pasuri.

Në kultin e gjarprit të shtëpisë shohim lidhje të ngushta me kultin e vatrës, animizimin e vatrës, pra ai na del si shpirt i vatrës, si shpirt i shtëpisë, qenia e të cilët na sjell mbarësi në shtëpi. Kulti i gjarprit të shtëpisë dhe i gjarprit në përgjithësi kanë një lidhje të pandashme dhe në këtë kuptim na paraqitet në dy rastet si shpirt i tokës, si zotërues i saj, pra si njëfarë hyjnie e saj; «është i tij trolli i shtëpisë». është e tij toka (që mbillet apo që është kulloso për bagëti). Ai është rojë e tyre. Pra, këtu kemi të bëjmë, ndër të tjera, dhe me tipare të demonit të pjellorisë së tokës.

Krahas me kultin e gjarprit të shtëpisë dhe, natyrisht, në lidhje të ngushtë me të e me funksionin e tij totemik e animistik, ruhet dhe kulti i gjarprit në përgjithësi dhe kjo shprehet në mbeturinat e tabusë për ta parë, për ta prekur (ose për ta ngarë) e aq më tepër për ta mbytur. Kjo shprehet dhe në besimet totemike të kthimit të njeriut në gjarpër e anasjelltas, shprehet dhe te përfytyrimet e tij në rolin

mbrojtës të njeriut në rrithana të vështira të jetës, në rolin e tij shërues, si penges sëmundjesh a fatkeqësish.

Paralelet e këtij kulti totemik të të parëve i gjejmë tek ilirët, bile, me sa na japid dëshmitë historike e arkeologjike, me tipare të përafërt funksionale me ato që na japid burimet etnografike të dy shekujve të fundit. Duke e parë këtë kult si fenomen indoevropian (nga tiparet e përafërt me të) dhe si fenomen universal, na bën të mendojmë njëherësh se këtu kemi të bëjmë me një kult të trashëguar nga koha e treva e banorëve ilirë, ose, për të qenë më të saktë, si një fenomen paleoballkanik, por që kultin më të fortë e ka pasur në trevë ilire dhe që prej andej është trashëguar, në rrugën e gjatë historike, deri te shqiptarët e sotëm.

GJINJTË E GRUAS

Ashtu si dhe në popuj të tjerë të Evropës, a të botës në përgjithësi, dhe te shqiptarët ruhet kulti i pragut të derës së shtëpisë ose, si mund të themi ndryshe, kulti i derës së shtëpisë. Sipas besimeve popullore, thuhej se nën prag të derës rrinë shpirrat e të parëve, ose se aty rrinë orët; në ndonjë rast thuhej se aty rri gjarpri i shtëpisë. Në Berat e krahina të tjera të Shqipërisë thuhej se aty rrinë engjëjt mbrojtës ose se aty rrinë shpirrat. Në lidhje me pragun e derës si rezultat i këtij kulti ka disa ndalime: në prag të derës të mos pijë njeri ujë natën, se shuplaket nga shpirrat (orët a engjëjt); në disa raste ndalohej të rrinte njeriu në prag të derës⁵³. Nganjëherë thuhej se pragu i derës duhej kaluar me të kapërcyer e jo me të shkelur në të. Një nga shkaqet e ekzistencës së këtij kulti, siç e shpjegojnë etnologë të ndryshëm, është fakti se në kohë të lashta pragu i derës ishte vendi i varrimit të të parëve të familjes, pra i varrimit të të vdekurve⁵⁴.

Varrimin në vatër e ndeshim dhe tek ilirët në Bosnjë e Hercegovinë. Natyrisht, një arsy e fortë e ruajtjes, ndoshta që ka të bëjë dhe me origjinën e këtij kulti (si faktor ndihmës e përfocues), është fakti që dera është për njeriun si cak, si kufi ku fillon mbrojtja e tij në banesë nga armiqjtë, kafshët e egra, agjentët e ndryshëm të natyrës që kërcënojnë jetën e njeriut; dera është vendi ku ndahet apo takohet njeriu me natyrën, me ambientin e jashtëm. Për këto arsyë duhet gjetur dera, pragu i derës, porta e oborrit, si vend magjish; për ruajtjen nga e keqja shqiptari, ashtu si edhe popuj të tjerë indoevropianë, vinte hekura në derë, më tepër potkonj kali. Thuhej në besimet popullore, se shtrigat nën prag të derës fshihnin një enë dheu me melhemin e tyre të zi, me të cilin lyenin trupin para se të fillonin veprimtarinë e tyre si shtriga.

Ky kult na shfaqet në një masë të dukshme në zbulimet që bëhen në murin rrith derës së shtëpisë. Ato, natyrisht, në një kohë të lashtë kanë pasur karakter magjik mbrojtës kundër së keqes, kundër shpirtrave të këqija, për fatbardhësi në familje e mbarësi në prodhimtarët e tijës së shtim pasurie. Kulti i pragut të derës na del

53) Veç të tjerash shih për këtë dhe: F. Ndocaj, *Bestytni*, AE, f. 4.

54) L. J. Shternberg, *vep. cit.*, f. 336

më tepër si një kult i shoqërisë patriarchale dhe kjo shprehet ndër të tjera dhe në faktin se me kultin e derës është i lidhur kulti i metaleve e kulti i forcës së burrit, në përgjithësi i shtesës e fuqizimit të shtëpisë në meshkuj. Këtë e vërejmë në disa figura burrash që bëhen-shin në derë e që i ndeshim në Malësi të Madhe, Berat etj., përmbarësi e fat në shtëpi⁵⁵, në ekzistencën e dorës së plakut të shtëpisë të bërë në derë, e që ka të bëjë me kultin e plakut si i parë i shtëpisë, shenjë kjo që simbolizon pozitën e tij zotëruese në familjen patriarchale e që kishte të bënte me mbeturina të forta të këtij sundimi patriarchal.

Nuk do të ndalemi në analizën e këtyre që radhita më sipër, por në një element tjetër që e ka origjinën te kulti i nënës si e parë e gjinisë.

Përmë disa gjurmë të matriarkatit në disa zakone të popullit tonë, si në fenomenin e mërkoshit, lehonisë së burrave, përvirgjnat, përkthimin në gjini dhe disa shfaqje të ovunkulatit ka bërë fjalë etnografsja A. Gjergji⁵⁶ në një punim të saj të veçantë e në analizën e këtyre çështjeve nuk do të ndalem. Në këtë rast do të përqëndrohem vetëm në ato kulte, rite, besime, mite që kanë të bëjnë me gjinjtë, gjendrat e qumështit të gruas.

S'ka dyshim se kulti i gjinjve të gruas, si burim i qumështit të parë me të cilin është ushqyer dhe njeriu më primitiv, me të cilin ushqehet edhe njeriu modern në përgjithësi në disa muaj apo në vitin e parë të jetës së tij, ka arsyet e veta që të jetojë si mbeturinë deri në këia shekujt e fundit, kjo, natyrisht, në mqedise me mbeturina patriarchale.

Gjatë ekspeditave në Dukagjin kemi vërejtur se në disa shtëpi ishin skalitur në relief të lartë anës derës sisë grash me zgjatje horizontale të majave (thithkave). Vërejtjet e mia i kam plotësuar dhe me të dhënat e informatorëve që më thanë se të tilla kishte pasur në disa dyer shtëpish të vjetra prej guri. Ata më thanë se ato bëhen-shin përmbarësi të shtëpisë, në njerëz e në pasuri. Të tillë gjinj të skalitur në gur, anash dhe sipër dyerve të shtëpive, i kemi ndeshur dhe në fshatra të Rrëzës së Tomorit (Roshnik e Dardhë), dhe, sipas shpjegimit të informatorëve, na dalin të bërë me të njëjtat motive si edhe në Dukagjin. Këtë fakt na e plotëson dhe ndonjë e dhënë tjetër përgjinjtë në derë në disa shtëpi të qytetit të Beratit, në fshatra të Rrëzës së Tomorit⁵⁷, në Labëri.

Në vise të ndryshme të Ballkanit gjemë figura njerëzish të skamorfe, të bëra prej guri a prej druri⁵⁸. Mendojmë se dhe te shqiptarët, të tillë figura hyjnish prej druri duhen të kenë qenë pararendëse të

55) F. Ndoci — *Bestytni*, Berat, 1963, f. 29-30. AE 247/15. Përmë Veriun janë konstatime direkte të autorit.

56) A. Gjergji, *Gjurmë të matriarkatit* në disa doke të dikurshme të jetës familjare, B.U.SH.T., (shkencat shoqërore), 1963 nr. 2, f. 284-289.

57) F. Ndoci, *Bestytni*, Berat, 1963, AE, f. 29-30, In. 247/15.

58) Në muzeun e fshatit në Bukuresht përpëra një banese primitive kam vërejtur një fetish në formë antropomorfe, që përfaqëson (në origjinë) hyjnинë mbrojtëse të shtëpisë, bërë prej druri.

skalitjeve në gur, siç ndodh në Berat e Dukagjin e në ndonjë vend tjetër. Kjo mënyrë shpjegimi përputhet me faktin se skalitjet në gur janë më të reja se sa përfytyrimet për këto hyjni mbrojtëse të shtëpive, sesa tradita e të bërit të këtyre figurave a figurinave në gur.

Mendojmë se këtu kemi të bëjmë me mbeturinat e ngurtësuarat e të ndryshuarat në brendi të kultit të gjinjve të së parës së gjinisë, ushqyeses së parë të pasardhësve të saj. Natyrishit, me kohë, këto skalitje në dru a në gur kanë marrë funksione thjesht zbukurimi.

Etnografë të ndryshëm të tillë skalitje kulti i shpjegojnë si mbeturina të kultit të gjinisë amtare.

Për kultin e gjirit të gruas dhe kuptimin e tij me origjinë të lashtë kemi dhe në mjaft të dhëna të tjera etnografike për popullin tonë.

Vetë termi «gjini» në shqip ka të bëjë me lidhjet gjinore nga ana e nënës, e pra origjinën e ka nga fjala «gjini-gjini», si gjendra të prodhimit të qumështit të gruas. Në të drejtën zakonore, kur themi se «jemi gjini bashkë», kuptojmë lidhjet gjinore nga ana e nënës, kur thuhet se «jemi të një gjaku», kuptohet afria gjinore nga ana e babës. Në Veri të Shqipërisë thuhet për lidhje të tillë gjinore dhe «lisi i tamlit»⁵⁹ dhe «lisi i gjakut», për të treguar respektivisht lidhjet nga ana e nënës dhe ajo e babës.

Dihet se për malësorët tanë, deri në fillim të këtij shekulli, një nga betimet më të forta ka qenë të betuarit në gjinjtë e nënës a «të lëshuarit be në gjinjtë e nënës», si: «për gjinjtë e nënës!», «Pash gjinjtë e nënës!», «Pasha(pafsha) gjinjtë e nënës!», «Pasha(pafsh) gjinjtë!» e të tjera si këto. Këto betime kanë të bëjnë thjesht me kultin e gjinjve të nënës, si simbolizuese të burimit të jetës dhe vazhdimit të gjeneratave njerëzore.

Është me interes të përmendet një fakt nga Drenica e Kosovës, që ka të bëjë me kultin e gjinjve të nënës të shkrirë me kultin e tokës⁶⁰. Në këtë informatë thuhet se njerëzve u ndalohej të rrin hin tokën me shkop; në qoftë se bëhej një veprim i tillë nga fëmijët (të rriturit nuk e lejonin një akt të tillë, por fëmijtë mund ta bënin nga padija), quhej një mëkat i rëndë. Kur fëmijët shiheshin duke e rrahu tokën, u thuhej: «Mos e rrih tokën, se rreh gjinjtë e nënës së vdekur!» Kjo shprehje thuhej gjithnjë në të tillë raste, pavarësisht nga fakti se ata mund ta kishin nënën gjallë. Pra këtu del ideja, natyrishit e ngurtësuar, se siç është toka burimi i jetës për njeriun, ashtu është dhe nëna me gjirin e saj burimi i jetës. Duke shprehur fjalët «gjirin e nënës së vdekur», këtu kuptohet se kemi të bëjmë me kultin e të vdekurve, por jo në vijën e babës, por në vijën e qumështit, pra në vijën e nënës. Po të gjurmohet në vend ky tabu (ndalim), mendoj se këtu kemi të bëjmë me një besim shumë të lashtë, që lidhet me kultin e gjinisë, dhe, në lidhje të ngushtë me të, me kultin e nënës tokë.

Një fakt interesant dhe kuptimplotë në lidhje me mbeturinat e kultit të gjinjve të nënës së parë të disa gjeneratave është një rit

59) Sht. Gjeçov, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 1933, f. 71.

60) I. Berhami, *Ritet e vdekjes në Drenicë të Kosovës*, AE, fq. 6.

vdekjeje, gjurmët e të cilit i gjejmë, ndonëse në praktika shumë të rralla deri në fillim të shekullit tonë në Drenicë të Kosovës⁶¹ dhe në fshatra të Alpeve të Shqipërisë Veriore⁶². Kur vdiste ndonjë plakë që kishte lënë pasardhës të shumtë, ose edhe të paktë, para se ta qisnin në varr, ose që para se ta nisin për në varrim, i zbulonin gjinjtë dhe shkonin dhe e puthnin me radhë pasardhësit e saj: në fillim të bijtë e saj, pastaj të nipërit, stërnipërit e kështu me radhë; pastaj fillonin e i puthnin gjinjtë femrat: në fillim bijat, pastaj të mbesat e kështu me radhë, por në këtë rit nuk merrnin pjesë bijtë e bijave. Pra mendojmë se ky është një rit që simbolizon ruajtjen e kujtimit të vazhdimit të gjeneratave nga ana e nënës.

Në forma të ndryshuara e të degjeneruara këtë rit e gjejmë dhe në vise të ndryshme të Shqipërisë së Jugut dhe të Veriut. Në Myzeqe, kur nëna marton djalin, ditën e martesës i jep të pijë ujë djalit me një cep të këmishës së saj dhe i thotë: «Hallall qumështin që të kam dhënë!». Të njëjtën veprim bën edhe e éma e vajzës kur e nis atë për martesë⁶³. Në Myzeqe njëherë moti, kur çupa e martuar nuk e donte burrin, i jepnin të pinte qumësht gjiri nga dy gra me gjë, që ishin nënë e bijë; po kështu i jepnin dhe djalit që nuk donte nusen⁶⁴. Me këtë veprim ritual besojej se do të hynte dashuria midis tyre. Në Mallakastër⁶⁵ dhe në Has⁶⁶ të Kukësit ditën e martesës, kur nusja hyn në derë (te burri), vjehrra do ta puthë tri herë në ballë e tri herë në gjinj, kjo natyrisht për mbarësi e trashëgimi.

Për kultin e gjinjve le t'i drejtohemi edhe legjendës së murimit aq e njohur në Shqipëri⁶⁷, në Kosovë e në përgjithësi në Ballkan. Gruaja e murosur porosit që «gjirin e djathë» t'ia lënë jashtë dhe me të të ushqehet fëmija i vogël i saj e kështu kalaja ka për të qëndruar e i biri do ta gëzojë, do të bëhet trim e të luftojë në të e të fitojë, siç këndohet në Shkodër e Mirditë, ose në një variant të Malësisë së Madhe, ku thuhet:

*Amanet burrë e kunetën
po ja u la nji porosi:
për mua gajle hiq mos kini,
vecse cikën (gjinin) jashtë ma lini;
ka'i herë në ditë djalin këtu me pru,
cikën djalit me n'ia dhanë».
Asht punue kalaja e a parua,
sa fort djali kenka rritë,
cika nanës kurrë s'i ka shterë,
ajo cikë askurrë nuk shterë,
njashtu thonë se â kenë motit⁶⁸...*

61) I. Berhami, *Po aty*, f. 6.

62) Shih për këtë dhe, F. Ndoci, *Si jetojnë malësorët e Veriut të Shqipërisë*, 1948, f. 127, AE, 3/2.

63) *Dhënë gojarisht* nga etnografja Ll. Mitrushi.

64) J. Nushi, *art. cit.*, f. 30.

65) M. Xhemali, *Familja në Kurjan*, AE, Fier, f. 78.

66) Dhënë gojarisht nga etnografsja A. Onuzi.

67) Q. Haxhihasani, *Këngë popullore legjendare*, f. 3-10.

68) Q. Haxhihasani, *Po aty*, f. 12-13 e tjere.

Sipas besimit populor, gjiri i nënës së murosur në kala, në urë a në objekt tjeter ndërtimi nuk shter kurrë. Ai është si simbol force e qëndrese të objektit. Në kala të Shkodrës dhe në kala a ura të tjera, për të cilat rrëfehen të tillë legjenda të murimit, rrjedh ujë në ndonjë vend në mure nga depozitat e shirave. Uji shkrin e merr me vete dhe gurët gëlqerorë e bëhet një çikë si i bardhë, si ngjyrë qumështi. Dikur besohej se ky ujë ishte rrjedhje qumështi nga gjiri i gruas së murosur që në kohët e vjetra. Këtë ujë shpeshherë e merrnin dhe «për derman», lanin gjinjtë me këtë ujë gratë që nuk kishin qumësht të mjaftueshëm për të ushqyer fëmijët e vegjël, duke besuar se kjo larje do t'u shtonte qumështin.

Në ciklin e kreshnikëve është mjaft e njojur legjenda e veprimit magjik të gjirit të femrës për t'u dhanë forcë kreshnikëve e për t'i bërë ata që të dilnin fitimtarë kudo. Ja disa shembuj: Muji (i ciklit të kreshnikëve *Muji e Halili*) tregon për nënën e tij kur ndodhej i mbyllur në shpellë: «E shkreta loke, â kenë një azgane gruaje qì veç deri njaty! Te se ma kur gatuente bukë i varte gjinjtë nëpër magje si dy calikë njize e u epte vap njenit e vap tjetnit përmbi sup e mbas shpinet.»⁶⁹

Kuptimplotë për kultin e gjinjeve është tregimi se si zanat e bëjnë Mujin të fuqishëm me gji, me nga tri pika gji. Le të kujtojmë këtu se zanat në origjinë kanë disa tipare që na kujtojnë rendin e gjinisë, janë pra, nji motërzim i amazonave që përfaqësojnë kohën e kalimit nga rendi i gjinisë në rendin e fisit. Muji, duke pirë tambël gjini nga zanat, nga një djalë shumë i dobët e i paforcë bëhet kreshnik:

«*Tamel gjiut Mujis për me i dhanë*,
tamel gjiut i kanë dhanë me pi,
me tri pika djalin ma kan ngi
e i ka falë zoti kaq fuqi,
sa me lujtë shkamin aty përbri.
«Kape gurin» zanat i kanë thanë.
Njimiokësh e ma guri ish kanë.
E kap gurin njimijokësh,
badjava peshue me duer e ka,
der m'nyje të kamës veç e nu mujt ma.
Njana shoqes atëherë i kanë thanë:
«Edhe do tamël Mujis me ia dhanë».
E ka marr tamlin Muji e e ka pi,
der në gju ai gurin e ka çue;
kenka ba si me kanë drangue.⁷⁰

Shembujt për një kult të tillë, e pra dhe për mbeturina të ngurtësuara në lidhje me kultin e gjinisë janë të shumtë, po do të mjaftoheni me shembullin e fundit, që ka të bëjë me figurën mitologjike aq të njojur në Shqipërinë e Veriut, atë të Mesme e në Jug deri në Totor: kuçedrën. Kuçedra (për të cilën do të flas në një rast tjetër të

69) Q. Haxhihasani, *Këngë popullore legjendare*, f. 302.

70) Po aty, f. 129.

veçantë) në personifikimin e forcave të natyrës na ka transmetuar në vetvete dhe disa tipare të periudhës së kalimit nga sistemi i gjinisë në atë të fisit. Kjo figurë përfytyrohet në disa variante si një grua plakë me gjinjtë shumë të mëdhenj, sa i varen deri te këmbët; «kur është në punë të saj», siç e beson populli. Kjo nganjëherë gjinjtë e saj i hedh mbas spine, kaq të gjatë i ka. Ajo lufton kundër armiqve të saj, dragonjve, duke i lagur me qumështin e gjinjve të saj. Pra, këtu qumështi i gjinjve na del si mjet shfarosjeje, si mjet lufte, me një forcë të tillë magjike, sa me mbytë dragonjtë.

Si rrjedhim i këtyre që thamë në lidhje me gjinjtë e gruas, na del se të gjitha variantet e këtij kulti, në një formë a në një tjetër, kanë lidhje gjenetike midis tyre.

Duke u bazuar në analizën e të dhënave faktike, mendojmë se këtu kemi të bëjmë me mbeturina të kultit të nënës së parë të gjinisë, pra kemi të bëjmë me mbeturinat e ngurëzuara të kultit të hyjnissë mbrojtëse të gjinisë (që e ka origjinën tek e para e gjinisë), e konsideruar kjo si hyjni e mbarësisë, pjellorisë, hyjni e nënës tokë.

Është me interes të shënohet se në Maliq⁷¹ të Korçës, në Kamnik⁷² të Kolonjës, në Cakran⁷³ të Fierit e gjetiu janë gjetur nga arkeologët shqiptarë Frano Prendi, Muzafer Korkuti, Zhaneta Andrea, gjatë gërmimeve, figurina prej balte të pjekur në formë antropomorfe, ku dalin në dukje sisët dhe pjesë të tjera të trupit, karakteristike për femrën. Në përgjithësi këto figurina i takojnë epokës së neolitit e në disa raste dhe epokës së bakrit. Arkeologët i kanë shpjeguar këto si objekte kulti, që kanë të bëjnë me gjininë amtare, me hyjninë grua si simbol i pjellorisë, simbol i nënës tokë.

Në stacionet neolitike, në trevën që u takon tokave të Jugosllavisë (pra brenda trevës ilire) janë gjetur disa figurina të tillë dhe janë analizuar në një artikull të veçantë nga D. Garashanin⁷⁴. Autorja këto figurina i lidh me kultin e gjinisë amtare.

MBI TË TRASHËGUARIT E EMRAVE VETJAKË

Emri vetjak, si anë funksionale, vlen për të përcaktuar me fjalë dallimin e një njeriu nga njerëzit e tjerë të rrëthit shoqëror, për identitetin e tij si person. Por në të përfshihen dhe vlera të tjerë me karakter shoqëror.

71) F. Prendi, *La civilisation préhistorique de Maliq*, «Studia Albanica», 1966, 1, f. 260 dhe Tab. X a.

72) F. Prendi, S. Aliu, *Vendburimi neolitik në fshatin Kamnik të rrëthit të Kolonjës* «Iliria», 1971, f. 25 dhe Tab. IX, 2.

73) Muzafer Korkuti, Zhaneta Andrea, *Stacioni i neolitit të mesëm në Cakran të Fierit*, «Iliria» III, Tiranë, 1974 f. 74-75 dhe f. 101. Tab. XXIII, 5. Figurina të tillë nga stacionet e ndryshme neolitike si Cakran, Kamnik, Maliq e tjerë janë të ekspozuara në vitrinat përkatëse në Muzeun Arkeologjik-Etnografik të Tiranës. Për këtë shih dhe në «Shqipëria arkeologjike», Tiranë 1971, fig. 9, 19 e 20 dhe shënimet sqaruese për to: 9, 19 e 20.

74) D. Garašanin, *Religija i kult neolitiskog čoveka na centralnom Balkanu*, në «Neolit Centralnog Balkana», Beograd, 1968, f. 241-263.

Në vënien e emrit një fëmije jorrallë luan rol përcaktues rastësia; mund t'i vihej një emër mund t'i vihej një emër tjetër. Por ë mos harrojmë se thërrmijëza të rastësisë përbëjnë atë që quhet domosdoshmëri. Kjo duket më mirë kur i studiojmë emrat vetjakë në kompleks pér kohë të caktuara, pér krahina të caktuara, pér shtresa shoqërore të caktuara. Në këtë rast emrat mund të shprehin ide të ruajtjes me forcë të traditës, ide që kanë të bëjnë me interesa klasseore të caktuara, rrëthana historike, mund të shprehin pikëpamje politike të caktuara, pikëpamje fetare, ide liberale e të péruljes pérpara kulturës së huaj dhe përcëmim pér atë që është thjesht shqiptare, shprehin formim ideologjik e kulturor të njerëzve.

Është e ditur që çdo njeri, si rregull i përgjithshëm, merr një emër që kur lind dhe atë e trashëgon deri në varr. Pra, pér vënien e emrit përgjegjësinë gjithnjë e kanë prindërit dhe të afërmit e fëmijës. Emri vetjak, pérveç si një shenjë dalluese midis njerëzve, ka dhe karakter të theksuar edukativ në shoqëri. Nga kjo rrjedh domosdoshmëria që ndaj vënies së emrave vetjakë të mbahet qëndrim kritik⁷⁵.

Forca e madhe e traditës, si në shumë fenomene të tjera shoqërore që kanë të bëjnë me familjen, edhe në përdorimin e emrave vetjakë, në zgjedhjen e tyre, luan një rol të madh.

Zgjedhja e emrave vetjakë pér t'ua vënë fëmijëve të porsalindur, nuk është një çështje thjesht personale, po merr karakter shoqëror, përderisa njeriu jeton në shoqëri. Zhvillimi shoqëror e kulturor në kushtet e ndërtimit socialist në vendin tonë kërkon që në zgjedhjen e emrave vetjakë njeriu ynë të udhëhiqet nga pikëpamje e ide të reja me arsyetime të thelluara në lidhje me këtë çështje. Emrat që dikur janë futur me forcë nga fetë e ndryshme, në mënyrë sado të tërthortë, pasqyrojnë psikologji fetare; emrat e marrë nga vendet a gjuhët e huaja pasqyrojnë botëkuptim të péruljes ndaj së huajës dhe tërthorazi përcëmim pér atë që është thjesht shqiptare. Kur kemi emrin e bukur shqip Drita, pse t'i vemë fëmijës emrin e huaj Luçi?!

Problemet në lidhje me emrat vetjakë janë të shumita, e ato mund të vështrohen në pikëpamje gjuhësore, historike, etnografike, sociologjike e disiplina të tjera shoqërore, por këtu shqyrtimi do të kufizohet në një problem të veçantë, siç është ai i trashëgimisë së emrave, pa u shpërndarë në probleme të tjera, qoftë dhe të karakterit etnografik.

Në rrafsh etnografik deri tani nuk është marrë ndonjë shqyrtim i veçantë në lidhje me emrat, ndërsa në rrafsh gjuhësor e historik ka disa kontributë të tillë⁷⁶.

75) Prindi në zgjedhjen e emrit pér fëmijën duhet të niset nga kërkasat e shoqërisë sonë socialiste.

76) A. Kostallari, *Contribution à l'histoire des recherches onomastiques dans le domaine de l'albanais*, në «St. Alb», Tirana, 1965, Nr. 1, fq. 49. Th. Kacorri, *Një regjistër osmano-turk i vitit 1642-1643*; «St. hist.», Tiranë, 1966, 3, f. 165-173. Ll. Mitrushi, *Kodiku i Manastirit të Shën Kozmait pér kontratat e fejesave (kodiku Ll. burim i onomastikës në krahinën e Myzeqesë)*, «Etnografia shqiptare III, Tiranë, 1966, f. 185-187». E. Giordano, *Fjalori i Arbëreshëvet të Italisë*, Bari, 1963, f. 587-590 (Nomi propri di persona) — H. Boissin *Sprovë e përkohshme pér një klasifikim të emrave të përvëcëm*. «Konf. I. St. Alb.», Tiranë, 1965, fq. 176-182 P. Daka, *Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe*, «St. fil.», 1968, f. 137-157.

Në ditë të sotme fëmijëve të porsalindur në përgjithësi u vihen emra të traditës së vjetër shqiptare, emra me origjinë ilire, emra nga bimësia e objekte të ndryshme të natyrës, emra që tregojnë cilësi të sendeve a fenomeneve e kështu me radhë. Sot, pra, në zgjedhjen e emrit për fëmijën e tij prindi në përgjithësi udhëhiqet nga motive të reja, nga një botëkuptim e psikologji e re, të karakterit kombëtar, nga bukuria e emrit si tingëllim. Në qoftë se në lidhje me emrat vetjakë në shumicën e rasteve tradita vështrohet në mënyrë kritike, në disa raste nuk ngjan pikërisht kështu. Ka elementë nga ata më të prapambeturit e shoqërisë sonë që ende u vënë fëmijëve emra «tradicionalë», të shtyrë tërthorazi a drejtëpërdrejt nga motive besimesh.

Sipas dëshmive që kemi në dorë nga shek. XIX dhe gjysma e parë e shek. XX, fenomeni i të vënët të emrave fëmijëve, të shtyrë nga motive të caktuara me origjinë besimesh, ka qenë shumë i rëndomtë. Pikërisht ky problem do të shqyrtohet këtu poshtë.

Emrat vetjakë që përdoreshin në të kaluarën mund t'i ndajmë në dy kategorji: e para, emra me karakter fetar: kristian, të ritit ortodoks, pra me origjinë greko-bizantine e slavë; të ritit katolik, pra me origjinë latine e neolatine; emra islamikë, me origjinë turke a arabe; e dyta: emra të traditës së lashtë shqipe, emra që shpjegohen vetëm nëpërmjet ligjeve fonetike e kuptimeve gjuhësore të shqipes.

Është e qartë se emrat me karakter kristian e islamik janë përhapur te shqiptarët që në mesjetë e më përpara (për emrat islamikë ky fenomen u takon shekujve XV deri XIX), të imponuar në fillim nga pushtuesit e huaj, të cilët fenë e kanë përdorur si bazë ideologjike të synimeve të tyre skllavëruese e shfrytëzuese. Kur ata kanë dashur të imponojnë fenë e tyre, në radhë të parë kanë kërkuar ndryshimin e emrave vetjakë; kjo gjë është bërë jo vetëm nëpërmjet klerikëve kristianë a islamë, por edhe nëpërmjet vetë administratorëve të huaj ushtarakë e civilë. Këta emra kanë hyrë me forcë si kusht paraprak për disa të drejta minimale ekonomike e shoqërore; dëshmitë historike na tregojnë se shqiptarët, pa marrë emra islamikë, nuk merreshin në punë në shërbimet e garnizonëve turke, siç ka ndodhur në malësitë e Labërisë. Në Mirditë, për të marrë misër nga depot e Turqisë, sipas një liste të caktuar duhej ndërruar emri, kryefamiljari duhej të regjistrohej me një emër islamik. Edhe sot gjemjë në mbiemrat e mirditasve (bile në Orosht) emra turko-arabë si Elez, Alia, Xhaferi, Sinani (sot përdoren si mbiemra) që janë vënë mbi bazën e një detyrimi ekonomik. Këtë fenomen e takojmë edhe në shumë krahina të tjera të vendit tonë në Veri e në Jug. Në Nikaj-Mertur e Shpat të Elbasanit, për tu shpëtuar persekutimeve të turqve dhe diskriminimit fetar, përdornin emra të fesë islamike, pavarësisht nga fakti se ata në të vërtetë nuk e kishin ndërruar besimin. Pas shpalljes së Pavarësisë disa fshatra të Shpatit të Elbasanit që njiheshin më parë si myslimanë e deklaruan veten të krishterë. Nga rrëthana të tillë shtërgimi të kohës së Turqisë në Nikaj-Mertur e në krahina të tjera të Alpeve ishte krijuar tradita që fëmijës t'i vinin dy emra: një të krishterë si emërtim brenda familjes dhe një mysliman për komunikim në rrëthin shoqëror e shtetëror.

Grupi tjeter i emrave vetjakë është me origjinë shqiptare që nga koha e paganizmit, e pra këta janë emra tradicionalë të mirëfilltë, deri-

vate të tyre, ose emra të rinj të formuar në përputhje me traditën kombëtare. Edhe këta mund t'i ndajmë në dy grupe: 1. në emra që janë me origjinë totemike dhe 2. në emra jototemike, por të marrë nga sende e fenomene të natyrës dhe të jetës shoqërore, ose nga cilësi të këtyre sendeve e fenomeneve.

Nga të dhënat e ekspeditave të bëra këto vitet e fundit në Kukës, në Malësi të Gjakovës (Tropojë), në Rrafsh të Dukagjinit (Kosovë), në Dukagjin, në Malësi të Madhe, Mat, Mirditë, Shkodër, Lezhë, Tomoricë, Berat, Labëri dhe nga të dhënat arkivale dhe të literaturës së botuar në lidhje me këtë problem për vise të ndryshme shqiptare, na del se të trashëguarit e emrave vetjakë për popullin tonë ka qenë deri vonë një zakon që është ruajtur me të gjitha tiparet dhe anët e tij më të qenësishme. Si rregull i përgjithshëm, në çdo krahinë i kishin të njojur e të caktuar emrat që do t'u viheshin fëmijëve të porsalindur. Në radhë të parë ishin emrat e gjuhshërvë, stërgjuhshërvë a të të parëve të fisit a vëllazërisë. Më i preferuar për djalin do të ishte emri i gjushit. Në qoftë se vdiste një burrë dhe gruaja e tij në kohën e kësaj vdekjeje ishte me barrë, fëmija që lindte merrte emrin e babait të tij të vdekur. Kur vdiste një fëmijë, emrin e tij prindërit ia vinin fëmijës që lindte pas tij, natyrisht në qoftë se edhe i dyti ishte i të njëjtët seks me të parin. Në disa raste, sidomos kur prindërit ishin të rinj dhe kishin shpresë të lindnin disa fëmijë, emrin që kishte fëmija i vdekur ia vinin jo fëmijës që lindte pas tij, por të tretit (pas fëmijës së vdekur). Kur prindërit, të cilëve u kishte vdekur një fëmijë dhe, për arrsyen moshe ose sëmundjesh, nuk kishin shpresë që t'u lindte fëmijë tjetër, dëshironin që me çdo kusht emrin e fëmijës së vdekur ta merrte një fëmijë i porsalindur i të afërmve të tyre, sidomos nga ana e babës, por kjo lejohej edhe nga ana e nënës, mjafton që emri «të mos dilte jashtë gjakut e gjinisë së tyre». Prindërit e fëmijës së vdekur nuk lejonin në asnje mënyrë që emrin e fëmijës së tyre (të të vdekurit) ta merrnin fëmijë jashtë vëllazërisë së tyre; një gjë e tillë ishte e ndaluar edhe nga rregullat morale të vendit, pa pyetur, pa marrë leje nga prindërit e fëmijës së vdekur. Le të kujtojmë për këtë dhe komedinë «14 vjeç dhëndër» të A. Z. Çajupit të botuar më 1903, ku Tana shkon e uron gruan që porsa ka lindur. Kur gruaja lehonë i thotë se vajzës që ka lindur ia ka vënë emrin Hënë, Tana skandalizohet, sepse fëmija i saj (i Tanës) që kishte lindur e vdekur 20 vjet më parë quhej Hënë. Ky reagim ndodh nga besimi i saj në faktin se bashkë me emrin i ka shkuar fëmija i saj i vdekur te një grua tjetër, gjë që për një prind me të tilla besime nuk mund të dëshirohej dhe as të pranohej⁷⁷⁾.

Duke e marrë në lidhje me sa u tha më sipër, është lehtë për të kuptuar dhe një fakt të vënë re dhe të njojur shumë mirë të malësorët shqiptarë: ishte prirja që në disa raste t'u vinin fëmijëve të tyre të porsalindur emra personash shumë të përmendur për trimëri, burrëri, besnikëri, mençuri, emra njerëzish në zë. Ata mendonin se bashkë

77) Çajupi, Vepra, Tiranë, 1957, f. 122-123.

me emrin do të transmetoheshin te fëmija i tyre edhe vetëtitë e larta shoqërore të personit të përmendur me të njëjtin emër⁷⁸.

Le të shënojmë këtu se trashëgimia e emrave ruhej më tepër në vijën atëreore e shumë pak në vijën e nënës. Kjo ka shpjegimet e veta:jeta me organizim patriarkal i jepte rëndësi vetëm shtimit në meshkuj dhe trashëgimisë së tyre, ndërsa elementi femër konsiderohej si i pavlerë. Pra, edhe në këtë drejtim femra ishte një qënie e poshtëuar si edhe në shumë drejtime të tjera.

Është fenomen i njohur në të gjitha krahinat malore e fushore të vendit tonë trashëgimi brez pas brezi i emrave të fisit nga gjyshi te nipi, te stërnipi e kështu pa mbarim. Dhe kjo ka lidhje me besimin se me emrin transmetoheshin nga brezi në brez edhe tiparet e fcrca e paraardhësve të fisit apo njerëzve të përmendur, kusht pa të cilin nuk mund të mendohej ekzistencia e fisit në të ardhmen.

Kur e pyet një prind se pse fëmijës i vë emrin e gjyshit ose të një paraardhësi tjetër të tij, ai thotë se këtë e bën pér të kujuar e pér të mos harruar të parin e tij. Por nga ana tjetër është dhe besimi i gjallë, se bashkë me emrin transmetohen dhe vetëtë e të parit të tyre, ose i një njeriu të përmendur nga krahina e tyre (në qoftë se një emër i tillë i vihet fëmijës). Mendimin e sipërm e mbështet dhe ky fakt: mund të ishte një emër i bukur si shqiptar, si tingëllim, si ngjyrë natyrore a veti shoqërore që paraqet, por, në qoftë se këtë emër e mban një njeri i keq e i paburrëri, atë emër nuk ia vinin fëmijës, nga frika se trashëgimtari i tyre mund të bëhej i keq e i paburrëri si personi i rritur e i plakur që mban emrin në fjälë.

Natyrisht që trashëgimia e emrit lidhet dhe me pikëpamje të tjera të trashëgimisë në farefis nga brezi në brez e kjo ka të bëjë, duke shqyrtuar sipas besimeve popullore, në ruajtjen e veçorive e të kompaktësisë së fisit në vazhdimin e gjeneratës. Në lidhje me këtë na flet shumë qartë një dëshmi e mbledhur nga Gjeçovi në Malësitë e Veriut e që thotë: «Gjaku thith gjakun», sipas fisit. Po të merren dy fëmijë prej dy fisesh, të merret një asht (kockë) nga varret e të parëve të njërit dhe një asht nga varret e të parëve të tjetrit; t'u shpohen dy fëmijëve nga një gisht që t'u dalë pak gjak, do të shohim se ashti i çdo njërit nga varret, sipas besimit popullor, thith vetëm gjakun e pasardhësit të tij e jo të fëmijës tjetër (jo pasardhës të tij)⁷⁹. Sado që kjo dëshmi e së drejtës zakonore është dhënë në formë anekdotë, si arsyetim midis Lekës e Skënderbeut, përsëri mendoj se ka vlerë dhe në lidhje me kultin e të parëve të vdekur, e marrë kjo në unitet me bashkësinë fisnore, me trashëgiminë nga brezi në brez, gjë që shprehet edhe në të vënët e të njëjtëve emra.

Për të shpjeguar rregullsinë e të trashëguarit të emrave në fis dhe emrave të njerëzve të përmendur na ndihmon dhe besimi që ruhej deri vonë në krahinat fshatare, më shumë në ato malore të vendit

78) Duhet shënuar se prindi jo të gjithë emrat e fëmijëve të lindur duhej t'i merrte nga paraardhësit e tij. Ai një, dy e deri tre merrte si emra vetjakë nga paraardhësit, ndërsa të tjerët i zgjidhë duke u nisur nga motive të ndryshme, midis të tjerash dhe nga emra njerëzish të përmendur. Këtu luan rol dhe mekanizmi i të shmangurit të përsëritjes së të njëjtit emër brenda vëllazërisë a farefisit.

79) Sh. Gjeçovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 1933, f. 122.

tonë, sipas të cilit shpirti i njeriut që vdiste kalonte te një fëmijë që lindte në fisin e tij; ai shpirt, hije a frymë, mund të kalonte edhe te dashi, te kau a në çdo kafshë tjetër. Prej kafshës mund të dilte përsëri e të trashëgohej në njerëz të fisit, pra shpirti i të parit bënte një udhëtim në mënyrë të pambarim. Ata pleq e plaka besimtarë, shpeshherë tregonin se shpirti i filanit që kishte vdekur, me siguri, sipas tyre, kishte hyrë te filani me të lindur, se ky i fundit i ngjante shumë të parit në paraqitjen e jashtme (në fytyrë), në sjellje, në forcë e burrëri e kështu me radhë. Në disa raste thuhej se deri në shtatë breza shpirti i të vdekurit do të hynte patjetër te një pasardhës i por-salindur. Kuptohet se këtu kemi të bëjmë me besim animistike, «të transmetimit» të «shpirtit» në mënyrë të «përjetshme» nga një formë në një tjetër, nga një qenie në një tjetër, nga një brezni në një tjetër.

Ky besim është i lidhur ngshtë me mbeturina të marrëdhënieve patriarkale e farefisnore, përderisa kërkohet mbi bazën e besimeve popullore, që nëpërmjet emrit shpirti i personit të vdekur «të transmetohet doemos» në të afërm në shtëpi a në farefis. Si i tillë, ky përfytyrim është mbartës i shumë mbeturinave të dëmshme me karakter fetar e patriarkal në jetën familjare e shoqërore, në vetvete është një botëkuptim arkaik i mbartur që nga bashkësia fisnore primitive dhe si pasojë ai helmon ndërgjegjen e njerëzve, pengon të hyrët e botëkuptimit shkencor materialist mbi jetën dhe vdekjen e njeriut, por forcon idenë fetare «të ko-tësisë së kësaj bote».

Transmetimi i shpirtit të njeriut nga një person në një tjetër bashkë me emrin është i njojur në popuj të ndryshëm të botës. Bile, sipas dëshmive të ndryshme etnografike, emri në popuj të ndryshëm nuk merrej thjesht si emër, por merrej si pjesa më e rëndësishme e njeriut, si thelbi i qenies njerëzore. «Gjithë popujt evropianë — thotë Rhys, — besonin deri vonë që emri jo vetëm përbënte një pjesë të njeriut, por ishte pikërisht ajo pjesë, e cila quhet shpirt, frymë e jetës,»⁸⁰ Lenorman thotë se «në të gjitha besimet aziatike emri mistik vështrohej si një qenie reale dhe «e shenjtë», e cila sundonte qenien (ekzistencën) e personit me një forcë të jashtëzakonshme si mbi natyrën, po ashtu edhe mbi botën e shpirtrave.»⁸¹

Ruajtja e emrit në shekuj konsiderohej kaq e rëndësishme për jetën pas vdekjes, sa në Greqinë e Vjetër, për shembull, emrat e klerikëve (paganë) gdhendeshin në pllaka metalike dhe lidheshin në fund të gjiut të Salaminës, për t'i ruajtur ata nga ndonjë zhdukje e mundshme.

Në Egjiptin e lashtë emrat e mbretërve i shkruanin në pllaka të gjata të veçanta, dhe atyre, si të ishin shpirtra të të vdekurve, u bënin flijime. Dhe në përgjithësi në Egjipt, «lumturia e të vdekurve», përveç të tjerash, varej nga fakti që për emrin e tij të ruhej kujtimi në tokë midis pasardhësve dhe në varr. Të fshihej emri i të vdekurit nga varri, ishte një krim i madh.

Edhe kristianizmi e islamizmi emrit i jepnin një rëndësi të madhe. Kështu fëmija bëhej anëtari i komunitetit përkatës, vetëm kur merrte emrin e atij besimi; emri ishte kushti i parë i përkatësisë në një besim

80) L. J. Shternberg, *vep. cit.*, f. 109.

81) L. J. Shternberg, *Si më sipër*, f. 109.

të caktuar. Klerikët ku shuguroheshin si të tillë ndërronin emrin, duke lënë të parin e duke marrë emrin e ndonjë «shejtori» e kjo bëhej në kuptimin e «mishërimit me të e në veprat» e tij. Është e qartë se këtë rregull kristianizmi e ka marrë nga kohët e lashta pagane, ashtu siç ka marrë edhe shumë elemente të tjera të tij, duke i përpunuar e duke u ndryshuar atyre kuptimin, në përkim me interesat e tij ideologjike, rrugë për të skllavëruar më lehtë njerëzit shpirtërisht.

Në drejtim të trashëgimisë së emrave do të shqyrtohen këtu në mënyrë të veçantë ata me origjinë të lashtë shqiptare, parakristiane e paraislamike, qofshin këta me origjinë totemike ose jotemike.

Trashëgimia edhe në të tillë emra vetjakë ndjek po atë rregull, ashtu si për emrat e këtij lloji në përgjithësi, por megjithatë këta ruajnë edhe disa vlera të veçanta.

Në Veri dhe në Jug të Shqipërisë janë të përhapur, sipas traditës, emra me origjinë pagane, emra të vjetër. Kështu kemi emrin Zogë, Shegë, Gur, Mal, Lule-Lulja, Rrap, Ujk (a Ukë), Diell-a, Hënë, Buç (a Bush) (Buç quhet edhe një lloj gjarpri) Bollë, e kështu me radhë.

Trevat ku janë ruajtur me shumicë këta emra me origjinë pagane, pra parakristiane (e paraislamike), janë Malësia e Gjakovës (Tropoja), Dukagjini dhe Malësia e Madhe. Në këto krahina të duket sikur këta emra konkurrojnë në sasi dhe me emrat kristianë dhe islamikë.

Këta emra vetjakë për këto zona mund t'i ndajmë në:

a. Emra nga sende e fenomene të natyrës; Gur, Shkamb, Diell, Hënë, Male (Malja), Vetimë, Borë, Bjeshkë;

b. Emra kafshësh e shpendësh: Ujk, (Ukë) Ka, Dash, Pulë, Dre, Drenushë, Zogë, Vuk, Dashe (Dashja), Gjel, (dhe Gjelosh), Shpend, Zog, Sykë, (Sykja), Sokol, Buç, Gjerpër, Bollë, Shytan, Dac, Peshk.

c. Emra bimësh: Lule, (dhe Lula) Groshë, Shegë, Rrap, Mollë, Lul-Lulash.

d. Emra cilësish: Bardhe (Bardhoke), Bute, Sose, Vogël (Vogla Vokërr (Vokrri), Shkurt (Shkurtë), Mirash. Keq, (Keqe-Keqja), Mire-Mirja, Bardhoc, Çun, Kros, Bardh-Bardhosh;

e. Emra të derivuar nga emra të tjerë, ose që nuk dihet se nga e kanë zanafilën: Marash, Kacol, Ajdush, Cenë, Doç Prend e kështu me radhë.

Për një kohë të gjatë emrat e vjetër vetjakë populli i ka ruajtur me dashuri e fanatizëm nga asimilimi prej emrave kristianë e islamikë, emra që janë bartës të ideologjive të pushtuesve të ndryshëm e që janë futur në popullin tonë me forcë më vonë. Kjo tregon qëndresë ndaj asimilimit, ndaj hyrjes së feve të pushtuesve të ndryshëm.

Në popull ekzistonte pikëpamja se emrat e traditës së lashtë shqiptare, që nuk janë as islamikë as kristianë dhe as të huajt nga të huajt në kohë të vona, ishin me shumë vlerë, kishin shumë forcë për të bërë që të jetonte fëmija. Kur disa prindërve u lindnin, por nuk u jetonin fëmijët (lindnin, një, dy tre, katër dhe me radhë lindnin e vdisnin), ata i vinin fëmijës që lindte më vonë një nga këta

emra me origjinë pagane. Për këtë qëllim përdoreshin shpeshherë emrat *Gur*, *Mal*, *Rrap*, që fëmija, sipas besimit popullor, të bëhej i fortë si guri a si mali, rrapi etj. që ai të imposhtte çfarëdolloj së-mundjeje e fatkeqësie. Le të kujtojmë këtu se në dy rastet e para kemi të bëjmë dhe me kultin e gurit që është aq shumë i përhapur te shqiptarët, si në Jug ashtu dhe në Veri. S'ka dyshim, se vetë cilësitë e gurit, si fortësia, pesha, përdorimi praktik i tij nga njeriu, që në lashtësi e kanë bërë atë fetish, duke i dhënë cilësi të mbinatyrrshme⁸².

Emrat vetjakë *Buç Bush* (një lloj gjarpri), *Bolle*, *Gjarpër* janë shumë të preferuar, sidomos në viset e Veriut të Shqipërisë. Këta emra i gjejmë në shumë raste edhe si emra vetjakë, edhe si llagapë. Këta emra kanë të bëjnë me kultin e gjarprit, për të cilin kemi folur në një vend tjetër, e pra, në njëfarë kuptimi, kanë origjinë totemike.

Shumë të përdorur, veçanërisht në Malësi të Gjakovës, në Dukagjin e në Malësi të Madhe janë emrat *Diell-a* dhe *Hënë-a*. Në Malësi të Madhe këta emra janë më të përdorshëm. Këta emra i gjejmë të praktikuar dhe në Myzeqe e vise të tjera të Jugut të Shqipërisë. Ajo që ka rëndësi është fakti se i gjejmë të përdorur në njerëz të të dy besimeve dhe në mënyrë të pakufizuar, por më shumë tek ata të ndikimit kristian. Mund të mendohet se emri *Hëna* do të jetë me ndikim turko-arab; nuk përjashtohet mundësia e një ndikimi të tillë, por jemi të sigurt se kulti i Hënës ka qenë shumë i fortë e në shumë drejtime te shqiptarët dhe ky, me sa na japid dëshmitë, është me origjinë të lashtë në traditën shqiptare. Këtë kult mund të themi se e gjejmë bile më të përhapur në zonat që ishin nën ndikimin kristian sesa në ato që ishin nën ndikimin islamik. Emri *Hënë* si emër njeriu në Veri të Shqipërisë s'ka dyshim se përdoret më tepër në popullsi të ndikimit kristian.

Në kompleksin e besimeve të popullit tonë për diellin dhe hënën dhe në lidhje me përdorimin e tyre në emra vetjakë mendojmë se kemi të bëjmë edhe këtu, ndër të tejra, dhe në emra me origjinë totemike.

Edhe emri *Ujk*, *Ukë*, *Ujka*, *Uka*, *Vuk* është shumë i përdorur si emër vetjak në Shqipërinë Veriore. Rreth ujkut si një kafshë rrëmbyese ekzistojnë një tok besimesh e, duke mos u ndalur në radhitjen e tyre, po shënoj vetë atë që ujku, në disa besime, na del në shqiptarë e malazez një kafshë totemike me origjinë indoevropiane⁸³. Pra si emër vetjak fjala ujk do të jetë doemos e ndikuar në origjinë nga elementi totemik i besimeve për të, ashtu siç ka ndodhur dhe në popuj të tjerë të botës.

Si emra vetjakë në popullin tonë përdoren edhe emrat e shumë

82) Le të kujtojmë në lidhje me këtë një rast mjaft interesant: deri në kohë të vona (nga fundi i mesjetës) jo vetëm në popujt primitivë e gjysmë-primitivë, por edhe në viset e Evropës flijimet bëhen duke përdorur thika guri. Këtu kemi të bëjmë me fetishizmin e gurit si vegël shumë e lashtë në duart e njeriut, si armë gjahu e vegël pune, si vegla e parë e përdorur në flijime në lashtësi, vegël aq e lashtë, sa ç'është dhe zakoni i flijimeve, sa ç'është dhe puna me vegla të bëra nga njeriu e që e dallojë atë nga bota shtazore.

83) Shih për këtë dhe: S. Kulišić, *Iz stare srpske religije*, Beograd, 1970, f. 20-27.

bimëve, por këtu do të shqyrtohet vetëm në mënyrë të përgjithshme ky fenomen. Në legjenda e besime të popullit tonë shpeshherë i gjemë njerëzit të kthyer në drunj, në pemë, veçanërisht pas vdekjes.

Duke u bazuar në rregullsinë e mbeturinave totemike të dhëna nga Morgani, Teilori, Frezeri, Hajtuni e mitologë të tjerë, na del se në lashtësi, dhe te njerëzit primitivë të kohës sonë, ruhej i plotë besimi i tyre në prejardhjen nga një kafshë, bimë a objekt i caktuar i natyrës. Në një fazë më të vonë, kur fenomeni kthehet në mbeturinë, ruhet besimi se njerëzit (me të ndodhur) kthehen nga kafshë, bimë a objekte të natyrës në njerëz dhe anasjelltas. Së fundi në një fazë akoma më të vonshme, kur kjo mbeturinë zbehet si besim, siç ndodh me popujt e zhvilluar, atëherë ruhen vetëm legjenda e besimi për kthimin e njerëzve në kafshë, bimë a objekte të natyrës. Fazën e fundit të fenomenit e ndeshim dhe në rastin tonë, si për sa u përket emrave që shqyrtuan më lart, ashtu dhe për sa u përket bimëve që do t'i shohim shkarazi më poshtë.

Në Macukull (Mat), në vendin te Lisi në Grykë, kanë qenë deri vonë tri dardha të mëdha shekullore. Legjenda popullore thotë se ato tri dardha kanë qenë tri gra që lanin rroba në një burim aty afër e që u kthyen në dardha nga një mëkat që bënë.

Aty ku u varros Gjergj Elez Alia me të motrën (Gjergj Elez Alia i ciklit të kreshnikëve) mbiu një bli⁸⁴; aty ku u varros Nik Peta me Marën (sipas veprës së Gavril Darës së Ri: «Kënga e sprasme e Balës») mbiu një qiparis dhe një mollë e artë dhe ata në varr do të dashurohen derisa të thahet qiparisi dhe molla e artë⁸⁵, krushqit e Mujit dhe Halilit bëhen gurë dhe kuajt e tyre bëhen drunj⁸⁶. Te balada e Gjon Pretikës⁸⁷ thuhet:

«*Edhe u kapën gryka n'grykë
porsi motra me vëllan,
të dy plasén tue kja.
Ku ra Gjoni, bini ftoni,
aty cili lule ftoni,
Ku ra Blega, bini shega,
aty cili lule shega».*

Pra, të gjitha, këto që u përmendën më lart kanë të bëjnë në mënyrë të tërthortë me kthimin e njerëzve në drurë, gjë që ka të bëjë me mbeturinat e totemizmit.

Trashëgimi i emrave të bimëve, si emra vetjakë që kanë arritur në mënyrë origjinale nga koha e lashtë e deri në kohën tonë, nuk janë të ndikuar drejtpërdrejt nga totemizmi, por në mënyrë të tërthortë dhe kryesisht nëpërmjet kultit të të parëve, nëpërmjet besimit të transformimit të shpirtit nga brezi në brez dhe kalimit të tij nga një

84) Q. Haxhihasani, *vep. cit*, f. 127.

85) Gavril Dara i Riu, *Kënga e sprasme e Balës*, Tirana, 1955, f. 134.

86) Q. Haxhihasani, *Këngë popullore legjendare*, 1955, f. 132-140.

87) Q. Haxhihasani, *vep. cit*, f. 63

formë në një tjetër në mënyrë të vazhdueshme e të pazhdukshme. Në ruajtjen e këtyre emrave në trashëgimi ka luajtur rol jo të vogël dhe adhurimi i kafshëve, bimëve, objekteve a fenomeneve të caktuara që konsideroheshin si gjëra «të shenjta».

Në ruajtjen e trashëgimisë së emrave nga brezi në brez natyrishët ka luajtur një rol të madh besimi animistik, besimi në transmetimin e shpirtit bashkë me emrin nga brezi në brez brenda fisit. Në lidhje të ngushtë me të parën një rol të madh në ruajtjen e emrave të trashëguar ka luajtur adhurimi i të parëve të vdekur të familjes a të fisit dhe kompleksi i besimeve që ka të bëjë me kultin e të parëve.

Njeriu i paditur «drejtohej për ndihmë» te të parët (te të parët e tij të vdekur) në ngushticat e jetës dhe shpresonte se me lutje e me flijime bërë atyre do të siguronte mbarësi në njerëz, në prodhimtari bujqësore e blegtori. Fatkeqësitë që i ndodhnin në jetë, i lidhte me mungesën e shërbimeve në lutje, ceremoni, flijime për të parët e tij të vdekur. Për fatkeqësitë që i ndodhnin thoshte se «po paguan kusurret e të parëve». Këto besime janë shprehje ideologjike e atyre kushteve shoqërore që e shtypnin dhe e skllavëronin njeriun shpirtërisht e materialisht, që nuk e linin t'i shihte fenomenet e ndryshme në një drithë të vërtetë, ato e pengonin në përpjekjet e tij për të ndryshuar realitetin shoqëror, në përpjekjet e tij për të ecur përpara drejt zhvillimit.

Trashëgimi i emrave të afërm nga brezi në brez është një shprehje e veçantë e fenomenit të animizmit, besimit në kalimin e shpirtit nga një trup në tjetrin, nga një brez në tjetrin bashkë me emrin e personit që e mban atë. Kjo na del si një formë besimi shumë e lashtë, po që ka pasur si elementë përforcues më vonë dhe fetë kristiane e islamike.

Në emrat e vjetër të traditës shqiptare në mënyrë të tertiortë ruhen dhe mbijetesat e jehonës së largët të besimeve totemike, në lidhje me kafshë, shpendë, bimë dhe sende.

Duke shqyrtuar problemin e të trashëguarit të emrave vetjakë, ne shohim, ndër të tjera, peshën e rëndë të një kompleksi besimesh që kanë të bëjnë me kultin e të parëve, peshë e rëndë e skllavërisë shpirtërore, që e ka bazën në nivelin e ulët të forcave prodhuase, në kushitet e vështira historiko-shoqërore dhe veçimin ndër male që ka kaluar populli ynë ndër shekuj, për të ruajtur qënien e tij si popull e për të dalë së fundi në arenën historike si komb i veçantë.

Të trashëguarit e emrave vetjakë nga brezi në brez sipas një rregulli tradicional, pa i vështruar ata në mënyrë kritike, duhet konsideruar, për kohën e sotme, si një shfaqje konservatorizmi, si një ndikim i njollave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve, i psikologjisë fetare, fisnore e patriarkale, i ndikimit të ideologjive të ish-klasave sunduese të së kaluarës dhe pushtuesve të ndryshëm dhe duhet luftuar. Të përdorurit e emrave të huaj në ditë të sotme duhet parë si një shfaqje e liberalizmit, si një përulje përpara ndikimit të huaj dhe tertiortorazi si një përcëmim për kulturën e traditën shqiptare.

Në zgjedhjen dhe përdorimin e emrave vetjakë duhet marrë për bazë ajo shtresë emrash që ka trashëguar kultura popullore shqiptare që nga lashtësia, ose që i ka përpunuuar ajo gjatë zhvillimit historik

e deri në ditët tona, atë që na jep gjuha e pastër shqipe, e pasuruar dhe me emra të rinj e me përbajtje të shëndoshë, por jo trashëgimitë thjesht fisnore, krahinore e fetare. Ne jemi për një unifikim në shkallë kombëtare të çdo gjëje pozitive që krijoj populli ynë në shekuj e që vazhdon të krijojë dhe në kushtet e ndërtimit socialist të vendit, duke përfshirë kështu dhe emrat vetjakë tradicionalë a të rinj që i përkasin fondit të artë të kulturës shqiptare. Jemi për një zgjerim e pasurim të fondit të emrave vetjakë e jo për ngushtim të tyre.

KUJTIMI I TË PARËVE, VARRET DHE TË VDEKURIT

Në doke e zakone të popullit tonë, është e kuptueshme, ruhen mjaft tradita të mira në lidhje me kujtimin e të vdekurve dhe në kujdesin përvaret. Përmenden në mënyrë të vazhdueshme në bisedat rrëth vatrës familjare ose dhe në takime shoqërore virtute dhe vepra të mira të atyre që kanë vdekur (të afërm ose të njohur të treguesve) e kjo bën që këto veti të mira të trashëgohen në pasardhës e në rrëthim shoqëror të tyre. Kjo ka qenë e është një shkollë e madhe edukimi për brezin e ri; natyrisht këtu është fjala më tepër përvrat e mira të njerëzve të përmendur si patriotë, dëshmorë të atdheut e heronj të luftës e të punës, po dhe përvjetorë të thjeshtë si bujq, blegtori, punëtorë të ndershëm, përvjetorë trima, guximtarë, mikpritës, besnikë në çaste të vështira të jetës, njerëz të paepur, luftëtarë të përmendur. Varret në vendin tonë nuk janë cenuar, pavarësisht se të kujt kanë qenë ato, edhe kur të varrosurit kanë qenë të panjohur; kjo në një drejtim tregon dhe respekt ndaj tyre. Te ne zakonisht varret janë bërë të grumbulluara, të rrëthuara e të mirëmbajtura. Kjo është dëshmi e traditave të lashta kulturore në popullin tonë. Këto tradita të mira duhen zhvilluar e çuar më tej në kushtet e reja të ndërtimit të shoqërisë sonë të re socialiste.

Por këtu poshtë do të shqyrtohen vetëm disa dukuri të karakterit arkaik e negativ që kanë të bëjnë me rite e besime përvjetore përvjetore dhe përvjetorët e tyre të dëmshme që ruhen ende e që duhen spastruar ngajeta e popullit.

Zakonisht ritet e besimet në lidhje me kujtimin e të parëve, me varret e të vdekurit, janë elemente që ruajnë përbajtje arkaike, përbajtje (natyrisht në shumë raste në mënyrë të fosilizuar) që ka të bëjë me stade të ndryshme të zhvillimit shoqëror, duke filluar që nga lashtësia përvjetore sotur në kohët më të reja. Kjo gjë vërehet në popuj të ndryshëm të Evropës, në popuj të ndryshëm të dotës.

Ky konservatorizëm i shfaqur në objektin në fjalë ka të bëjë me mbeturinat patriarkale e fisnore në jetën e popullit, ka të bëjë me besime në lidhje me jetën përvjetore varrit dhe me qëllime, sipas të cilave, duke u shërbyer të vdekurve të parë të familjes a fisit, të sigurohet mbarësi, prodhimtari, mirëqenie përvjetore pasardhësit që jetojnë.

Këtu do të shqyrtojmë disa besime e rite përvjetore më të afërmë konkretë të fisit a të familjes, dhe jo përvjetore aq mitikë siç ishte rasti i përfytyrimeve përvjetore «nënën e vatrës», «vitoren», «gjinjtë e gruas». Natyrisht ndonjë kufi i prerë kohësor midis të parëve dhe

të dytëve nuk mund të vihet, sepse përfytyrimet pér më të lashtit vijnë e pleksen me përfytyrimet pér më të rinxjtë dhe anasjelltas⁸⁸.

Këta të parë të familjes a të fisit, pér të cilët bëhet fjalë këtu, nganjëherë na dalin në mënyrë të përgjithësuar e të papercaktuar, pra si të parë në përgjithësi, e nganjëherë dalin të përcaktuar e si të parë të familjes a të fisit me emra, si të vdekur disa kohë më parë, para një a disa brezash. Shpeshherë, kujtimi i të parëve me rite e me ceremoni është gërshtuar me elemente kristiane e islame, por këta dy elementet e fundit na dalin më tepër si veshje e jashtme, ndërsa në brendi në përgjithësi kemi të bëjmë me tradita të lashta paraislame e parakristiane.

Në Shqipëri, në Veri e në Jug në disa festa fetare të ritit kristian e islamik përkujtohen të parët, ose si quhen thjesht festa të fisit, të bajrakut, a të krahinës së caktuar. Këta quheshin «shenjtorë», mbrojtës të fisit, bajrakut e krahinës dhe festa e tyre kremitohej me miq e të ftuar, me bija (që janë të martuara e në këtë rast vinin te prindërit e tyre). Si të tillë kemi edhe «shenjtorë» mbrojtës të familjes.

Ky s'është një fenomen i veçantë pér shqiptarët, këtë e ndeshim edhe në popuj të tjerë të Ballkanit, ndër popuj të ndryshëm të Evropës si Gjermani, vendet skandinave, Francë e kështu me radhë. Këtu, sipas etnografëve të ndryshëm, kemi të bëjmë me festën e të parëve të lashtë të fisit, festa që më vonë janë kristianizuar, pra kanë ndryshuar emrat dhe veshjen e jashtme. Kështu të tillë kemi te Shënkollia, Shëngjergji, Shëngjini, Shënmitri etj.

Hahni thotë se në Shqipëri të Jugut i gjithë fisi lut një «shejt» që është patroni i tij: në këtë rast bëhet një gasti ku marrin pjesë miqtë dhe krushqia⁸⁹. Nopça vë në dukje një gjë të tillë pér Shqipërinë e Veriut. Përveç fiseve kanë pasur pajtorë dhe familje të veçanta dhe festa e pajtorit, qoftë e fisit, qoftë e familjes, lutej me miq të ftuar dhe të paftuar. Nga autorët të ndryshëm dhe nga të dhënat e terrenit vihet re se në Shqipërinë e Veriut çdo fis kishte patronin e tij që i kremitonte festën. Përveç fiseve patron kishin dhe familje të veçanta dhe festa e patronit, qoftë e fisit apo e familjes, lutej me miq të ftuar dhe të paftuar⁹⁰. Në të tillë festa ndizeshin qirinj në kujtim të këtyre patronëve, në shumë raste liheshin në natën e festës dyer e dritare hapur që të vinin e të hynin shpirrat e të parëve pér të ngrënë a pér të pirë, bile në disa raste liheshin dhe një a dy vende bosh në tryezë kur uleshin të hanin bukë në këto festa. Thuhej se «vijnë shpirrat e rrinë në vatër në këto net dhe ata na shohin e ne nuk i shohim». Nganjëherë në festa hidhen ushqime në zjarr që shpirrat e të parëve të ndiejnë erën. Edhe në festa të ndryshme thjesht të ritit kristian e islamik, përkujtoheshin të vdekurit në këtë mënyrë, ta zëmë në bajramin e madh, bajramin e vogël, natën e kadrit, pér këershëndella, pashkë e raste të tjera. Sipas një dëshmie të regjistruar në fshatin Romas të Tomoricës, mendonin se «në disa raste shpirrat e të vdekurve kthe-

88) Në këtë syth do të analizohen vetëm disa fenomene nga më të qenësishmet e që duken më interesante, sado që objekti e materiali që kemi në dorë do të lejonte një shtrirje në një hapësirë shumë më të gjërë.

89) J. G. Hahn, *vep. cit.*, f. 153.

90) Për këtë shih dhe F. Nopça, *vep. cit.*, f. 70-72.

heshin në shtëpinë ku kanë pasë qëndruar kur ishin gjallë». Ata thoshin se «shpirrat e të vdekurve vijnë në vatér në të tilla net, por asnjëri nuk i sheh».

Në Shpat të Elbasanit kremitoheshin deri në kohë të vona festa kushtuar njerëzve «të mirë» të fisit (të vdekur nga më të përmendurit e fisit)⁹¹.

Ndër të tjera me interes është të përmendet festa e shën Rrokut që kremitonte lagjja Zajsë e Oroshit të Mirditës. Çdo vit, në vjeshtë, kremitohet kjo bashkërisht në një shtëpi nga e tërë lagjja. Përgatitjen dhe shpenzimet për këtë festë i bënte për çdo vit një shtëpi, e aty mblidheshin përfaqësuesit e gjithë shtëpive të lagjes në këtë kremitim (nga një, nga dy a tre njerëz për shtëpi). Radha e kremitimit (me shpenzime) nuk caktohet, por bëhej sipas vendit që zinte çdo shtëpi në vëllazëri e në fis (kjo sipas afersisë e largësisë me barqe me shpinë që quhej e parë e fisit). Në këtë natë të festës ndizet edhe qiri në kujtim të shën Rrokut. Thuhej se, po të mos bëhej kjo festë kështu e përbashkët, «na jepej keq në bereqete e në gja të gjallë». Festa e fisit ka qenë një fenomen i rëndomtë dhe me shpenzime të mëdha dhe në Kosovë, siç na flasin dëshmi të ndryshme.

Le të kujtojmë se në kremitimet e festave të patroneve të fiseve në malësitë shqiptare bëheshin shpenzime të mëdha, thereshin disa bagëti, duke përfshirë këtu edhe lopë e qe. Veprime të tilla ishin një rëndim i vërtetë për ekonominë familjare,

Një festë që kremitohet në kujtim të të vdekurve në kristianë, në Veri e në Jug, janë «të shumat» (një nëntor). Këtu kemi të përzier elementë kristianë dhe elementë tradicionalë vendas. Në këtë natë përkujtohen të vdekurit si në shtëpi, ashtu dhe te varret. Në shtëpira bëheshin gosti, ndiznin qirinj në kujtim të të vdekurve; mendohej se atë natë vinin shpirrat për të ngrënë. Kjo festë kremitohet dhe ndër varre ku ndiznin qirinj, çonin dhe ushqime, kjo bëhej veçanërisht në Malësinë e Veriut si Nikaj-Mertur, Dukagjin, Malësi e Madhe etj. Në këtë ditë u bëheshin falje lypësve, të varfërve nga gjithë llojet e berreqeteve të prodhimtarisë bujqësore e blegtore. Falje bëheshin në shtëpi, po në shumë raste bëheshin edhe në varre. Thuhej se këtë apo atë gjë «po e falim për shpirt të të parëve» a «për shpirt të babës», «gjyshit», «gjyshes» apo për ndonjë tjetër njeri të caktuar nga ajo familje që ka vdekur pak kohë më parë apo shumë kohë më parë.

Siç u tha dhe më sipër, këto falje bëheshin ndër varre nga të afërmijt e të vdekurve dhe thuhej se këto vërtet i merrnin lypësit a të varfrdit, por shkonin në mënyrë të dhjetëfishuar për shpirt të të parëve të tyre.

Në disa raste, në Malësi të Veriut, bëheshin ndërrime ushqimesh ndër varre ditën e të shumave (rita e të shuemëve): në vend që t'uaj jepnin lypësve a të varfërve, ose t'i linin në varr, i ndërronin me njëri-tjetrin, me mendim që një gjë e tillë kushtonte për shpirt të të parëve.

91) M. Begolli, *Demonologja, Shpat e Shelcan i Elbasanit*, 1973, AE, f. 25.

Në Bëtoshë të Nikaj-Merturit ndeshim në një variant flijimi ende më origjinal, arkaik e që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me bashkësinë fisnore. Ditën e të shumave çonin të gjithë ushqime (ndër to: mish e raki) te varret; këto ushqime i bashkonin, uleshin e i hanin të gjithë bashkërisht për shpirt të të parëve.

Krengimet e festave të të parëve të fisit e të familjes dhe ushqimet në varre ditën e të shumave ose ndonjë ditë tjeter të vitit e kanë ndryshuar krejt kuptimin e vjetër, ashtu siç kanë ndryshuar në shumë drejtime dhe si praktika kulti.

Kuptimi i lashtë i këtyre riteve me ushqime ka qenë të flijuarit për të vdekurit, flijime për t'u ushqyer ata në «botën tjeter» dhe duke u ushqyer ata në «atë botë», me fuqinë e tyre si të parë të fisit, do të ndihmonin dhe pasardhësit e fisit në mbarësi në familje, në prodhimitari bujqësore e blektorale. Jo më kot të tilla festa kanë marrë kuptime e funksione të karakterit bujqësor e blektoral.

Për kuptimin dhe praktikën më arkaike të këtij fenomeni është një fakt shumë interesant i mbledhur nga Z. Dukagjini, sipas të cilës «Nik Çuni, ndie prej babagjyshit, se qysh motit kishim pasë zakon me i pre kurban shën Nikollit e me djegë mishin e berrit krejtësisht mbi lter të kishës së shën Gjonit»⁹².

Kjo është një shfaqje shumë arkaike, parakristiane e flijimeve kushtuar të parëve të fisit. Kjo mënyrë flijimi dikur ka qenë shfaqje e përgjithshme në festat kushtuar të parëve të fisit e që më parë nën ndikimin e kristianizmit kanë pësuar ndryshime në formë e në përbajtje.

Le të kujtojmë kështu se darkat, gostitë e përbashkëta të fisit në ditën e patronit të fisit, deri vonë, kanë qenë të praktikuara shumë në vise të ndryshme të Jugosllavisë, trevë ilire e kohës së lashtë. Disa dijetarë të huaj kanë shfaqur mendimin se këto festa fisnore të pujve të kësaj treve kanë origjinë ilire.

Në festat e patronëve të fiseve a për të *shuma* një element me shumë interes është të ndezurit qirinj të vdekurve për shpirt të tyre në shtëpi. Këta qirinj i kushtoheshin patronit të familjes ose thjesht të vdekurve të parë të fisit a familjes. Në disa raste ndizeshin tre qirinj, një nga të cilët i kushtohej një të pari të largët të familjes, emri i të cilës nuk mbahej mend, dhe emërohej me një emër krejt të përgjithësuar, emri i llagapit apo emër tjeter. Thonë: «Këtë qiri ia kushtojmë Roskut, një të parit tonë të largët». Rosku në të vërtetë është *fati i shtëpisë*. Pra ai i kushtohet të parit të largët të shtëpisë a fatit me qëllim që ai të bjerë fat e mbarësi në shtëpi. Në Mirditë, në disa raste, (kjo ndodhë për të *shuma* më tepër) ndiznin tre, katër, shtatë e e deri në 13 qirinj të vegjël afër një qiriu të madh. Qiriu i madh i kushtohej «shenjtit» patron të fisit, një tjeter *Shënnitrit*, mbrojtësitet të bagëtive nga ujqit dhe qirintë e tjerë u kushtoheshin të parëve të tjerë të familjes a fisit të dhënë me emra. Të gjithë këta të parë të vdekur ishin burra (meshkuj) e në ndonjë rast të rrallë ishin femra. Në të vdekurit e sekosit femër kishte raste që i kushtohej ndonjë qiri ndonjë plake të vdekur, e parë e tyre, që kishte qenë e përmendur,

92) Z. Dukagjini, *Doke të ndryshme, besime e bestytni*, 1962, AE, f. 79-82.

më tepër kur ajo kishte rritur jetimë, kishte qenë si zot shtëpie në të gjallë të saj. Kështu i kushtoheshin qirinj të ndezur Dilës së Llesh Gjetë Voci të Shebe (Mirditë), që kishte qenë plakë me zë; kur ajo kishte qenë e re, i ishin vrarë të gjithë burrat e shtëpisë, ndër ta dhe i shoqi; ajo fëmijë të sajën nuk kishte pasur, por megjithatë kishte qëndruar aty e kishte rritur fëmijët e të kunetërve, kishte bërë vetë dhe kullën trekatëshe. Kur ajo vdiq, fëmijët e kunetërve që kishte rritur, filluan t'i ndiznin qirinj për shpirt. Kjo traditë u vazhdua për tre breza me radhë e mbaroi më 1967 kur u lanë të tilla rite krejtësisht.

*
* *

Të tilla praktika e përfytyrime në lidhje me të parët e fisit janë ruajtur si mbeturina deri në gjysmën e parë të shekullit tonë; ato kanë qenë mbajtur dhe nga fakti se tradita e lashtë vendase ka qenë gërshtuar me besimet kristiane e islamike, për të cilat ishin të interesuar shumë klerikët e të dy besimeve, se me të tilla mjete mbillnin padjeninë, errësirën e obskurantizmin fetar në popull, me të tilla mënyra përforconin në popull dogmën e ideologjinë e tyre. Në vitet e pushtetit popullor, të tilla përfytyrime u zbehën e praktikisht u lanë, por megjithatë mbeturinat e besimeve në lidhje me kultin e të vdekurve ende nuk janë shkulur me rrënje ngajeta e popullit; këto manifestohen në mosha të vjetra e në elemente të tjera të prapambetur të shoqërisë sonë. Ato manifestohen shumë herë edhe në mënyrë të pandërgjegjshme, se nuk kuptohet aq sa duhet esenca idealiste e të tilla besimeve.

Me psikologjinë e krijuar nga mbeturinat e besimit në lidhje me kultin e të parëve ka të bëjë shumë herë në ditët e sotme dhe këmbëngulja për t'i ndërtuar dhe shtëpitë e reja në truallin e shtëpive të të parëve, se aty kanë pasur trojet e të parëve, se aty shtëpia e tyre ka pasur mbarësi në shekuj, se «aty ka arritur të bëhej shtëpia deri 60 veta». Pra, sipas tyre, të tilla troje të vjetra janë të provuara e rrjedhimisht janë me fat për njerëz dhe për pasuri. Kështu, në disa raste, nga të tilla mendime prapanike pengohet plani i ri rregullues i fshatrave që është ngritur me kaq forcë nga organet e pushtetit e të Partisë. Kështu natyrisht kemi të bëjmë dhe me psikologjinë e trashëguar nga e kaluara për pronën private e veçimin në natyrë, por sidqoftë dhe mbeturinat e psikologjisë dhe besimeve në lidhje me kultin e të parëve luajnë rolin e tyre negativ në këtë drejtim. Ja pra, se si ato i bëhen pengesë ecjes përpara të shoqërisë sonë të re, sido që në vështrim të parë mund të duken si të parëndësishme, të padëmshme.

Kjo gjë del më e qartë në traditën që ka të bëjë me vendin e varrimit të të vdekurve, të anëtarëve të vëllazërisë a të fisit, element që do ta shqyrtojmë më poshtë. Varret në popullsinë fshatare, në përgjithësi, i gjemjë të grumbulluara bashkë sipas vëllazërisë dhe sipas fisit. Vendi i varreve, sipas traditës së vjetër, nuk lëviz. Të gjithë të afërmitt e një shtëpie, vëllazërie a fisi duhet të varroseshin në një vend afër e afër.

Tradita e të varrosurit në një vend të përbashkët e gjithë vëllazërisë a fisit ka qenë kaq e fortë, sa është ligjësuar dhe në të drejtë

zakonore të malësive shqiptare të Veriut, ashtu siç na e jep edhe Shtjefën Gjeçovi:

«Në vorre të njij vllaznije a të njij fisi s'hin i dekuni a i vrami i vëllaznisë a i fisit tjetër. Po e bani kush kët punë pa leje të vëllaznise a të fisit, të cilit janë vorret, Kanuni i ven detyrë me nxjerr të dekunin prej vorrit të huej.»⁹³⁾

Në Mirditë, për të tre bajrakët e fisit, deri nga shekulli i kaluar, është ruajtur tradita (natyrisht jo në tërësi, por pjesërisht) që të vdekurit të mbaheshin e të varrosheshin në pllajë të Malit të Shenjtë afër kishës së Shëngjinit. Pra, i binin të vdekurit për t'i varrosur këtu nga Spaci, nga Blinishti dhe vetë Oroshi, të cilit i përkiste mali në fjalë. Vinin fiset me të vdekurit e tyre që nga Qafa e Malit, që kufizon Pukën me Kukësin e deri nga Mënela, që kufizon Pukën me Shkodrën. Për të varrosur të vdekurit ata bënин deri dy ditë e dy net rrugë në këmbë. Si traditë kishte qenë që një natë fisi me të vdekurin ta kallonin në Qafë të Qirit, prej nga ka marrë dhe emrin ky vend, sepse aty ndiznin qirinj te kryet e të vdekurve. Një fushë, disa metra nën këtë qafë, ishte vend që nuk e kapte shumë era, e prandaj, siç e shpjegojnë, aty ishte bërë traditë që të qëndronin me të vdekurin natën para varrimit.

Të varrosurit e të vdekurve në një vend kaq të largët vendasit e shpjegojnë me arsyen se në fshatrat e tyre nuk ka pasur kisha. Prandaj ngeli si traditë që t'i varroshnin ata në Mal të Shenjtë. Një arsyetim i tillë nuk u qëndron fakteve. Së paku që nga shek X me sa na flasin dëshmitë e ndryshme historike, ka pasur disa kisha shumë të afërtë me ato fshatra prej nga shpinin të vdekurit për t'u varrosur në Mal të Shenjtë; bile ato kisha kanë qenë dhe me varre, po me saduket, popullsia që ishte e ardhur në ato vende nga afërsitë e Malit të Shenjtë, vazhdonte t'i binte të vdekurit për t'i varrosur aty te varret e më të parëve të fisit; popullsia që nuk ishte e ardhur prej andej, i varroste të vdekurit në kishat afër fshatrave përkatëse. Pra, këtu kemi të bëjmë me kultin e varreve të të parëve, afër të cilëve duheshin varrosur edhe pasardhësit, sado larg të ishin me banim e sado që një veprim i tillë paraqiste vështirësi.

Kjo traditë e ruajtur deri vonë (në lidhje me të varrosurit e të vdekurve në Mal të Shenjtë) mendoj se është një argument jo pa rëndësi për të përcaktuar trevën më të vjetër të Mirditës së mirëfilltë.

Në kohën tonë, për nevoja të sistemit të fshatrave, shpeshherë ka lindur nevoja e lëvizjes dhe e sistemimit të varreve të fshatit. Në këto raste jorrallë kërkohet nga vendasit që varret të mos lëvizin nga varreza e tyre e mëparshme; duan pra, të ruajnë vendin e varreve të vjetra të të parëve të tyre. Në Romas të Tomoricës, për arsyen të sistemimit të fshatit, ishte vendosur nga organet e pushtetit dhe të urbanizimit që varret e fshatit të bashkoheshin e të sistemoleshin në një vend të caktuar, po fshatarët ngurronin ta bënë një gjë të tillë; megjithëse vendimi ishte marrë para tre vjetësh, akoma deri vonë asnjë varr nga të mëparshmit nuk ishte transferuar për në vendin e ri të varreve; as nga të vdekurit rishtas asnjë nuk ishte varrosur në vendin

e caktuar për varre. Ata thoshin se, po të bëhej një transferim i tillë i varreve, u vdisnin njerëz të tjerë në shtëpi dhe i gjenin fatkeqësi të ndryshme në familje.

Ka raste që pleq të ardhur nga fshati në qytet te fëmijët e tyre, para se të vdisnin e kishin lénë me fjalë që të varroshin në malësi, te varret e të parëve të tyre, sado që fshatrat malore prej nga ishin larguar mund të kishin një largësi të tillë, siç është ta zëmë Puka e Tropoja me Tiranën.

Këtë prirje të shqiptarëve në shëk. XIX për t'i varrosur të vdekurit te varret e të parëve, te vendi i të parëve të tyre (ose të pak-tën për të bérë atje ceremonitë e varrimit, në rastet kur të afërmit vdesin në kurbet shumë larg Shqipërisë), e ka vënë re shumë mirë dhe Hahni⁹⁴. Është e kuptueshme se këtu kemi të bëjmë dlie me mallin e dashurinë për vendlindjen.

Është me interes të shënohet fakti se në malësitë shqiptare respektohen jo vetëm në përgjithësi varret e të parëve të tyre të drejtë (historia e të cilëve njihet pak a shumë nga populli), por dhe varre të vjetra, historinë e të cilave nuk e njohin fare (kur nuk dinë se ç'popull është varrosur ndër ato varre). Në Martanesh ka disa varre të vjetra që quhen Varret e Kaurëve e, megjithëse banorët e kësaj krahine ka shekuj që kanë qenë nën ndikimin islamik, po ato varret nuk i ka ngarë kush. Po kështu ndodh dhe me «Varret e Kaurit» në Dardhë të Beratit (afër majës së Tomorit). Kudo varret quheshin si vend vakëfi, si vend i paprekshëm, pavarësisht se të kujt e të ç'kohe ishin. Kemi takuar disa raste që respektohen si vende «të shenjtarëve» të mesjetës së hershme shqiptare dhe varre ilire⁹⁵. Një plak i përmendur i një fisi nga fshati Kullaxhi i Mirditës që kishte vdekur nga fillimi i këtij shekulli, kishte lénë fjalë që ta varroshin (edhe porosia ishte mbaruar) jo në varret e fisit të tij, pranë kishës së fshatit, po te varret e vjetra në Bukël (këto varre janë të përcaktuara prej arkeologëve si të shek. VI-VIII të erës së re, pra të kulturës së mesjetës së hershme), vend në të cilin, në të vërtetë, kishte shenja të një kishe të vjetër, historinë e së cilës nuk e dinte njeri, por që varre të kohës sonë nuk kishte, me përjashtim të varreve të dy fëmijëve që kishin vdekur apo kishin lindur, pra që i dinin të papagëzuar (sipas besimit kristian, të papagëzuarit nuk duhej të hynin në dhe në «varret e bekuara» nga kisha po jashtë tyre si paganë. Kjo gjë mendoj se ka të bëjë me kultin e varreve më të vjetër, me kultin e të parëve legjendarë.

* * *

Nga sa del prej shqyrtimit të «kultit» të të parëve, të varrimeve dhe të të vdekurve» në popullin tonë, deri në fillim të këtij shekulli.

94) J. G. Hahn, *vep. cit.*, f. 152.

95) Për këtë shih dhe: M. Tirtja, «Mbeturina fetare në jetën e popullit», «Studime historike», 1973, Nr. 1, f. 96-99.

janë trashëguar në këtë drejtim një seri ritesh, besimesh, zakonesh që ruajnë karakter arkaik. Këto besime e praktika shfaqen në kremtimin e festave të të parëve të fisit e të patronëve të fisit (të fundit si një kristianizim ose si një islamizim i një tradite më të lashtë). Një fenomen i tillë është i lidhur me mbeturinat e organizimit fisiong patrional, i kushtëzuar ky nga rrëthana të veçanta të zhvillimit historiko-shoqëror të ngadalët, në kushtet e një ekonomie më tepër të karakterit natyror dhe të veçuar në malësitet e vendit tonë.

Ritet, praktikat, besimet në lidhje me kujtimin e të parëve dhe varamet, sipas asaj tradite të vjetër, janë një shprehje e prapambetjes shoqërore në të kaluarën, ndërsa mbeturinat e tyre në kohë të sotme janë një pengesë e madhe në ecjen e shoqërisë sonë përpara, në fitoren e së resë mbi të vjetrën, në transformimet ideologjike e psikike të njerëzve të shoqërisë sonë.

Pra, del detyra e një lufte të paprerë kundër këtyre mbeturinave të ideologjive të së kaluarës, riteve e besimeve që e kufizojnë horizontin shoqëror të njeriut të shoqërisë sonë, që e mjegullojnë atë e nuk e lënë të shohë përpara në të ardhmen e vendit tonë socialist.

Ritet e zakonet e vjetra është e domosdoshme të zëvendësohen me zakone të reja shoqërore, me përbajtje të re. Të tilla do të ishin festat e prodhimit bujqësor, blegtoral, ekskursionet jubilare në male a në qendra historike, kremtimi i festave nationale e patriotike, kremtimi çdo vit i ditës së formimit të kooperativës, ndërmarrjes, institucionit e kështu me radhë. Natyrisht që dhe numri i datave të festave të reja me karakter popullor e nacional duhet të jetë i një mase të caktuar e të arsyeshme e jo të mbushet me festa, sa të dëmtohet puna prodhuese.

*
* * *

Nga analiza e bërë për disa fenomene mitologjike e besimesh që kanë të bëjnë me dukuri të kultit të të parëve ndër shqiptarë, na dalin disa tipare të përgjithshme të tij, tipare që do t'i parashtrojmë shkurtazi këtu poshtë.

U shqyrtuan fenomenet mitologjike si «nëna e vatrës», «gjarpri i shtëpisë», «gjinjtë e gruas», «të trashëguarit e emrave vetjakë», «kujtimi i të parëve, varret dhe të vdekurit» dhe nga ky shqyrtim na del se në përgjithësi me të njëjtat tipare janë të përhapura në gjithë Shqipërinë dhe në zonat jashtë Shqipërisë të banuara nga shqiptarë. Në këto figura, në këto dukuri nuk mund të mohojmë se ka dhe vëçori dalluese krahinore, por, me sa na jepin materialet e me sa jemi në gjendje t'i shqyrtojmë, këto dallime krahinore janë të sipërfaqshme, dallime emërtimesh apo elementesh të dorës së dytë; shpeshherë, këto janë shtesa të vonshme të karakterit ortodoks, katolik, islamik. Pra ajo që është thelbësore e më e vjetër është më unike në të gjithë popullin shqiptar (natyrisht të malësive, se atje janë ruajtur më tepër mbeturinat e këtyre miteve, riteve e besimeve që kanë të bëjnë me kultin e të parëve). Pra, këto flasin në të mirë të një uniteti etnik të lashtë të popullit tonë dhe problemi nuk qëndron ashtu siç e para-

gesin disa studiues të huaj tendenciozë që pohojnë se ndër shqiptarë vërehet një konglomerat kulturash që nuk përputhen me njëra-tjetrën.

Këto zakone, rite e besime që i takojnë objektit në fjalë, kanë jetuar edhe në gjysmën e parë të këtij shekulli, e diku-diku deri në ditë të sotme, ashtu siç vërehen dhe në popuj të tjerë të Ballkanit e të Evropës, kryesisht në popullsinë e zonave malore. Ato janë të lidhura në përgjithësi me jetën familjare dhe të gërshtuara me mbeturina të tjera të jetës patriarkale, me mbeturinat e fisit, të kanuneve që kanë ekzistuar e kanë vepruar në të kaluarën në vendin tonë, janë të pleksura me normat e feve të ndryshme që na kanë imponuar pushtuesit e huaj. «Një problem i madh shoqëror e ideologjik, thotë shoku Enver Hoxha, eshtë lufta për çrrënjosjen e paragjykimeve fetare dhe zakoneve prapanike që janë të gërshtuara midis tyre... Feja eshtë munduar që çdo ngjarje në jetën e njeriut ta veshë me petkun e saj mistik e reaksionar. Këto praktika të fesë janë futur jo vetëm në jetën e atyre që e besojnë, por bile dhe të atyre që nuk besojnë, të cilët i vazhdojnë ato ngandonjëherë pa i ditur e pa kuptuar.»⁹⁶ Për t'i çrrënjosur ato, duhet shpjeguar drejt shkencërisht përbajtja e tyre historike, botëkuptimore me thelbin e saj reaksionar.

Këto mbeturina të riteve e të besimeve, ndonëse në përgjithësi i takojnë së kaluarës, ruhen ende në njerëz të moshave të kaluara, në njerëz të prapambetur të shoqërisë sonë e sidomos në njerëz të deklasuar. Fenomene negative të këtij lloji duhen parë si një shfaqje e veçantë e luftës së klasave, luftë midis botëkuptimit të ri dhe atij të vjetrit, si mbeturina të ideologjive të klasave shfrytëzuese, të botëkuptimit patriarchal, feudal e borgjez; duhen parë në disa drejtime dhe si shfaqje e presionit të ideologjisë borgjeze e revizioniste, që e ushqen ruajtjen e këtyre mbeturinave në njerëzit tanë në ditët e sotme.

Më tepër mbeturina besimesh e praktikash të dëmshme në ditët e sotme ruhen në njerëz të veçantë në lidhje me të trashëguarit e emrave vetjakë dhe në lidhje me kujtimin e të parëve, varrimet dhe të vdekurit; këtu duhet drejtuar dhe tehu i propagandës ateiste shkençore, për të formuar koncepte të reja shkencore te njerëzit tanë në lidhje me këto fenomene.

Eshtë e vërtetë se të tilla mbeturina besimesh e praktikash në lidhje me kultin e të parëve i ndeshim më tepër në krahinat malore të Shqipërisë, por nga ndikime negative të këtij lloji nuk duhen përashtuar as zonat fushore e qytetet.

Duke qenë se disa rite e besime janë të lidhura me disa zakone të vjetra tradicionale të jetës familjare, ato do të zhduken bashkë me këto zakone. Pra, duhet luftuar për zëvendësimin e festave të vjetra me festa të reja popullore e të karakterit shoqëror e patriotik-nacional, duhen përgjithësuar fenomenet e reja të lindura në kushtet e ndërtimit socialist, siç eshtë rasti i emrave me përbajtje të shëndo-shë, kremitimin e jubileve kushtuar kujtimit të dëshmorëve, zakone të reja shoqërore në lidhje me të vdekurit, siç mund të jenë fjalime mbi punën e veprat e mira të atij që ka vdekur, vënie kurorash në varr, rregullim e sistemim i varrezave të reja në vende larg «vakëfeve» e objekteve të ndryshme të kultit të krishterë a islamik.

96) E. Hoxha, *Raporte e fjalime*, 1967-1968, Tiranë, 1973, f. 203.

Myftar MEMIA

MARTESA NË NIKAJ-MERTUR TË MALËSISË SË GJAKOVËS

Nikaj-Merturi, si nga lidhjet e gjakut, ashtu edhe nga territori i banimit, është pjesë përbërëse e Malësisë së Gjakovës. Kjo krahinë, me ndarjen administrative të pasçlirimit, është një ndër zonat e Malësisë së Gjakovës (tani rrathi i Tropojës).

Krahina e Nikaj-Merturit në përgjithësi ruan territorin e moçëm krahinor dhe shtrihet nga Qafa e Kolçit (në perëndim të Krasniqes) e deri në Qafën e Agrit, ku kufizohet Malësia e Gjakovës me krahinën e Dukagjinit (me Shalën e Thethin).

Vendasit kanë qenë të besimit katolik. Ky territor gjithnjë është thirrur me emrin e fiseve të banorëve të këtij vendi, Nikaj¹ — Mertur². Nikajt dhe Merturi, si nga numri i fshatrave, ashtu edhe nga numri i shtëpive dhe i banorëve, kanë qenë të barabartë dhe thirreshin: «*Treqind shpi Nikaj, treqind shpi Mertur*», ose «*Gjashtëqind shpi Nikaj-Mertur*».

Nikaj-Merturi ka qenë një vend blegtoralo-bujqësor dhe një nga zonat më të izoluara e më të varfра në Shqipëri, ku vendasit, me shumë vështirësi siguronin minimumin e jetesës. Banorët e kësaj krahine blinin bukë për pjesën më të madhe të vinit. Ata, për mungesë toke, (burrat) për nëntë muaj të vinit, emigroron nëpër Krasniqe, Gash e në Rrafsh të Dukagjinit, për të «çelë rrah» (d.m.th. për të hapur toka të reja) dhe për të bërë punë të tjera të rënda bujqësore vetëm e vetëm për të siguruar bukën e gojës. Po, me gjithë varfërinë e madhe dhe me mungesën e burimeve ekonomike, ata nuk e kanë braktisur kurrë trauillin e tyre.

Banorët e këtij vendi deri në Çlirimin e Shqipërisë, madje deri me zbatimin e Reformës Agrare, jetonin krejtësisht në Nikaj-Mertur. *Me zbatimin e Reformës Agrare* pushteti popullor familjeve që kishin shumë pak tokë të punueshme u shpërndau tokë. Kështu prej vitesh Cernica e Bukova (fshatra të reja me tokat më pjellore në Lugun e Malësisë së Gjakovës) banohen krejtësisht nga nikaj-merturasit, të cilët sot

1) *Nikaj* — Nikajt kanë lidhje gjaku me fisin e Krasniqes, me të cilën mund ti takosh deri në shtatë-tetë breza dhe nuk martoheshin në mes tyre. Nikaj përbëhej nga këto fshatra: Curraj i Epërm, Curraj i Poshtëm, Gjonpepj, Lekbibaj, Mserr, Peraj, Kapit.

2) *Mertur* — Merturi i Gurit, janë të fisit Berishë. Merturi përbëhej nga këto fshatra: Rajë, Bëtoshë, Shëngjergj, Tetaj, Salcë, Palç, Brisë.

punojnë në NB dhe në kooperativën bujqësore të bashkuar «8 Nëntori» (Llugaj-Luzhë).

Nikaj-merturasit, si burrat dhe gratë, janë shumë punëtorë. Ata, me kujdesin e treguar nga Partia dhe pushteti, dhe me punën e tyre të palodhur, gjatë viteve të pasçlirimit, kanë bërë një revolucion të vërtetë në jetesë, revolucion, i cili ka transformuar në mënyrë thelbësore edhe botëkuptimin e tyre. Sot jetesa e tyre nga çdo pikëpamje as që mund të krahasohet me të kaluarën e zezë e plot trishtim. Mjafton të përmendim vetëm faktin që në atë krahinë, para Çlirimt, asnjeri nuk e përdorte dyshekun e jorganin, kurse tanë nuk gjen familje që të mos jetë pajisur me rroba fjetjeje e orendi të reja shtëpiake.

Në të kaluarën feja, si vegël përcarjeje në duart e regjimeve dhe të klasave shtypëse e shfrytëzuese, duke spekuluar në ndjenjat fetare të besimtarëve, ka luajtur një rol shumë reaksionar përcarës, shtypës e shfrytëzues. Ndonëse Nikajt (katolikë) dhe Krasniqja (myslimanë) nga pikëpamja gjenealogjike janë dy degë të një trungu, që takohen në shtatë-tetë breza, feja myslimanë në psikologjinë e krasniqasve kishte mbjellë dhe një përcnim të theksuar ndaj vëllait të tij të një gjaku-Nikajt. Përgjithësisht ish-besimtarët myslimanë në Malësinë e Gjakovës përcmonin ish-besimtarët katolikë. Një ndjenjë përcarjeje e urejtjeje të thellë ndaj besimtarëve myslimanë kishte predikuar feja e kleri katolik te besimtarët e vet. Por më i theksuar ka qenë përcmimi i myslimanëve ndaj katolikëve, sidomos lidhur me prapambetjen e tyre, me papastërtinë e jetesën primitive, çka sot nuk ekziston më, vetëm si një kujtim i keq i së kaluarës.

* * *

Këtë punim të shkurtër do t'ua kushtoj vetëm zakoneve të martesës të zonës së Nikaj-Mërturit pér periudhën e paraçlirimit, zakone të cilat nuk i kam përfshirë në artikujt e mi të mëparshëm³. Prandaj mendova se paraqet interes t'u kushtohet një punim i veçantë, ku, në mënyrë krahasuese me zakonet e ish-pjesës myslimanë të Malësisë së Gjakovës, të vëmë në dukje zakonet e përbashkëta autoktone dhe ndryshimet e shkaktuara gjatë shekujve, si rezultat i evoluimit të tyre dhe i ndikimit të zakoneve të huaja, sidomos, të *myslimanizmit*.

Në zakonet e martesës të Nikaj-Mërturit, ndonëse kanë qenë dy fise, gjatë hulumtimeve të bëra, nuk munda të gjej ndonjë ndryshim në përbajtje as në formë. Kjo shpjegohet nga fakti se mbeturinat e këtyre dy fiseve, duke jetuar që nga shek. XVII⁴ në një territor të përbashkët, në kushte të njëjtë ekonomiko-shoqërore e politike dhe duke u martuar kryesisht në mes njëri-tjetrit, i kanë unifikuar edhe ato ndryshime lokale që mund të kenë pasur midis tyre. Ky fenomen duket plotësisht dhe në ish-pjesën myslimanë të Malësisë së Gjakovës e konkretisht në mes të Gashit, Krasniqës, Berishës dhe Kelmendit (Vu-

3) M. Memia, *Dasma e Malësisë së Gjakovës*, «Etnogr. Shq.» I, 1962, f. 276, dhe *Lindja e Kumaria në Malësinë e Gjakovës*, «Etnografija Sh.» II, 1963, f. 254.
4) Rr. Zojzi, *Ndarja krahinore e popullit shqiptar*, «Etnografija Shqiptare» I, Tiranë 1962, f. 42-43.

thajt) ku deri pas çlirimt ruhej me rigurozitet zakoni i lidhjes së martesës jashtë fisit (ekzogamia).

Zakonet e martesës të Nikaj-Mërturit deri në vitet gjashtëdhjetë përshkoheshin nga mbeturina të vjetra, që i paraqesin ato me një fytyrë arkake dhe me një ritual mjaft të pasur e interesant ceremonish.

Tradita zakonore e ndalonte martesën brenda fisit. Pavarësish nga vendbanimi, brenda ose jashtë territorit, me dhjetëra breza larg në vijën e babës, ata e konsideronin njëri-tjetrin *vëlla e motër*. Kurse në vijën e nënës konsideroheshin dhe thirreshin «dajë» i gjithë fshati i nënës. Si rrjedhim, brenda atij fshati nuk mund të lidhej martesë, sepse vajzat i konsideronin *teze*.

Kështu, deri në vitet gjashtëdhjetë, nuk ka pasur raste që nikçarët ose merturasit të jenë martuar brenda fisit, sepse një veprim të tillë tradita zakonore e ndalonte. Madje para Çlirimt normat kanunore e ndëshkonin shumë ashpër. Këtë zakon e kemi ndeshur edhe në ish-bësimtarët myslimanë të Malësisë së Gjakovës⁵. (Moslidhja e martesës brenda fisit, krahas me interesat pronësore, në të kaluarën e hershme ka ndikuar për ruajtjen e kompaktësisë së tij dhe ka siguruar daljen zot njëri-tjetrit ndaj fiseve të tjera në çdo rast rreziku). Kështu ekzogamia, si një nga mbeturinat më të fuqishme të rendit fisnor, arriti e pacenuar deri në vitet e pasçlirimt. Kjo deri me Çlirimin e vendit (1944) vepronte fuqimisht në ruajtjen e kompaktësisë së mbeturinave fisnore, qoftë edhe jashtë territorit të banimit. Themelet e ekzogamisë u tun-dën vetëm me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit dhe të zhdukjes së shfrytëzimit të njeriut prej njeriut.

M A R T E S A

Martesa, si një nga ngjarjet më të rëndësishme për jetën e njeriut, ka gjuar jo vetëm djalin e vajzën, por edhe të gjithë familjen dhe farfisin e tyre. Por në mes të familjes së djalit dhe të asaj të vajzës, ajo e djalit gjëzohej, kurse familja e vajzës gjëzohej që martonte vajzën, por hidhërohej se i pakësohej një krah pune. Kështu, familjes së djalit i shtohej një forcë e re pune, një pjesëtare familjeje, e cila, së bashku me njeriun e gjakut tjetër, do t'i ripërtërinte konakun, oxhakun me «trimë» e «trimnësha». Për këtë arsy familja e djalit bënte dasmë të madhe, kurse në familjen e vajzës as që ndihej atmosfera e gjëzimi i dasmës. Madje e gjithë ceremonia e përcjelljes së vajzës përshkohej nga një ritual me nota të theksuara elegjiakë. Prandaj nuk ndeshej as fjala «dasmë» te familja e vajzës, por përdorej fjala «përcjellje e çikës».

1. F E J E S A

Martesa, që kalonte nëpër disa etapa, familjen e djalit e vinte në një seri telashesh e vështirësish: nga një anë, «*me gjetë mikun dhe çikën*», nga ana tjetër, për të përballuar të gjitha shpenzimet ekonomi-

5) M. Memia, art. cit., «Etnografia Shqiptare», I, 1962, f. 276-277.

ke që kërkonte martesa. Sipas zakonit të përgjithshëm të Malësisë së Gjakovës, të gjitha shpenzimet e martesës i përkisnin familjes së djalit, kurse familja e vajzës, kryesisht preokupohej që vajzën ta martonte në një familje me gjendje të mirë ekonomike, me qëllim që t'i merrte sa më shumë «mësit», dhe vajza të mos vuante pér burkën e gojës. Njëkohësisht ajo preokupohej t'i jepte vajzës pér burrë një mashkull nga një familje sa më e mirë, sa më në zë, d.m.th. që të përmendej pér burräri, trimëri, besë, bujari etj.

Familja e djalit, në radhë të parë, interesohej të lidhët miqësi me një familje të «sojshme» (të fisme), me një familje të fortë, sepse edhe djali që do të lindte me atë grua do t'u ngjante dajave dhe do të bëhej trim si ata. Për këtë qëllim ajo informohej shumë kohë përpara se të kërkonte vajzën pér fejesë. Gjithashtu, edhe familja e vajzës, kur i kërkonin vajzën, para se t'i jepte fjalën e fejesës njërit apo tjetrit, hetonte sa më shumë si pér familjen, edhe pér djalin ose burrin pér të cilin i kërkonin vajzën. Ajo në radhë të parë informohej pér anën ekonomike. Por familja e vajzës nuk shkonte kurrë drejtpërdrejt në fisin tjetër pér të këruar dhëndër pér bijën e vet, mbasi një veprim i tillë konsiderohej si turp, i ulte dinjitetin. Por ka pasur raste që edhe familja e vajzës tërthorazi të merrte nismën e fejesës, duke ia sjellë ndër mend anës së djalit nëpërmes të ndonjë bije të martuar në atë fshat.

Sipas traditës zakonore, fejesa e martesa nuk bëheshin me njohjen paraprake të të interesuarve. Frederik Engels ka nënvizuar se: «Martesa nuk është një çështje e të interesuarve, të cilët shpesh edhe nuk i pyesin, por e prindërve të tyre. Kështu, shpeshherë fejohen dy persona që nuk njihen fare midis tyre, të cilëve u bëhet e ditur marrëveshja që është bërë vetëm atëherë, kur vjen koha e martesës...»⁶ Edhe në zonën e Nikaj-Merturit fejesat e martesat bëheshin nga prindërit e djalit e të vajzës pér llogari të tyre. Djali dhe vajza, ndonëse nuk e njihnin fare njëri-tjetrin, e pranonin këtë marrëveshje pa kundërshtim. Problemi i fejesës dhe i martesës nuk u përkiste direkt të interesuarëve, vajzës dhe djalit, por prindërve të tyre, të cilët i fejohen pa i pyetur fare, sidomos vajzën. Madje ka pasë mjaft raste që fejesat të jenë bërë në moshë të mitur ose edhe para lindjes. Ky zakon është ndeshur edhe në ish-besimtarët myslimanë të Malësisë së Gjakovës⁷.

Për gjetjen e mikut familja e djalit kishte si pikësynim që famili ja e vajzës të ishte derë e përmendur pér burräri e trimëri, pér besë e bujari, d.m.th. me gjetur «mikun ma të naltë se veten». Përveç kësaj, ajo interesohej edhe pér dajat e vajzës, madje edhe pér dajat e babës e të nënës së vajzës, sepse fëmijët mund t'u ngjasin edhe atyre. Kështu informoheshin pér origjinën si nga vija e babës, ashtu edhe e nënës. Krahas këtyre hetonin edhe pér pamjen fizike të vajzës, por në radhë të parë pér cilësitë dhe sjelljet e saj morale.

6). F. Engels — *Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit*, Vepra të zgjedhura, vëll. II; bot. shqip. f. 194-195.

7) M. Memia, art. cit., f. 277.

«Lypja e çikës»

Në Nikaj-Mertur, ashtu si në ish-besimtarët myslimanë të Malësisë së Gjakovës⁸, në Lumë⁹, Mirditë¹⁰, Myzeqe¹¹, Kallmet¹², Mat¹³ etj. fejesat bëheshin me shkuesi dhe në çdo rast shkuesi dérgohej nga ana e djalit.

Për të kërkuar vajzën, prindërit e djalit në fillim çonin dajën e saj, kumbarën, probatinin ose mikun e asaj familjeje që kishte të bënte me të. Ky quhej «shkues». Mbasi shkuesi merrte fjalën për fejesën e vajzës, njoftonte familjen e djalit se i kishte nxjerrë çikën, d.m.th. kishte marrë pëlqimin për lidhjen e miqësisë midis atyre dy familjeve.

Familja e vajzës nuk e jepte pëlqimin menjëherë, përkundrazi, ajo edhe kur ishte dakord, e zgjaste, me qëllim që t'i merrte sa më shumë «mësit» mikut, sepse e quante turp, se mund të mendonin bota se kishte frikë se po i mbetej vajza pa martuar.

Familja e djalit i paguante shkuesit rrugën për nxjerrjen e vajzës. Pagesa për shkuesin ishte sa vlefta e një dhie apo deleje.

Shkuesi, sipas marrëveshjes me prindërit e vajzës, i tregonte ditën kur duhej të shkonte për të «nxan çikën», d.m.th. kur duhej të shkonte familja e djalit bashkë me shkuesin te familja e vajzës për të pirë kafen e fejesës.

Shkuesi i thoshtë familjes së djalit se «sot nji javë kemi me shkue tu miku me nxan çikën». Për të bërë ceremoninë e fejesës, te familja e vajzës, zakonisht shkonin të dielen në mbrëmje. Nga ana e djalit, bashkë me shkuesin që ishte amanetqari i tij, shkonin në familjen e vajzës 3,5 ose 7 burra, d.m.th. tek. Këta të gjithë, me përjashtim të shkuesit, ishin farefis i dhëndrit një nga të cilët kryesori duhej të ishte baba a vëllai i dhëndrit, pra përfaqësues i shtëpisë së dhëndrit.

Dita e fejesës caktohej më parë sipas pëlqimit të familjes së vajzës, prandaj ajo edhe përgatitej për të pritur miqtë.

Miqtë priteshin nga «shpiaku», d.m.th. nga i zoti i shtëpisë, si dhe nga të afërmit e tij të ndarë nga një zjarr. «Shpiaku», bashkë me burrat e tjerë të fshatit, të ftuar për këtë qëllim, prisnin në shtëpi dhe, kur shihnin se miqtë po vinin, ngriheshin në këmbë, por nuk dilnin për t'i pritur qoftë edhe në oborr.

Posa futeshin miqtë brenda, shtëpiaku bashkë me meshkujt e tjerë, u merrnin armët dhe ua varnin në «çivillek», d.m.th. në vendin e armëve në fund të dhomës së burrave. Pastaj u thoshin të zinin vend, të uleshin.

Në markëzën¹⁴ e madhe uleshin miqtë, ndërsa markëza e vogël i

8) M. Memia, *art. cit.*, f. 276.

9) Sh. Hoxha, *Fejesa e martesa në Lumë*, «BUSHT.» Ser. Shk. Shoq. Nr. 4, 1960, f. 246.

10) K. Shtjefni, *Doke mirditore*, «Etnografia Shqiptare», II, 1963, f. 276.

11) Ll. Mitrushi, *Dasma në lalët e Myzeqesë*, «Etn. Shq.» II, 1963, f. 180-181.

12) M. Prendushi, *Vështrim etnografik mbi krahinën e Kallmetit*,

13) K. Ulqini, *art. cit.*, f. 230.

14) Ana e djathë e oxhakut quhet markëza e madhe dhe ana tjetër markëza e vogël.

takonte shtëpiakut e bashkëfshatarëve të tij. Kështu uleshin të dy palët dhe një mashkull i shtëpisë qëndronte në këmbë për t'u ndezur miqve llullat dhe për t'u dhënë kafet.

Shtëpiaku u piqte kafe të ëmbla dhe miqtë uronin:

— Për të mirë e në gjime!

— Paç bereqet e nafakë! — u përgjigjej shtëpiaku dhe vazhdonte biseda rrëth punëve bujqësore e blegtore.

Shtëpiaku, pa humbur kohë, u thoshte meshkujve të shtronin sofren, ku vihej menjëherë rakia e mezetë dhe mbas rakisë shtrohej darka.

Gjatë pajes dhe darkës qëndronin në këmbë dhe gratë e vajzat e shtëpisë, por nuk shtroheshin në pije, as në sofër të darkës me burrat.

Mbasi pinin kafet dhe ndiznin cigare, shtëpiaku bashkë me meshkujt e tij dhe shkuesin, i linin miqtë në dhomë e dilnin për të bise-duar.

Mbasi pak, ata ktheheshin në dhomë te miqtë dhe u tregonin kërkkesat që kishin ndaj palës së djalit. Aty përfshiheshin 12-15 qese serm dhe dy kokë dhi. Nga këto njëra i jepej krushkës (nënës së vajzës), kurse tjetra i jepej kujt të dëshironte familja e vajzës, d.m.th. dajës, tezes, ose kumbarës së vajzës.

Pagesa bëhej gjysma me bagëti e gjysma me para, të cilat i paguante familja e dhëndrit sipas afateve të caktuara.

Të nesërmen e fejesës, në mëngjes, me ditë të re, nga familja e djalit që zinte vajzën, zbrazeshin tri pushkë. Kështu merrej vesh që vajza ishte fejuar dhe shtëpiaku u bënte miqve kafe të ëmbla dhe shtronte një drekë.

Kur pinin kafen e fejesës, miqtë uronin:

— Për hajër na qoftë miqësia!

— E trashëgofshi! — u përgjigjej shtëpiaku.

I ati i dhëndrit, kur pinte kafen dhe lëshonte filxhanin, në tabaka qiste një sasi të vogël të hollash, gjë që simbolizonte bërjen e fejesës, lidhjen e miqësisë. Ai njëkohësisht u dhuronte edhe grave të shtëpisë nga një peshqesh të vogël në të holla, p.sh., nga një koronë, kurse krushkës pesë korona.

Miqtë, mbasi pinin kafen e pasdrekës, çoheshin dhe shtëpiaku së bashku me meshkujt e tij dhe shokët pjesëmarrës në drekë i përcillnin deri te shtegu i oborrit.

Kur familja e dhëndrit i plotësonte të gjitha, sipas marrëveshjes së bërë, dhe kur vajza bëhej 15-16 vjeçë, sepse fejesa mund të bëhej edhe në moshë të mitur, miku kërkonte caktimin e ditës për marrjen e nuses. Pra, kuptohet se vajza fejohej në moshë të mitur dhe mar-tohej në moshë tepër të re.

Që në vitet e para të Çlirimt marrja dhe dhënia e mësinit, si edhe fejesa e martesa pa arritur moshën 16 vjeç për vajzën e 18 vjeç për djalin u ndaluan me ligj.

Për të luftuar, ndaluar e çrrënjosur këtë fenomen negativ ngajeta e shoqërisë sonë, Partia, organizatat e masave dhe organet shtetërore zhvilluan një punë sistematike e të gjithanshme sqaruese e bindëse.

Ndaj rasteve flagrante u morën edhe masa shtrënguese e ndëshkuese, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi. Kështu, gjatë viteve të pushtetit populor, lidhur me çrrënjosjen e këtij fenomeni të trashëguar nga e kaluara, është bërë një revolucion i thellë në psikologjinë e malësorit të kësaj zone.

Përgatitja e «çejzit»

«Çejz» quhej e gjithë paja që përgatitej pér nusen. Aty përfshihej veshmbathja e nuses, peshqeshet që ajo i çonte burrit, prindërve e farefisit të tij, si dhe krushqve.

«Unaza» e nuses përbëhej nga dy veshje të plota: dy xhubleta, dy pështjellakë, dy kërdhukla, dy palë të brendshme, dy palë opinga, dy shami koke, dy palë çorape, tri unaza (myhyrë) sermi, një palë dykme (gjoksore), një palë vëthë sermi, një brez i veshur me sërm, ruba nuseje (duvak i bardhë ose i kuq) pér ditën e martesës.

Nusja përgatiste si dhurata²⁰, nga një palë çorape leshi pér të gjithë farefisin e burrit, pér ilakatë e veta dhe pér aq krushq, sa do të ftonë dhëndri në dasmë, që mund të ishin 30-60 veta. Leshin pér përgatitjen e dhuratave e çonte dhëndri, kurse çorapet i thurte nusja ose familja e saj.

«Premja e orokut»

Kur përfundonin të gjitha përgatitjet e martesës, pala e djalit shkonte te familja e vajzës dhe kërkonte caktimin e ditës së dasmës, ose siç e quajnë vendasit «*premjen e orokut*».

Sipas dëshirës së prindërve të vajzës, dita e martesës caktohej mbas tri ose katër javësh. Vajzës i njoftohej dita e caktuar pér martesë dhe ajo nuk merrej me punë bujqësore e blegtorale, si më parë, por qëndronte në shtëpi.

Shtatë deri dhjetë ditë përparrë ditës së dasmës, nga ana e djalit shkonin te shtëpia e vajzës një ose dy burra pér të çuar «*cikrritë*».

«Cikrritë» nuk përmblidheshin në «*pazarin e çikës*». Ato ishin: një krëhër, një pasqyrë, një unazë dhe një pare qafe sermi, një sapun tualeti (ky është shtuar vonë). «Cikrritë» dërgoheshin nga një i afërm i dhëndrit, i cili mund të ishte vëllai ose kushërir i parë i tij dhe daja i vajzës ose kumbara, që kishin të bënin me familjen e vajzës.

Në qoftë se familja e dhëndrit nuk kishte dërguar «*Cikrritë*», familja e vajzës nuk ua dorëzonte nusen krushqve, prandaj «*cikrritë*» dërgoheshin me kohë.

20) Pas Çlirimt, këtë dekadën e fundit, në Nikaj-Mërtur, zakonin e dhuratave pér krushqit e kanë hequr. Ngritja e pakrahassueshme e nivelit ekonomik e kulturor, dhe e mënyrës së jetësës në atë zonë ka rritur edhe kërkosat pér përgatitjen e më shumë rrobave pér veshmbathjen e nuses, p.sh., nga dy palë në përgatitjen e aty-këtu vërehen teprime. Janë shtuar rrobat e fjetjes, dyshekë, katër. Kështu aty-këtu vërehen teprime. Tani është jorganë, etj., të cilat para Çlirimt as që përdoreshin në atë zonë. Tani është shtuar edhe një arkë (sënduk) nuseje, e cila blihet në koop. e artizanatit të qytetit «Bajram Curri».

2. D A S M A

Familja e dhëndrit përgatitej për dasmë shumë kohë përpara, si p.sh. me mish, raki, bukë etj., por përgatitjet kryesore bëheshin mbas caktimit të ditës së dasmës. Gëzimi i dasmës përfshinte tërë fshatin, sidomos mbas thirrjes së krushqve.

Thirrja e krushqve

Krushqit ftoheshin për në dasmë nga familja e dhëndrit tetë ditë përpara, sepse atyre u duhej kohë për t'u përgatitur me veshmbathje, me duhan e sidomos me fishekë.

Krushqit ftoheshin në fshatin e dhëndrit nga një për shtëpi, kurse kushérinjtë e ndarë nga një zjarr ishin të ftuar krushq kush të dëshironte për të shkuar. Ftoheshin krushq edhe ilakatë e dhëndrit, si p.sh. daja, kumbara, probatini etj., të cilët nuk ishin nga fshati i dhëndrit. Ftohej edhe daja i nuses.

Për të ftuar krushqit, dërgohej një i afërm i shtëpisë së dhëndrit, i cili mund të ishte kushériri i parë, i dytë etj. Ai që ftonte krushqit i shkonte secilit në shtëpi dhe i thoshte:

— Sot një javë je krushk te Q.N., se marton djalin ose vëllanë, nipi etj.

— Faleminderit, e gëzofshin njéri-tjetrin!, ose Për hajër i koft nusja! — i përgjigjej i ftuari.

Autoritetet e pushtetit lokal, siç ishin nënprefekti, kryetari i komunës, rrethkomandanti, postkomandanti etj., masa e malësorëve nuk i ftonte në dasmë, gjë që tregon për urrejtjen e hapur që ushqente populli ndaj regjimeve antipopullore.

Ai që ftohej krushk e quante si një nder të madh që i bënte shtëpiaku, por secilin prej të ftuarve e preokuponte shumë përgatitja me veshmbathje, duhan e fishekë, meqë ishin shumë të varfër dhe detyroheshin ta kërkonin nëpër shokë e miq veshmbathjen; nga ana tjetër, përgatitja me fishekë kishte shpenzime, se në dasmë qiteshin shumë pushkë, qoftë për gjuajtjen e shenjit (qitjen në shenj), qoftë për tua kthyer përshëndetjet me të shtëna pushkësh atyre që i përshëndesnin gjatë rrugës. Kështu pra, shpenzimet nuk ishin të vogla edhe për krushqit.

«Dasmorët» dhe «dasmoreshat»

Në krahinën e Nikaj-Mërturit, ndryshe nga ish-besimtarët myslimanë të Malësisë së Gjakovës, një natë para ditës së dasmës, shtëpia e dhëndrit çonte te miku për të marrë nusen tre burra e dy gra, të cilët quhen dasmorë dhe dasmoresha.

Dasmoresha dërgoheshin:

- 1) E motra e dhëndrit, ose tezja e tij, që quhej «marrësja».
- 2) E motra e nuses, ose tezja e saj, që quhej «përcjellësja».

Dasmorja e parë ishte përfaqësuesja e dhëndrit, kurse dasmorja e dytë përfaqësuesja e nuses.

Dasmorët ftoheshin nga farefisi më i afërt i dhëndrit, si p.sh. vëllai, kushëriri i parë, xhaxhai etj.

Dasmorët e dasmoret shkonin te shtëpia e mikut në mbrëmje, para se të errej. Ata priteshin në oborr të familjes së vajzës dhe miku i shtinte brenda, u pikte kafe të ëmbla, kurse për darkë e për të fjetur shkonin te një më i afërm i tij, i cili ishte i ndarë prej një zjarri.

Te shtëpia e nuses dasmorët dhe dasmoret çonin një dhi, tri okë raki dhe tri okë djathë për meze. Këto dërgoheshin nga shtëpia e dhëndrit për shpenzimet që do të bënte miku në drekën që do të shtronte në mëngjesin e ditës së dasmës me dasmorët, dasmoret dhe të ftuarit e fshatit të vet për të përcjellë vajzën në «pjekje».

Më i afërm i shtëpisë së vajzës, që i merrte për darkë, u shtronte raki, meze dhe bukë e mish. Aty merrnin pjesë edhe burra të tjerë nga pala e vajzës. Mbasdarke luheshin kapuçat²¹ dhe nga pala e vajzës bëhej çmos për t'i mundur e për t'i kënduar miqtë në kapuça.

Kur dasmorët dhe dasmoret arrinin në shtëpinë e vajzës, ajo qante tri herë me zë të lartë:

— Oj, oj, oj!

Atë natë, në shtëpinë e vajzës, nuk mblidheshin gra as vajza dhe nuk bëhej ndonjë ceremoni, siç ndodhë natën e «kanagjeçit»²² në ish-besimtarët myslimanë të Malësisë së Gjakovës.

Ditën që do të shkonte vajza nuse, në mëngjes herët, babai i vajzës, nga fshati i vet ftonte nga një burrë për shtëpi, për të nxjerrë vajzën në «pjekje». Ai u shtronte atyre një drekë të hershme, në të cilën merrnin pjesë edhe dasmorët e dasmoret.

Shtëpiaku në fillim u qiste duhan dhe kafe të ëmbla, pastaj u shtroste rakinë me meze dhe më vonë u shtrohej buka.

Në sofrën e parë uleshin dasmorët së bashku me disa nga burrat e ftuar nga shtëpiaku, ndërsa sofrat e tjera mbusheshin me të ftuar të tjerë nga fshati, të cilët uleshin secili në vendin që i takonte, sipas oxhakut. Kurse dasmoret hanin me gratë, mbasi të mbaronin së ngrëni burrat. Pas buke pjesërnarrësve në drekë u bën edhe kafe të ëmbla.

Ditën e dasmës, pa qenë nevoja për t'i ftuar, në mëngjes herët, shkonin vajzat e fshatit për të parë shoqen e vet të veshur nuse dhe përtë përcjellë atë kur të dilte prej shtëpie.

Vajza vishej nuse ditën e martesës, në mëngjes herët. Atë e vishtë dasmorja e anës së saj. Në atë moment vajza nuse fillonte të qante me zë. Zëri dëgjohej larg dhe shoqet e saj, që kishin shkuar për ta përcjellë, qanin me lot për ndarjen e saj.

Momenti më pikëllues ishte ai kur vajzën e kapte për krahu një mashkull i shtëpisë, vëllai, kushëriri etj. për ta nxjerrë nga shtëpia dhe ajo duke bërtitur, tërhiqej me forcë për të mos dalë.

Vajza përcillej nga shtëpia tri-katër orë mbasi gdhihej dita. Në këtë rast ajo qante me zë të lartë, duke bërtitur dhe duke përqafuar me radhë të gjithë njerëzit e shtëpisë dhe të afërmit. Kështu, duke bërtitur me të madhe ajo shkonte katër-pesëqind hapa rrugë nëpër fshatin e saj.

21) M. Memia, art. cit., f. 281.

22) M. Memia, art. cit., f. 285.

Kur vajza dilte nga shtëpia, një mashkull i shtëpisë zbrazte tri pushkë, gjë që simbolizonin ndarjen e vajzës nga familja e fisi i vet.

Vajza derisa dilte nga oborri bërtiste e têrhiqeje prapa, por, kur kalonte oborrin, ecte duke kthyer kokën pas, derisa largohej nga shtëpia.

Deri në «pjekje» dasmorët shkonin përpara, mbas tyre shkonin përcjellësit, pastaj vinin: dasmorja e parë, nusja dhe në fund dasmorja e dytë. Dasmorët lidhnin një shami të kuqe rrith qafës. Nusja gjatë gjithë rrugës ecte në këmbë duke u mbajtur për krahu prej një nga të afërmit e saj.

Mbledhja e krushqve

Krushqit mblidheshin në shtëpinë e dhëndrit në mëngjesin e ditës së dasmës, si p.sh. të dielën. Ata, para se të shkonin në shtëpinë e dhëndrit, mblidheshin në një vend dhe i thërrisin shtëpiakut nga larg. Ata e përshëndesnin atë me zbrasje armësh të gjata dhe ai ua kthente përshëndetjen, por pushkët e fundit u mbeteshin krushqve.

Krushqit priteshin në oborr nga shtëpiaku, nga meshkujt e tjerë të shtëpisë dhe kushërinjtë të ndarë prej një zjarri. Ata hynin në dhomën e përgatitur për ta. Mbas ulej secili në vendin që i takonte, shtëpiaku (i zoti i shtëpisë) i qeraste me duhan e kafe të ëmbla.

I zoti i dasmës u shtronte një drekë të hershme me raki, meze, bukë e mish. Ata këndonin këngë «*maje krahu*», duke i përcjellë me zbrasje pushkësh. Dreka hahej shpejt dhe menjëherë krushqit niseshin për në «pjekje». ²³⁾

Para se të niseshin krushqit për në «pjekje», shtëpiaku caktonte të parin e krushqve, i cili ishte burri më i njohur. Ai jo vetëm u printe krushqve gjatë rrugës, por edhe në «pjekje» dhe në dasmë i jepte tonin bisedës.

Krushqit gjithë rrugën e bënин duke kënduar këngë *maje krahu*, të cilat shoqëroheshin me qitje pushkësh. Ata gjatë rrugës gjuanin dhe në shenjë, sidomos në «pjekje».

Pjekja²⁴⁾

Përcjellësit e nuses, bashkë me dasmorët e dasmoret dhe nusen, duhej të arrinin medoemos përpëra krushqve në «pjekje» për t'i pritur.

Posa arrinin krushqit në «pjekje», pala e nuses (përcjellësit) u qisnin miqve duhan, kafe të ëmbla dhe raki, pastaj edhe krushqit u qisnin përcjellësve duhan e raki. Si përcjellësit ashtu dhe krushqit merrnin me vete nga katër gota dhe nga dy ibrikë rakte, për të gostitur palën tjetër. Aty qëndronin duke biseduar rrith dy orë.

Mbas mbaronte gostitja reciproke, fillonte gjuetja në shenjë nga

23) M. Memia, *art. cit.*, f. 293.

24) «*Pjekja*» caktuhej me marrëveshje në një shesh, në një livadh, në një qafë dhe, kur koha ishte e keqe, në ndonjë shtëpi.

të dy palët. Por të parët shtinin në shenjë krushqit e dhëndrit. Në një shpat mali përkarshi pala e nuses venin katër-pesë rrasa guri të bardha pér t'i gjaujtur.

Në «pjekje» nusja, bashkë me dy dasmoret dhe me ndonjë mashkull të familjes së saj, qëndronte në ndonjë lëndinë dy-treqind hapa larg krushqve.

Kur krushqit donin të niseshin, përcjellësit u dorëzonin atyre bï-jën e tyre dy dasmoreve dhe «deverit»,²⁵ i cili mbante nusen nga krahu i djathtë.

«Deveri» që është më i afërm i dhëndrit, por i ndarë prej një zjarrri, konsiderohej nga nusja si njeriu më i afërm nga i gjithë farefisë i burrit. Prandaj te shtëpia e këtij nusja hante bukë pér herë të parë mbas shtëpisë së dhëndrit.

I pari i krushqve printe në ballë dhe nusja udhëtonte në fund të krushqve. Kur krushqit largoheshin katër-pesëqind hapa nga «pjekja», ndërsa përcjellësit qëndronin në këmbë, i pari i krushqve, ose «deveri», u thërriste përcjellësve me zë të lartë dhe ata i përgjigjeshin po me zë të lartë. Atëherë i pari i krushqve u thoshte përcjellësve:

— O lamtumirë, e u pafshim pér hajër, more uaaa! — dhe i përhëndesnin me një breshëri pushkësh prej pesë deri pesëmbëdhjetë të shtënash.

— O paçi hajër, dhe i pafshi hajrin nuses, more oaaa! — Dhe ua kthenin përshëndetjen po me të shtëna pushkësh.

Krushqit vazhdonin rrugën, ndërsa përcjellësit, mbasi largoheshin pesë-gjashtëqind metra nga «pjekja», u thërrisin krushqve pér emër dhe iu uronin nusen dhe rrugë të mbarë, duke i përshëndetur me të shtëna pushkësh. Dhe krushqit u përgjigjeshin me breshëri armësh. Pushkët vazhdonin tri-katër minuta nga të dy palët, duke mos ia lënë asnjëra palë tjetrës, por pushkët e fundit u mbeteshin krushqve marrës. Përcjellësit kishin pér qëllim t'ua shpenzonin fishekët krushqve, prandaj vazhdonin t'u thërrisin me radhë.

Përcjellësit ktheheshin pér në shtëpi, ndërsa krushqit vazhdonin rrugën duke kenduar këngë «maje krahu» dhe duke i shoqëruar me të shtëna pushkësh.

Kur krushqit kalonin nëpër fshatra të fisit të tyre, fshatarët i uronin dasmën shtëpiakut me të shtëna pushkësh. Njëkohësisht u thërrisin edhe krushqve dhe u uronin atyre rrugë të mbarë dhe i përshëndesnin me të shtëna pushkësh. Dhe krushqit ua kthenin përshëndetjet me më tepër të shtëna.

Në qoftë se në afërsi të rrugës nga kalonin krushqit ndodhet me shtëpi ndonjë i afërm i dhëndrit, si p.sh. kushërirri, kumbara, baxhanaku, probatini etj., ai, pasi i përshëndeste krushqit me të shtëna pushkësh, i ndalonte ata bashkë me nusen dhe i gostiste me duhan e raki.

Krushqit gjatë gjithë rrugës vazhdonin udhëtimin me këngë e të shtëna armësh deri kur dilnin në fshatin e dhëndrit përballë shtëpisë së tij. Aty mblidheshin të gjithë, bënin një pushim të vogël dhe këndonin këngë «maje krahu» dhe shtinin me pushkë.

Krushqit në Nikaj-Mërtur, ashtu si në pjesën e ish-besimtarëve my-

25) M. Memia, art. cit., f. 299.

slimanë të Malësisë së Gjakovës²⁶, si dhe në Skrapar²⁷, në Mat²⁸; në Lumë²⁹, në Myzeqe³⁰, në Çamëri³¹ etj., nuk shkonin dy herë nëpër të njëjtën rrugë. Në «pjekje» shkonin nëpër rrugën më të vështirë e më të padukshme, ndërsa, kur ktheheshin me nuse, binin nëpër rrugën më të lehtë dhe të dukshme. Mjaftonte që rruga të shmangej goftë edhe në një largësi fare të vogël. Ky zakon është një mbeturinë e rendit fisonor primitiv që ka lidhje me zakonin e grabitjes së femrës.

Nga vendi i ndalimit, krushqit bashkë me «deverin» i thërrisin dhëndrit në emër me zë të lartë e me sokëllimë dhe ai u përgjigjet nga oborri i shtëpisë së vet, ku qëndronte për të pritur krushqit e nusen.

Krushqit i drejtoheshin dhëndrit me këto fjalë:

— O pramja e mirë, more uaaa! — Ata zbraznin pesë pushkë.

Dhëndri u përgjigjet:

— O mirë se vini, more uaaaa! — Ai i përshëndeste duke zbrazur pushkën pesë herë.

Krushqit deri në oborr vazhdonin rrugën duke kenduar këngë «maje krahua» e duke shtënë pushkë.

Mbërritja e krushqve në shtëpinë e shtëpiakut

Për të pritur krushqit në oborr të shtëpiakut dilnin burrat e shtëpisë, të cilët s'kishin shkuar krushq, meshkuj të fshatit, gra, vajza etj. me në krye plakun e shtëpisë, kur ai nuk kishte mundur të shkojë krushk.

Në mes të oborrit të shtëpisë shtrohet një sofër buke me një bukë cerepi, me një «gogël djathë» përmbi të.

Kur krushqit hynin në oborr, përshëndeteshin me pritësit. Pas krushqve vinte «deveri» me nusen për krahua dhe dy dasmoret, të cilat e shoqëronin nusen gjatë rrugës.

Krushqit bashkë me pritësit qëndronin në oborr, në këmbë, po kështu edhe dasmorët, kurse «deveri» me nusen për krahua silleshin tri herë rreth sofrës së shtruar. Në krye të çdo rrotullimi shtihej një herë me revole. Në këtë rast përmbi nusen, «deverin» e sofrën hidhej një sasi gruri nga një mashkull tjetër i shtëpisë, i cili duhet të ishte në moshë të re, i martuar e me fëmijë, ose nga një i afërti i dhëndrit, i ndarë prej një zjarri me të.

Mbasi mbaronte kjo ceremoni, dhëndri, që qëndronte në këmbë te dera e shtëpisë, para se nusja të futej brenda, i binte me një grusht të lehtë në sup. Nusja, bashkë me «deverin», hynte brenda në «konak» (në shtëpi) dhe fill pas saj shkonin dy dasmoret. Ata, dhe menjëherë pas tyre edhe dhëndri, shkonin në odën e burrave. Kështu, nusja, de-

26) M. Memia, *art. cit.*, f. 295.

27) Rrok Zojzi, *Dasma në krahinën e Skraparit*, «Bul. I USHT.» Ser. Shk. Shoq. 2, 1958, f. 229.

28) K. Ulqini, *art. cit.*, f. 233., Q. Alushi, *Dasma matjane AE*, Dok 293/32, fq. 20.

29) Sh. Hoxha, *art. cit.*, f. 256.

30) Ll. Mitrushi, *art. cit.*, f. 210.

31) Abaz Dojaka, *Dasma çame*, «Studime historike», nr. 2, Tiranë 1966 f.

veri, dy dasmoret dhe dhëndri, që të pesë shkonin në odën e burrave, ndërsa krushqit qëndronin në oborr.

Posa hynte nusja në dhomë, e ulnin në një stol dhe menjëherë i çonin një djalë dy-trevjeçar dhe ia ulnin në prehër (gjunjë). Nusja e puthte fëmijën në të dyja faqet dhe i jepte një palë çorape fëmije, të cilat i kishte përgatitur për këtë qëllim. Brenda në çorapet shtinin disa kokrra sheqeri.

Kur nusja puthte fëmijën, dhe i jepte çorapet, dasmorja e parë i hiqte nuses duvakun. Në këtë rast dhëndrit dhe nuses u çonin një kulaç gruri dhe një «bludë»³² me mjaltë.

Kulaçi u jepej në dorë dhëndrit e nuses. Ata, duke e tërhequr secili nga vetja, e thynin kulaçin dycopash, por nuses duhej t'i mbetej më pak në dorë, kurse dhëndrit, si mashkull, pjesa më e madhe, çka simbolizonte epërsinë e mashkullit mbi femrën. Kjo ceremoni quhej «*thymja e kulaçit*». Ndërsa dhëndri nga pjesa e vet nuk i jepte askujt, nusja nga pjesa e saj u jepte pjesëmarrësve të kësaj ceremonie nga një ose dy kafshata kulaç të ngjyer në mjaltë. Të parit i jepte dhëndrit, pastaj «*deverit*», dasmorëve dhe së fundi hante edhe vetë. Kjo bëhej me qëllim që t'u shkonte jeta me ëmbëlsi.

Posa mbaronte kjo ceremoni, nusen e çonin në vendin e saj, d.m.th., në odën e fjetjes, duke u liruar odën e burrave krushqve dhe të ftuarve të tjerë, të cilët prisnin në oborr.

Krushqit, para se të hynin brenda, armët e gjata ia dorëzonin shtëpiakut, dhe ai i vendoste në odën e burrave, d.m.th. në dhomën ku do të rrinin krushqit. Ato i varte me radhë në çivillëk, në fund të dhomës.

Krushqit hynin në odën e burrave dhe uleshin sipas vendeve që u takonin. Porsa uleshin, shtëpiaku ose një mashkull tjetër i shtëpisë u qiste duhan, tjetri i ndizet llullat dhe shtëpiaku u pikte kafe të émpla, kurse një mashkull i shtëpisë ose një i afërt shpérndante kafet. E gjithë biseda zhvillohej rreth udhëtimit, qëndrimit në «*pjekje*», pritjes e përcjelljes nga ana e palës së nuses, gjuajtjes së shenjit, shpenzimit të fishekëve nga krushqit etj.

Krushqit, mbasi pushonin pak, delnin në oborr për «*t'i la duert*» dhe pastaj hynin brenda dhe shtroheshin në pijë.

«Lamja e duerve»

«Lamja e duerve» fillonte me radhë sipas, vëllezërive dhe «oxhaqeve». P.sh. në fillim i lante duart i pari i fshatit, si përfaqësues i fshatit, d.m.th. si shtëpiak. Pas këtij i lante bajraktari i fisit, pastaj me radhë sipas vëllazërive e oxhaqeve dhe kështu derisa mbushej sofra e parë me dhjetë-dy mbëdhjetë burra, pastaj e dyta, e treta, e katërtë, e pesta etj., derisa të lanin duart të gjithë krushqit.

Kur dasma ishte në Mërtur e nusja merrej në Nikaj, apo në ndonjë fis tjetër, dhe anasjelltas, nga burrat e fisit të vajzës s'mund të merrte

32) M. Memia, art. i cit., f. 299.

kush pjesë në dasmë, sepse, sipas traditës zakonore, konsiderohej turp.

Ky zakon ka qenë shumë rigoroz, por ka filluar të prishet që nga viti 1925.

«*Lamjen e duerive*» e drejtonin 'tre burra, njëri nga të cilët thërriste njerëzit sipas radhës e vëllazërisë, tjetri u qiste të lanin duart, kurse i treti shikonte nëse njerëzit po «*lahen*» sipas radhës, apo ndonjëri po paraqitej pa radhë, çka mund të bëhej shkak ngatërresash që mund të shkaktonte vëllavrasje midis vëllazërive, bile edhe fiseve.

Ai që thërriste njerëzit për të larë duart, quhej i dyti i fshatit ose i bajrakut. Prandaj atij i rezervohej edhe vendi në sofrën e parë, kurse atij që u qiste për të larë duart i caktohej vendi në sofrën e dytë, ndërsa atij që shikonte nëse po respekohej radha, në sofrën e tretë, sepse që të tre kishin një farë parillëku të vogël në fshat ose në fis.

Mbas Çlirimit zakoni i «*lamjes së duerive*» është hequr në zonën e Nikaj-Mërturit.

Si në darkë ashtu edhe në drekën e shtruar nga shtëpiaku për krushqit, në fillim shtrohej rakia me meze të thjeshta, pastaj shtrohej buka.

Rakia nuk qitej nga meshkujt e shtëpiakut, por ai u jepte krushqve tre ibrikë me raki e gjashtë gota. Në fillim ibrikët me raki dhe gotat i merrnin tre pari kryesorë të cilët, duke qëndruar në këmbë, u qitnin një radhë gotash të gjithë krushqve, duke i uruar dasmën shtëpiakut dhe u uronin edhe krushqve shëndet. Mbas këtyre i merrnin ibrikët me raki dhe gotat tre pari të tjerë, të cilët vinin mbas këtyre dhe u qitnin krushqve një radhë gotash dhe kështu me radhë të gjithë krushqit vazhdonin me ibrikë e gota në dorë duke u qitur krushqve nga një radhë gotash me raki.

Bajraktari vetë personalisht nuk u shërbente krushqve me raki, por përfaqësohej nga më i afërmë i tij, d.m.th. radhën e tij e kryente një mashkull i gjakut të tij, duke filluar i pari, si pari kryesore që ishte.

Konsiderohej fyerje e madhe publike për një krushk, në rast se nuk i jepej ibriku me raki për t'u shërbyer krushqve, prandaj të gjithë krushqit shërbentin sipas radhës.

Ata që qisnin rakinë qëndronin në këmbë, derisa mbaronin radhën. Në dorën e djathtë mbanin ibrikun me raki dhe në dorën e majtë gotat, të cilat i mbushnin plot dhe ua jepnin në dorë secilit krushk, duke uruar sipas zakonit. Krushku i kthente urimet shpërndarësit të rakisë, conte gotën me fund dhe ia dorëzonte prapë në dorë atij që shërbente. Kështu vazhdonte qitja dhe pija e rakisë.

Sofra e «*madhe*», d.m.th. sofa e parë ku uleshin të parët e fshatit apo të fisit, mbante qetësinë e dasmës dhe i jepte tonin gjithë bisedës. Ajo fillonte e para rakinë dhe propozonte për ta hequr pijen. Por kur sofrat e tjera kërkonin të vazhdonte rakia, ajo vazhdonte derisa sofrat e tjera të binin dakord që të hiqej.

Mbasi mbaronte radha e parë e shërbimit nga të gjithë krushqit dhe fillonte radha e dytë, krushku i parë, i cili zinte vend në sofrën e «*madhe*», në qoftë se mendonte të ndalohej rakia, ai nuk e vinte gotën në buzë, por e vinte atë përpëra në sofër dhe kështu vepronin edhe të tjerët në sofrën e parë, d.m.th. asnjë nuk e vinte në buzë, pa e vënë paria kryesore që qëndronte në krye të vendit.

Kjo bëhej me qëllim që të hiqej rakia, por sofra e dytë, kur e shihte se sofa e parë e ndalonte rakinë, për t'i treguar asaj dhe sofrave të tjera se nuk ishte dakord për të hequr pijen, i drejtohej njëzëri si në kor të parit të krushqve me këto vargje:

*Putiro, del t'u via,
bavde mir o Z.A.*

Me këto vargje, sofa e dytë i tregonte sofrës së parë se do të vazhdonte prapë rakia.

Dhe sofa e parë, për t'i treguar asaj se kanë pirë mjaft, njëzëri i përgjigjej me këto vargje:

*Putiro, more dushman,
mos më myt, po lem derman!*

Kurse sofa e tretë ia fillonte me këto vargje:

*Putiro, mos më ban hile,
se nuk e çoj pa i pi dhet' kile!*

Po kështu dhe sofa e katërt përgjigjej me këto vargje:

*Unë dhet' kile i kam pi,
po nuk e çoj pa i pi dhet dy a tri!*

Në këtë mënyrë, me kërkesën e sofrave të tjera, sofa e parë detyrohej të fillonte përsëri pijen dhe rakia vazhdonte për dy-tri orë të tjera, sepse do të qisnin prapë të gjithë krushqit me radhë, që mund të ishin pesëdhjetë-gjashtëdhjetë veta.

Pra, siç shohim, për heqjen e rakisë nuk mund të vendonte sofa e parë, në të cilën zinin vend të parët e fshatit ose të fisit, por rakia hiqej vetëm atëherë kur binin në një mendje të gjitha sofrat. Kështu bajraktari, me gjithë pozitën e tij shumë të privilegjuar si pari kryesore, nuk kishte të drejtë komandimi.

Gjatë pirjes së rakisë, krushqit bënin biseda të holla plot alegori dhe këndonin këngë kreshnikësh dhe këngë trimërie, që vinin në pah luftërat dhe qëndrimin burrëror të shqiptarëve kundër turqve, shovinistëve sérbo-malazez, austro-hungarezëve dhe italo-gjermanëve. Këngët ekzekutoheshin me lahutë ose me çifteli dhe këndoheshin edhe këngë «maje krahu», të shoqëruara me zbrazje pushkësh e revolesh.

Dejha nga rakia konsiderohej shumë e turpshme, sa prishte dasmën. Prandaj krushqit ruheshin dhe nuk ndodhëtë dehej kush në dasmë. Rakinë e përdornin të butë 12-16°.

Pirja e rakisë zgjaste disa orë me radhë. Kur çohej rakia, shtrohej buka: në fillim me djathë, pastaj shkonte «bluda» me dhjamë, mishi i zier dhe në fund kosi.

Shtëpiaku që bënte dasmën, edhe në rast se therte ndonjë lopë, e cila ia plotësonte nevojat për mish, ai prapë detyrohej të therte edhe një berr të imët. Kjo për arsyen se, sipas zakonit, paria që ulej në dy sofrat e para duhej dalluar nga sofrat e tjera, d.m.th. nga vegjelia.

Në sofrën e parë, pérveç mishit, shkonte koka dhe njëra shpatull e berrit, kurse në sofrën e dytë shpatulla tjetër dhe veshkat, ndërsa në sofrat e tjera vetëm mishi, pa ndonjë shenjë dalluese. Bishti nuk konsiderohej shenjë dalluese.

Kryet e berrit, si shenjë kryesore, i qitej bajraktarit ose atij që zinte kryet e vendit. Ai nuk e hante, por i hiqte vetëm fëlqitë (nofullat) dhe kokën, ia jepte kuzhinierit që ziente mishin, kurse shpatullat u qiteshin dy *parive të dytë*, që ishin ulur njëri në sofrën e parë dhe tjetri në të dytën. Atyre që u qitej shpatulla, nuk e mbanin pér vete, por ua ndanin të tjerëve në të dyja anët e sofrës, d.m.th. në të djathëtë dhe në të majtë, ndërsa pér vete mbanin vetëm nga një shenjë. Mishit tjetër nuk ndahej, por secili merrte mish sa të donte nga ena, e cila vendosej në mes të sofrës pér të gjithë.

Kur çohej darka, shtëpiaku u qiste krushqve duhan dhe kafe të ëmbla, pastaj qisnin kapuçat, ku luheshin vetëm katër loja. Në orët e vona të mesnatës krushqit shpérndaheshin pér të fjetur nëpër shtëpitë më të afërtë, kurse aty qëndronin vetëm të largëtit, ata që nuk ishin nga fshati i shtëpiakut.

Të nesërmen në mëngjes krushqit mblidheshin prapë te shtëpia e dhëndrit dhe përshëndeteshin me njëri-tjetrin, sikur të mos ishin parë pér një kohë të gjatë dhe secili ulej në vendin që i takonte.

Shtëpiaku, fill mbas kafeve, u qiste nga tri-katër gota me raki pa meze. Mbas pak kohe, më i afërmë i shtëpiakut, i cili ishte i ndarë prej një zjarri me të, i merrte në shtëpinë e tij gjithë krushqit. Ai në fillim i gostiste krushqit me duhan, me kafe të ëmbla, pastaj u shtronte rakinë me meze të thjeshta dhe mbas pijes u shtronte bukën me «*mazë të zier*»³³ me yndyrë (gjalpë) e mijaltë sipër saj, petulla e kos. Në «*Syfyr*» mishi nuk përdorej, berr nuk therej.

«*Syfyr*» zgjaste tri-katër orë dhe, kur mbaronte pija e buka, krushqit shkonin përsëri në shtëpinë e dhëndrit. Aty fillonte gjuajtja në shenjë, ku provoheshin qitësit dhe dalloheshin shenjtarët më të mirë.

Pérveç gjuajtjes së shenjës, krushqit luanin kapuçat, këndonin këngë kreshnikësh me lahitë, këngë trimërie me çifteli, këngë «maje krah», të shoqëruara me zbranje pushkësh e revolesh. Aty zhvilloheshin edhe biseda të tjera rrëth problemeve ekonomiko-shoqërore e politike, që i preokuponin ata.

Pas gjuajtjes në shenjë, i zoti i dasmës, në orët e vona të pasditës, shtronte pijen pér krushqit. Edhe në këtë rast rakia shtrohej me meze si në darkë dhe, mbasi çohej rakia, shtrohej dreka, e cila zgjaste deri në orët e vona të ditës.

Gjatë drekës, kur krushqit ishin duke pirë, nusja, e shoqëruar nga të dy dasmoret, hynte brenda te krushqit dy-tri herë dhe qëndronte në këmbë afër derës. Nusja qëndronte «divan», d.m.th. në këmbë, me fytyrë të zbuluar dhe dasmoret i qëndronin anash, njëra në të djathëtë dhe tjetra në të majtë.

Këtu krushqit e shihnin nusen pér herë të parë. Kjo quhet: «*Divan para krushqve*».

33) M. Memia, *art. cit.*, f. 304.

Dhëndri, natën e martesës nuk hynte dhëndër, por rrinte me krushqit dhe ata bënin shumë shaka me të. Madje në shaka e sipër e qëllonin, sidomos moshatarët e tij. Nusja natën e parë të martesës flinte me dasmoret.

Krushqit kur pinin kafet dhe gjatë pirjes së rakisë, uronin shtëpiakun me këto fjalë:

- Për hajër u koftë nusja!
- Ta gëzofte djali ose nipi, vllau! — etj.
- Gëzofshin njeni-tjetrin!

— Goja ju lumtë e paçi faqen e bardhë! — përgjigjej shtëpiaku. Sipas zakonit të tyre tradicional, krushqit, në të gjitha vaktet që pinin e hanin, e uronin shtëpiakun dhe ai ua kthente urimet.

Mbasi hahej dreka, nusja shkonte në dhomë te krushqit dhe rrinte në këmbë, ndërsa «deveri» merrte *fundin e bukës* dhe ulej në mes të krushqve dhe fillonte i pari për t'i falur (dhuruar) nuses. Fill mbas «deverit» krushqit me radhë i dhuronin nuses para, të cilat ia dorëzonin «deverit» dhe ai, si për veten e tij edhe për çdo krushk, komunikonte sasinë e të hollave që i dhuronin nuses. Ai më në fund i numëronte të gjitha paratë e dhuruara dhe tregonte shumën e përgjithshme të të hollave, që krushqit i kishin dhuruar nuses.

Bashkë me krushqit nuses i dhuronin edhe dy dasmorët dhe veçanërisht shtëpiaku i dhuronte asaj një berr. Bagëti mund t'i dhuronin e lhe njerëz të tjerë si kumbara, probatini etj. dhe «deveri» i komunikonte të gjitha në prani të krushqve.

Të hollat dhe bagëtitë që i dhuronin ishin të nuses, të cilat ajo i përdorte për vete e për burrin, si ekonomi ndihmëse. Bagëtitë i jepte «përkryesa». ³⁴ Gjithashtu edhe të hollat e dhuruara nga krushqit etj., nusja i blente bagëti dhe i jepte përkryesa.

Për shkak të varfërisë dhe shpenzimeve të mëdha që bënte familja e dhëndrit për martesën dhe për dasmën, shpeshherë ndodhite që bagëtitë e nuses t'i mbante përkryesa shtëpia e burrit. Kështu brenda-përbrenda ekonomisë së përbashkët të familjes, lindte një ekonomi e dytë që i takonte vetëm një pjese të kësaj familjeje. Kjo lindte për shkak të varfërisë së theksuar, mbasi familja nuk ishte në gjendje ekonomike të përballonte veshmbathjen e gruas, të fëmijës dhe të burrit të saj nga ekonomia e përbashkët. Prandaj, ashtu si edhe në Gash, Krasniqe, Bytyç e Berishë të Malësisë së Gjakovës, çdo çift detyrohej të krijonte brenda ose jashtë ekonomisë së përbashkët një ekonomi të vogël ndihmëse mbi bazën e «*gjasë përkryesa*».

«Dita e divanit»

Quhej «*dita e divanit*» dita e nesërme e martesës, d.m.th. dita e hënë, kur nusja merrej të dielën.

³⁴ «Përkryesa, d.m.th., bagëtitë, dhen ose dhi, të cilat i merrte ai që kishte nevojë dhe për çdo kokë bagëti sipas sistemit të «deles së pangordhshme» (kojun olmos) i detyrohej të zotit nga një okë lesh për kokë dhe më në fund t'i kthente aq kokë bagëti «*kryet e gjasë*». Kjo formë ka qenë shumë e përhapur në Malësinë e Gjakovës deri në Çlirim të vendit.

«*Ditën e divanit*» nusja çohej nga gjumi para se të lindte dielli. Ajo merrte një «*bucak*»³⁵ në dorën e djathtë, dhe bashkë me një djalë 5-7 vjeçar, i cili duhej të ishte me nënë e me babë, shkonte te kroi, e mbushte «*bucakun*» me ujë dhe kthehej në shtëpi.

Nuses me «*buçak*» në dorë i printe djali që e shoqéronte dhe ajo, së bashku me djalin, shkonte në odën e burrave dhe në radhë të parë i qiste të lajë faqet «*deverit*» dhe me radhë të gjithë burrave. Pastaj ajo shkonte në odën e saj dhe rrinte në këmbë, dhe pranë saj qëndronin dasmoret.

Natën e martesës dhe «*ditën e divanit*» nuk mblidheshin gra as vajza. Aty shkonin vetëm gratë e vajzat e të afërmve sa për të parë nusen. Ato rrinin pak dhe iknin në shtëpitë e tyre.

Nuses nuk i këndohej asnje këngë, qoftë natën e dasmës, qoftë «*ditën e divanit*». Është shumë karakteristik fakti që në Nikaj-Mërtur gratë e vajzat nuk këndonin nëasnje ceremoni fejese, martese, lindjeje etj. Këtu ndeshëm një ndryshim rrënjesor në mes të ish-besimtarëve katolikë të zonës së Nikaj-Mërturit (ndonëse gratë e vajzat e kësaj zone dilnin lirisht dhe merrnin pjesë gjerësisht në të gjitha punët bujqësore e blegtore, ato nuk kishin të drejtë të këndonin nëasnje ceremoni, duke përjashtuar rastin e vajzave që këndonin në mal me bagëti, para se të martoheshin) dhe ish-besimtarëve myslimanë të Malësisë së Gjakovës, ku me gjithë fanatizmin e theksuar, dhe kufizimin e femrës, si vajzat edhe gratë këndonin dhe kërcenin. Ato i këndonin vajzës këngët më pikëlluese natën e «*kanagjeçit*»³⁶, kurse nuses këngët më të bukura natën e dasmës dhe «*ditën e divanit*»³⁷, ku mblidheshin të gjitha gratë e vajzat e fshatit si natën e «*kanagjeçit*» ashtu dhe «*ditën e divanit*»). Femrën në Nikaj-Mërtur feja katolike e kishte privuar nga një e drejtë e tillë.

Ky ishte një nga ndryshimet më të dukshme në mes të ish-besimtarëve katolikë dhe atyre myslimanë të Malësisë së Gjakovës, ndonëse, siç e kemi thënë në fillim të këtij artikulli, ish-banorët e të dy besimeve, si nga gjaku, gjinia dhe territori i banimit ishin pjesë përbërëse e Malësisë së Gjakovës.

«T’ falat e nuses»³⁸

Posa «*deveri*» komunikonte shumën e të hollave dhe të bagëtive që krushqit i kishin dhuruar nuses, dasmoret çonin në odë te krushqit «*t’ falat e nuses*» (dhuratat që kishte sjellë nusja).

Nusja i conte nga një peshqesh çdo pjesëtar të familjes së burrit, farefisit të tij dhe çdo krushku.

«*T’ falat e nuses*» përbëheshin nga një palë çorape leshi për çdo pjesëtar të familjes dhe farefisit të burrit dhe për çdo krushk.

Në mënyrë të veçantë dalloheshin dhëndri dhe «*deveri*», të cilëve nusja u conte çorape dhe meste, kurse të tjerëve vetëm çorape.

35) ibrik prej druri.

36) M. Memia, *art. cit.*, f. 285-293.

37) M. Memia, *art. cit.*, f. 298-299.

38) Nga fjala «*fal*», dhuroj një send (në shenjë respekti ose ndihme).

«*T' falat e nuses*», si pér pjesëtarët e familjes, farefisit të burrit dhe të krushqve, ndaheshin në prani të të gjithë krushqve. Kur ndaheshin peshqeshet, nusja qëndronte në këmbë, «*divan para krushqve*», dasmorët mbanin në duar «*t' falat e nuses*», ndërsa «*deveri*» ua ndante «*t' falat*» krushqve, duke ia dhënë secilit në dorë dhe ata uronin duke thënë:

— T'u rrit nera ty dhe mikut! — dhe krushqit i futnin «*t' falat*» e nuses në brez, ose i hidhnin në sup.

— Paç nerë e nafakë! — përgjigjej «*deveri*».

Porsa shpérndaheshin «*t' falat e nuses*», shtëpiaku gostiste prapë krushqit me duhan e kafe të émpla.

Gratë dhe fëmijët nuk hanin në odë me krushqit. Edhe gratë pinin raki, por jo me burrat. Ato bashkë me fëmijët hanin drekë, mbasi mbaronin krushqit së ngrëni.

Nusja nuk shtrohej në «*syfyr*», as në drekë me gratë, por i shtronin bukë veç në odën e saj. Bashkë me nusen mund të hanin edhe dasmoret, sidomos përcjellësja, që nuk i ndahej pér asnje çast.

Ndërsa te burrat këndohej me lahitë e çifteli, te gratë dhe te nusja natën e dasmës dhe të nesërmen, «*ditën e divanit*» nuk përdorej ndonjë vegël muzikore.

Shpérndarja e krushqve

Para se të shpérndaheshin krushqit, nusja dilte nga oda e krushqve dhe shkonte në odën e vet.

Krushqit, mbas shpérndarjes së «*t' falave të nuses*», dilnin në oborr të shtëpiakut, «*hallalloseshin*» (përshëndeteshin) me shtëpiakun, me meshkujt e tij, me dhëndrin dhe me farefisin e tij, pastaj me njëri-tjetrin. Ata shpérndaheshin secili në drejtim të shtëpive të veta dhe, mbasi largoheshin pak, i thërrisin shtëpiakut pér emër dhe i thoshin:

— O lamtumirë e i pashi hajrin nuses, u pastë ardhë me hajër, more uaaa! — Dhe ai që i thërriste e përshëndeste të zotin e dasmës me 5-6 të shtëna pushke ose revoleje.

— O paç hajër e nafakë e t'koft udha e marë, more uaaa! — u përgjigjej shtëpiaku dhe e përshëndeste secilin me aq të shtëna pushke:

Pastaj krushqit i thërrisin edhe njëri-tjetrit, duke uruar rrugën të mbarë dhe duke u përshëndetur me të shtëna pushkësh. Kështu e gjithë krahina e merrte vesh se krushqit u shpérndanë nga dasma.

Natën e shpérndarjes së krushqve në shtëpi të dhëndrit nuk mbetej kush i huaj, vetëm farefisi i tij. Po këtë natë, hynte dhëndri te nusja, por pa ndonjë ceremoni. Dasmoreshat mund të qëndronin aty edhe atë natë.

Ditën e tretë të dasmës, d.m.th. të nesërmen e shpérndarjes së krushqve, «*deveri*» merrte nusen pér drekë. Po të ishin aty dasmoreshat, edhe ato shkonin te «*deveri*» bashkë me nusen. Së bashku me nusen shkonte edhe vjehrra, si dhe ndonjë grua tjetër e shtëpisë,

Te «*deveri*» nusja rrinte «*divan*» (në këmbë). Ajo ulej shpeshherë, por çohej në këmbë në çdo rast kur hynte e dilte kush, burrë apo grua qoftë.

«Deveri» shtronte një drekë për nusen dhe për gratë e tjera që e shoqëronin atë. Dreka shtrohej me pije (raki e meze), me mazë të zier me yndyrë, mjaltë etj., por mish nuk therej. Në drekë «deveri» dhe meshkujt e shtëpisë së tij nuk shtroheshin në sofër me gratë. Dhe në këtë rast nuk bëhej ndonjë gasti me këngë, valle etj. Mbasi hahej dreka, nusja bashkë me shoqërueshet e saj, para se të errej, kthehej në shtëpinë e burrit.

Nusja që të nesërmen e shpérndarjes së krushqve fillonte të punonte në shtëpi të burrit. Ajo në mëngjes zgjohet e para nga gjumi dhe ndezte zjarrin, fshinte shtëpinë, oborrin, shtronte e çonte bukën, mbushte ujë në krua dhe u jepte ujë për të pirë të gjithë pjesëtarëve të familjes. Ajo qëndronte në këmbë, e gatshme që t'u shërbente të gjithë pjesëtarëve të familjes dhe miqve, qofshin gra apo burra, deri dhe fëmijëve.

«Marrja e bisë në të panë së pari»

Mbas dy javësh, prindërit e vajzës shkonin për ta marrë bijën e tyre «në të panë së pari». Kjo ditë caktohet nga prindërit e nuses ditën e dasmës, në «pjekje» dhe shtëpiaku, d.m.th. i zoti i shtëpisë së djalit u thoshte prindërvë të nuses: «Ju pres me sa të duash me ardhë».

Për të marrë bijën «në të panë së pari» prindërit e nuses shkonin «miq së pari» pesë, shtatë, ose nëntë burra, gjithnjë tek, se çiftin e plotësonte bija që do të vinte në gjini.

«Miqtë së pari» priteshin nga pala e dhëndrit në oborr të shtëpisë me respekt të madh. Shtëpiaku për të pritur miqtë ftonte kushérinjtë dhe burrat më të dëgjuar të fshatit të vet, të cilët i mbante për darkë dhe për drekë, me qëllim që miqtë të kishin me kë të kuvendonin.

Posa uleshin në odë, shtëpiaku i gostiste miqtë me duhan dhe me kafe të émpla. Mbas një bisede të shkurtër, rrëth punëve bujqësore e blegtorale, shtëpiaku u shtronte rakinë me meze dhe me gjellët më të mira, si në dasmë.

Aty këndoheshin këngë kreshnikësh, të shoqëruara me lahitë dhe këngë trimërie, të shoqëruara me çifteli. Mbasi hahej darka, ku mund të shtroheshin dy-tri sofa burrash, luanin disa loja kapuçash, ku çdonjëra palë bënte përpjekje për të mundur palën tjetër dhe «për ta knue në kapuça». Kështu vazhdonin deri në orët e vona të natës.

Të nesërmen shtëpiaku u shtronte miqve dhe të ftuarve një drekë të hershme, me raki e meze, me gjellët më të preferuara, si në darkë. Mbasdreke, mbasi pinin kafet e pasbukës, miqtë çoheshin, merrnin bijën me vete dhe niseshin. Ata i përcillte (shoqëronte) një mashkull i shtëpiakut derisa të dilnin nga fshati i tij.

Bija, e veshur me rroba nusërie, udhëtonë në këmbë me prindërit e të aférmit që kishin shkuar për ta marrë «në të panë së pari». Ajo rrinte në gjini dy-tri javë, aq sa e lejonte familja e burrit. Gjatë kohës që rrinte në gjini ajo nuk vishej me rrobat e vajzërisë, sic veprohej në Gash, Krasniqe, Bytyç, Berishë e Kelmend të Malësisë së Gjakovës, por qëndronte me rrobat e nusërisë;³⁹

39) M. Memia, art. cit., f. 304.

Marrjen e bijës «në të panë së pari» e prisnin me gëzim të madh gjithë pjesëtarët e familjes së saj, burrat, gratë, fëmijët si dhe të afërmit e farefisi, por me padurim e priste e ëma bijën e vet. (Ajo gjatë ditëve që vajza qëndronte në gjini, për të interesohet në mënyrë të vëçantë, por një interesim i tillë, një dashuri e madhe manifestohet nga të gjithë vëllezërit, motrat kushérinjtë e të afërmit). Gjatë kohës që bija qëndronte «në të panë» familja atë nuk e ngarkonte me punë.

«Marrja e nuses nga të pani së pari»

Në vargun e ceremonive të martesës, një ditë e shënuar ishte edhe dita e «marrjes së nuses nga të pani së pari», ceremoni e cila bëhej me miq.

Ditën kur prindërit e nuses merrnin bijën e tyre në gjini, caktohet edhe dita kur do të shkonin pala e dhëndrit për të «marrë nuses nga të pani së pari».

Pala e dhëndrit caktonte ditën kur do të shkonin dhe menjëherë ftonin ata që do të shkonin «miq së pari», me qëllim që të kishin kohë për t'u përgatitur.

Për të pritur sa më mirë «miqtë së pari», prindërit e nuses përgatiteshin me raki, mish etj., ndërsa miqtë përgatiteshin me rrobat më të mira, me fishekë etj., për të shkuar «mik së pari».

Në qoftë se prindërit e nuses kishin shkuar për të marrë bijën në gjini me pesë ose me shtatë veta, pala e dhëndrit shkonte me tre ose me nëntë. Kjo bëhej sipas gjendjes së pritësit, d.m.th. në qoftë se prindërit e nuses ishin në gjendje të mirë ekonomike, pala e dhëndrit shkonte me më shumë miq sesa kishte çuar dhe anasjelltas.

Si në rastin e parë, kur pala e nuses shkonte për të marrë bijën në të panë, ashtu edhe në rastin e dytë kur pala e dhëndrit shkonte për të marrë nusen, shkonin vetëm burra e jo gra. Dhëndri nuk shkonte «mik së pari» për të marrë nusen e tij, por shkonin meshkuj të tjera të shtëpisë, qoftë dhe të ndarë nga zjarri. Tani shkon edhe vetë dhëndri.

Prindërit e nuses ftonin shumë burra nga fshati i tyre për të pritur miqtë dhe për të kuvendar me ta.

Si për miqtë dhe për të ftuarit nga fshati, prindërit e nuses shtronin darkë dhe një drekë të hershme me raki, meze, mish etj. Ashtu si në familjen e dhëndrit, kur pala e nuses shkonte për të marrë bijën në gjini, edhe në familjen e nuses, kur shkonin miqtë për të marrë nusen, shpenzimet ishin mjaft të mëdha, sidomos në mish e raki, etj., sepse në të dy rastet shtroheshin nga tri-katër sofra në vakt. Shpenzimet, si në rastin e parë dhe të dytë, u afroheshin shpenzimeve të një dasme. Këto vitet e fundit shpenzimet për ceremoni të tilla janë kufizuar deri në njëfarë mase. Këto ceremoni, si në shtëpinë e dhëndrit ashtu dhe në shtëpinë e palës së nuses, bëheshin të njëjta.

Të nesërmën, mbasi hahej dreka, pala e nuses bënин nusen gati dhe miqtë çoheshin. Në këtë rast pala e nuses i përcillte miqtë në një largësi më të madhe dhe me më shumë burra nga ç'i kishin përcjellë ata. Nusja gjatë gjithë rrugës shkonte në këmbë pas burrave që kishin shkuar për ta marrë.

Thirrja e nuses

Në fshatin e burrit nusen e ftonin për drekë të gjithë ata që kishin qenë krushq ditën e martesës së saj. Gjithashu e ftonin për drekë gjithë farefisi dhe të afërmit e burrit dhe të vetët. Por i pari e ftonte deveri, pastaj të tjerët.

Në këto dreka nusja shoqërohej nga vjehrra dhe ndonjë grua tjetër e shtëpisë së burrit.

Në drekat që shtroheshin për nusen merrnin pjesë vetëm gratë. Ai që i ftonte nuk therte ndonjë berr, por i gostiste me raki, meze, mazë të zier me yndyrë, mjaltë etj., ose mund të therte ndonjë pulë.

Thirrja e nuses për drekë mund të bëhej para dhe pas shkuarjes së nuses «në të panë së pari». Nusja mund të ftohej çdo ditë të javës me përjashtim të ditës së premte.

«Zania e kumarës së nuses»

Para se të bëhej celebimi, me pëlqimin e të gjithë pjesëtarëve të rritur të familjes së dhëndrit dhe të nuses, bëhej «zanja e kumarës së nuses».

Kumbara konsiderohej personi më i besueshëm i nuses dhe i familjes së burrit. Prandaj ai quhet «kumara i nuses» dhe «kumara i shpisë».

Kumbara, vitin e parë e thërriste në shtëpinë e tij «nrikullën» dy-tri herë dhe e mbante në familjen e tij nga tri ose pesë net, kurse vitet e tjera e ftonte të paktën një herë në vit. Nusja, d.m.th. ndrikulla, kumbarën dhe gjithë familjen e tij i konsideronte si familjen e vet. Prandaj lejohej nga burri të shkonte në shtëpinë e tij pa ndonjë kufizim, tamam si te vëllezërit e saj.

Ndrikulla shkonte te kumbara me bukë, d.m.th. me kuleçë misri ose gruri, me mollë, arra etj., të cilat ua jepte fëmijëve të kumbarës. Po kështu, kur ndrikulla kthehej në shtëpinë e burrit, i jepnin ndrikullës kuleçë, arra etj. për fëmijët. Në këtë mënyrë ndërrohej buka me kumbarën e nuses.

Marrëdhëniet në mes të dy familjeve, që kishin lidhur kumari, ishin shumë të ngushta. Ato mbështeteshin në sinqueritetin dhe në nder-shmërinë reciproke. Prandaj edhe kishin ndaj njëra-tjetrës një besim të pakufishëm. Shkelja e këtij besimi dënohej me ashpërsi nga i gjithë opinioni shoqëror dhe nga normat zakonore të Malësisë së Gjakovës.

Gruaja kishte të drejtë të shkonte në familjen e vet një herë në vit, në vjeshtën e vonë, mbasi të «hinte kora në kosh», d.m.th. mbasi të mblidheshin bereqetet. Ajo mund të qëndronte një muaj. Përveç kësaj, ajo mund të shkonte edhe për rast të jashtëzakonshëm, gëzim apo hidhërim qoftë.

Për ta marrë atë «në të panë» shkonin të afërmit e saj, d.m.th. i ati, i vëllai, apo ndonjë kushuri tjetër, ndërsa nga prindërit shkonin dhe e merrnin pala e dhëndrit. Në të dyja rastet ajo conte kuleçë misri ose gruri, mollë etj. për fëmijët.

Nusja nuk u thërriste në emër prindërve të burrit, por nënë e baba. Njëkohësisht edhe prindërit dhe farefisi i burrit atë nuk e thërrisin në

emër, por i thërrisin nuse, emër i cili mund t'i mbetej deri në pleqëri. Zakonin pér të mos e thirrur nusen në emër e kanë pasur edhe krahina të tjera të Shqipërisë, si p.sh. Çamëria.⁴⁰

Kur gruaja nuk lindte fëmijë ose lindte vetëm vajza, burri, zakonisht pa ndarë gruan e parë, mund të merrte grua tjetër «në gjynah», me qëllim që të lindte djalë. Martesën me grua të dytë kisha katolike e dënonite, duke mos i vënë kurorë në kishë dhe duke e shkishëruar burrin që martohej «në gjynah». Kjo formë poligamie, d.m.th. martesa e dytë pér fëmijë ose pér djalë ka ekzistuar deri në Çlirim, ndonëse në raste të rralla. Por theksojmë se, edhe pse kisha e dënonite, normat zakonore të Malësisë së Gjakovës nuk e kufizonin as nuk e dënonin martesën e dytë pér fëmijë, sidomos pér të lénë djalë (trashëgimtar) pas, se përndryshe shuhej zjarri.

Siq tregojnë pleqtë, në krahinën e Nikaj-Mërturit fenomeni i poligamisë nuk njihej. Megjithatë, aty-këtu ka pasur ndonjë rast tepër të rrallë, që pér të lénë patjetër trashëgimtar, njëri apo tjetri ka marrë grua të dytë, kurse në ish-besimtarët myslimanë të Malësisë së Gjakovës, poligamia ka qenë karakteristike pér klasat shtypëse e shfrytëzuese, siq ishin bajraktarët, agallarët, vojvodët, fshatarët e pasur, klerikët⁴¹ etj. ky fenomen ka vazhduar deri në vitet e Çlirimit të Shqipërisë, kur u ndalua me ligj.

Gruaja në Nikaj-Mërtur ka qenë një forcë e madhe fizike. Ajo gjithnjë, si në punët bujqësore, ashtu edhe në ato blegtoriale, ka punuar krah pér krah me burrin, pér krijimin e të mirave materiale.

Pra nusja, posa kthehej nga «të panë së pari» ngarkohej me punë bujqësore e blegtoriale si gjithë gratë e tjera të shtëpisë. Ajo mund të dërgohej edhe pér shtegtim me kosh në shpinë, ku rrugëtonte me ditë të téra nga Nikaj-Merturi në Gjakovë,⁴² ose, në qytetin e Shkodrës, tri-katër ditë rrugë vetëm vajtje, pér të shitur prodhimet e pakta, dhe pér të siguruar, në radhë të parë, kafshatën e gojës dhe ndonjë gjë shumë modeste pér veshmbathje. Ajo udhëtonte me barrë në shpinë, por edhe me furkë në dorë duke tjerë lesh, ose me shtiza në dorë duke thurur ndonjë palë çorape. Kështu, malësorja e Nikaj-Mërturit, në luftë dhe në përpjekje shumë të ashpra me jetën, me natyrën e vendit shumë të ashpër të Alpeve të thepisura të Veriut, pa iu nënshtruar asnjëherë vështirësive të jetës, ka fituar cilësitë më të larta të punës, të burrërisë, të trimërisë, të bujarisë dhe të mikpritjes.

Është karakteristik fakti që po të shkoje në Nikaj-Mërtur, pavarësisht nëse ishin apo jo burrat në shtëpi, mjaftonte që aty të ndodhej një vajzë apo një grua, qoftë edhe nuse dhe ajo do të thoshte:

— Hajde, bujrëm! — dhe të priste, të përcillte, e të nderonte sikur të kishte mik shtëpie dhe të njojur prej kohësh. Në çdo kohë të ditës që të shkoje, ajo të vinte bukën përpëra me çfarë t'i qëllonte, siq thonë vendasit e asaj ane, «udhëtari në çdo kohë mund të

40) A. Dojaka, *art. cit. f. 16.*

41) M. Memia, *Lindja e kumbaria në Malësinë e Gjakovës*, «Etnog. shqip.» II Tiranë 1963, f. 257.

42) Gjakova deri me vënien e kufijve politikë të 1913-s ka qenë edhe qyteti i Malësisë së Gjakovës (Tropojës).

jetë unshëm», prandaj buka e ka vaktin në qdo kohë. Kështu, malësorja e asaj krahine në qdo çast e nderonte veten e saj, origjinën nga rridhët dhe familjen e burrit.

Ajo, edhe në rrugë po ta takoje, bisedonte si një burrë i pjekur. Ajo dinte të ruante personalitetin e saj para cilitdo,

*
* *

Gjatë epokës së Partisë, si kudo në Shqipëri, edhe në zonën e Nikaj-Mërturit, që shtrihet në zemër të Alpeve tonë të thepisura, socializmi është ngjitur lart triumfalishët dhe me hap të sigurt.

Kolektivizimi i bujqësisë, përhapja dhe masivizimi i arsimit dhe kulturës, elektrifikimi i të gjitha fshatrave dhe familjeve deri në majë të malit, pjesëmarrja masive e grave dhe vajzave në prodhim dhe në aktivitetet politiko-shoqërore, pjesëmarrja masive e të rinjve dhe të rejave në aksionet lokale e kombëtare, ndërtimi i objekteve social-kulturore (çerdhe, kopshte, spital, maternitet, shtëpi lindjeje, shtëpi e vatra kulturore etj.), futja e radios dhe e televizionit, shtypit, librit e filmit, telefonizimi i fshatrave, lufta sistematike kundër normave kanunore të patriarkalizmit, çlirimi shpirtëror nga helmi shumëshekullor i propagandës kishtare, lidhja e kësaj zone të thellë me rrugë automobilistike kombëtare, ndërtimi e meremetimi i shtëpive të banimit me kreditë e dhëna nga shteti dhe puna e tyre e pakursyer, kanë sjellë si rezultat edukimin e njeriut të ri, që udhëhiqet në të gjithë veprimtarinë e vet nga ideologjia marksiste-leniniste, nga direktivat e Partisë sonë heroike dhe mësimet e shokut Enver Hoxha.

Ndërtimi me sukses i bazës ekonomike të socializmit, thelli i mëtejshëm i revolucionit kulturor e ideologjik dhe lufta sistematike e Partisë për emancipimin e plotë të gruas në shoqëri dhe në familje, shkallmuani normat kanunore patriarkale dhe ato mistiko-fetare që mbisundonin në zakonet e lidhjes së martesës dhe në ceremoninalin e dasmës në atë zonë të thellë malore. Kështu, nëpërmjet një lufte të ashpër klasore, lindën norma të reja, të cilat, të mbështetura në trashëgiminë pozitive, po mbruhen me një përbajtje të re revolucionare socialiste.

I gjithë ceremoniali i dasmës ka evoluar, është pastruar nga bestytëtë mistiko-fetare e normat kanunore patriarkale poshtëruese për femrën.

Dekadën e fundit në këtë zonë fejesat bëhen pasi merrët pëlqimi i vajzës, ose bëhet drejtpërdrejt me njohjen e të interesuarve dhe pastaj merrët edhe pëlqimi i prindërve të vajzës dhe të djalit. Por aty-këtu, ndonëse në raste gjithnjë e më të rralla, akoma bëhen fejesa pa pëlqimin e vajzës, raste të cilat i dënon vetë opinioni shoqëror.

Tradita për ceremoninalin e fejesës, martesës, marrjes së bijës «në të panë së pari», marrjes së nuses «nga të pani së pari» etj. është ruajtur, por kjo traditë është mbrujtur me normat e reja socialiste. Tani së fejuarës dhëndri i dhuron një unazë, një copë për fustan, në ndonjë rast edhe orë dore. Dhëndri shkon bashkë me dasmorët për të marrë nusen, është hequr duvaku, shpenzimet e tepërtë në fejesë, në dasmë dhe në ceremoni të tjera janë kufizuar. Rakia shtrohet në sofër dhe secili pi aq sa i pihet, e jo siç pihej më parë. Nusja mund t'u

çojë peshqeshe prindërve, pjesëtarëve të familjes së dhëndrit dhe të afërmve të tij, por jo të gjithë krushqve. Edhe këta mund t'i japin nuses ndonjë dhuratë modeste, kurse krushqit nuk i japin asgjë.

Paja e nuses është e kufizuar në rroba fjetjeje e veshmbathje. Ajo, si edhe më parë, përgatitet me shpenzimet e dhëndrit, kurse familja e vajzës nuk kontribuon asgjë në këtë drejtim. Mësит nuk merr as nuk jep kush.

U këndohet luftërave të të parëve tanë për liri e pavarësi, për drejtësi e përparim shoqëror, Partisë sonë heroike me shokun Enver në krye, Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, fitoreve të revolucionit e të socializmit, jetës së re të gëzuar e plot perspektivë. Këngët i ekzekutojnë me tingujt epikë të lahutës dhe të çiftelisë.

Me punën e madhe dhe sistematike që bëri Partia dhe Pushteti Popullor gjatë dekadave të pasçlirimit, si qdo gjë në RPSSH, edhe personaliteti i gruas malësore u rrit në një shkallë të paparë.

Traditat e mira jo vetëm u ruajtën, por ato u zhvilluan më tej. Ato mbruhen dita-ditës me një përbajtje të re revolucionare, në përputhje me rendin ekonomiko-shoqëror të socializmit. Si rrjedhim, personaliteti i femrës malësore u ngjit në lartësi të pakrahasueshme, sidomos mbas fjalimit programatik të shokut Enver Hoxha, të mbajtur më 6 shkurt 1967.

Sot malësoria e Nikaj-Mërturit është bërë një forcë e madhe politiko-shoqërore, një luftëtare e së resë revolucionare, një shok i sigurt jete, një kreshnike dhe sokoleshë, që lufton pa u trembur kundër mbeturinave të normave të vjetra kanunore patriarkale. Ajo tani ka besim të plotë në forcat e veta dhe nuk i nënshtronhet fatit, por krah për krah me burrin lufton pa u përkulur, lufton me guxim kundër pengesave e vështirësive, merr pjesë gjerësish në jetën e gjallë politike e shoqërore, duke dhënë kontributin e saj të gjithanshëm si për krijimin e familjes së re e të shëndoshë socialiste, ashtu edhe për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit edhe në zemër të Alpeve të ashpra. Ajo mbron me guxim e kurajë të drejtat e veta dhe lufton për barazi të plotë në familje, duke shpartalluar mbeturinat e normave kanunore mesjetare dhe mbeturinat fetare, kur ato nxjerrin krye në një formë apo tjetër.

Afërdita ONUZA

MJESHTERIA SHTËPIAKE E PUNIMIT TË ENËVE PREJ BALTE

Kultura materiale e një populli përbën një pjesë të rëndësishme të kulturës së tij në përgjithësi, prandaj dhe studimi i saj paraqet interes të madh për njojjen në mënyrë konkrete të mënyrës së jetesës, të aftësive krijuarës në disa fusha të jetës.

Në këtë punim jemi përpjekur të shqyrtojmë një aspekt të kësaj kulture në Shqipëri, që ka të bëjë me jetën e përditshme të pjesës më të madhe të popullsisë, konkretisht me punimin e enëve prej balte brenda ekonomisë shtëpiake në periudhën që përbledh fundin e shek. XIX e fillimin e shek. XX.

Rëndësia e studimit të kësaj mjeshterie të kufizuar shtëpiake shërben për t'u njojur me një stad të hershëm të mjeshtërisë së qeramikës, qoftë për anën teknike, qoftë përfaktin se kush është marrë me këtë mjeshteri. Në literaturë kjo njihet me emrin «qeramika e grave», sepse në të shumtën e rasteve mbeti një specialitet vetëm i tyre, me përjashtim të qendrës qeramike të Kavajës, ku këto enë i kanë puanur vetëm burrat.

Për hartimin e këtij punimi jemi bazuar në të dhëna të ndryshme të marra gjatë disa ekspeditave të bëra në terren, në materialet që ndodhen pranë Muzeut Etnografik në Tiranë dhe në ato që ndodhen në muzetë e rretheve apo të disa fshatrave, në materiale të mbledhura nga shokët e tjera etnografë, në përgjigjet e ardhura nga pyetësori i hartuar nga autorja posaçërisht, për këtë temë, si dhe në burime të tjera të shkruara nga udhëtarë e studiues të huaj përvendin tonë.

Deri tani për këtë problem nuk është shkruar posaçërisht, kështu që, nëpërmjet këtij punimi, mendojmë se do të japim një kontribut modest rreth kësaj mjeshterie.

Nga të gjitha të dhënat rezulton se në shumicën e familjeve fshatave shqiptare, deri në fillim të shek. XX e madje në disa zona më të izoluara deri në prag të Çlirimt, pjesa më e mirë e enëve dhe orëndive, që përdoreshin nëpër odat e zjarrit apo këndet e bulmetit, qenë prej balte ose prej druri, të punuara kryesisht brenda ekonomisë shtëpiake. Në vartësi të gjendjes ekonomike, pozitës gjeografike dhe ekzistencës së lëndës së parë, diku përdoreshin më shumë enët e baltës e diku më shumë ato prej druri, por rrallë mund t'i gjeje pa njërat-jetrën. Kështu, në fshatrat e Devollit (Korçë) apo në ato të Shqipërisë së Mesme Bregdetare numrin më të madh e zinin enët prej balte, por krahës tyre gjeje dhe ato prej druri, ndërsa në zonat malore të shumtata

ishin prej druri dhe më të kufizuara qenë ato prej balte. Bashkë me to, në përdorim të përditshëm, ishin futur dhe enët e bakërtë, porse me një inventar më të pasur ato gjendeshin në shtresat më të kamura të familjeve myslimanë dhe në ato familje, që kishin ndonjë pjesëtar të tyre në kurbet. Enët e tjera metalike më gjérë u futën në përdorim pas Luftës së Parë Botërore.

Enët, që nuk mungonin pothuajse në asnjë shtëpi fshati, ishin ato prej balte të punuara me parete shumë të trasha, të njoitura më shpesh me emrin «çerep» e «saç», që shërbenin për të pjekur bukë dhe ushqime të tjera. Punimi i këtyre enëve, në të shumtën e rasteve, që një mjeshtëri e çdo amvise, ndonjësa disa e bënin për nevoja familjare e disa të tjera u shquan për punimin e tyre edhe për treg. Krahë tyre pati dhe zona apo fshatra të veçanta ku këto enë nuk mbaheshin mend që kur ishin përdorur, mbasi vendin e tyre qysh herët e kishin zënë furrat ose tezpité e bakërtë. Të tillë ishin fshatrat e bregdetit në Jug të Shqipërisë, fshatrat e Sarandës e Himarës, një pjesë e mirë e fshatrave të Gjirokastrës e të Korçës, ndonjë fshat në Skrapar etj. Megjithatë edhe në një pjesë të këtyre fshatrave ndonjë bukë ceremoniale, apo për ndonjë mik të nderuar, piqej në çerep prej balte, të mbuluar me saç prej metali. Pra kjo që një mjeshtëri e ushtruar në shumicën e fshatrave tona, porse midis tyre disa u dalluan si më të specializuara që jo vetëm furnizonin fshatin e tyre e ata përreth tij, por edhe mbarë krahinën e tyre e madje dilnin edhe jashtë saj. Të marrë së bashku, fshatrat ku punoheshin këto enë, për lehtësi studimi, mund t'i ndajmë në dy grupe. Në grupin e parë hyjnë ato fshatra ku pothuajse çdo amvisë (duke përjashtuar familjet më të kamura) i punonte vetë këto enë dhe i përdorte vetëm për nevojat e shtëpisë së saj. Prodhimet e tyre disa herë qenë të një cilësie jo aq të mirë, qoftë për sa i përket rezistencës, qoftë dhe për paraqitjen e tyre. Në fshatin Theth (Dukagjin)¹ në modelimin e çerepëve gratë mjafthoheshin vetëm me dhëni thjesht të formës së një diskur, pa rrëth të ngritur anash, gjë që na kujton formën më të hershme të kësaj ene. Dosido çerepët i punonin dhe gratë në stane kur u thyheshin e kur nuk kishin mundësi të tjera për t'i siguruar.

Ky grup fshatash, në të shumtën e rasteve, ishte më i izoluar ose më larg pikave të tregjeve krahinore, prandaj qenë të detyruar t'i punonin gjithnjë vetë.

Grupin tjetër e përbënë ato fshatra ku gratë mjeshtre, ndonjëse enët i punonin gati me të njëjtën teknikë pune, qenë «specializuar» për punimin e këtyre enëve e përmendeshin në tërë krahinën. Destinacioni edhe për treg i kishte detyruar të ishin më të kujdeshshme në dhëni e formës dhe në përgatitjen e brumit për të rritur rezistencën. Në Shqipërinë Veriore shumë të kërkuar ishin çerepët e punuar në fshatin Bytyç (rrethi i Tropojës), apo ato të fshatrave shqiptare Zhur e Verbnicë, që ndodhen jashtë kufijve të sotëm politikë. Po kaq të njojur për punimin e këtyre enëve qenë dhe fshatrat Gojan (rrethi i Pukës), Bardhoc e Bushtricë (rrethi i Kukësit), Muhurr e Hoçisht (rr-

1) Abaz Dojaka, *Enët dhe orënditë e Dukagjinit*, «Etnografia shqiptare» Nr. 1, Tiranë 1962, f. 116.

thi i Dibrës), German, Selitë, Luf e Ketë në rrithin e Matit. Në Shqipërinë e Mesme përmendeshin çerepët e punuar në fshatrat Farkë (rrathi i Tiranës), Mirakë (rrathi i Elbasanit), Stravaj (rrathi i Librazhdit) e për më tepër çerepët e qendrës qeramike të Kavajës, që kishin një rreze mjaft të gjërë shpërndarjeje. Ndërsa në Shqipërinë Jugore kjo traditë u ruajt më mirë në fshatin Peshtan e Sinanaj (rrathi i Tepelenës), në Kërpitë (rrathi i Gramshit), Zaloshnjë, Osojë, Potom (rrathi i Skraparit). Në rrithin e Korçës përmendeshin fshatrat Bradavicë, Vérلن e Bitinckë, ndërsa në rrithin e Pogradecit fshatrat Plešisht e Beragozhëdë.

Në përgjithësi jo të gjitha gratë e fshatit e ushtronin këtë zanat. Ato zakonisht përfaqësonin familjet më të varfra të fshatit, që e ndienin thellë mungesën e të ardhurave të domosdoshme në ekonominë e familjes e, për t'i siguruar këto, mundoheshin të gjenin rrugëdalje me të gjitha mundësitë që kishin. Për më keq, këto gra shihejshin dhe me një sy më përbuzës sesa ato të familjeve të tjera po aq të varfra, por që nuk punonin çerepë. Në fshatin German thuhej me përbuzje se këto gra «bridhnin derë më derë e pak gja binin te shpija». Nuk përjashtoheshin rastet që me këtë mjeshtëri qenë marrë dhe ato gra që ishin në gjendje ekonomike më të mirë, por që këtë punë e kishin «për zanat».

Në fshatin Farkë (Tiranë), me punimin e çerepëve merreshin vetëm gratë e familjeve të varfra, që kishin kaluar moshën e lindjes së fëmijëve, mbasi besohej se gratë që lindnin akoma, u thyheshin shpejt çerepët. Punimi i këtyre enëve, si rregull, praktikohej në stinët e ngrohta të vitit e në mënyrë të veçantë vihej re një aktivizim më i madh në muajt e fundit të pranverës, kur mungesa e drithit ndihej më shumë. Amvisat e fshatit, sa po merrnin vesh se mjeshtret fillonin të nxirrin dhé për çerepë, shkonin e porosisnin sasinë që u nevojitej, ndërsa nga fshatrat fqinjë porositë vinin nëpërmjet të njoburve e pastaj mjeshtret u caktonin ditën kur të vinin për t'i marrë. Në fshatra më të largëta të krahinës, apo jashtë saj, prodhueset kalonin vetë derë më derë me çerepë të ngarkuar në shpinë apo kafshë, ose i shisnin në tregjet e krahinës. Në disa raste tregtimin e bënin edhe burrat, sidomos kur tregu ishte larg e nuk mund të kthehet në shtëpi brenda ditës.

Sipas traditës, çerepi prej balte apo ndonjë enë tjetër druri, miqve e farefisit gjithmonë u dhuroheshin, ndërsa me të tjerët praktikohej shkëmbimi me prodhime në natyrë ose me para, sipas nevojave e leverdisë së prodhuesit.

Prej kohësh nëpër krahina ishte krijuar një rrjet tradicional i tregtimit të këtyre orëndive. Kështu fshati Bytyç rregullisht furnizonte me çerepë anë e kënd zonat e Gashit, Krasniqes, Merturit e Dukagjinit, duke i shitur herë derë më derë e herë në tregun e Trojpojës, apo në panairin që bëhej çdo vit në Kabash të Pukës e që quhej «e diela e enëve»²⁾. Në këtë panair shiteshin edhe çerepë e vorba të punuara në Gojan. Përveç këtij rasti, gratë gojanase rregullisht i

2) Xhemal Meçe, *Panairi i Kabashit*, AE, dok. 1036/16.

shisnin prodhimet e tyre në tregjet e Pukës, Fushë-Arrëzit, Rrëshenit etj.

Pjesa më e madhe e fshatrave të rrethit të Matit e një pjesë e fshatrave të Krujës, pér të pjekur bukën, përdornin çerepë e saçë prej dhei të punuar nga gratë e fshatrave German, Luf e Selitë, të cilat i shisnin prodhimet e tyre në forma të ndryshme, derë më derë ose duke i ekspozuar në tregjet e Burrelit, Klosit, Burgajetit e Komsisë. Cereppunueset germanase, dy nga dy apo tre nga tre, shkonin pér t'i tregtuar enët e tyre edhe në pazarin e Krujës, ku pëlqeheshin më shumë se enët e krahinave të tjera. Një pjesë e fshatrave të rrethit të Tiranës, që nuk i punonin këto enë, i merrnin nga gratë e Farkës, nëpërmjet tregut të Tiranës. Ndërsa fshatrat fushore të Shqipërisë së Mesme dhe ato të Myzeqesë i merrnin nga Kavaja, nëpërmjet disa tregtarëve ambulantë që shkonin fshat më fshat pér të shitur edhe enë të tjera balte. Çerepët e fshatit Mirakë shiteshin sa në pazarin e Elbasanit e sa në atë të Librazhdit, ose viniñ vetë amvisat e i merrnin në Mirakë. Gratë në fshatrat e Skraparit rrallë i shisnin këto enë, mbasi shumica i punonin vetë, madje ajo grua që nuk dinte të punonte ponice (çerep), nuk konsiderohej amvisë e mirë. Mjeshtret e çerepëve në Bradvicë e Vërلن (Devoll) ua ngarkonin burrave në kuaj pér t'i shpëndarë atje ku kishte më shumë kërkesa ose i shisnin në panairët që bëheshin pranë kishave, ndërsa ato të Bitinckës i çonin në tregun e Bilishtit.

Në treg dhe në rastet kur viniñ e i blinin në vend, ose kur prodhuesja i çonte derë më derë, shkëmbimi bëhej më shumë me prodhime në natyrë, mbasi edhe në rastin më të mirë të ardhurat në para ishin aq sa pér të plotësuar nevojat e familjes me vajguri, kripë. sapun dhe rrallë pér të blerë ndonjë metër beze ose shami koke. Në këto raste gruaja mjeshtre mund t'i përdorte thjesht pér punët e saj paratë e fituara, si pér të blerë bojëra pér vajzat e saj të rritura, ose pér të darovitur ndonjë nuse apo fëmijë të porsalindur.

Poçarët kavajas çerepët i shkëmbenin me vezë, me gjalpjë, djathë ose pula dhe rrallëherë i shkëmbenin me para, gjë që u sillte më pak përfitimit.

Përveç përfitimit ekonomik, vajtje-ardhjet nga një fshat në tjetrin apo nga një krahinë në tjetrën, kanë bërë që lidhjet krahinore e ndërkrahinore të forcoheshin e banorët e tyre, qofshin edhe gratë, të mos bënin një jetë të mbyllur.

* * *

Të dhënat që kemi pér teknikën e përgatitjes së këtyre enëve nëpër qendra të ndryshme, na dokumentojnë një fazë të hershme të mjeshtërisë së qeramikës, që vazhdoi të mbijetojë aty-këtu deri në kohën tonë. Krahas kësaj, në ndonjë pikë të shkëputur, siç është fshati German në rrethin e Matit e ai i Muhurrit në rrethin e Dibrës, nga disa vegla të thjeshta që u përdorën, veçanërisht diskur pér mbështetjen e enës, shihen përpjekjet që u bënë pér kalimin e kësaj teknike në atë me përdorimin e çarkut me dorë.

Sapo të ngrohej koha në pranverë (në fund të muajit mars apo

në prill) e toka të kishte avulluar, mjeshtret çereppuneset ngarkonin në shpinë ose në gomar koshat dhe një lloj kazme të posaçme e niseshin për të nxjerrë dheun, që përgjithësisht quhej me emrin «botë» e që diku ishte me ngjyrë të kuqe e diku si në të verdhë. Duke folur për vetitë e dherave në përgjithësi thuhej: «botë e butë», «botë e ashpër», «botë e gjatë» «botë e shkurtër», veti që kanë të bëjnë me masën e plasticitetit të tyre. Në ndonjë fshat (Trebisht-Dibër, Surroj-Kukës), për nxjerrjen e dheut preferohej një ditë me hënë të vjetër e jo të plotë, se thuhej që me dheun e marrë në atë kohë bëheshin çerepë më të fortë. Për të nxjerrë dheun mund të shkonte secila prodhuese veçmas, ose dy-tri shoqe së bashku.

Në disa fshatra dheun e nxirrin njerëz për gjithë vitin dhe e depozitonin në një kënd pranë shtëpisë, në disa të tjera nxirrej herë pas here gjatë sezonit të punës.

Sipas të dhënave gojore, në fshatrat Vërbnicë e Zhur, çerep punueset, për të nxjerrë dheun, shkonin në mënyrë të organizuar, duke bërë shaka rrugës e, po të takonin nuse të reja, u dhuronin ndonjë kokërr mollë. Me vete për të ngrënë merrnin kulaçë me djathë, mollë apo arra, që i kishin ruajtur në fund të arkës për këto ditë. Të qeshurat vazhdonin derisa fillonte gërmimi, pastaj mbahej një qetësi e rreptë mbasi po të flisje gjatë gërmimit, besohej se çerepët çaheshin gjatë kohës që modeloheshin. Gjithashtu, po të dëgjohej krismë pushke pranë vendit ku nxirrej dheu, ai dhë nuk duhej përdorur, se çerepët nuk rezistonin gjatë nxehjes në zjarr³. Kështu besonin dhe çereppuneset në Surroj (Kukës); çereppuneset shqiptare në Podrimlje shkonin për të gërmuar dheun, të enjten e fundit para Shëngjergjit dhe e nxirrin për gjithë sezonin e punës.⁴ Në fshatrat e Opojës dhe të Gorës ditën e Jeremisë (më 13 maj) takohen vajzat e rritura të lagjeve, të veshura me rrobat më të mira dhe shkojnë në një vend të caktuar për të nxjerrë dhé, me të cilin punojnë çerepët. Rreth gropës së dheut, para se të fillojnë gërmimin, vajzat hedhin valle në fomë rrethore dhe këndojnë këto vargje:⁵

*I kemi vu shamijat me topa,
jemi kan me çel gropat.*

• • • • •
*Lloçin e çerepit jemi tuj e shkel,
botën kur e morëm shum' e kemi zgjedh
O çerepi ri, bota tokës ton,
dora e devojkës po t'limon për an.
Shamijat me theke larg po na vetojn,
çerepët e rij na po i venojm etj., etj.*

Dheun që sillnin në shtëpi, pasi e pastronin me kujdes nga rrënjet e gurët e ndryshëm, e grumbullonin për gatim. Ky proces pothuajse

3) Dy informueset nga fshati Vërbnice tregojnë që njëherë pronari i vendit ku nxirrej dheu, duke parë dëmet që i shkaktonin gratë nga nxjerrja e vazhdueshme e tij, shtiu disa herë me pushkë e ato nuk shkuan më për të nxjerrë dhé aty.

4) M. Filipović, «Zenska Keramike kod ballkanskih naroda», Beograd 1951, f. 44.

ishte i njëjtë kudo, ndryshonte vetëm përbërja e dheut. Në fshatin German mjeshtret përzienin disa lloj dherash me veti të ndryshme dhe si rezultat enët fiton rezistencë më të madhë. Në fshatrat Bytyç, Çerem, Abat (rr. Tropojë), Farkë (Tiranë), Krumë e Surroj (Kukës), Polis-Gostimë (Librazhd), Muhurr (Dibër), për të rritur rezistençën, përzierja bëhej me lesh dhie. Në të vërtetë kjo përzierje i bënte shumë më rezistente. Në fshatrat Iballë, Gojan, Agripa e Gurit të rrethit të Pukës dhe në Xhuxhë e Orosht e Mirditës, përveç leshit të dhisë, që quhej «kmenë», praktikohej dhe përzierja me lesh derri.

Në fshatrat Bardhoc e Bushtricë (Kukës), në Tomoricë, Osojë (Skrapar), në disa fshatra të Përmetit, në Kavajë, në fshatrat Vërlen, Bitinckë e Bradvicë (Korçë), përzierja bëhej me kashtë të grirë imët që ato e quajnë byk. Rrallëherë praktikohej edhe përzierja me lesh dhie. Diku-diku i hidhnin edhe rërë të imët ose dhé shtufi. Masa e çdo lloj përzierjeje matej vetëm me sy.

Mbasi t'i kishin përzier mirë këto, mbi një shesh të ngjeshur mirë, masa e dheut lagej me ujë të valuar e pastaj trazohej me kujdes derisa të thithët plotësisht ujin. Balta që formohej ngjeshej me këmbë rrëth dy-tri orë. Mjeshtret, para se të ndërprisin ngjeshjen, duhej të provonin masën e plasticitetit që kishte fituar brumi. Kjo bëhej duke bërë një kallam balte, të cilin e përdridhnin nëpër gishta. Në rast se ai këpuntej, gatimi vazhdonte ende. Disa të tjera merrnin një copë baltë dhe e përplasnin në mur, po qe se ajo ngjitej, tregonte se ngjeshja duhej të vazhdonte edhe më. Mbasi përgatitjes së brumit diku modelimi fillohej menjëherë, gjetkë bëhej të nesërmen, sepse brumi i ndenjur «kapej» më mirë.

Mënyra e modelimit të këtyre enëve, siç kemi thënë më lart, qe mjaft e thjeshtë. Të gjitha veprimet kryheshin me duar, por ishin të nevojshëm dhe një kupë me ujë për të lagur duart si dhe një disk prej druri ose prej balte të ngritur pakëz në mes, për të mbështetur fundin e çerepit.

Gjatë kohës që punonte, mjeshtria rrinte ulur në tokë, me një gju ose me të dy gjunjët para vetes. Në fillim modelohej fundi i çeripit, duke shtrirë me pëllëmbët e duarve një masë të caktuar brumi për të formuar një disk me njëfarë trashësie. Kur arrihej diametri i dëshiruar, ktheheshin anët për të formuar «rrëthin» ose «kurorën e çeripit». Diametri matej me pëllëmbë, ndërsa lartësia e rrëthit të çeripit përgjithësisht qe sa gjatësia e gishtit tregues të personit që e punonte, ajo zakonisht arrinte deri në 6-7 cm. Në fund, me duar të lagura vazhdimi, rrafshohej e lëmohej sipërfaqja brenda dhe jashtë, pastaj çerepi i përfunduar hiqej me kujdes nga disku dhe vendosej për tu tharë në një kënd me hije, ose për nevoja të ngutshme edhe në kënde me pak diell. Periudha e tharjes në hije vazhdonte 7-8 ditë e në diell 3-4 ditë. Mbasi kalonte afro një orë në diell, lyenin sipërfaqen me një solucion që diku përgatitej me blozë të tretur në ujë e diku tretnin në ujë një lloj dheu të kuq që quhej «xixë» (German),

5) Të dhënët janë marrë në terren nga autorja në ekspeditën e bërë në tetor 1979, ndërsa vargjet janë regjistruar në terren nga Agron Xhagolli.

ose «parore» (Polis-Gostimë). Ky, sipas analizave të bëra në laboratorin kimik të Institutit të Kulturës Popullore, rezulton se përmban sasi mineral mike dhe talku. I pari ka veti ngjyrosëse, ndërsa i dyti ka veti që t'u rezistojë temperaturave të larta.

Lyerja me këto solucione bëhej kryesisht për të rritur rezistencën e objektit.

Në një numër fshatash, për t'i zbukuruar çerepët, krijoeshin disa motive të thjeshta që shpeshherë shërbenin dhe si stampa për zbukurimin e bukëve që piqeshin në to.

Çerepët e përdorur në Shqipërinë Veriore zbukuroheshin me kryqe të vogla, gropëza, ose me rrathë të vendosura rrallë nëpër fundin e tij. Në ndonjë prej tyre vizatoheshin dy vija të kryqëzuara e në bazë të gjurmëve të këtyre i zoti i shtëpisë ndante bukën. Sipas një figure të vizatuar nga F. Nopçë⁶, krejt fundi i çerepit është i zbukuruar me një kryq dhe paralel me krahët e tij, janë tërhequr dhe dy vija që formojnë kënde të drejta.

Çerepët e punuar nga shqiptarët e Malit të Zi zbukuroheshin me një kryq të madh dhe në fund të katër ekstremeve të tij bëhej nga një vrimë.⁷ Në fshatin Polis-Gostimë në disa raste çerepët i zbukuronin me gropëza, të cilat rrëthohen me një vijë të valëzuar, ndërsa në qendër të tyre vihej një kryq i vogël. Në fshatrat Vërlen e Bradavicë, sipërfaqja e fundit të çerepit mbushej me gropëza. Kështu vepronin dhe disa fshatra të Skraparit.

Te shqiptarët në rrëthin e Prizrenit çerepët i shponin në mes, ndërsa anash u bënин gropëza me gisht. Po kështu dhe në Podrimlje, ku çerepët i punonin vetëm gratë e varfëra shqiptare.⁸ Motivet bëheshin me gisht (gropat), me filxhan (rrathët) ose me ndonjë copë krande.

Madhësia e çerepëve ndryshonte; në çdo rast ajo matej me bukatore, gjë që do të thotë se sa veta mund të hanin me bukën që piqej në njërin ose tjetërin çerep.

Në përgjithësi çerep i madh konsiderohej ai që kishte këto përmasa: diametri i fundit 44-45 cm, diametri i unazës (rrethit) 46-47 cm. dhe lartësia e jashtme rrëth 7 cm. Kishte dhe më të vegjël, në këto përmasa: diametri i fundit rrëth 42 cm, lartësia e jashtme 7 cm. Akoma më të vegjël ishin ata me diametrin e fundit 33 cm, diametrin e rrëthit 35 cm dhe lartësinë e tij 7 cm. Në Mirditë punoheshin çerepë akoma më të vegjël që shërbenin për të pjekur kuleçët për fëmijë dhe quheshin me emrin «gjoca».

Cerepi përbëhet nga disa pjesë të quajtura nga amvisat: fundi i çerepit, rrëthi dhe buzët. Fundi i kthyer përmbyss, quhej shpina e çerepit dhe mbi të zakonisht piqnin një lloj kulaçi të hollë (si petë) për çobanët që niseshin në mëngjes herët. Këtu piqeshin dhe petët e

6) M. Filipović, *vep. cit*, f. 132.

7) M. Filipović, *Po aty*, f. 11.

8) M. Filipović, *Po aty*, f. 12.

një lloji lako, që gatuhej me qumësht e me vezë ose një lloj lako me petë të trasha e me barishte në mes.

Në fshatin German (rrethi i Matit), Bytyç (rrethi i Tropojës), Kërpite (rrethi i Gramshit), si dhe në disa fshatra të tjera të krahinës së Tomoricës,⁹⁾ krahas saçit metalik, janë përdorur dhe punuar vazhdimisht edhe saçë prej dhei që, bashkë me çerepët, tregtoheshin në mjaft fshatra të rretheve përkatëse. Punimi bëhej me të njëjtin brumë, porse procesi i modelimit, ndryshe nga ai i çerepëve, bazohej në dhënien e formës me kallëpe prej dhei me formë gjysmësferike të cekët.

Së pari mbi kallëp shtrihej me dorë një shtresë balte me trashësi 2-2,5 cm (Diametri varej nga dëshira e modelueses). Kur arrihej diametri i dëshiruar, enët ktheheshin paksa nga jashtë, me qëllim që të krijohej njëfarë pengese për të mbajtur hirin dhe shpuzën, që hidhej mbi saç. Sipas kallëpit, saçi merrte formën e një segmenti sfere me lartësi rrëth 0,15-0,20 cm. Ndërsa diametri duhej të ishte paksa më i madh se ai i çeripit që vihej mbi të. Në pjesën më të ngritur të tij vihej dorëza që shërbente për ta kapur kur hiqej nga zjarri. Trashësia dhe mënyra e vendosjes së saj llogaritej në atë mënyrë, që ajo të mund ta mbante mirë gjithë peshën e saçit.

Pastaj, ashtu siç ishte në kallëp, e vendosnin për t'u tharë.

Gjatë kësaj kohe gruaja mjeshtre i kontrollonte herë pas here, i kthente në pozicione të ndryshme e pastaj, me një sy të stërvitur dhe nga tingujt që lëshonin goditjet në enë, përcaktohej nëse tharja ishte bërë sa duhej apo jo. Mbas tharjes fillonin përgatitjet për pjekjen ose «djegien» e tyre.

Edhe ky proces pune bëhej në mënyrë të thjeshtë, duke i pjekur në zjarr të hapur.

Zakonisht buzë mbrëmjes, në një qoshe të oborrit të shtëpisë, ndiznin një zjarr të madh e mbi të vinin një ose dy çerepë ose saçë. Ndërkohë zjarri ushqehet vazhdimisht me dru, derisa enët të skuqeshin plotësisht. Mbas arrihej kjo, ndërpritej zjarri, ndërsa enët liheshin mbi shpuzë, derisa ajo të shuhej gradualisht. Përveç kësaj pjekjeje, ndonjë amvisë, para se t'i përdorte çerepët, u bënte dhe një pjekje të lehtë vetë, por më përpara lyente me të bardhë veze gjithë sipërfaqen e brendshme të fundit të çeripit me qëllim që ajo të ngurtësohej edhe më shumë.

Në çerep të mbuluar me saç, përveç bukës së thjeshtë e të ardhur piqeshin dhe ushqime të tjera si lako, peshku (nga fshatrat pranë lumenjve), patate, kungull, mollë, thana, kumbulla. Në disa fshatra të rrethit të Kukësit (Surroj, Bushat, Nangë, Arrën etj.) buka e dhëndrit duhej pjekur vetëm në çerep.

Banorët e disa fshatrave të Korçës çeripin e kanë përdorur dhe

9) Sipas të dhënave të marra nga Abaz Dojaka në ekspeditën e bërë në vitin 1964 në krahinën e Tomoricës. AE, 893/11.

si bazament në ndërtimin e vatrave të oxhaqeve, disa të tjerë mbanin shpuzën pér t'u ngrohur.

Pér të pjekur bukën apo ndonjë gatim tjetër në çerep, ai në fillim vihej pér t'u nxehur në zjarr ku lihej derisa paretet e tij të zbardheshin. Pastaj me anë të një lopate, që përdorej posaçërisht pér ta hequr e pér ta vënë në zjarr atë, hiqeje prej aty dhe vendosej në një kënd midis vatrës dhe magjes së bukës. Menjëherë hidhej buka në të dhe derisa të ngrohej saçi, e mbulonin me një disk prej druri të quajtur «qër» ose «palare». Saçi, i mbuluar me pak hi lihej pér t'u nxehur pak më shumë se çerepi dhe, pér të ruajtur nxehtësinë, ai mbulohej me shpuzë e pastaj vendosej mbi çerep. Mbas 30-40 minutash buka piqeji plotësish e kishte një shije më të mirë se ajo që piqeji në enë metalikë, sepse në enë balte përgjithësisht ushqimet zihen apo piqen ngadalë e jo rrëmbyer.

Mbasi hiqeje buka, çerepin e fshinin me një leckë e bashkë me saçin i mbështesnin në qoshen e caktuar pér to. Asnjëherë saçi nuk vihej mbi çerep kur ky ishte bosh sepse besohej se «mbetej shtëpia shkretë».

Periudha mesatare e përdorimit të çeripit apo të saçit (kur ky qe prej balte, mbasi shumica përdornin saç prej metali) ishte 6 muaj deri në një vit, por një amvisë e kujdeshme një çerep mund ta përdorte deri në dy vjet ose më shumë. Kështu konsumimi pér një kohë të shkurtër i detyronte amvisat t'i punonin nganjëherë edhe vetë këto enë.

Enët që shërbenin pér të pjekur bukën, në krahina të ndryshme të Shqipërisë, janë njobur me terma të ndryshëm. Në Malësinë e Madhe haset termi «çerem» (pér çerepin) e «kakin» (pér saçin), në Shqipërinë Verilindore përdoreshin fjalët çerep e saç, në Malësinë e Tiranës dikush u thoshte «çerjep» e dikush «çurup», ndërsa saçi njihej po me këtë term. Në fshatrat e Shqipërisë së Ulët Bregdetare përdoreshin termat «ponicë» e «fishnik». I pari ishte më i përhapur i dyti më pak e kryesisht në fshatrat përreth Kavajës e në Kavajë brenda, ndërsa saçi njihej me termin «sahaç». Në disa fshatra të Librazhdit çerepi njihej me këtë term, ndërsa saçi quhej «gorrik». Në krahinën e Korçës çerepi njihej edhe me termin «ponicë» edhe «çerep» po kështu dhe saçi njihej me emrin «sahaç» ose «saç» e diku «kakin» si në Malësinë e Madhe. Në krahinat e Skraparit, Beratit, Tepelenës, Përmetit, përgjithësisht janë përdorur termat «ponicë» e «saç», kurse në fshatin Kérpitë të rrëthit të Gramshit është përdorur termi «ponicë» pér çerepin dhe «çerep» pér saçin.

Si çerepi ashtu edhe saçi janë enë panballkanike. Madje çerepi, me pak ndryshime të vogla fonetike, është njobur dhe me të njëjtin emër në disa vende të Ballkanit. Në Bullgarinë Perëndimore quhet «çerep» ose «çirep», në Turqi «çerepene», te popujt e Jugosllavisë përdoren termat «çrapna», «crepula» dhe «crijepna».¹⁰

10) M. Filipoviç, Po aty. f. 11.

Nopca thotë se në vend të saçit të hekurit, në Rumani dhe në Bosnjë përdorin edhe saç prej dheu, që njihej dikur në periudhën e Hallstadtit në Bosnjën Veriore. Për autoktoninë e saçit në viset ilire flet ndodhja e tij në ngulimet «hall-stadtiane» në Ripar dhe Dolnje-Dolina të Bosnjës. Në këtë vend saçi ka mundur të qëndrojë që prej kësaj periudhe deri në ditët tona.¹¹

Punimi e përdorimi në masë i këtyre enëve i takon së kaluarës së largët, megjithatë aty-këtu në zonat malore të vendit e në ndonjë vend tjetër, më shumë për shkak të forcës së traditës, këto vazhduan të përdoren deri në vitet 50-60 të shekullit tonë. Masat që u morën pas kolektivizimit të plotë të fshatrave për funksionimin e furrave të bukës e si rezultat blerje e bukës së gatshme, bënë që këto enë të pakësohen gradualisht e të kufizohen vetëm për të gatuar ndonjë bukë për qejf. Vendin e tyre përherë e më shumë po e zënë enët metalike ose të zinkuara jo vetëm për të pjekur bukën, por dhe për gatimin e gjellëve të ndryshme.

11) F. Nopcsa, «Albanien (Bauten trachten un Geraten Nordalbanich)», Vjenë, 1923, f. 100.






Fig. 1, 2, 3, 4 Pregatitja e baltës për punimin e çerepëve e saçëve në fshatin Kër-pitë (Tomoricë-Skrpar).



Fig. 5, 6, 7, 8 Sac e çerep të punuar në fshatin German.



Fig. 10 Sag metalik (Kërpitë)



Fig. 9 Sag e çerep (German)




Fig. 11 Enë balte të punuar në fshatin German.

Spiro SHKURTI

NJË VËSHTRIM MBI VESHJET POPULLORE TË ZONËS SË VURGUT NË FUND TË SHEK. XIX E NË FILLIM TË SHEK. XX

Ndër veshjet e shumëlojta e të pasura të popullit tonë zënë vend edhe veshjet e zonës etnografike të Vurgut, të cilat deri tani jo vetëm që nuk janë studiuar aq sa duhet, por në përgjithësi janë njojur edhe pak. Evidentimi dhe studimi i këtyre veshjeve ka rëndësi jo vetëm për të njojur kulturën e popullit, krijimtarinë e tij të pasur edhe në këtë fushë, por edhe për të njojur mirë kërkuesat estetike të popullsisë që i ka përdorur këto veshje, nivelin ekonomik e shoqëror të saj, mbasi veshja, krahas banesës dhe ushqimit, është pasqyrim direkt i gjendjes ekonomike dhe pozitës shoqërore të bartësit të saj. Popullsia e kësaj zone, ndonëse e varfér dhe në luftë të vazhdueshme për të siguruar kërkuesat minimale të jetës, kishte në përdorim përraste ceremoniale jo vetëm kostume relativisht të shumta në numër, por edhe të bukura, ndonëse të thjeshta e të pangarkuara aq shumë në ar e argjend, siç ndodh në disa zona të tjera etnografike. Kjo gjë shpreh, në fund të fundit, edhe pozitën ekonomike e shoqërore të bujkut pa tokë, sikurse ishte fshatari i Vurgut.

Në fund të shekullit të kaluar e në fillim të shekullit tonë, në këtë zonë nisi të ngushtë etnografike janë mbajtur kostume të shumëllojshme, si për gra ashtu edhe për burra. Si veshje grash, krahas veshjes me dhipllar krejtësisht të bardhë e të punuar prej liri, përdorej veshja me *cibun*, e punuar në pjesën më të madhe prej leshi. Një shtrirje më të gjerë, në krahasim me dy veshjet e para, kishte veshja me *allaxha*, një kostum i bukur dhe elegant, që punohej kryesisht me material të blerë në treg, që ka bashkëjetuar, bile edhe në të njëjtën familje e në të njëjtin person, me veshjen me *cibun* (kostumi i dytë i fshatrave të zemrës së Vurgut), një veshje e rëndë dhe e punuar krejtësisht prej leshi. Për burra, krahas veshjes me fustanellë, është përdorur edhe veshja me poture dhe, në një kohë më të vonë, ajo me killota.

Bashkëjetesa e varianteve të shumta në veshjen e popullit, vëcanërisht për gra, në një zonë të ngushtë si ajo e Vurgut, që nuk ka më shumë se 19 fshatra, pra kjo pasuri e larmi edhe në veshjet popullore, ku mesatarisht çdo pesë fshatra kanë një kostum të tyre të veçantë, flet edhe në favor të tezës së hedhur prej nesh për origjinën etnike të ndryshme të grupeve të popullsisë që sot banojnë në këtë zonë. Kjo ndryshueshmëri në veshje në zonën e Vurgut, ku fshatrat janë shumë afër me njëri-tjetrin dhe popullsia ka qenë në të njëjtin nivel zhvillimi ekonomik e shoqëror, nuk ka si të shpjegohet ndryshe,

veçse me ruajtjen e transmetimin e asaj tradite të krijuar që më parë nga këto grupe. Kështu fshati Finiq e Vrion nuk janë më larg se 2 km njëri nga tjetri, kanë qenë në kushte të njëjtë ekonomike e shoqërore, pa asnjë pengesë natyrore midis tyre e, megjithatë, ata ruanin dy variante veshjesh të ndryshme, i pari veshjen me cibun, ndërsa i dyti veshjen me allaxha.

Në fund të shek. XIX e fillim të shek. XX, gruaja vurgare e punonte vetë, brenda ekonomisë shtëpiake, lëndën që i duhej jo vetëm për veshjen e saj, por edhe për të gjithë anëtarët e familjes. Për përgatitjen e veshjes dy ishin materialet kryesore: liri dhe leshi i deles. Pambuku dhe mëndafshi pothuaj nuk janë përdorur, mbasi ata nuk janë kultivuar në këtë zonë në periudhën që kemi marrë në studim. Gjithashtu edhe gjineshtra punohej pak e rrallë, vetëm në disa fshatra të pjesës lindore të zonës, pranë të cilave rritej kjo bimë në kushte natyrore.

Të paktën që nga fillimi i shek. tonë e deri në mesin e viteve 50, në të gjitha fshatrat e zonës, është kultivuar, në masë e me shumicë liri, i cili përbënte një nga materialet kryesore për veshje. Ai mbi-lej, në pjesën më të madhe në kopshte e ara, afër ndërtesave të banimit. Me kultivimin e punimin e lirit zakonisht merreshin vetëm gratë. Gratë e mbillnin atë, i shërbën deri në periudhën e pjekjes së plotë, e korrnin dhe pastaj po ato e kalonin në të gjitha proceset e përpunimit, që nga futja në ujë për kalbëzim, tharja, rrahja në mandër, zbardhja, krehja, tjerrja e deri në endjen në vegje.

Me li punoheshin jo vetëm veshjet e brendshme si për burra dhe për gra, që në popull njiheshin me emrin «të linjta», por në ndonjë nënzonë edhe e gjithë veshja, si ndodh p.sh. në fshatrat ku është përdorur veshja me dhipllar.

Në veshjet e zonës, krahas materialit prej liri, një vend të rëndësishëm zinte materiali prej leshi. Bile edhe në ato fshatra ku liri ishte materiali kryesor për punimin e veshjes, me lesh punoheshin përpajet, brezat, çorapet dhe në mënyrë të veçantë cibuni, kjo pjesë e sipërme veshjeje, që përdorej në periudhën e ftohtë të dimrit pothuaj në të gjitha fshatrat. Këtu duhet të vëmë në dukje se, ndonëse leshi kishte gjetur një përdorim të gjerë në të gjitha veshjet e zonës, ai nuk prodhohej nga çdo familje, bile ishin shumë të rralla ato familje që plotësonin nevojat me leshin e prodhuar vetë, mbasi zona e Vurgut ishte kryesisht zonë bujqësore dhe ishin të rralla ato familje që mbanin dhen. Nevojat e saj për lesh çdo familje i mbulonte ose duke shkëmbyer prodhime bujqësore me lesh, ose duke e blerë atë nga blektorët labë e vllej që dimëronin me kopetë e tyre në këtë fushë.

Ndërsa përgatitja e materialit për veshje bëhej, në pjesën më të madhe, brenda ekonomisë shtëpiake, qepja e veshjeve që në fund të shekullit të kaluar kishte dalë nga ky kuadër. Veshjet priteshin e qepeshin nga rrobaqepës shëtitës, të cilët shkonin nga fshati në fshat e nga banesa në banesë, aty ku ishte puna. Këta rrobaqepës ishin nga fshatra të tjera jashtë zonës së Vurgut. Ata jo vetëm punonin, por edhe jetonin në shtëpitë e fshatarëve, për aq kohë sa të mbaronin punë.

Për të dhënë një ide më të saktë për veshjen e zonës, më poshtë po shqyrtojmë veças veshjet e grave për të tri nënzonat etnografike,

duke përfshirë këtu jo vetëm kostumin e parë, ceremonial, por në ndonjë rast edhe kostumin e dytë, që ndryshon në morfologji, në prerje e në material nga veshja ceremoniale. Së fundi, po shqyrtojmë edhe variantet e veshjes së burrit, të cilat janë të unifikuara jo vetëm për Vurgun, por edhe për një zonë shumë më të gjerë, që përfshin Shqipërinë Juglindore dhe Jugore.

I: VESHJE GRASH

a) Veshja me dhipllar

Veshja me dhipllar ka qenë një nga veshjet më të vjetra të zonës së Vurgut, e cila, në prag të Luftës së Parë Botërore është e dokumentuar në tri fshatra (Kranë, Finiq, Jermë). Duke qenë se fshatrat ku shtrihet kjo lloj veshjeje janë fshatrat më të vjetra e të vete me të kësaj zone, të dokumentuara si vendbanime të paktën që në vitin 1431, jemi të prirë nga mendimi se kjo ndoshta ka qenë veshja e banorëve më të hershëm të kësaj zone, që ka ardhur trashëgim brez pas brezi, sigurisht duke iu përshtatur nivelit ekonomik, nevojave të popullsisë dhe kërkesave estetike të kohës. Në këtë përfundim na shtyn edhe fakti se kjo lloj veshjeje përgatitej krejtësisht prej liri, që, siç shprehet në literaturën etnografike, është material karakteristik për përgatitjen e veshjes nga popullsitë që në bazë të jetës së tyre ekonomike kanë pasur bujqësinë.

Këtu duhet të vëmë në dukje se veshja me dhipllar, bile edhe në fillim të shek. tonë, ka pasur një rrëth më të gjerë përhapjeje, jo vetëm brenda fshatrave të rrëthit të sotëm administrativ të Sarandës, por edhe jashtë tij. Kështu këtë lloj veshjeje ne e kemi dokumentuar nëpërmjet mbledhjes së materialit në terren jo vetëm në të tri fshatrat e përmendura më sipër të zonës së Vurgut, por edhe në fshatrat e zonës kodrinore të Livadhjasë (Hoxhës), në fshatrat e Muzinës e bile edhe në fshatrat e Dropullit të Sipërm e të Poshtëm, në të cilat, edhe në veshjet që kanë pasur në përdorim deri në vitet e para të pasçlirimit, ka pasur një pjesë veshjeje me emrin dhipllar, pothuaj me të njëjtën prerje e po prej materiali të linjtë, gjë që flet, për ngjashmërinë e për identitetin e madh të këtyre veshjeve.

Duke parë shtrirjen relativisht të gjerë territoriale të veshjes me dhipllar, që fillonte në perëndim nga brigjet e detit Jon dhe arrinte në lindje në fushën e Dropullit, duke pasur në jug si kufi krahun e djathtë të lumit Pavël e në veri rrugën e sotme automobilistike që lidh Sarandën me Gjirokastrën, duket qartë se kjo veshje në shekullin e kaluar ka qenë e përgjithshme në një zonë më të gjerë. Sipas materialit të mbledhur në terren ajo përdorej në të gjithë këtë zonë si veshje e vetme ceremoniale dhe çdo grua, kur martohej, e kishte detyrimisht në pajën e saj. Në vitet që rrodhën pas mesit të shek. të kaluar, si rezultat i kushteve të reja ekonomike, zona të veçanta, herë njëra e herë tjetra, filluan ta lënë këtë veshje dhe neve sot na ka ardhur vetëm kujtimi i përdorimit të saj, me përjashtim të fshatit Jermë, ku dimë se ajo është përdorur për herë të fundit, si veshje martese, në vitin 1927. Pra, uniteti që vihej re në të gjithë zonën e përmendorur

më sipër në përdorimin e dhipllarit, në fund të shek. të kaluar e në fillim të shek. tonë, u prish dhe gjithë kjo zonë e madhe kostumologjike u copëtua në disa mikrozona, me diferenca të dukshme në veshje, gjë që krijoi atë larmi të madhe në veshjen e grave, që kemi të dokumentuar për gjysmën e parë të shekullit tonë.

Karakteristikë kryesore e veshjes me dhipllar ka qenë ngjyra e saj e bardhë, e cila është thyer me aplikim apo qëndisje me material apo fije ngjyrash të ndryshme. I bardhë është dhipllari, pjesa kryesore e kësaj veshjeje, prej së cilës ajo ka marrë edhe emrin, e bardhë është këmisha, mbulesa e kokës (mahramaja). Mbizotërimi i ngjyrës së bardhë në tërë veshjen është një dëshmi tjetër etnografike që flet për vjetësinë e kësaj veshjeje.

Në tërësinë e saj veshja me dhipllar është e bukur dhe e lehtë. Ngjyra e bardhë e dhipllarit, e thyer aty-këtu me aplikime apo qëndisje me penj bojë kafe, vishnjë, të kuq etj., është një kombinim harmonik ngjyrash, që shpreh, në fund të fundit, shijet e holla estetike të bartësve. Pastaj e bardha e thyer me ngjyrën bojë kafe të myllur të përparjes dhe me çorapet apo kallcat me vija shumëngjyrëshe, krijojnë atë kontrast të këndshëm ngjyrash, që e bëjnë veshjen në tërësinë e saj tërheqëse dhe të bukur (fig. 1).

Veshja me dhipllar përbëhet prej pjesëve të mëposhtme, të cilat po i përshkruajmë jo sipas rëndësisë së tyre në tërësinë e veshjes, por sipas radhës që ato visheshin.

Fanella — Punohej me lesh deleje të butë e të dredhur hollë. Fanella mbulonte pjesën e sipërme të trupit deri në bel, gjithashtu edhe krahun deri te kyçi i dorës. Kjo punohej nga vetë gratë me pesë shtiza të gjata, me punë të thjeshtë e vija vertikale dhe përbëhej prej tri pjesësh kryesore: shpinës, gjoksit dhe mëngëve, të cilat bashkoheshin duke u qepur. Pjesa e përparme, te gjoksi dhe kapakët e mëngëve, pra pjesët e dukshme, zbukuroheshin duke i qëndisur me fije leshi apo pambuku ngjyrash të ndryshme.

Fanella të tilla janë përdorur deri vonë, dhe vetëm nga mesi i viteve 50 të shek. tonë ato filluan të zëvendësoheshin nga prodhimet e industrisë. Sot ato mbahen e përdoren në pak raste nga gratë e moshuara, por pa asnjë zbukurim.

Këmisha — Është punuar me pëlhirë liri të bërë në vegjë, por pas Luftës së Parë Botërore e veçanërisht pas vitit 1925, punohej edhe me kambrik. Në këtë periudhë pëlhra prej liri e punuar në vegjë filloj pak nga pak të dalë nga përdorimi për rastet ceremoniale dhe të përdoret vetëm në veshjet e përditshme e për punë. Është kjo arsyje që këmisha të tilla ne nuk kemi gjetur, por atë po e përshkruajmë sipas materialit të mbledhur në terren, në bazë të kujtimeve të të moshuarve.

Këmisha mbulonte trupin nga qafa e deri në pulpë të këmbës. Këmishët më të vjetra janë punuar në avlëmend me katër lisa, me fije të hollë liri, thjesht e pa zbukurime. I vetmi kujdes ishte zbardhja sa më e mirë e saj, veçanërisht e pjesës së poshtme, që dilte rrëth 7-10 cm. nën dhipllar e për këtë arsyebinte më shumë në sy.

Këmisha përbëhej prej dy copash: prej gjoksit dhe fundit. Pjesa e sipërme përbëhej prej dy pjesësh, shpinën dhe gjoksit, të cilat qepeshin për t'u bashkuar nën sqetull dhe mbi supe. Pjesës së gjoksit

i është hequr një copë në formë T-je, që vjen duke u ngushtuar sa më poshtë zbret. Kjo e çarë shkon deri afér belit. Në të gjithë gjatësinë e saj i është shtuar një copë tjetër e gjerë rrëth 2 cm, e qëndisur thjesht me fije të bardha.

Mëngët e këmishës janë në formë kambane, më të ngushta te supet e më të gjera në fund. Për t'i dhënë formën e kambanës, te supi, në pjesën e përparme të tij, janë krijuar disa pala. Mëngët janë të gjata deri pak nën bërryl.

Pjesa e poshtme e këmishës është qepur në formë kambane me shumë rrudha në bel e me shumë pala në fund, duke i dhënë asaj formën e një fustanelle, me aq pala sa copë ka. Këmisha që kemi parë kishte 96 copë pëlburë, të cilat janë të gjera në fund 14 cm. secila, pra në fund ajo krijon 96 pala. Një plakë e moshuar në Finiq (82 vjeç) tregon se, kur ishte martuar, kishte veshur një këmishë me 120 «pjetë» (pala). Pjesa e sipërme e këmishës dhe pjesa e poshtme e saj janë bashkuar me një rrip pëlburë të bërë dysh e të forcuar me qepje.

Këmishë të tillë priteshin e qepeshin nga vetë gratë, kur bëhen shin me pëlburë liri, por pjesa e poshtme e saj qepej edhe nga mjeshtra zejtare, kur filloj të përdorej pëlburja e kambrikut.

Jeleku — Vishej mbi këmishë. Ai ishte i gjatë deri pak mbi bel. Prerja e tij ishte si në fig. 2, d.m.th. përbëhet prej tri copash, shpinës dhe dy anët e gjoksit. Pjesët e gjoksit janë bërë prej kadifeje të zezë. Ndërsa shpina prej një cope çfarëdo. Pjesa e gjoksit ishte e zbukuruar. Në këtë pjesë, mbi kadife, është aplikuar një copë në ngjyrë vishnje, mbi të cilën ka zbukurime me fije mëndafshi, me vija paralele e zig-zage, në ngjyrë të zezë, të kuqe e të bardhë.

Dhipllari — Është pjesa kryesore që i ka dhënë emrin edhe vetë veshjes. Është punuar me fije liri në vegjë me katër lisa. Ajo mbulon pjesën e sipërme të trupit deri afér pulpave dhe është pa mëngë. Ngjyra e dhipllarit është krejtësisht e bardhë, veçse pjesa e tij nga supet deri pak nën gjoks është zbukuruar rëndë, qoftë me aplikim të copave të tjera me ngjyrë të ndryshme nga ajo e dhipllarit, qoftë me qëndisje me fije mëndafshi apo leshi ngjyrash të ndryshme, të cilat janë qepur me tegel tejembanë në formë bordure, duke rrëthuar nga jashtë të gjitha pjesët e qëndisura (fig. 3).

Prerja e dhipllarit është si ajo e fig. 4, d.m.th. ai përbëhet prej shpinës, gjoksit dhe nënsqetullorëve.

Shpina ka formën e një katërkëndëshi kënddrejtë, me gjatësi 86,5 cm dhe gjerësi 25,5 cm. Në këtë pjesë, duke filluar që nga qafa e tij e deri pothuaj afér mesit, ka dy vija paralele, të punuara me «punë kryq», me fije leshi ngjyrash të ndryshme, ku dominon ngjyra vishnje dhe e gjelbër. Kombinimi i këtyre ngjyrave është bërë në mënyrë alternative, në mënyrë të tillë që e gjithë vija nuk ka të njëjtën ngjyrë, por në një gjatësi prej afro 7 cm. është përdorur fije me ngjyrë të gjelbër e kështu me radhë deri në fund. Menjëherë pas qëndisjeve me punë kryq, janë qepur me makinë tufa fijesh leshi, me gjatësi 2-3 cm, me ngjyra të ndryshme, ku dominon ngjyra vishnje dhe e gjelbër. Kombinimi i tufave me fije leshi është bërë në mënyrë të tillë, që fije me ngjyrë vishnje ka dy herë më shumë se fije me ngjyrë të gjelbër.

Pjesa e gjoksit është ajo që është më e zbukuruar në dhipplar, pjesa që i është kushtuar më shumë rëndësi. Ajo ka në pjesën e përparmë formë të harkuar, që vjen duke u ngrënë sa më poshtë zgresin nga gjoksi. Në këtë pjesë është përshtatur një copë vishnje, në formën e një trekëndëshi me bazë 11,5 cm dhe lartësi 25,5 cm, mbi të cilën janë krijuar tre trekëndësha më të vegjël, si rezultat i aplikimit të një cope të zezë mbi copën vishnje. Në trekëndëshin qendror, është bërë me fije ari një selvi, karakteristikë kjo edhe për veshje të tjera të zonës së Vurgut dhe zonave të tjera kostumologjike të rrëthit administrativ të Sarandës. Në dy trekëndëshat anësorë është aplikuar një lulledredhëz, punuar me fije të verdha e të bardha. Pjesa e poshtme e gjoksit, ashtu si shpina, nën qëndisje me punë kryq, është zbukuruar me tufa fijesh leshi vishnjë, të gjelbër etj.

Ky kombinim harmonik ngjyrash: vishnje, e kuqe, e zezë, e gjelbër dhe e verdhë, mbi të cilat spikat herë-herë vija e bardhë e fijeve dhe bardhësia e vetë dhipplarit, i jatin këtij një bukuri të rrallë, gjë që flet për shijet e holla artistike të popullsisë që e ka mbajtur këtë veshje.

Nënsqetullorja përbëhet prej katër copash: dy të vogla, të cilat janë vendosur nën sjetull, duke formuar harkun e poshtëm të saj dhe dy të tjera, të qepura poshtë tyre, që kanë afërsisht formën e trekëndëshave me bazë nga poshtë. Në fund, në vendin ku bashkohen të dy bazat e trekëndëshave, është lënë një e çarë që ka po formën e një trekëndëshi të vogël.

Dy copat e para të nënsqetullores janë zbukuruar me qëndisje, ashtu si pjesa e gjoksit, ndërsa dy pjesët e tjera, me përjashtim të gjitanit që shkon përfundi në të gjithë gjerësinë e dhipplarit, nuk kanë asnjë zbukurim.

Dhipplari qepej nga mjeshtra rrobaqepës shëtitës, sipas kërkësave estetike të porositësit. Ajo që është e rëndësishme këtu ishte se, ndonëse ata qepeshin nga mjeshtra zejtarë, ishin të kushtëzuar nga tradita. Është kjo arsyja që të gjithë dhipplarët që kemi parë janë të njëllotjë me njëri-tjetrin, ndonëse nga njëherë janë qepur nga mjeshtra zejtarë të ndryshëm.

Brezi i gjerë — Është punuar në avlëmend, me fije leshi në ngjyrë kafe ose vishnje. Shërbente për ta ngjeshur për mesi mbi dhipplar. Ai është i gjerë 7 cm dhe i gjatë 110 cm, në mënyrë të tillë që të mbështilej 2-3 herë për mesi. Vetëm në dy skajet është i zbukuruar (fig. 5). Përveç funksionimit dekorativ ai luan edhe një detyrë funksionale. mbajtjen e mesit shtrënguar dhe ruajtjen e tij prej të ftohtit.

Brezi i ngushtë — Vishej mbi brezin e gjerë, duke u sjellë rrëth mesit disa herë, në mënyrë të tillë që xhufkat e tij të binin lirshëm në të dy anët e pjesës së poshtme.

Brezi i ngushtë punohej në vegjë me katër lisa, me fije leshi të dredhur hollë, të ngjyrosur në bojë kafe, të gjelbër, të zezë, të verdhë e të bardhë. Punohej me shije të hollë artistike, gjë që tregon se kjo pjesë ka pasur vetëm funksion dekorativ. Në të dy skajet e brezit të ngushtë, që bien më shumë në sy, janë lënë tufa fijesh me një gjatësi prej 11 cm, me të gjitha ngjyrat me të cilat është punuar vetë brezi (fig. 6).

Gjatësia e brezit të ngushtë është 3,20 cm, pa xhufkat anësore, të cilat varen anash.

Brezi i ngushtë punohej në avlëmend nga çdo grua, por edhe nga gra të specializuara në këtë punë, që punonin me porosi dhe me hakë.

Përparja — Përparjet zakonisht janë punuar me fije leshi të dredhur hollë. Ato punoheshin në avlëmend me katër lisa. Puna bëhej zakonisht shumë e ngjeshur, në mënyrë që përparja të dilte e fortë e të qëndronte e ngrirë. Endja është bërë në formën e një mozaiku. Fusha punohej me ngjyrë blu të thellë, që afrohej në nuancat e së zezës e në të kanë kaluar vija të punuara me fije të bardhë, bojë kafe, të verdhë e të gjelbër. Kjo bëhej vetëm në pjesën e brendshme, duke lënë në ngjyrën blu një rrip anësor me gjerësi rrëth 7 cm në të gjitha anët e përparjes, në të cilën janë qepur me makinë fije leshi të bëra kordon, me ngjyrë të verdhë, të gjelbër, bojë kafe e të bardhë. Këta kordona prej fijesh leshi janë vendosur në vijë të drejtë në të gjitha anët e përparjes e në pjesën e sipërme; në mes janë qepur, duke krijuar një tufë fijesh jo të gjatë (fig. 7).

Mbulesa e kokës (mahrama) — Punohej me avlëmend me katër lisa, me fije liri të dredhura shumë hollë. Gjerësia ishte aq sa gjerësia që mund të punonte vegja, 33 cm, ndërsa gjatësia e saj bëhej sipas dëshirës. Mbulesa e kokës që kemi parë kishte një gjatësi prej 163 cm.

Fusha e saj është punuar thjesht, duke lënë në intervale të caktuara (mbas çdo 8 centimetresh) në mënyrë simetrike, «gishta» të hollë. Të dy skajet e mbulesës, në një gjatësi prej 6 cm, janë zbukuruar me qëndisje me fije mëndafshi me ngjyrë të verdhë, manushaqe dhe të kuqe. Fije të tillë e po me këto ngjyra janë ngjitur në të tri anët e jashtme të katerkëndëshit të zbukuruar, duke krijuar tufa me ngjyrat e mësipërme, ku spikatin edhe fijet e bardha, me të cilat është punuar copa (fig. 8).

Mbulesa e kokës shërbente për të mbuluar pjesën e sipërme të kokës e më rrallë edhe qafën. Kur përdorej për të mbuluar pjesën e sipërme të kokës, ajo mbasi vendosej në kokë, pjesët anësore paloseshin mbi të, në formë trekëndëshash, duke lënë të varur mbi ballë njëren anë të mbulesës, të qëndisur e me xhufka. Kur përdorej për të mbuluar edhe qafën, cepat e saj liheshin të varur, duke mbuluar shpatullat dhe gjoksin. Ky përdorim i mbulesës së kokës bëhej vetëm një herë, ditën kur vajza bëhej nuse. Mbas vitit të parë të martesës përdorej lidhja e mbulesës që përshkruam për rastin e parë.

Kallca — Mbulojnë pulpën, që nga gjuri deri në nyjë të këmbës. Zakonisht punoheshin në formë të një tubi, më të gjera në krye e pak më të ngushta në fund (fig. 9). Punoheshin me fije leshi të dredhur fort me 5 shtiza. Ngjyra e fushës ishte bojë kafe e çelur, ndërsa zbulurimet e motivet punoheshin po me fije leshi ngjyrash të ndryshme. Në krye kishte një «gjalmë» me fije leshi të bëra gërshtet që shërben për ta mbajtur atë të shtrënguar fort pas këmbës.

Kallcat punoheshin vetë nga çdo grua fshatare deri në çerekun e parë të shekullit tonë; mbas kësaj kohe ato filluan të prodhoheshin edhe në zonën e Theologos (Partizani), veçanërisht në fshatrat Leshnicë e Sipërme, Leshnicë e Poshtme dhe Dhivër. Kallcat e prodhua e këtu këmbeheshin me prodhime bujqësore edhe në zonën e Vurgut.

Opingat — Në zonën e Vurgut janë përdorur dy lloj opingash: caruqi dhe poha. Opingat (caruqi) prodhoheshin në qytete, veçanërisht në Delvinë dhe bëheshin prej një lëkure disi të trashë, që në popull njihej me emrin «telatinë». Ato kishin formën e një farke me hundën e ngritur përpjetë, mbi të cilën vihej një tufë fijesh leshi në ngjyrë të kuqe, ose gjysmë për gjysmë të kuqe dhe të zezë (për gratë pak të thyera në moshë).

Opingat (poha) prodhoheshin brenda ekonomisë shtëpiake dhe kishin një përdorim më të gjerë. Ato bëheshin me lëkurë bagëtish të trasha (lopësh, qesh), ose me lëkurë derri të egër të regjur, brenda ekonomisë shtëpiake. Lëkura pritej në formë vezake e i ngriheshin anët, duke kaluar në to rripa lëkure, për të fomuar «folenë e këmbës».

Shaguni — Është një xhokë leshi e gjatë deri pak nën gju, pa mëngë, që vishet mbi dhipllar në stinën e ftohtë të dimrit. Shaguni pritej në mënyrë të tillë që gjatësia e tij të ishte pak më e shkurtër se ajo e dhipllarit, që të linte të dukej pjesa e fundit e tij.

Shajaku, prej të cilit bëhej shaguni, punohej në vegjë me katër lisa, me fije leshi. Copa ishte e dërstilur. Ngjyra ishte e zezë ose blu e thelli.

Shaguni, si shikohet në fig. 10, përbëhej prej këtyre copave: shpina, nënsqetulloret dhe gjoksi. Pra, siç shikohet, ai ka përafërsisht prerjen e dhipllarit.

Shpina ka formën e një katërkëndëshi kënddrejtë me gjatësi 98 cm dhe gjerësi 22 cm. Është i zbukuar me gajtanë në qafë, mbi supe, nën sqetull e në fund, në një gjerësi prej 4 cm.

Nënsqetulloret përbëhen prej tri copash, që kanë afërsisht formën e një trapezi. Nënsqetullorja e parë ka formën e një trapezi me bazën e vogël 9 cm, të madhen 13 cm dhe lartësinë 15,5 cm. Nën të janë ngjitur dy nënsqetulloret e tjera, të cilat kanë formën e një trekëndëshi, por pa kulme, me bazë në drejtim të fundit të shagunit. Është pikërisht kjo prerje e këtyre copave që i jep shagunit në fund formën e një rrithi. Në fund, aty ku bashkohen të dy pjesët, është lënë një e çarë në formë V-je, të kthyer përmbyss.

Gjoksi ka gjithashtu formën e një trapezi, por vetëm deri nën sqetull, ku fillon, nga njëra anë të ngrihet supi e nga ana tjetër lihet e çara e nënsqetullës.

Pjesa e përparme, pjesa fundore, vendet e daljes së krahut dhe qaforia e shagunit, në një gjérësi prej rrith 4 cm janë rrethuar me gajtanë të kuq e vjollcë. Gjithashtu është zbukuar edhe nënsqetulla, që është pjesa më e ngarkuar e shagunit. Këtu përveç shiritave karakteristikë që rrethojnë tejembanë të gjithë shagunin, është krijuar me gajtanë të kuq një figurë në formë vezake.

Aksesorët — Aksesorët e veshjes ishin të përbashkët në veshjen të qafës, të vendosura në dy-tri radhë rrith saj, *grepit*, që ishte një varëse që varej në të dy anët e gjoksit e arrinte deri afër mesit e që përbëhej prej dy palë zinxhirësh, në të cilët ishin kaluar monedha të ndryshme metalike dhe paftës së brezit që përbëhej nga dy copa metalike në formën e kërmillit, në mes të të cilave ishin vendosur gurë të shkëlqyeshëm në ngjyrë të kuqe ose të gjelbër. Të gjithë këta aksesorë bliheshin në treg.

Frizura — Gruaja e veshur me cibun i kushtonte rëndësi në mënyrë të veçantë mënyrës së rregullimit të flokëve. Kur kishte shaminë, ajo linte të vareshin mbi ballë një tufë të vogël flokësh, «xullufet». Mbi ballë flokët ndaheshin përgjysmë, duke formuar një vijë në mes të kokës, ndërsa mbrapa ato formonin dy gërshteta, të cilët vazhdonin deri në dy të tretat e gjatësisë së flokëve, pastaj vareshin lirshëm mbrapa. Bukuria e flokëve qëndronte në trashësinë e gërshtave dhe gjatësinë e tyre. Për këtë arsy, ato që nuk kishin flokë të mirë, vinin gërshtata të prerë nga një grua tjetër (gërshtata të rreme).

b. Veshja me cibun

Këtë veshje e kemi emëruar kështu, mbasi cibuni është pjesa më kryesore e saj, pjesa, së cilës i është kushtuar kujdes e vëmendje e veçantë, qoftë në prerje e qepje, qoftë në zbukurimin e pjesëve të dukshmë të tij.

Veshja me cibun na paraqitet në dy forma: në atë të kostumit të katër fshatra të zonës së Vurgut që shtriheshin në krahun e djathtë të rrjedhjes së lumit Bistrice (Finiq, Mavropull, Karahaxh dhe Vromero), ndërsa para kësaj periudhe ajo është përdorur edhe në fshatin Kranë, i cili më vonë, për arsy nga më të ndryshmet, braktisi këtë veshje dhe iu përshtat gradualisht një veshjeje të re, veshjes me allaxha.

Veshja me cibun, ndonëse pak e rëndë, është e bukur dhe e trigon mbajtësen e saj elegante. Cibuni dhe shaguni në ngjyrë të zezë, të qëndisur me fije ari në pjesët e dukshme, që të bien më shumë në sy, këmisha e bardhë me ato mëngë të gjera që varen lirshëm po-thuaj deri në mes të parakrahut dhe palat e shumta që zbresin hijshëm deri pak nën gju, përparja në përmasa të vogla, në ngjyrë manushaqe, çorapet e bardha, të pëershkuara nga vija të punuara me fije të gjelbra, blu, të verdha e të zeza, së bashku me shaminë e kokës të qëndisur përpara dhe anash me fije ari, krijojnë ato kontraste që e hijeshojnë kostumin dhe nxjerrin në pah jo vetëm fytyrën, por edhe gjithë trupin (fig. 11).

Në fillim të shek. tonë pjesët kryesore të veshjes me cibun kishin dalë nga kuadri i përgatitjes brenda ekonomisë shtëpiake. Ato, në pjesën më të madhe të tyre, përgatiteshin nga rrobaqepës shëtitës, të cilët shkonin e punonin në shtëpinë e vajzës për aq kohë, sa të qepnin kostumet e pajës që merrte nusja me vete (kostumin e nusërisë dhe një kostum të dytë). Është e vërtetë se këta rrobaqepës kanë punuar sipas traditës e shijes artistike të porositësit, por njëkohësisht ata nuk mund të punonin krejtësisht në mënyrë mekanike, pa derdhur në pjesët e veshjeve që qepnin, së bashku me djersën, edhe dëshirat e ndjenjat e tyre.

Veshja me cibun na paraqitet në dy forma: në atë të kostumit të parë, ceremonial, dhe në atë të kostumit të dytë. Të dy kostumet kishin pjesë të njëjta e prerje të njëjtë, veçse ndryshonin nga cilësia e materialit të përdorur dhe sasia dhe cilësia e zbukurimeve të bëra mbi to. Këtu duhet të theksojmë se të dy kostumet përdoreshin në mbi to. Këtu duhet të theksojmë se të dy kostumet përdoreshin në raste festive dhe asnjëherë për punë, veçse përdorimi i tyre varej

nga mosha e gruas që e mbante dhe rëndësiq e rastit festiv. Kështu në vitet e para të martesës, kur gruaja e re nuk kishte lindur më shumë se dy fëmijë, për vizita, për festat më të rëndësishme publike e shoqërore, përdorte më dendur kostumin e parë, ndërsa në periudhën e mëvonshme, kur ajo kishte lindur dy a më shumë fëmijë, kur ajo ishte «plakur», mbahej më shumë kostumi i dytë, ndërsa kostumi i parë palosej e futej në «sënduk» për ta përdorur e bija në vitet e para të martesës. Në këtë mënyrë i njëjtë kostum përdorej për raste festive nga nëna tek e bija, nganjëherë edhe për tre-katër breza rresht. Kjo gjë, së bashku me numrin e paktë të kostumeve që nusja merrte në pajë kur martohej, tregojnë varférinë e fshatarësisë së zonës dhe koston e lartë të një kostumi të tillë ceremonial, i cili i kushtonte familjes fshatare shumë, aq sa nganjëherë ajo detyrohej të shiste kaun e vetëm apo bagëtitë e bulmetit për ta bërë atë.

Në parashtrimin e materialit që do të bëjmë më poshtë për këtë lloj veshjeje, ne do të pëershkrumë vetëm veshjen e parë, atë ceremoniale, pa u ndaluar te veshja e dytë, e cila është e njëjtë në prerje me të parën. Këtu do të theksojmë se copa prej së cilës bëhej kostumi i parë ishte e një cilësie më të mirë dhe zbukurimet e bëra në të ishin me fije apo kordona të thurur me fije ari, ndërsa copa prej së cilës bëhej kostumi i dytë ishte e një cilësie më të dobët dhe zbukurimet e tij bëheshin me fije mëndafshi të verdhë.

Në përdorimin e këtyre veshjeve kishte edhe tri veçori karakteristike.

Veshja e parë përdorte detyrimisht çorape, ndërsa veshja e dytë përdorte kallca. Ka pasur raste që me veshjen e dytë të janë përdorur çorape, por në asnjë rast nuk janë përdorur kallca me veshjen e parë.

Në të dyja veshjet shamia ishte e zezë, por ndërsa mbulesa e kokës e përdorur në kostumin e parë pritej në formën e një trekëndëshi dybrinjënjëshëm dhe qëndisej me fije ari në të gjitha anët e saj, shamia e përdorur në kostumin e dytë kishte formën e një katërkëndëshi dhe nuk kishte asnjë zbukurim. Edhe në mënyrën e lidhjes së mbulesës së kokës kishte ndryshim. Ndërsa shamia e përdorur në kostumin e parë kalonte pak mbi ballë e lidhej nën zverk, duke u varur cepi i saj mbi shpatulla, mbulesa e kokës e përdorur në kostumin e dytë palosej mbi kokë, pra ajo lidhej njësoj si mbulesa e kokës në veshjen me dhipllar.

Së fundi, veshja ceremonialë si aksesorë të domosdoshëm të saj kishte varëset e qafës dhe zbukurimet e gjoksit, ndërsa veshja me kostum të dytë ishte zhveshur plotësisht nga këta aksesorë.

Duke pasur parasysh këto ndryshime jothelbësore që theksuan për këto dy veshje, kur të pëershkrumë veshjen ceremonialë, mund të krijojmë një përfytyrim të saktë edhe për veshjen e dytë. Pëershkrimin e pjesëve të veçanta të kostumit ceremonial ne do ta bëjmë jo sipas rëndësisë dhe peshës që kanë këto pjesë në tërësinë e kostumit, por sipas radhës që visheshin.

Këmisha — Ishte e njëllojtë me këmishën e përdorur në veshjen me dhipllar (fig. 12).

Çorapet — Në fund të shek. të kaluar punoheshin me lesh të bardhë të dredhur hollë, rënduar me vija zigzage, ngjyrash të ndryshme. Në këtë periudhë çorapet punoheshin nga çdo grua brenda

ekonomisë shtëpiake, duke përdorur pesë shtiza. Duke filluar nga dhjetëvjeçari i parë i shekullit tonë e deri në fund të Luftës së Parë Botërore, ato, shkallë-shkallë, filluan të dalin nga kuadri i punës brenda ekonomisë shtëpiake dhe për punimin e tyre të specializohen gra në zona të tjera, jashtë Vurgut. Kështu në këtë periudhë këto çorape punoheshin në masë në fshatin Dhrovjan të zonës së Muzinës dhe më pak në fshatrat Lefterhor dhe Kakodhiq. Karakteristikështë fakti se këto çorape në këtë fshatra punoheshin jo për përdorim vetjak, por për t'i trajtuar në fshatrat e zonës së Vurgut, ku shkëmbeshin me produkte bujqësore, veçanërisht me misër dhe oriz. Është kjo arsyja që këto çorape kudo në zonën e Vurgut njihen me emrin çorape dhrovjanite.

Çorapet dhrovjanite punoheshin me fije të bardhë pambuku të dredhur me dorë. Fija e bardhë e pambukut përbën gjithë fushën e çorapes, por në të, në intervale të caktuara e në mënyrë simetrike, kalonin via zigzage, të punuara me fije leshi në ngjyrë blu, të gjelbër, të zezë e më rrallë edhe me fije ari. Pjesa e çorapes që fillon nga nyja e këmbës e deri në pulpë ishte e zbukuruar më rëndë se pjesa që fillon nga pulpa deri nën gjurin e këmbës (fig. 13).

Gjoksurja — Është një copë mëndafshi, zakonisht në ngjyrë të verdhë, e prerë në formën e një katërkëndëshi kënddrejtë, me madhësi 20×10 cm, e mbledhur në pjesën e sipërme me rrudha, që i japin asaj formën e një trapezi, më të ngushtë në qafë e më të gjerë në fund. Në të dy skajet e gjoksorës zgjaten dy rripa, të cilët shërbejnë përtak lidhur në qafë. Pjesa e përparme e shiritit që është vënë përtë formuar rrudhat është e qëndisur me fije mëndafshi, ku mbisundon ngjyra e gjelbër.

Gjoksorja shërben përtë mbuluar pjesën e sipërme të kraharorit që mbetet e zbuluar nga e çara në formë T-je që kishte këmisha. (fig. 14).

Cibuni — Është pjesa më kryesore që i ka dhënë emrin tërë veshjes. Ai mbulonte pjesën e sipërme të trupit pothuaj deri pak mbi gjunjë dhe pjesën e krahut, deri pak përmbi bërryl.

Cibuni punohej me shajak të zi, të bërë me vegje e të dërstitialur. Ngjyra e shajakut detyrimisht ishte e zezë ose blu e thellë.

Cibuni pritej siç tregohet në fig. 15, d.m.th. ai përbëhet prej shpinës, pjesëve anësore, gjoksit dhe mëngëve.

Shpina pritej në formën e një katërkëndëshi kënddrejtë, me përmasat e përdorueses, por ai që po pëershkrumjë ka një gjatësi prej 85 cm dhe gjatësi prej 27.5 cm.

Pjesa anësore e cibunit është ajo që paraqit më shumë interes dhe që e bën atë të dallueshmë në prerje nga dhipllari. Ajo përbëhet prej nënsqetulloreve dhe pjesës së poshtme. Nënsqetullorja është formuar si rezultat i bashkimit të katër copave në formë e madhësi të ndryshme, ndërsa pjesa e poshtme përbëhet prej një cope të vetme, në formën e një trapezi, me bazën e madhe 30 cm, bazën e vogël 10 cm dhe lartësinë 30 cm.

Gjoksi pritej siç tregohet në fig. 15. Për zbukurimin e tij tregohet vëmendje e kujdes i veçantë. Pjesa e përparme e tij, që fillon nga qafa e deri pak nën gjoks, është më e zbukuruara e që tërheq vëmendjen përmotivet e bëra në të dhe kombinimin harmonik të figurave dhe ngjyrave të përdorura. Në këtë pjesë janë aplikuar me qëndisje në disa radhë, motive gjometrike e floreale, të punuara me

fije mëndafshi ngjyrë manushaqe dhe fije ari. Kombinimi i goditur i ngjyrës manushaqe me refleksin në të verdhë të fijeve të arit, të qëndisura në sfondin e zi të zhgunit, i japid kësaj pjese një bukurë të rrallë që dashur padashur të térheq vështrimin.

Mënga pritej si në fig. 16, në mënyrë të tillë që pjesa e poshtme e saj të vinte pothua puthitur mbas llërës së dorës, që të shtrëngonte pjesën e sipërme të mëngës së këmishës, për të lënë pjesën e poshtme të saj të varej lirshëm, në formën e një kambane.

Mbas gjoksit, mënga është pjesa më e zbukuruar e kësaj veshjeje. Në pjesën e fundit të saj, rreth e rrotull, në një gjerësi prej afro 8 cm, janë qepur kordonë të bërë prej fijesh mëndafshi në ngjyrë manushaqe e fije ari, ndërsa në pjesën e mbrapme të saj është qëndisur edhe një motiv floreal.

Përparja — Përparja është një element tjetër i veshjes me cibun që është i njëllotë edhe në veshjen me dhipillar, veçse ajo ka dy karakteristika jo të qenësishme, që e bëjnë atë të dallueshme nga simotra e saj në veshjen me dhipillar.

Së pari, përparja në veshjen me cibun dallohet nga përparja e veshjes me dhipillar nga ngjyrat e përdorura. Ndërsa në përparjen e veshjes me dhipillar është e pëlqyer ngjyra blu, që është edhe ngjyra bazë e fushës, në përparjen e veshjes me cibun është e pëlqyer ngjyra manushaqe.

Së dyti, në përparjen e veshjes me cibun, në pjesën e fundit të saj, ka qëndisje motivesh floreale me kordonë të bërë me fije ari. Ndërsa në përparjen e veshjes me dhipillar një gjë e tillë nuk vihet re.

Brezi i gjerë e brezi i ngushtë — Janë dy elemente të përbashkëta për të dy veshjet, për veshjen me cibun e për veshjen me dhipillar.

Shaguni — Është pjesë e pandarë e veshjes me cibun dhe këtu është një nga ndryshimet me shagunin e përdorur në veshjen me dhipillar, që është copë suplementare dhe vishet vetëm në stinën e ftohtë të dimrit. Ai është pa mëngë e vishet mbi cibun në çdo kohë që përdoret veshja, në dimër e në verë. Sikurse e tregon edhe vetë emri, ai punohej me zhgun të dërstilur. Ngjyra e tij është e zezë.

Prerja e tij ishte siç tregohet në fig. 17, d.m.th. ai kishte po ato pjesë e po atë prerje që kishte cibuni. Këtu është një ndryshim tjetër me shagunin e përdorur në veshjen me dhipillar, i cili ndiqte po ato linja në prerje që kishte dhipillari.

Në pjesën e fundit të shpinës, përpara e nën sqetull, shagunit i janë aplikuar motive floreale të bëra me kordonë fijesh mëndafshi në ngjyrë manushaqe dhe fije ari. Shaguni i përdorur në veshjen me dhipillar, me përjashtim të nënsqetullës, zbukurime të tilla nuk ka.

Pra, ndonëse shaguni është përdorur në të tre variantet e veshjeve të zonës së Vurgut, bile duke pasur edhe të njëjtin emër, ai ndryshon nga njëra veshje te tjetra jo vetëm nga mënyra e prerjes, por edhe prej faktit nëse ai është pjesë e pandarë e veshjes, apo shtesë mbi të në stinën e dimrit.

Mbulesa e kokës — Kishte në prerje formën e një trekëndëshi dybrinjënjëshëm. *Copa* e mbulesës së kokës ishte mëndafsh i zi dhe zbukurohej me qëndisje me fije ari në të gjitha anët e saj. Mbulesa e kokës lidhej në këtë mënyrë: baza e mbulesës vendosej pak përmbi

ballë dhe të dy kulmet e saj lidheshin nën zverk, duke lënë të varej përmbrapa njëri cep i mbulesës.

Opingat — Këto punoheshin nga zejtarët profesionistë në qytete e prandaj për të tri variantet e kostumeve janë të përbashkëta.

d. Veshja me allaxha

Me emrin veshja me allaxha njihet në popull, në të gjithë fshatrat e zemrës së Vurgut, kostumi ceremonial (fig. 18). Si shikohet, në këtë rast është përdorur emri i materialit prej të cilil bëhej pjesa kryesore e veshjes për t'i dhënë emrin tërë veshjes dhe jo si në rastet e tjera kur e gjithë veshja ka marrë emrin e një pjese, zakonisht të asaj më kryesoresh, si ka ndodhur p.sh. në veshjen me dhipllar apo atë me cibun.

Veshja me allaxha në të kaluarën shtrihej e përdorej si kostum ceremonial në pjesën më të madhe të fshatrave të Vurgut, me përjashtim të fshatrave Finiq, Karakaxh, Vromero, Mavropull e Kranë. Siç kemi theksuar edhe më parë, si rezultat i marrëdhënieve martesore të fshatit të fundit me fshatrat e zemrës së Vurgut, veshja me cibun dalngadalë ai la vendin veshjes me allaxha, aq sa në mes të viteve 30 të shek. tonë kjo veshje u bë jo vetëm sunduese, por edhe e vetme.

Veshja me allaxha në tërësinë e saj është një veshje e lehtë dhe elegante. Mbulesa e bardhë e kokës, e lidhur në atë mënyrë karakteristike, me cepat që varen lirshëm mbi shpatulla, allaxhaja në ngjyrë hiri, me via të holla në ngjyrë të bardhë ose të verdhë, me pala të shumta në pjesën e poshtme të saj, përparja dhe jeleku punuar me kadife të zezë dhe pjesët e tjera të dukshme të kostumit, si këmisha, brezi i gjerë, brezi i ngushtë dhe çorapet, krijojnë një harmoni të pëlqyeshme ngjyrash dhe evidentojnë mbajtësen e kësaj veshjeje. Karakteristikë e kësaj veshjeje është se në të përdoret pak e në masë ngjyra e zezë ose blu e thellë, që është mbizotëruese për kostumin e dytë të kësaj zone që do të përshkruajmë më poshtë, apo për veshjen me cibun.

Nga të tri variantet e veshjes së gruas që parashtruam më sipër, veshja me allaxha është më e përparuara. Ajo, në pjesët kryesore të saj, ka dalë nga kuadri i përgatitjes brenda ekonomisë shtëpiake. Materiali për përgatitjen e pjesëve kryesore të saj blihej i gatshëm në treg dhe vetëm një pjesë fare e vogël e tyre ndiqte traditën, duke u prodhuar nga çdo grua për nevojat e saj. Kjo flet për marrëdhëni e ngushta të këtyre fshatrave me tregun në gjysmën e parë të shekullit tonë.

Veshja me allaxha përbëhej prej pjesëve të mëposhtme:

Këmisha — Zakonisht punohej me pëlhurë liri të endur në avlëmend, por pas Luftës së Parë Botërore punohej edhe ma kambrik importi. Por, pavarësisht nga materiali, ajo në të gjitha rastet pritej ashtu si tregohet në fig. 19. Shpina dhe gjoksi përbëheshin prej një cope të vetme, me gjatësi afro 65 cm dhe gjerësi 50 cm e cila palosej në dysh së gjati për të formuar gjoksin dhe shpinën. Në pjesën e përparme hapej një e çarë në formë T-je që shkon afersisht deri pak përmbi

bël, për të futur kokën gjatë veshjes. Kjo është edhe pjesa e vetme e zbukuruar e këmishës.

Pjesa e fundit e këmishës është prerë dhe qepur në mënyrë të tillë, që ajo të krijojë shumë pala, por vetëm në pjesët anësore dhe mbrapa, duke lënë pjesën e përparme të drejtë, pa pala (fig. 19). Pikërisht këtu ndryshon prerja e këmishës së veshjes me allaxha nga këmisha e përdorur në veshjen me cibun që kemi shqyrtuar më lart.

Këmisha ka gjysmë mëngë, të gjata deri afër bërryilit të dorës e të gjera, pa asnjë zbukurim.

Grykësja dhe çorapet ishin të njëjtë me atë të përdorur në veshjen me cibun.

Allaxhaja — Është pjesa kryesore e më e rëndësishme e kostumit, që i ka dhënë emrin gjithë veshjes. Ajo punohej me material importi dhe pritej e qepej nga rrobaqepës të specializuar për këto kostume. Zakonisht rrobaqepësit ishin shëtitës kështu që ata qepnin sipas porosisë në banesat e fshatarit porositës, ku qëndronin për aq kohë, sa mbaronin plotësisht qepjen e pajës së nuses. Por duhet të theksojmë se pas Luftës së Parë Botërore, në disa fshatra të Vurgut u hapën lokale rrobaqepësie dhe në këtë mënyrë rrobaqepësi nuk shkonte më në banesën e fshatarit, por porositësi shkonte në dyqanin e rrobaqepësit.

Sic shihet edhe në fig. 20, allaxhaja përbëhet prej dy pjesësh, të bashkuara midis tyre me qepje, prej pjesës së sipërme dhe fundit.

Pjesa e sipërme është prerë në formën e një jeku, por me mëngë të gjata. Në pjesën e përparme është lënë një e çarë në formë T-je që shkon deri afér mesit dhe qëndron e hapur. Mëngët janë të gjata deri te kyçi i dorës dhe përfundojnë zakonisht me një «kapak» të bërë me kadife të zezë. Pjesa e përparme dhe kapakët e mëngëve janë të vetmet pjesë të allaxhasë që janë zbukuruar jo rëndë, vetëm me fije pambuku ose mëndafshi të ngjyrosur.

Pjesa e poshtme ka po atë prerje që ka këmisha e kësaj veshjeje, d.m.th. anash e mbrapa ka pala të shumta, ndërsa pjesa e përparme, pikërisht ajo pjesë mbi të cilën vendoset përparja, është e prerë drejt e pa pala. Allaxhaja shkonte e gjatë deri pak nën gjurin e këmbës.

Brezi i gjërë, brezi i ngushtë e përparja janë të njëjta si në veshjet e tjera të kësaj zone.

Jeleku — Ishte pjesa e sipërme e kësaj veshjeje dhe mbulonte allaxhanë nga mesi e lart, me përjashtim të mëngëve. Jeleku pritej si në fig. 21, d.m.th. përbëhej prej gjoksit dhe shpinës.

Pjesa e gjoksit punohej zakonisht me kadife të zezë ose blu të thellë, mbi të cilën qepeshin me makinë ose me dorë shirita me fije ngjyrash të ndryshme, në vija të drejta ose zigzage nga lart-poshtë.

Pjesa e prapme e jekut bëhej me po atë copë që bëhej vetë allaxhaja dhe nuk kishte asnjë zbukurim.

Jeleku kur vishej mbërthehej vetëm në pjesën e fundit të tij.

Mbulesa e kokës — Kishte zakonisht formën e një katrori me brinjë afro 1 m. Ashtu sic e kemi gjetur në përdorim, kjo pjesë e veshjes është prodhim industrial e blihej e gatshme në treg, por të moshuarit na kanë treguar se kjo lloj mbulesa ka hyrë në përdorim mbas vitit 1930. Më parë mbulesa e kokës përgatitej në vegjë me fije të holla liri dhe ishte shumë më e gjatë sesa e gjerë. Por, pava-

rësishët nga materiali, ajo është lidhur në kokë, në të dy rastet, në të njëjtën mënyrë. Mbulesa, mbasi palosej më dysh, hidhej në kokë, duke vendosur cepin e palosur të shamisë mbi ballë e pastaj të dy cepat që varen në drejtim të témthave ngrihen e palosen mbi njëra tjetrën mbi kokë, duke lënë të varet cepi tjetër me thekë mbi shpatulla. Shamia e kokës fiksohej me karfica llojesh të ndryshme për të mos rënë.

Aksesorët — Gratë mbanin vëthë, unaza e varnin në qafë rruaza të ndryshme, në një ose në disa vargje, e zbukuruese gjoksi.

c. Veshja me cibun (Varianti II)

Në çerekun e parë të shek. tonë kjo veshje përdorej në pjesën më të madhe të fshatrave të zonës së Vurgut (Vrion, Çukë, Metoq, Çauš, Aliko, Neohor, Tremul, Palë, Hajderaga, Rahullë, Ymerefend etj.), pra ajo kishte një përhapje shumë më të gjerë se dy veshjet e tjera të përdorura në këtë zonë (veshja me dhipllar dhe veshja me cibun). Veçse duhet të sqarojmë që në fillim se, kur flasim për veshjen e fshatrave të mësipërme, kemi parasysh dy variantet e veshjeve të përdorura: veshjen me cibun (kostumi i dytë) dhe veshjen me allaxha (kostumi i parë), të cilat ndryshojnë midis tyre jo vetëm nga rasti i përdorimit, por edhe në prerje e material. Ndryshimet midis këtyre veshjeve janë të thella, saqë i bëjnë ato dy variante të veçanta, pa lidhje midis tyre, në pjesët kryesore e të dukshme, ndonëse ato pëndoreshin përkrah njëra-tjetrës dhe ruheshin në të njëjtin sënduk. Duke studiuar këto dy variante veshjesh, mendojmë se veshja me cibun ka qenë në një të kaluar më të largët, ndoshta veshja bazë dhe më e vjetër, ndërsa veshja me allaxha është veshja më e re, ndikim i zonave të tjera përreth. Në këtë përfundim na shtyn jo vetëm materiali bazë i përdorur për këto veshje (veshja me cibun është punuar me shajak, ndërsa veshja me allaxha punohej me copë pambuku importi, me vija), por edhe materiali gojor i mbledhur në bazë. Mjaft gra të moshuara, kur i pyetëm për këto veshje na thanë: «Gjyshet dhe nënët tona visheshin me cibun dhe vetëm në kohën tonë (fillimi i shek. XX - S. Shkurti) u përdor veshja me allaxha, me të cilën më parë visheshin gratë e Sopikut, fshat në kufirin jugor të zonës së Vurgut, veçse ne e ndryshuam pak atë. Edhe sot veshjes me allaxha i themi «sopiqotiko» (sipas modelit të Sopikut).» Pra depërtimi i marrëdhënieve kapitaliste, që çoi në lidhjet më të ngushta me tregun, solli në këto fshatra jo vetëm një kostum të huazuar, sigurisht duke iu përshtatur kërkeseve estetike të fshatarësise së kësaj zone, por edhe një spostim të kostumit me cibun, nga kostumi i parë ceremonial, në një kostum të dorës së dytë. Ky ndërrim vendi bëri që për veshjen me cibun të mos tregohej më kujdes e vëmendje si më parë. Është kjo arsyje që edhe vlerat estetike të këtij kostumi janë të pakta.

Këto dy variante veshjesh, duke qenë përdorur nga e njëjta popullsi, bile edhe po nga i njëjti person, përvëç ndryshimeve që janë të rëndësishme, të dorës së parë, kanë edhe pjesë të përbashkëta që janë jokryesore, të dorës së dytë. Kështu përparja, brezi i gjerë e brezi i ngushtë në të dy variantet janë të njëjta. Gjithashtu mbulesa

e kokës, ndonëse në kostumin me cibun është e zezë dhe në atë me allaxha është e bardhë, ka të njëjtën formë e madhësi dhe lidhet në të njëjtën mënyrë. Kjo flet për ndikimet reciproke e marrëdhëniet e ngushta të popullsisë së kësaj zone me njëra-tjetrën.

Veshja me cibun është veshje në të cilën pjesët më kryesore e më të rëndësishme janë punuar me lesh. Prej leshi janë punuar fanella, cibuni, shaguni, brezi i gjerë, brezi i ngushtë, kallcat dhe në një kohë më të hershme edhe përparja (fig. 22). Ky përdorim masiv i lesit në përgatitjen e veshjes flet për faktin se kjo popullsi, ndonëse ndryshoi kushtet e jetës dhe tanë merrej kryesisht me bujqësi, ruajti të fortë traditën e të parëve të saj blegtorë.

Duke qenë se të dy kostumet përbëjnë variante më vete me karakteristika kryesore dalluese, po përshkruajmë veçmas veshjen me cibun.

Veshja me cibun përbëhej prej pjesëve të mëposhtme:

Fanella — Ishte e ngjashme me fanellën e përshkruar në veshjen me dhipllar.

Këmisha — Këtë pjesë veshjeje, me gjithë kërkimet tona, ne nuk e gjetëm, mbasi ajo prej kohësh ka dalë nga përdorimi. Për këtë arsyе do ta përshkruajmë vetëm sipas kujtimeve të të moshuarave.

Deri në dhjetëvjetorin e parë të shek. tonë këmisha bëhej me copë të endur me fije liri në vegjë dhe vetëm në vitet pas Luftës së Parë Botërore filloi të përdorej kambrik importi. Shpina dhe gjoksi përbëheshin prej një cope, në pjesën e përparme të së cilës lihej një e çarë në formë T-je, që shkonte afërsisht deri në mes. Pjesa e poshtme i ngjante një fundi me pak rrudha dhe ishte e gjatë deri pak nën gjurin e këmbës. Këmisha kishte mëngë të ngushta e pak më të shkurtra se mëngët e cibunit. Ajo nuk kishte asnjë pjesë që të dilte jashtë kostumit e për këtë arsyë nuk zbukurohej.

Cibuni — Është pjesa më kryesore që i ka dhënë emrin edhe të gjithë veshjes. Ndonëse kjo pjesë e veshjes mban të njëtin emër me atë të përdorur në fshatrat Finiq, Karahaxh, Vromero e Mavropull, ato janë të ndryshme dhe, përveç emrit, nuk kanë gjëra të përbashkëta.

Cibuni vishej direkt mbi këmishë dhe, pak përmbi mes, ana e djathtë palosej mbi të majtën, pa u mbërthyer. Ai ishte i gjatë po-thuaj deri në pulpë të këmbës.

Cibuni punohej me shajak të dër stilur, në ngjyrë të zezë. Ai pri-tej si në fig. 23, d.m.th. përbëhej prej shpinës, gjoksit, mëngëve, nënsqetullores dhe fundit.

Gryksja, kallcat, brezi i gjërë, brezi i ngushtë janë të njëllojta si ato të veshjes me cibun, të përdorur në fshatrat Finiq, Karahaxh, Mavropull e Kranë.

Përparja — Në prerje ka formën e një drejtkëndëshi, por meqë në pjesën e sipërme është qepur me rrudha, ajo ka marrë formën e një trapezi, më e ngushtë në krye dhe më e gjerë në fund. Në 1/5 e gjatësisë së saj, nga fundi, i është ngjitur një shirit i qëndisur më parë, ose i blerë gati në treg, në një apo dy radhë.

Përparja, në variantin që e kemi gjetur, është e punuar me kadife të zezë, por ky është një novacion i viteve 30 të shekullit tonë, mbasi

më përpara është përdorur përparje leshi, e afërt me përparjen e përdorur në veshjen me dhipllar. Dhe kjo është bindëse, sepse një përparje e punuar me material të tillë nuk pajtohet me tërësinë e kostumit që është i punuar i gjithë me lesh e brenda ekonomisë shtëpiake. Në këtë veshtrim kjo përparje është e vetmja pjesë e rëndësishme e kostumit që blihej në treg.

Mbulesa e kokës — Kishte formën e një katrori me gjatësi afro 1 m. Ajo punohej zakonisht me vegjë, duke përdorur fije pambuku të dredhura hollë, ose blihej edhe e gatshme në treg. Ngjyra e saj ishte e zezë. Në njérën anë, në atë të prapmen, i viheshin thekë. Lihet njëlloj me mbulesën e kokës të përdorur në veshjen me dhipllar.

Shaguni — Ishte pjesë veshjeje plotësuese për stinën e ftohtë të dimrit dhe në prerje ishte shumë i afërt me atë të përdorur në veshjen me dhipllar.

II. VESHJE BURRASH

Edhe në zonën e Vurgut, ashtu si edhe në zonat e tjera të Shqipërisë së Jugut, veshjet e burrave janë në numër më të kufizuara dhe nuk paraqesin atë larmi e pasuri që vëmë re në veshjet e grave. Këtu duhet të theksojmë se këto veshje, duke filluar që nga mesi i shek XIX, ndoshta edhe më parë, e deri në çerekun e parë të shek. tonë, paraqiteshin të njëjta, sigurisht duke ruajtur vetëm disa variacione lokale në zbukurime e ngjyrën e copës prej së cilës bëheshin për një zonë shumë të gjerë të Shqipërisë së Jugut, bile duke përfshirë edhe tokat e të gjithë Çamërisë, jashtë kufijve politikë. Kjo veshje e njëjtë në një zonë kaq të gjerë flet për atë fakt që prej kohësh kjo veshje ishte unifikuar për arsyen nga më të ndryshmet, e në radhë të parë nga krijimi i një tregu të përbashkët me karakteristika të njëjta për të gjithë këtë zonë të gjerë. Gjithashtu ky unifikim flet për atë unitet kulturor të krijuar në këtë zonë, karakteristik jo vetëm në veshje, por edhe në fushat e tjera të kulturës materiale.

Në veshjet e burrave, në ndryshim nga ato të grave, karakteristik është emërtimi i tyre, duke u nisur nga ajo pjesë e veshjes që mbulon trupin nga mesi e poshtë, ndërsa emërtimi në veshjet e grave është bërë gjithnjë duke marrë për bazë pjesën e sipërme të veshjes. Kështu, duke u nisur nga karakteristika e mësipërme, veshjet e burrave emërohen: veshja me fustanellë, veshja me poture dhe veshja me kilota,

Në fund të shekullit të kaluar e në vitet e para të shek. tonë pëndoreshin përkrah njëra-tjetrës veshja me fustanellë dhe veshja me poture. Në përdorimin e tyre si veshje ceremoniale vëmë re një vëçori jo të parëndësishme. Ndërsa veshja me fustanellë është në tërheqje, në rënie, derisa në prag të viteve të Pavarësisë, ose diçka më vonë, ajo del krejtësisht nga përdorimi, veshja me poture është në rritje, aq sa ajo mbas fitores së Pavarësisë Kombëtare deri në fillim të viteve 20 të shek. tonë, bëhet jo vetëm veshja e vetme ceremoniale, por edhe veshje dominuese për punë. Vetëm pas Luftës së Parë Botërorre filloi të përdorej për punë, krahas veshjes me poture edhe veshja me kilota, e cila pas hyrjes në përdorim, u përdor gjithnjë e më

tepër edhe si veshje festive deri në prag të Çlirimtë vendit, bile edhe në vitet e para të periudhës të pasçlirimt.

Këtu duhet të vëmë në dukje që, ndonëse këto veshje janë të ndryshme midis tyre e qëndrojnë më vete, ato nuk janë të shkëputura nga njëra-tjetra. Në këto variante veshjesh ndryshon vetëm pjesa e sipërme dhe vetëm në elementet kryesore, ndërsa pjesët e veshjes së brendshme dhe elementet e tjera të dorës së dytë mbeten të njëjtë, veçanërisht në veshjen me fustanellë e me poture. Kështu fanella, këmisha, brezi, mbulesa e kokës, tizgat, çorapet dhe opingat mbeten të njëjtë për të dy llojet e veshjeve të përmendura më sipër. Këto afri janë më të vogla në veshjen me kilota dhe kjo është e kuptueshme, sepse kjo veshje, duke qenë e importuar, erdhi në një shkallë të lartë zhvillimi, duke mos ndjekur në vendin tonë shkallët e nevojshme të evoluimit.

Veshja me fustanellë

Veshja me fustanellë ka qenë veshja më e vjetër për burra që mbahet mend. Ajo, me sa kujtohet, është përdorur gjithnjë si veshje festive, në ditë të shënuara të vitit, në festa me karakter kolektiv e familjar, në rastet kur burrat e shtëpisë zbrisnin në qytet për ditë pa zari, ose kur shkonin në institucionë zyrtare. Në fund të shekullit të kaluar e në fillim të shekullit tonë ajo përdorej shpesh edhe brenda fshatit, veçanërisht pasditeve, kur burrat grumbullohen në sheshin e fshatit për biseda. Mbajtja e veshjes me fustanellë vlerësohej si shenjë burrerie dhe pasurie.

Në veshjen me fustanellë mbizotéronte ngjyra e bardhë. E bardhë ishte fanella, këmisha, fustanella dhe kofsharët. Në këtë veshje ndryshonte në ngjyrë vetëm mëngorja, që ishte në ngjyrë blu të thellë dhe festja që, në fund të shekullit XIX e në fillim të shekullit tonë, ishte e kuqe dhe më vonë e zezë. Mbizotërimi i ngjyrës së bardhë dhe thyerja e saj me ngjyrën blu të thellë të mëngores dhe ngjyrën e kuqe ose të zezë të festes i jep veshjes bukur e freski e nxjerr më në pah pastërtinë e saj (fig. 24).

Veshja me fustanellë përbëhej prej pjesëve të mëposhtme, të cilat po i përshkruajmë shkurtimisht sipas radhës që visheshin.

Fanella — Punohej me fije leshi në ngjyrë të bardhë, të tjerrë hollë. Ajo bëhej nga çdo grua sipas nevojave, duke përdorur pesë shtiza të gjata. Përbëhej prej tri copash kryesore: shpinës, gjoksit e mëngëve, të cilat punoheshin veças, mandej bashkoheshin me qepje. Fanella, me përjashtim të pjesës së poshtme të mëngëve, nuk kishte asnje zbukurim. Në këtë pjesë, në afërsi të kycit të dorës, janë kaluar me gjilpërë via zigzage me fije leshi në ngjyrë kafe, por edhe të zezë.

Duhet të vëmë në dukje se në raste më të rralla, veçanërisht në shtresat më të varfra të popullsisë, trupi i fanellës bëhej prej pël-hure liri të endur në avlëmend, ndërsa mëngët prej leshi.

Këmisha — Ishte një nga pjesët më kryesore e të dukshme të veshjes së burrit me fustanellë e për këtë arsyë asaj i është kushtuar kujdes i veçantë. Në fund të shekullit të kaluar e në fillim të shekullit tonë ajo punohej me pëlhirë liri të endur në avlëmend, brenda eko-

nomisë shtëpiake. Në vitet që pasuan pas shpalljes së Pavarësisë Kombëtare e në mënyrë të veçantë pas Luftës së Parë Botërore pëlhura e lirit gradualisht filloi të zëvendësohej me pëlburë importi. Duke qenë pjesë e rëndësishme e veshjes, ajo pritej e qepej nga zejtaret rrrobaqepës në qytetin e Delvinës e më rrallë edhe nga ata të fshatrave.

Këmisha ashtu siç paraqitet në fig. 25, përbëhet prej dy pjesësh: trupit dhe mëngëve.

Trupi, në këmishën që kemi parë, është i gjatë rrith 70 cm dhe përbëhet prej dy fletësh kambriku, një përpara e tjetra mbrapa, të qepura mbi supe dhe nën sjetulla. Rrith grykës është qepur një copë pëlzure dyfishe me rrudha, ndërsa në të çarën e qafës, përpara, përsëri është qepur me makinë një shirit pëlzure i gjerë rrith 2 cm, mbi të cilin ka qëndisje me gjilpërë, duke përdorur fije të bardhë.

Mëngët janë të gjata deri pak përmbi bërrylin e dorës dhe shumë të gjera. Mbi supe mëngëve u janë qepur 5-6 «pjeta» (pala), të cilat bëjnë që ato të mos derdhen ashtu lirshëm mbi llérën e dorës, por të krijojnë rrudha.

Kofsharët — Sikurse e tregon edhe emri, ato mbulonin këmbët. Punoheshin me shajak të hollë leshi të importuar, në gjyrë të bardhë. Ato kishin formën e një tubi, më të ngushta në fund e me të gjera në krye. Zakonisht kishin në krye dy rripa për t'u lidhur me iliqe në mes e për të qëndruar të puthitura pas këmbës.

Fustanella — Ishte pjesa më kryesore e veshjes që i dha asaj edhe emrin. Ajo përgatitej nga kambrik importi dhe ishte e gjatë deri pak mbi gjunjë. Të moshuarit kujtojnë se në fillim të shekullit tonë fustanellat janë bërë edhe më pëlburë liri të endur në vegjë.

Fustanella përbëhej prej dy pjesësh, që visheshin njëra përpara e tjera prapa. Këto bashkoheshin në mes dhe anash me kapëse teli. Ato në zonën e Vurgut nuk ishin të gjera, si në zonat e tjera të Shqipërisë së Jugut. Sipas materialit të mbledhur në terren, fustanella më e gjerë nuk i kalonte të 200 kindat, gjë që shpreh edhe pozitën ekonomike të fshatarit vurgar.

Brezi — Punohej në vegjë me katër lisa, me fije të hollë leshi të bardhë, në të cilën, në distanca të caktuara prej 5 cm, kalonin vija të holla, punuar me fije leshi bojë kafe, që shkonin në drejtim vertical me punimin. Brezi ishte i gjatë 2,5 m dhe mbështillej rrith belit disa herë. Gjerësia e tij lëvizte nga 15 cm në 20 cm. Zakonisht mbi brez, veçanërisht për burrat deri në moshën 30-35 vjeç, vihej një shami e qëndsur, e palosur në formën e një trekëndëshi, me kulm nga poshtë dhe e anuar pak nga e djathta.

Mëngorja — Ishte veshja e sipërme dhe mbahej mbi këmishë, me përjashtim të mëngëve që nuk visheshin, por rrinin varur mbrapa shpinës, duke pasur vetëm funksion dekorativ. Mëngorja përgatitej me stof blu të thellë e më rrallë edhe me stof të zi importi. Deri në dhjetëjetëshin e parë të shekullit tonë mëngoret janë përgatitur edhe me shajak, po në këto ngjyra, por të punuar hollë dhe ngjeshur.

Mëngorja përbëhet prej tri copash: shpinës, gjoksit dhe mëngëve Shpina është njëcopëshe, në formën e një katërkëndëshi, e gjatë deri pak mbi bel. Gjoksi përbëhet prej dy copash, të cilat rrumbullakosen pak në cepa. Mëngët janë të myllura vetëm në pjesën e poshtme,

kurse pjesa tjetër rri e hapur. Ato janë qepur me trupin e mëngores vetëm në pjesën e prapme të krahut. Për të qëndruar mirë në trup, zakonisht ato në pjesën e prapme qepen në fund me njëra-tjetrën. Pra, siç shikohet, mëngët kanë vetëm funksion dekorativ.

Mëngorja, veçanërisht në gjoks, në mëngë dhe në pjesën e fundit të shpinës, është zbuluar me gjajtan të verdhë, në formë vijash zigzage apo paralele e më rrallë edhe me ndonjë motiv, veçanërisht në pjesën e mëngëve nga bërryli e poshtë.

Tizgat — Janë dy rripa të gjatë rrith 50 cm që lidhen mbi kofsharët pak nën gjurin e këmbës. Ato kishin ngjyrë të kuqe e të zezë. Me ngjyrë të kuqe tizgat i mbanin burrat në moshë jo të thyer, ndërsa me ngjyrë të zezë burrat e moshuar. Duhet të vëmë në dukje se, kur tizgat ishin të kuqe, xhufkat, që kur lidheshin duhej të vareshin në anën e jashtme të kërcirit të këmbës, ishin të zeza dhe e kundërtat, kur tizga ishte e zezë, xhufka ishte e kuqe.

Mbulesa e kokës — Mbulesa e kokës së burrit të veshur me fustanellë ka qenë e ndryshme në periudha të ndryshme. Kështu deri në vitin 1912 ai mbante në kokë një festë të kuqe ose vishnje, me një xhufkë që i varej deri përmbi supe. Mbas vitit 1912 festja e kuqe filloj të zëvendësohej nga një kapelë e zezë, në formë varke, që populli e njeh me emrin kapele grebeneçe.

Mbathjet e këmbës — Edhe mbathjet e këmbës të përdorura në veshjen me fustanellë ishin dy llojesh. Deri në pragun e Luftës së Parë Botërore janë përdorur opinga teletini, me xhufkë, dhe mbas kësaj periudhe filluan të pëndoreshin këpucë me hundë e me proka, që në popull njihen me emrin «këpucë vllaqiko».

Veshja me poture

Veshja me poture, karakteristike për një zonë të gjerë të Shqipërisë së Jugut, në zonën e Vurgut ka bashkëjetuar për një kohë me veshjen me fustanellë, derisa më në fund, pas fitores së Pavarësisë Kombëtare, pak nga pak, u bë veshja më e rëndësishme dhe e vetme ceremoniale. Ky variant veshjeje për burra ka një unitet më të gjerë dëshët pothuaj i njëllojtë, qoftë në prerje, qoftë në ngjyrën e copës së përdorur, në një zonë të gjerë të Shqipërisë së Jugut. Nga gjurmimet e bëra në terren del qartë se në përdorimin e këtij varianti të veshjes ka nuanca zonale, të cilat konsistonin jo aq në mënyrën e prerjes sesa në përbërjen dhe ngjyrën e copës së përdorur. Kështu, ndërsa pjesa ish-muslimane e Labërisë që merrej më shumë me blegtori mbante poture të bardha, të bëra prej cope leshti të endur në vegjë, pjesa ish-ortodokse e deri diku edhe qytetet e Labërisë, mbanin blu të thellë ose edhe të zezë. Ndërsa në pjesën ish-muslimane veshja me poture shoqërohej me qylafin e bardhë karakteristik lab, në pjesën ish-ortodokse kjo veshje shoqërohej me një kapelë, relativisht të gjatë, me kanal në mes, në ngjyrë blu të thellë ose të zezë, të punuar me një cohë të fabrikuar, me push, e afërt me pushin që ka kadifja e sotme, që në popull njihet me emrin kapelë grebeneçe. Por duhet të theksojmë se këto nuanca nuk ishin të dhëna njëherë e për-

gjithmonë, sepse në mjaft raste veshja me poture në ngjyrë blu të thellë përdorej edhe nga burri ish-mysliman. Veshja me poture e zonës së Vurgut është e njëjtë me veshjen me poture të zonës ish-ortodokse të Shqipërisë së Jugut, d.m.th. ajo kishte ngjyrë blu të thellë ose të zezë. Në kërkimet tonë në terren në asnjë rast nuk kemi ndeshur në këtë zonë në përdorimin e potureve me ngjyrë të bardhë, qoftë edhe kur ato bëhen prej leshi të endur në avlëmend.

Veshja me poture është veshje e thjeshtë, e lehtë e më praktike se veshja me fustanellë, të cilën e zëvendësoi. Në këtë variant veshjeje burrash mbizotërojnë dy ngjyra bazë: bluja e thellë, ose e zeza dhe e bardha. Kombinimi i ngjyrës blu të thellë me të bardhën i jep veshjes bukur dhe kontraste të pëlqyeshme. Kështu në këtë veshje e bardhë është fanella, këmisha, kallcat dhe brezi, ndërsa blu e thellë ose e zezë kapela, jeleku dhe poturet (fig. 26).

Veshja me poture përbëhet prej këtyre pjesëve kryesore: fanella, këmisha, jeleku, poturet, kallcat, brezi, çorapet, kapela, tizgat dhe opingat. Fanellën, këmishën brezin, çorapet, tizgat dhe opingat këtu nuk po i pëershruajmë, mbasi këto pjesë janë të njëjtë me ato të përdorura në veshjen me fustanellë.

Poturet — Janë pjesa më e rëndësishme, që i kanë dhënë emrin tërë veshjes. Poturet mbulonin pjesën e trupit nga mesi e deri pak nën kupën e gjirit.

Ato janë prerë si në fig. 27, d.m.th. në mënyrë të tillë që të rrinë të gjera në trup e në pjesën e poshtme këmbëzat vijnë duke u ngushtuar, derisa nën gju puthiten plotësisht. Në pjesën e sipërme ato lidhen për mesi me një ushkur. Në pjesën e fundit këmbëzat janë zbuluar me qëndisje në tri radhë paralele me fije gjatani të zi ose blu të thellë.

Jeleku — Bëhej po prej së njëjtës copë që bëhen prej leshi edhe poturet. Ai pritej siç tregohet në fig. 28*, d.m.th. shpina prej një cope të vetme në formë të një katërkëndëshi, me të cilën bashkoheshin nën sqetull dy gjoksoret që kryqëzoheshin mbi njëra-tjetrën dhe mbërtheshin me unaza teli. Zakonisht jeleku pritej i shkurtër. Gjatësia e tij arrinte afërisht deri pak përmbi bel. Zbulurohej në gjoks, përreth trupit dhe në të çarat e mëngëve me një fije të hollë gjatani në ngjyrë blu të thellë.

Ashtu si poturet, edhe jeleku bëhej prej cohe të fabrikuar vetëm kur veshja destinohej për t'u përdorur në raste festive, veçanërisht për të bërë kostumin e martesës. Për të gjithë rastet e tjera të përdorimit si poturet, ashtu edhe jeleku priteshin prej shajaku të ngjyer me bojë blu të thellë ose të zezë.

Poturet dhe jeleku, si dy pjesë më kryesore të veshjes, priteshin e qepeshin prej rrobaqepësve profesionistë në qytetin e Delvinës, apo prej atyre që kishin hapur dyqane rrobaqepësie në fshatrat e zonës.

Kallcat — Qepeshin në formë tubi, por gjithnjë të puthitura me pulpën e këmbës. Ato punohen me një lloj shajaku të hollë e në ngjyrë të bardhë, që në shumicën dërrmuese të rasteve ishte prodhim industrial dhe importohej, si thonë, prej Bullgarie.

* Skicat e këtij punimi janë bërë prej punonjësit Gjergj Martini.

Kallcat zbukuroheshin në pjesën e poshtme të tyre ose duke iu ngjitur një copë në ngjyrë blu, ose duke i qëndisur me penj kafe të errët.

Veshja me kilota

Veshja me kilota është relativisht e re, ajo filloi të përdoret edhe në zonën e Vurgut në vitet pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Si duket nga disa shenja, kjo lloj veshjeje për burra në këtë zonë erdhi si ndikim nga Jugu, nga zonat e banuara me popullsi çame. Kjo është ndoshta arsyaja që veshja me kilota në zonën e Vurgut njihet edhe me emrin «veshje çameko». Pavarësisht nga fakti që kishte ndikim nga veshja e ushtrive të huaja që morën pjesë në Luftën e Parë Botërore e që kaluan edhe mbi vendin tonë, kjo veshje në zonën e Vurgut, ashtu si edhe pothuaj në të gjithë Shqipërinë e Jugut, gjeti një përdorim të gjerë e masiv, aq sa për një kohë relativisht të shkurtër u bë veshja kryesore për burra, veçanërisht për punë, por edhe për raste festive, duke zëvendësuar veshjen me poture. Kjo përhapje masive u kushtëzua në radhë të parë nga prakticiteti i saj. Ajo elemizonte ato pjesë të veshjes me poture, si bie fjala fanellën e këmishën, të cilat, si pjesë kryesore e të dukshme të kësaj veshjeje, nxirrin telashe qoftë në sigurimin e materialit, që tani nuk prodhohej më brenda ekonomisë shtëpiake por blihej në treg, qoftë në mirëmbajtje, si pjesë të ekspozuara të veshjes. Pastaj veshja me poture elemizonte kallcat dhe brezin, dy pjesë delikate dhe më të paqendrueshmë në veshjen me poture. Këtu duhet të theksojmë se, me gjithë përhapjen e gjerë që pati kjo veshje, ajo nuk mundi të zëvendësojë plotësisht veshjen tradicionale me poture, e cila mbeti deri në vite 50 të shekullit tonë veshja më e preferuar, veçanërisht për dhëndëri. Ajo zëvendësoi plotësisht veshjen me poture në përdorimin e përditshëm dhe në atë për punë.

Veshja me kilota, ndonëse në prerjen e pjesëve të saj kryesore nuk ruante asgjë nga tradita popullore, në materialin prej së cilës bëhej kjo veshje u përputh plotësisht me të. Ajo punohej me zhgun leshi në ngjyrë të zezë, të punuar në vegjë brenda ekonomisë shtëpiake, ose të blerë nga blegtorët labë e vlleh që dimëronin në këtë zonë. Meqë në prerje ajo është larg traditës, pjesët e saj nuk po i përshkrumjë.



Veshja e zonës së Vurgut në fund të shek. XIX e fillim të shek. XX dallohet për origjinalitetin e saj si në përdorimin e materialit, në mënyrën e prerjes, të qepjes dhe të zbukurimeve të bëra në veshje, ashtu edhe në përdorimin e ngjyrave. Ky origjinalitet ruhej jo vetëm midis veshjes së zonës së Vurgut dhe zonave të tjera përreth saj, por edhe midis fshatrave të veçanta brenda zonës. Kështu veshja me *dhipllar*, që në mesin e shek. XIX kishte një shtrirje të gjerë, në çerekun e parë të shekullit tonë përdorej akoma në tri fshatra të zo-

nës (Jermë, Kranë, Finiq), ishte e dallueshme, qoftë për sa i përket materialit dhe ngjyrës së tij, qoftë për sa i përket mënyrës së prerjes dhe zbulurimeve, prej veshjes me *cibun*, e cila shtrihej në këtë periudhë në katër fshatra të zonës, në krahun e djathtë të rrjedhës së lumit Bistricë (Finiq, Karahaxh, Vromero, Mavropull). Kjo nga ana e saj ishte krejt e ndryshme, qoftë nga materiali, qoftë nga prerja, me veshjen me *allaxha*, që përdorej në pjesën dërrmuese të fshatrave të zonës që shtriheshin në krahun e majtë të rrjedhës së lumit Bistricë dhe në tri fshatra të rrjedhës së krahut të djathtë të tij.

Me gjithë ndryshimet e dukshme që vihen re midis të të tri varianteve që dhamë më sipër, këto veshje, duke qenë përdorur nga popullsia e së njëjtës zonë etnografike, në të njëjtat kushte ekonomike, shoqërore, arsimore e natyrore, me marrje e dhënie të shumta midis tyre, duke përfshirë këtu edhe marrje e dhënie grash gjatë martesave, të cilat, ndonëse në bazë të zakonit do të bënin për martesë kostumin ceremonial të fshatit ku do të martoheshin, fusnin në këtë kostum elemente ose edhe pjesë të veshjes së tyre karakteristike, veçanërisht në ato pjesë të kostumit që punoheshin brenda ekonomisë shtëpiake, kanë edhe elemente të përbashkëta që i afrojnë. Kështu brezi i gjerë, brezi i ngushtë dhe çorapet për të tri variantet e veshjeve janë të njëjtë, ndërsa cibuni dhe përparja për veshjen e variantit të parë dhe të dytë janë identike. Këto afri duken mirë jo vetëm në pjesët e përbashkëta që kanë këto variante kostumesh, por edhe në mënyrën e përdorimit të pjesëve të veçanta të veshjeve. Kështu mbulesa e kokës, pavarësisht nga materiali, motivet e ngjyrat që përdoreshin e që ishin të ndryshme, lidhej njëloj në veshjen me dhipllar, në veshjen me allaxha dhe në kostumin e dytë të veshjes me cibun, pra ajo lidhej njëloj në të tri variantet e kostumeve të përdorura në zonë, pavarësisht nëse këto ishin veshje ceremoniale apo jo. Këtc elemente apo mënyra përdorimi të përbashkëta në të tri variantet flasin për ndikime e huazime reciproke të këtyre veshjeve te njëratjetra, për marrëdhëniet e ngushta që kanë pasur bartësit e tyre në të kaluarën.

Fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX shënon dobësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve feudale dhe depërtimin më të thellë të marrëdhënieve kapitaliste, veçanërisht edhe në fshatrat e zonës së Vurgut. Duke filluar që në kohën e sundimit të Ali pashë Tepelenës, kur fusha e Vurgut u shpyllëzua dhe u caktua si zonë e rëndëssishme bujqësore për të përballuar një pjesë të nevojave të pashallëkut me këto prodhime, ajo jo vetëm u popullua me bujq të rinj, por filloi të lidhej më ngushtë me tregun, veçanërisht me qytetin e Delvinës, që ishte qendra më e rëndësishme administrative, tregtare e zejtare për të gjithë fshatrat e zonës. Në vitet që pasuan, veçanërisht në gjysmën e dytë të shek. XIX, këto lidhje u forcuan më shumë. Zhvillimi dhe forcimi i marrëdhënieve tregtare dhe monetare çoi rrjedhimisht në ndryshime në të gjithë kulturën materiale të fshatarësise së zonës, duke përfshirë këtu edhe veshjen popullore, e cila ishte e para që pati ndikime më të mëdha dhe pësoi ndryshime më të thella. Këto ndryshime, para së gjithash, prekën materialin prej të cilët përgatitej veshja, aksesorët e saj dhe pastaj pjesë të veçanta të veshjeve. Kështu, si rezultat i marrëdhënieve më të ngushta me tregun, fillimi i

zëvendësua materiali që deri tani përdorej për veshjen e brendshme, qoftë për burra, qoftë për gra, që prodhohej brenda ekonomisë shtëpiake, me material që blihej i gatshëm në treg e që plotësonë më mirë kërkesat e fshatarësise. Në ndonjë veshje, si në veshjen me allaxha, marrëdhëniet me tregun ndryshuan jo vetëm veshjen e brendshme, por në përgjithësi të gjithë veshjen, duke përfshirë edhe pjesët e jashtme të saj. Këto marrëdhënie u ndien më shumë në ndonjë pjesë të vecantë të veshjes dhe në aksesorët e saj, të cilët shkuan drejt unifikimit.

Tregu i përbashkët dhe marrëdhëniet më të ngushta me të unifikuani disa pjesë të tri varianteve të veshjes. Kështu p.sh. u unifikuani opingat (caruqi), të cilat tani prodhoheshin në seri nga zejtarët e qytetit të Delvinës dhe të Janinës, u unifiku mbulesa e kokës, e cila është e njëllojtë jo vetëm në variantet e veshjes brenda zonës së Vurgut, por edhe në një pjesë të madhe të veshjeve të zonave të tjera brenda rrëthit të Sarandës, si në veshjen e Muzinës, Mesopotamit, Theologos e Karroqit, u unifikuani çorapet, të cilat, ndonëse nuk prodhoheshin në zejtarinë qytetare, por brenda ekonomisë shtëpiake, por për tregun, janë karakteristikë për një zonë shumë të gjerë fshattrash, duke përfshirë edhe fshatrat e Vurgut. Këto çorape, në fillim të shek. tonë, prodhoheshin për të gjitha zonat më shumë në fshatin Dhrovjan e prej këndeje mandej përhapeshin në të gjitha fshatrat, më shumë duke u këmbyer me produkte në natyrë sesa duke u blerë. Për këtë arsyë këto çorape njiheshin me emrin *alla dhrovjanitika* jo vetëm në zonën e Vurgut, por edhe në zonat e tjera. E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për kallcat (çorape pa pjesën e poshtme) që përdoreshin me kostumin e dytë apo për punë, për prodhimin e të cilave ishin specializuar disa fshatra të zonës së Theologos. Gjithashtu u unifikuani në tri variantet e veshjes, brezi i gjerë dhe brezi i ngushtë.

Marrëdhëniet me tregun u ndien më shumë se kudo në aksesorët e veshjes. Kjo bëri që objekte të tilla si varëset e qafës zbukurueset e gishtave dhe të veshëve të unifikohen jo vetëm brenda zonës që kemi marrë në studim, por në një rrëth më të gjerë fshattrash të banuara nga ish-popullsia ortodokse si në zonën e Muzinës. Mesopotamit, Karroqit, Theologos e Mursisë brenda rrëthit të sotëm administrativ të Sarandës, në fshatrat e Dropullit të Poshtëm, Dropullit të Sipërm e deri diku edhe të Lunxhërisë, brenda rrëthit administrativ të Gjirokastrës.

Sic shikohet nga materiali i paraqitur më lart, veshjet popullore të zonës së Vurgut, gjatë rrugës së zhvillimit të tyre, si rezultat i marrëdhënieve me tregun dhe i marrëdhënieve ekonomike e shoqërore të bartësve të tyre, jo vetëm brenda zonës, por edhe me zona të tjera, filluan të shkrihen midis tyre, të humbasin gradualisht ato karakteristika të imprehta dalluese e të unifikojnë elemente të vecanta. Ky unifikim në fund të shek. të kaluar e në fillim të shekullit tonë ishte në fillimet e tij në veshjet e grave dhe kishte mbaruar plotësisht në veshjet e burrave. Veçse kjo prirje zhvillimi drejt unifikimit në veshjen e grave nuk vazhdoi gjatë. Ajo e ndërpren rrugën e zhvillimit menjëherë në vitet e para të periudhës së pasclirimt, kur veshjet popullore humbën vlerën e përdorimit të tyre praktik në jetën e përditshme duke u zëvendësuar me veshje të kohës, shumë më praktike

në përdorim, më të lehta dhe njëkohësisht më të mira. Këtu duhet të theksojmë se prirja e përgjithshme e këtij zhvillimi drejt unifikimit, të paktën për zonën e Vurgut, ka një karakteristikë dalluese: zhvillimi drejt unifikimit preku fillimisht ekstremet, mbulesën e kokës, çorapet, opingat dhe më vonë pjesët e tjera të veshjes, por gjithnjë ato që janë më afër këtyre ekstremeve, si: qaforen, gjoksoren e të tjera elemente të dorës së dytë, por pa mundur të prekë elementet kryesore të saj, të cilat u treguan më «kokëforta» e më «të pabindura» për t'iu nënshtuar këtyre ndryshimeve. Për këtë arsyë, ndonëse këto veshje kanë elemente të përbashkëta, që janë rezultat i prirjes së zhvillimit drejt unifikimit, ato janë të dallueshme nga njëra-tjetra e përbëjnë variante më vete, që ndryshojnë midis tyre, qoftë nga materiali i përdorur, qoftë nga ana morfologjike dhe artistike.

Duhet të theksojmë se një rol të rëndësishëm në ndryshimin e veshjes kanë luajtur edhe zonat ku lidheshin marrëdhëniet martesore në të kaluarën. Ky rol ka qenë ndonjëherë kaq i rëndësishëm, saqë ka bërë të ndryshojë krejtësisht edhe veshja, veçanërisht ajo e grave. Tipik në këtë drejtim është fshati Kranë. Veshja e këtij fshati deri në vitet 30 të shekullit tonë ishte e njëllojtë me veshjen e Finiqit, Vromeroit, Karahaxhit dhe Mavropullit, d.m.th. përdorej veshja me cibun. Në këtë periudhë edhe marrëdhëniet martesore të këtij fshati bëheshin, në pjesën dérrmuese të tyre, me katér fshatrat e përmendura më sipër. Aty nga vitet 1924-1925, për arsyë nga më të ndryshmet, Kraneja filloi t'i shkëputë marrëdhëniet martesore me zonën tradicionale dhe të lidhet me fshatrat e tjera të Vurgut, gjë që prapasollë edhe ndryshimin e veshjes. Si rezultat i këtyre marrëdhënieve të ngushta, në këtë fshat u kufizua shumë veshja me cibun dhe filloi të përdorej në masë veshja me allaxha, aq sa në prag të Çlirimt të vendit vetëm rrallë e në gra të moshuara shikohej veshja me cibun. Sot në këtë fshat, edhe në raste festive, sikurse janë festivalet folklorike, në asnjë rast nuk përdoret veshja e vjetër tradicionale, por veshja e zemrës së Vurgut, veshja me allaxha.




Fig. 1



Fig. 2




Fig. 4





Fig. 3






FIG. 5




FIG. 6




Fig. 7




Fig. 8




Fig. 9




Fig. 10




Fig. 12



Fig. 11




Fig. 13

Fig. 14




Fig. 15 16




Fig. 17




Fig. 19




Fig. 18




Fig. 21




Fig. 20



Fig. 22




Fig. 23




Fig. 25




Fig. 24




Fig. 26




Fig. 27






Fig. 28



Ali MUKA

TIPA BANESASH NË DISA FSHATRA TË LIBRAZHDIR

Në këtë artikull do të japim një vështrim mbi banesën popullore të disa fshatrave që shtrihen në krahun e djathtë të rrjedhjes së mesme të Shkumbinit, në afërsi të Librazhdit. Fjala është përfshirat Kutru-man, Zgozhd, Letëm, Koshorisht, Qarrishtë, Dorëz, Gizavesh, Librazhd-Katund dhe Dragostunjë. Vështrimi do të mbështetet kryesisht në materialin faktik të mbledhur në fillim të viteve 70 gjatë ekspeditave të kryera në këtë zonë.¹ Ndërtimet e vjetra të banimit që do të shqyrtohen i përkasin si kohë gjysmës së shekullit XIX dhe fillimeve të shekullit tonë. Në ditët tona një pjesë e mirë e banesave të vjetra janë zhdukur, duke pësuar edhe konsumim fizik, ose janë transformuar hera-herës në mënyrë rrënjosore. Procesi i fundit është më i ndjeshëm në funksionet e ambienteve dhe në trajtimin e brendësisë së tyre. Sido-qoftë, materiali ekzistues, i zhveshur nga ndryshimet e modifikimet e vonshme, si dhe të dhënët e banorëve të moshuar, ndihmojnë përfshirë t'u njojur me këto ndërtime, me karakteristikat dhe veçoritë e tyre tipologjike.

Për një njojje më të mirë me zonën, vendbanimet dhe banesat, paraprakisht do të jepen disa të dhëna me karakter të përgjithshëm. Edhe përfshirë këtë mbështetje kryesore është materiali i mbledhur në terren. Në analizën e banesave do të mbahet si kriter themelor ai i tipologjisë. Zhvillimi planimetriko-volumor dhe analiza e ambienteve kryesore të banimit do të përbëjë bërtamën e kësaj analize tipologjike. Shtrirja, analogjitet e paralelizmat me tipa të tjera përbëjnë detyrën e fundit të këtij vështrimi.

Tradita thekson se shumica e këtyre fshatrave kanë bërë pjesë me Çermenikën e vjetër². Në një artikull përfshirë banesën popullore të Çermenikës³, është vënë në dukje se tipi mbizotëruesh i banesës së kësaj zone ka qenë tipi që nga banorët njihet gjerësisht me emrin «*Shpia me telize*». Kjo banesë ka qenë përhapur edhe në fshirat që përmendëm më lart. Ndërkohë, gjurmimet tregojnë se veç kësaj banese, sidomos në këto fshatra, të cilat përbëjnë kufirin më jugor të Çermenikës, janë ndërtuar edhe tipa të tjera. Pika këtë artikull janë objekt kryesor shqyrtimi në këtë artikull.

1) Ekspeditat janë kryer në vitet 1971, 1972, 1973.

2) Tradita përjashton vetëm Qarrishtën dhe Dragostunjën. Të moshuarit theksojnë se zona e Qarrishtës më parë ka qenë pyll dhe shfrytëzohej edhe përlindëm drusore, edhe si «mera gjaje». Para 4-5 brezash (d.m.th. para rreth 120-150 vjetësh), filluan të nguliten aty familje me banim të përherëshëm. Ato u përkisnin fiseve *Bicak* (Çermenikë) dhe *Alhasë* (Zabzun-Dibër). Me kohë këto familje u rritën duke formuar dy lagje kryesore të këtij fshati.

3) A. Muka, *Banesa popullore e Çermenikës* në «Studime historike» Nr. 1, Tiranë 1974, f. 131-161.

Në kuptimet që e shtrojmë problemin, artikulli, duke synuar të japë material faktik nga disa fshatra të caktuara, vetiu shërben si plotësim i mëtejshëm i artikullit për tipologjinë e banesës dhe veçoritë e ndërtimeve popullore në zonën e Çermenikës.

Mandej në një kuptim më të gjërë, ky material i sjellë është kontribut në evidentimin e shumëllojshmërisë së tipave të banesës fshatare dhe shkallën e përhapjes së tyre në vendin tonë.

1. TË DHËNA ME KARAKTER TË PËRGJITHSHËM PËR VEND-BANIMET, BANORËT DHE NDËRTIMET POPULLORE.

Tradita e ndan Çermenikën në dy pjesë: në Çermenikën e Bardhë dhe Çermenikën e Zezë. Fshatrat Zgozhd, Letëm, Qarrishtë, Gizanesh, Dorëz, Librazhd-Katund, Koshorisht hyjnë në Çermenikën e Bardhë⁴. E dhëna se këto fshatra janë vendbanime të vjetra, gjen edhe mbështetje dokumentare. Kështu, në rëgjistrin turk të vitit 1467⁵ përmenden: *Librazhda* (Librazhdi) me 33 shtëpi⁶, *Dorezi* me 10 shtëpi⁷, Letmije (Letmi) me 15 shtëpi⁸, *Kosharisht* me 6 shtëpi⁹, *Izgosht* (Zgozhdhi) me 7 shtëpi¹⁰, *Dragostunjë* me 9 shtëpi¹¹. Në favor të vjetërsisë së këtyre fshatrave vijnë në konsideratë edhe toponimet e kishave, të cilat i gjen gati në të gjitha fshatrat e Çermenikës¹². Ndërsa në afërsi të Koshorishtit ndodhet një shpellë me piktura të hershme bizantine. E gjithë zona ku janë vendosur vendbanimet karakterizohet nga terreni i thyer. Kushtet natyrore-gjeografike, të pleksura me faktorët shoqërorë, kanë lënë gjurmët e tyre në fisionominë urbanistiko-arkitektonike të këtyre vendbanimeve. Banesat janë vendosur me grumbullime të vogla në bazë mëhalle.

Veprimitaria kryesore ekonomike në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar dhe dekadat e para të shekullit tonë kanë qenë bujqësia dhe blegtoria. Prona e vogël private, karakteri ekstensiv i degëve kryesore të ekonomisë, të para brenda kuadrit ekonomiko-shoqëror të kohës, ishin burim i pamundësisë për të siguruar të ardhurat e nevojshme vjetore për jetesë. Kjo gjendje i detyronte meshkujt e aftë për punë, që të shkonin të punonin në vise të ndryshme edhe jashtë Shqipërisë. Kanë shkuar sidomos në Selanik e Stamboll, si bahçevanë, si punëtorë të thjeshtë krahu, apo edhe si mjeshtër ndërtimi. Niseshin në formë grupi 10-15 veta, zakonisht nga i njëjti fshat. Punonin deri në 6 muaj, në periudhën e dimrit.

4) Për këtë shih edhe Rr. Zojzi, A. Gjergji, *Raporte të vitit 1949*, Arkivi Etnografik (AE), dok. 6/2, f. 30.

5) Në «Kopja e defterit emëror të vilajetit të Dibrës, Dullgobërdës, Rjekës, Çermenikës dhe të tjera», v. 871 h (1467). Citimet jepen sipas përkthimit shqip që ruhet në arkivin e Institutit të Historisë (AIH).

6) *Po aty*, faqe 126 e origjinalit.

7) *Po aty*, faqe 127 e origjinalit.

8) *Po aty*, faqe 132 e origjinalit

9) *Po aty*, faqe 133 e origjinalit.

10) *Po aty*, faqe 137 e origjinalit.

11) *Po aty*, faqe 138 e origjinalit

12) Përveç të dhënave që i kemi mbledhur në terren, lidhur me këtë problem shih edhe në AE, Dok. 6/2 (vep. cit.) në faqet 82, 83, 84.

Sipas statistikave të publikuara në vitet '20 të shekullit tonë, numri mesatar i personave për çdo familje (sipas fshatrave) ka qenë: Zgozhdhi 10 veta, Librazhdhi-Katund, Dorezi, Gizaveshi e Dragostunja nga 8 veta, ndërsa Letmi e Qarrishta nga 9 veta¹³. Këto të dhëna janë të afërta me ato që kemi mbledhur në popull. Lidhur me këtë problem tradita thekson se në çdo fshat ka pasur një numër të kufizuar familjesh me 20, e shumta me 30-35 anëtarë.

Për tregti, banorët e këtyre fshatrave i tërhiqte më shumë Elbasani. Jorrallë shkonin edhe në Dibër e Strugë, sidomos kur ishte fjala për bereqet. Në fshatin Zgozhd, i ndodhur pranë rrugës së vjetër të karvaneve që shkonin nga Elbasani për Dibër, kanë qenë ngritur *hane*, që shërbenin si vende qëndrimi të këtyre karvaneve¹⁴.

Banesat i kanë ndërtuar mjeshtër të ardhur nga fshatrat e Dibrës ose vendas. Ustallarë edhe me vazhdimësi brezash ka pasur sidomos nga Fenaresi, Kostenja, Prevalli, Letmi etj.

Si materiale kryesore për ndërtim janë përdorur guri dhe druri. Fshatari që do të ndërtonte banesë, pranë truallit të caktuar grumbullonte materialet e nevojshme të paktën 6 muaj deri një vit më parë. Më tej bëhej marrëveshja me mjeshtrit ndërtues. Të moshuarit tre-gojnë se në fillimet e shekullit tonë, për të ndërtuar një banesë dyka-tëshe, me dy ambiente banimi sipër e dy ambiente për bagëtinë poshtë, duheshin të paktën 10 qese. Një qese kishte 500 groshë. Në kushtet e një ekonomie të varfër, një shumë e tillë, vetëm si hak pune¹⁵, nuk ishte e vogël. Mandej me këtë pagë banesa zakonisht përfundonte vetëm si karabina¹⁶. Me këtë nënkuptoher që mjeshtri kryente vetëm punimet kryesore dhe nuk merrej me punimet e brendshme të banesës. Sidomos punime të tillë, siç janë dyshemetë, dyert, dritaret e dollapët, ngeleshin të papërfunduara. Ato kryhesin gradualisht nga i zoti i shtëpisë, duke marrë nganjëherë edhe ndonjë mjeshtër që merrej me punime druri.

Banesat kanë qenë me dy dhe me tri kate. Prej tyre përdorim masiv kanë pasur ato me dy kate¹⁷. Ekonomia bujqësore-blegtorale, me prodhimtari e rendimente të ulëta, si ekonomia bazë, ndikonte jo vetëm

13) T. Selenica, *Shqipëria më 1923*, Tiranë 1923, f. 72. Mesataren për çdo fshat e kemi nxjerrë duke u bazuar në të dhënat globale që përban botimi i mësim-përm.

14) Për këtë shih edhe A. Çauši, *Transporti në Elbasan gjatë shekujsh*, «Etnografia shqiptare» Nr. 2. Tiranë, 1963. Duke bërë fjalë përrugën Elbasan-Dibër, autori thekson: «Në këtë rrugë, e pakta që nga e katërtë e fundit të shek. XIX e këndej, nuk reshpërojshin ma karvanet, por qiraxhijtë me 4-5 kuaj...» dhe më tej shton: «Udhëtimi i ditës së parë në këtë rrugë mbaronte në han të Zgozhdit, që mban 8 orë nga Elbasani». (faqe 161).

15) Mjeshtërve u sigurohej fjetja (kur ishte nevoja), dhe ushqimi i përditshëm falas.

16) Të moshuarit edhe sot kujtojnë shprehjen që i thuhej mjeshtrit kur bëhej marrëveshja për ndërtimin e banesës: «Sa t'i qitësh çikën përjashta, o usta, sa ma ban». Kur bëhej marrëveshja me kryemjeshtrin, shuma totale e caktuar nuk paguhej njëherësh, por në dy këste: Gjysma jepej kur hidheshin trarët e dvshemesë, ndërsa gjysma tjetër kur banesa mbaronte si karabina.

17) Të moshuarit e përdorin rëndom fjalën «kullë», jo vetëm kur banesa është me tri kate, por edhe kur është me dy kate, me nra një ambient në çdo kat. Në këtë rastin e fundit quajnë «kullë» ambientin e banimit.

te banesat, të cilat kanë numër të kufizuar ambientesh, por edhe te ndërtimet ekonomike të vendosura në oborr. Këto të fundit kanë qenë të kufizuara si numër, me karakter të përkohshëm ndërtimi dhe madje edhe me përmasa të vogla si volum. Në këto rrrethana oborri si kompleks banimi paraqitej i varfër. Ai zakonisht rrrethohej me gardh pa ndonjë rregullsi të caktuar. Përveç banesës, në oborr ishte një gozhdar misri me planimetri rrrethore ose drejtkëndëshe dhe një kasolle bari¹⁸.

Si njësi mase në ndërtimin e banesave përdorej *pashi* pér përmasat e mëdha dhe *pëllëmba* pér përmasat e vogla. Mbi bazën e këtyre njësive «lëshohej shtëpia», sikurse thuhet. Gërmimi i themeleve vazhdonte derisa të dilte toka e fortë, apo «*tabani*», siç e quan tradita. Thellësia nuk lejohej më pak se 3 *pëllëmbë*, ndërsa normale quhej 5 *pëllëmbë*. Në ato vende ku toka dukej e dobët, atje ku «*toka lun*», siç e quan tradita, viheshin tri trungje dru lisi, që kapeshin ndërmjet tyre me ganxha kovaçi dhe mbi to hidhej themeli. Lidhur me këtë, në popull thuhet: «Kur i ven trena tabanit që lun, atëhere muri ma vonë nuk çahet, por kur don me u ulë, ulet njëherësh». Para vendosjes së shtresës së parë të gurëve në themel, kryemjeshtri me dëshirën e pronarit të banesës therte në qoshen jugore të themelit një «*kurban*». Gjaku i tij duhet të rridhte brenda në themel. Si zakon përveç gjakut, si gur i parë duhej të ishte koka e bagëtisë së therur. Muratura e themelit zakonisht fillonte me një shtresë gurësh të thatë, por thuhet se edhe e gjithë pjesa e themelit deri në rrafshin e tokës, mbushej me mur të thatë.

Trashësia e murit në vazhdim bëhej 3-4 *pëllëmbë*. Gjerësia e banesës shkonte 3-5 *pashë*. Në lartësi të caktuara viheshin brezat e drurit. Brezi i parë prej druri vihej në një lartësi të tillë nga toka sa «*mos i kapi shiu i tokës*» pasi «*kalben shpejt*». Të dy elementet që formojnë brezin vihen në dy faqet e murit pér së gjati, duke u kapur tërthorazi me *kushakë* të vegjël. Lidhur me muraturën e gurit, tradita njeh tri lloje, në varësi nga shkalla e përpunimit të gurit. *Muri i zakonshëm* quhet ndryshe edhe «*mur me pe*». Në këtë rast gurit i bëhet një punim-shumë i lehtë. Tregohet kujdes në qoshet, por pa ndonjë diferencim të thellë. Ky lloj muri është përdorur në masë në këtë zonë dhe në të gjithë Çermenikën. «*Mur me rreshta*», në këtë lloj muri, që përsëri përdorej «*peri*», gurët ghendeshin në të katër faqet lidhëse. Kujdesi pér qoshet e muraturës në këtë rast ishte akoma më i madh. Duke pasur si bazë gurët e zgjedhur të qosheve, kalonin një apo dy rreshta gurë ndërmjetës, duke qenë secili rresht i rrafshuar. Ndërsa lloji i tretë i murit, ishte «*muri me daltë*». Në këtë mur përveç kujdesit që tregohej pér qoshet, gurët e rreshtave skaliteshin jo vetëm në katër faqet lidhë-

18) Transformimet që janë bërë në fshatin e sotëm socialist, kanë lënë gjurmë të dukshme edhe në ndërtimet ekonomike dhe në oborrin në përgjithësi. Por, në vetë kushtet e sotme të fshatit, këto ndërtime nuk janë zhdukur krejt ketë një parcelë toke të punueshme dhe një numër bagëtish si pronë personale pér nevojat e tij. Kjo gjendje dikton përsëri nevojnë e ndërtimeve ekonomike me karakter sezonal apo të përkohshëm disayjeçar. Ato i ndëronton vetë fshatari me materiale rrrethanore dhe me teknikën tradicionale. Një thjeshtim të për tufëzimin e bagëtive të imëta personale, proces i cili ka filluar në masë mbarë vendin.

se, por edhe në faqen e pestë që dukej nga jashtë. Është e kuptueshme se dy llojet e fundit të mureve kishin kosto të lartë, e sidomos ai i fundit. Llojin e dytë me shumë gjasë e ka përdorur edhe shtresa e mesme e fshatarësisë, ndërsa lloji i tretë takohet shumë rrallë. Tradita pohon se krahas veglave të punës të domosdoshme e të zakonshme të mjeshtrit murator, në varësi nga lloji i murit janë përdorur edhe vegla të tjera¹⁹.

Me përfundimin e muraturës së gurit hidhet *brezi i çatisë*, i përbërë nga dy trarë druri të latuar në dy anë. Më tej vazhdon procesi i ndërtimit të strukturës mbajtëse të çatisë dhe së fundi mbulimi i saj. Tradita njeh dy lloje çatish. Njëra quhet çati «*kathiq*» që përdoret për hapësira relativisht të mëdha dhe tjetra çati «*dyliq*» që përdoret për hapësira relativisht të vogla dhe madje edhe në ndërtimë provizore. Për mbulim është përdorur në masë *tjegulla e lugtë*, por nuk ka munguar edhe përdorimi i rrasës së gurit e sidomos i furdes. Tjegulla prodhohet nga vetë fshatarët, në «Zallin» më të afërt, ku të kishte ujë pranë dheu të ishte i përshtatshëm²⁰.

Nga sa parashtruam në vija kryesore, del e qartë se kemi të bëjmë me një zonë ku ka tradita ndërtimi. Në një zonë të tillë me terren të thyer banonin fshatarë që kishin pronat dhe ekonominë e tyre. Pra, në marrëdhëniet ekonomike i karakterizonte prona e vogël private. Në fushën shoqërore si tipar dallues ka qenë ekzistanca e familjes me mbeturina patriarchale. Mbizotëronte familja e vogël dhe mesatare, por nuk ka munguar edhe familja e madhe.

Shtresëzimi shoqëror ekzistonte mbi bazën e një vargu të tërë krishteresh komplekse. Në këtë varg kriteresh, vendin më të rëndësishëm e zinte kriteri ekonomik e pasuror. Kështu, familjet më në zë, me gjendje më të mirë ekonomike tradita i njeh me emrin «*dyert e para*».

Këto probleme të pleksura me mënyrën e jetesës dhe zakonet e traditat, të marra në tërësinë e tyre, kanë përcaktuar në vija themelore programin e kërkesave jo vetëm për banesën, por për të gjithë oborrin e banimit. Psikologjia e pronës private, punimi i tokës me mjetet vetjake, e bërët malësorin e këtyre anëve të lidhur pas pronës e tokës. Kjo çonte në njëfarë pavarësie ekonomike, gjithmonë brenda kuadrit të përgjithshëm të kohës, dhe ndihmonte e ushqente marrëdhëniet patriarchale brenda familjes. Me këta faktorë lidhet në radhë të parë ai karakter i shpërndarë i fshatrave ku banesat, e në tërësi

19) Veglat e zakonshme të mjeshtrit murator kanë qenë: Çekiçi, mistria, *plumçja* (e njohur në popull më shumë me emrin «*topçe*»), *nivela* (njihet edhe me emrin «*terzia*»), çaprazi, dhe *goneja* (tradita e njeh më shumë me emrin «*gjanë*»). Ndërsa kur punohej «*muri me rreshta*» përdorej edhe një daltë në formë kunji e njohur me emrin «*zomë*». Tradita thotë se kjo daltë i heq «*kodrat*» gurit. Kur punohej «*muri me daltë*», është përdorur një daltë tjetër në formë shpatukjeje, e njohur me emrin «*pallaskë*». Tradita thotë që kjo daltë «*e lan gurin*». Përveç çekiçit të zakonshëm përdorej çekiçi «*topure*» për të goditur daltën në procesin e skalitjes së gurit. Ky i fundit të lë përshtypjen e një vareje të vogël.

20) Kur i pyet të moshuarit, edhe nga ata që kanë prodhuar vetë tjegulla lidhur me përmasat e këtyre të fundit, e kanë më lehtë të përgjigjen. «I bajshim sa për të lidh një fëmijë në të».

kompleksi i banimit me gjithë aksesorët përbërës, ndërtohej atje ku ishin tokat e bukës dhe kishte edhe mundësi kullotjeje. Karakteri ekstensiv i degëve kryesore të ekonomisë, shtimi natyror i popullsisë, rritja e familjes e shoqëruar me procesin e dekompozimit të familjes së madhe e bashkë me to nevoja për toka buke dhe vështirësitet praktike për sigurimin e saj në kushtet e ekzistencës së pronës private, i bën në të vështira ndërtimet e banimit pranë njëra-tjetrës.

Nga sa parashtuam, kuptohet që faktorët social-ekonomikë nga njëra anë dhe terreni, materialet rrethanore e klima nga ana tjetër, kanë lënë gjurmët e tyre në karakterin e vendbanimeve dhe në programin e banesave të kësaj zone. Thelbi i njëjtë i programit me praninë e shtresëzimit shoqëror dhe të traditave e zakoneve të njëjta, janë baza ku duhet kërkuar brenda larmisë së zgjidhjeve kompozicionale, përbajtja e njëjtë: plotësim nevojash kryesore jetësore.

II. PËRSHKRIMI DHE ANALIZA E BANESAVE

Objekt analize e shqyrtimi do të bëhen: 1. *Banesa me «qoshk»*, 2. *Banesa me çardak* dhe 3. *Shpia me telize* e Qarrishtes. Tipin e parë do ta analizojmë më gjerësisht, pasi është relativisht më i përhapur në krahasim me dy të tjera. Për të dy tipat e tjera do të merremi kryesisht me analizën kompozicionale, si më e rëndësishmja për qëllimet e artikullit.

1. Banesa me «qoshk»

Shembuj të këtij tipi kemi gjetur më shumë në fshatin Zgosht, por nuk ka munguar edhe në fshatra të tjera. Sikundër është theksuar, tipari i parë që të bie menjëherë në sy, kur vrojton shembuj të këtij tipi²¹, është një qoshk, ose një lloj ballkon i myllur nga jashtë, që del në katin e sipërm të ndërtesës (foto 1,2). Këtë banesë e gjejmë me dy dhe me tri kate. Mbështetur te kjo veçori e fundit, materialin do ta shqyrtojmë në dy variante bazë. *Varianti i parë* përfshin shembujt me dy kate, ndërsa *Varianti i dytë* përfshin shembujt me tri kate. Nëpërmjet materialit faktik del mirë në dukje se çfarë i bashkon këto variantë në një tip të vetëm, ku qëndron e përbashkëta dhe ku qëndrojnë veçoritë ndërmjet tyre. Së pari, në lidhje me shtrirjen në plan dhe ngri-tjen në lartësi vërehet që varianti i dytë karakterizohet nga theksimi i dukshëm vertikal, kurse varianti i parë karakterizohet nga një raport i ekuilibruar midis shtrirjes horizontale dhe theksimit vertikal. Kjo është dukuria më thelbësore që i bën të dallueshëm ndërmjet tyre këto dy variantë në formulimin e jashtëm. Në aspekte të tjera të këtij formulimi ato kanë mjaft ngjashmëri që shkon deri në idenditet. Kështu, të dy variantet karakterizohen nga volume të myllura. Muratura e gurit ndërpitet në lartësi të caktuara nga breza druri dhe nga hapësira ndriçimi me përmasa të vogla. Ky volum i myllur kurorëzohet gjithnjë me çati katërflegërshe. Qoshku i dalë në pamjen kryesore të banesës, i krijon volumit tërësor një thyerje të dukshme. Së dyti, në të dy variantet ka

21) P. Thomo, *Banesat me «qoshk» në Shqipërinë e Veriut*, në «Etnografia shqiptare», VIII, Tiranë 1976, f. 191-238.



Foto. 1

një ndarje të qartë funksionale të kateve, ku kati përdhes shfrytëzohet vetëm për bagëtinë dhe kattet mbi të për banim. Në variantin e parë ambientet e banimit janë të bashkangjitura dhe komunikojnë direkt me njëri-tjetrin, kurse në variantin e dytë, ambientet e banimit janë të vendosura njëri mbi tjetrin dhe komunikojnë midis tyre me ndërmjetësinë e shkallëve.

Tiparet e përbashkëta, si shprehje e refleks i kushteve të caktuara, flasin me gjuhën e tyre për zhvillim të banesës brenda një kuadri të njëjtë zakonesh e traditash. Ndërsa veçoritë tregojnë se kanë vepruar faktorë specifikë brenda këtij kuadri të përgjithshëm. Kështu, këto veçori nuk ka pse të mos shihen si

shprehje të shtresëzimit klasor të shoqërisë, apo dhe si kundërvënie ndaj pasigurisë shoqërore të kohës, duke ndërtuar banesë me theksim vertikal, me pak hyrje nga jashtë dhe me sa më shumë ambiente nën një çati të vetme. Këto tiparet e fundit i gjejmë sidomos në variantin e dytë.



Foto. 2

Analiza e variantit të parë. — Për analizën e materialit do të nisemi nga shembujt më të thjeshtë. Në tab. I, 1, jepet një banesë dykatëshe me nga një ambient në çdo kat. Në ambientin përdhes strehej bagëtia. Ai njihet me emrin «*aher*» ose «*burg*». Në ambientin mbi të jetonte familja. Ky ambient njihet me emrin «*shpia*» ose «*kulla*». Ka një derë të vetme hyrjeje. Në të djathtë të hyrjes për në ambientin e banimit ndodhet oxhaku. Elementë të tij janë *vatra*, që ngrihet paksa nga dyshemeja e ambientit, *nifa* e oxhakut, *shkorsa* dhe *dollapët* e *murit* në të dy anët e oxhakut. Në dollapët e djathtë mbahen takëmet e kafes. Në këtë anë, sipas zakonit, gjithmonë ulet i zoti i shtëpisë. Në faqen përballë hyrjes është një derë që tëçon në ambientin sanitari, ndërsa në faqen majtas është qoshku. Qoshku kufizohet me mure të holla, të ndërtuara me skelet druri e të veshura me mur guri. Dyshemeja e qoshkut ngrihet rreth 30 cm. mbi atë të ambientit. Në muret e qoshkut janë lënë dritare, të vendosura në një lartësi të tillë nga dyshemeja, nga ku njeriu ndenjur shesh vrojton përfjashta normalisht²². Ambienti i banimit, duke qenë i vetëm, është mjaft i ngarkuar: aty mbahen produktet ushqimore, përgatitet dhe hahet ushqimi, kalohet dita, pritet miku dhe së fundi edhe flihet.

Në tab I, 2 kemi përsëri një banesë dykatëshe me nga një ambient në çdo kat. Në këtë shembull bien në sy këto veçori: *Qoshku* është banesës është drëjtkëndëshe me raport brinjësh 1:1,3 (ndërsa në shembullin e parë ky raport ishte 1:1). Ambienti ka në të dy anët e ngushta oxhaqe, prej të cilave njëri përdorej për përgatitjen e ushqimit, gatim, ngrënje e ndenjen e fëmijëve, ndërsa tjetri përdorej sidomos kur vinin miq. *Dollapët* e *murit* janë të dimensioneve të ndryshme e në përgjithësi pa kapakë. Çatia është treflegërshe. Kallkani në anën përendimore tregon se ideja e ndërtimit të banesës ka qenë e tillë, që me kohë të shtohej, gjë që praktikisht ka ngelur pa u realizuar. *Qoshku* është realizuar me skelet druri të veshur me dërrasa. Dy dritaret e tij mbyllen me kapakë dërrase, që lëvizin horizontalisht. Kati përdhesh ka pasur dy hyrje dhe në brendësi një ndarje të lehtë me gardh, me qëllim që llojet e bagëtive të strehuara të mos përziheshin.

Të dy shembujt që sollëm përfaqësojnë nénvariantin e parë të variantit në shqyrtim. Tradita pohon se banesa të tilla kanë qenë mjaft të kufizuara si numër. Si banesë me një ambient të vetëm banimi, ajo plotësonte kërkesa minimale për të jetuar. Kjo gjë na shtyn të menojmë se duhet të janë përdorur jo vetëm nga familje me përbërje numerike të vogël, por edhe jo në gjendje të mirë ekonomike. Prej dy shembujve që sollëm, njëri është ndërtim relativisht më i vonë se tjetri. Ky fenomen tregon praktikisht se një skemë banese, sado e thjeshtë qoftë, nga një anë nuk përdoret njëherë dhe «pushon» përdorimin e saj dhe nga ana tjetër, duke vazhduar të mbahet, ajo nuk përsëritet mekanikisht. Për këtë flet individualiteti që paraqet secili nga të dy shembujt që

22) Banesa me kohë ka pësuar modifikime të brendshme. Janë hapur dritare të reja (pasi më parë kanë qenë vetëm ato të qoshkut), qoshku është mbyllur nga brenda duke u kthyer në një ambient përfjetje etj.

23) Shembulli i dytë është braktisur me kohë nga banorët. Atë e gjetëm në proces degradimi.

Në tab. II, kemi një banesë dykatëshe, e cila fillimisht ka pasur nga dy ambiente në kat. Ambientet e katis të sipërm, që kanë shërbyer për banim, kanë edhe hyrje të pavarura nga jashtë dhe njëkohësisht komunikojnë midis tyre nga brenda. Qoshku, si element i odës së miqve, shërben edhe si pikë kalimi për në ambient. Oda e miqve është me përmasa më të vogla sesa shtëpia e bukës. E para ka pasur dy oxhaqe në brendësinë e saj, ndërsa e dyta ka pasur fillimisht vatër në mesin e dyshemesë. Me kohë, me rritjen e kërkuesave, janë bërë ndryshime e modifikime të brendshme. Në odën e miqve është vecuar një ambient përfjetje, ndarja e të cilit është realizuar me dërrasa të zdruguara. Në pjesën e poshtme të ndarjes është formuar një podium ndenjës dhe një musëndër për mbajtjen e teshave të fjetjes. Në shtëpinë e bukës pasi është spostuar oxhaku pranë një faqeje muri, janë krijuar edhe tri ambiente përfjetje. Ndarjet e tyre janë bërë me gardh purtekash dhe janë suvatuar me llaç balte. Një praktikë e tillë tregon se cila ishte njëra prej rrugëve që ndiqej për zgjidhjen e nevojave të familjes kur i shthoheshin kurorat²⁴. Shembulli i sjellë përfaqëson nënvariantin më të zhvilluar të variantit të parë. Ambientet themelore të banimit janë oda e miqve dhe shtëpia e zjarrit. Këto janë ambientet më të zakonshme që gjemjë në banesat e kësaj zone. Në këtë nënvariant qoshku është kristalizuar si element vetëm i odës së miqve.

Analiza e variantit të dytë Në tab. III, 1, 2, po japid dy shembuj baneshash trekatëshe me nga një ambient në çdo kat. Raporti i brinjëve në plan ndryshon nga 1:1,4 në shembullin e parë në 1:1,1 në shembullin e dytë. Në secilën banesë në katin përdhesh është «burgu i gjasë» në katin e mesit «shtëpia e bukës» dhe në katin e sipërm «oda e miqve», Të tillë banesa në mënyrë të veçantë tradita i njeh me emrin «kullë». Në secilin rast (foto 3,4) formulimi i jashtëm ka individualitetin e tij. Qoshku është i pranishëm vetëm në odën e miqve. Në shembullin e dytë ambientet e banimit komunikojnë ndërmjet tyre vetëm me shkallë të brendshme druri. Një mënyrë e tillë komunikimi përdoret edhe me burgun. Në shembullin e parë, ngjitja për në katin e tretë bëhet me shkallë të jashtme të ndërtuara posaçërisht. Në të dyja rastet ndarjet me perde dërrase që vërehen në ambientet e banimit janë realizime të mëvonshme. Këto ndarje, të diktuara nga nevoja jetësore, kanë bërë që edhe oxhaku në katin e tretë të shembullit të parë, të spostohet. Në shembullin e tab. IV kemi përsëri një banesë me tri kate me nga një ambient në çdo kat. Me kohë këtij volumi i është mbështetur një dykatëshe (foto 5). Trekatëshja i ka përmasat në planimetri në raportin 1:1,6. Qoshku i saj shërben edhe si pikë hyrjeje për në ambientin e katis të tretë. Ka të ngjarë që fillimisht hyrja nga jashtë të mos ketë qenë në këtë pozicion. Spostimi duhet të ketë ndodhur kur u ndërtua dykatëshja²⁵. Mundet që hyrja nga jashtë për në trekatëshë të ketë qenë

24) Është një nga banesat më të vjetra të fshatit Letëm. E kemi gjetur të pabuanar dhe në proces rrënimis.

25) Trekatëshen nuk e mbajnë mend banorët e sotëm se kur është ndërtuar. ndërsa dykatëshi në fillim të shekullit tonë. Vonë në të gjithë kompleksin janë bërë modifikime të ndryshme, si zgjerimi i dritareve, suvatime muresh, ribërje dyshemesh etj.



Foto. 3

Foto. 4



ajo që ekziston edhe sot në anën perëndimore. Në atë rast komunikimi me katin e sipërm realizohej me shkallë të brendshme druri. Më vonë, me ndërtimin e dykatëshes, u spostua edhe hyrja, e cila, në pozicionin e ri që është vendosur, ndihmon për një komunikim e ndërlidhje më harmonike të kompleksit në tërësi. Ambientet e banimit të trekatëshes janë me nga dy oxhaqe, fenomen ky i njojur në zonën e Çermenikës, në Martanesh, Shemil dhe në Malësinë e Tiranës. Me kohë, sipas nevoja ve janë realizuar edhe ndarjet e brendshme. Ambientet e reja që kanë rezultuar nga këto ndarje janë përdorur përfjetje. Fillimisht *Shtëpia e bukës* ka qenë në katin e mesit të trekatëshes. Me ndërtimin e shtesës, ajo u spostua në katin e sipërm të

kësaj së fundi. Vatra të dykatëshja ka qenë me përmasa jo të zakonshme. Ajo ka pasur të diferencuar dukshëm këndin e pjekjes nga këndi i gatimit të gjellëve, duke qenë përsëri të dy brenda një platforme. Kjo platformë është paksa e ngritur nga dyshemeja prej dhei të ngjeshur e ambientit. Për zonën në shqyrtim është unikal si shembull. Mjaft të ngjashme me të na është dhënë rasti të gjejmë edhe një vatër tjetër në një banesë të Martaneshit. Ka të ngjarë që t'i ketë ndërtuar e njëjtë dorë mjeshtri.

Qoshku i pjesës dykatëshe, me përmasa të mëdha dhe i diferencuar dukshëm nga dyshemeja e ambientit, është përdorur veçanërisht si kënd pér mbajtjen e bulmetrave. Një praktikë e tillë takohet jorrallë në banesat e kësaj zone.

Në tab. V kemi dhënë një banesë trekatëshe me nga dy ambiente në çdo kat. (foto 6). Në katin e tretë ambienti me qoshk ka qenë *oda e miqve*, ndërsa ambienti bri tij shtëpi buke²⁶. Kati i dytë është shfrytëzuar vetëm pér fjetje, kurse në katin përdhes kanë qenë *burgje* pér bagëtinë.

Nga shembujt që sollëm pér variantin e dytë, del e qartë se realizimet më solide të këtij varianti dhe të tipit në tërësi janë banesat trekatëshe me nga një ambient në çdo kat.

Banesa me qoshk karakterizohet nga një skemë kompozicionale e thjeshtë dhe e lexueshme qartë. Me rritjen e kërkesave të familjes pér ambiente të reja, janë ndjekur rrugë të ndryshme zgjidhjeje. Në shumicën e rasteve numri i ambienteve pér banim është rritur nëpërmjet ndarjeve të brendshme të bëra kohë pas kohe. Skema fillestare e banesës, përmasat në plan, pozicioni e struktura e lehtë e shkallëve, hapësirat e ndryshme të lëvizjes e të ndriçimit dhe numri i oxha-



Foto. 5

26) Në shumicën e rasteve *shtëpia e bukës* vendoset me katin e dytë, kurse ambientet e katit të tretë shfrytëzohen si odë miqsh dhe pér fjetje. Banesa kon siderohet si një nga më të vjetrat në fshat. Ndarjet e brendshme me gardh të suvatuar me llaç balte apo me perde dërrase janë një dukuri e vonë. Pozicioni i qoshkut ka një asimetri që lexohet sidomos dukshëm në formulimin e jashtëm të banesës. Dyshimi që rrjedh se mos banesa ka kaluar dy fazë ndërtimi, nuk gjen asnjë mbështetje bindëse në muraturë.

qeve, e kanë favorizuar e lehtësuar këtë fenomen. Kjo tregon se, duke pasur parasysh rritjen e familjes e rritjen e kërkesave të saj për ambiente fjetjeje, pronari në bashkëpunim me mjeshtrin ndërtues dhe në përputhje me mundësitë që kishte, i dilte problemit përpara me kohë. Për më tepër që nga pikëpamja konstruktive realizimi i ndarjeve me strukturë të lehtë nuk hapte telashe e nuk sillte ndryshime në strukturën mbajtëse të banesës. Një parashikim e zgjidhje e tillë ishte racionale, si nga ana ekonomike ashtu dhe nga ana funksionale. Përvoja kishte treguar se nuk ishte aq lehtë të ndërtoje një banësë me kate dhe të harroje parashikimin e plotësimit të kërkesave dhe nevojave për njëfarë kohe. Është e kuptueshme se kjo rrugë e rritjes së numrit të ambienteve, ku banesa përsëri funksionon si një e tërë unike, tregon, nga një anë, se familja nuk i është nënshtruar ende procesit të dekompozimit të saj, procesit të krijimit të njësive të reja familjare, dhe, nga ana tjetër, tregon që me ngushtimin sipërfaqësor të ambienteve tradicionale, sic janë *shtëpia e bukës* dhe *oda e miqve*, banesa ekzistuese brenda volumit të saj nuk mund t'i përballonte më këto nevoja. Përveç parashikimeve për ndarje të brendshme, vërehet edhe fenomeni kur volumit



Foto. 6

fillestar i bashkangjitet një përdhese apo edhe dykatëshe (*P.sh. tab. IV*). Edhe në këtë rast, ndërtimi, ndonëse është realizuar me fazë, funksionon përsëri si një e tërë organike për një familje të vetme.

Së fundi, vërehet edhe fenomeni kur volumit fillestar i bashkangjiten volume të njëpasnjëshme. Shembulli që sjellim për ilustrim (*tab. VI*), ka pasur si bërthamë fillestare një trekatëshe me qoshk, me nga një ambient në çdo kat. Në dy etapa të mëvonshme i janë bashkangjitur dy blloqe të njëpasnjëshme. Ky fenomen vërehet atëherë kur familja është ndarë në njësi të reja, por që vazhdojnë të jetojnë nën një çati të vetme. Këtë e tregon edhe fakti që blloqet e reja të shtuara funksionojnë

edhe të pavarura nga njëri-tjetri. Në pikëpamje etnografike ky fenomen tregon se lidhjet në fis janë ende të forta, gjë që, me sa duket, e ushqen koha me pasigurinë e saj. Ndërsa në pikëpamje arkitektonike në këto raste nuk mund të flitet për zhvillim nga ana kompozicionale si tërësi, sepse kuptohet që kompleksi i banuar nuk u nënshtronhet një qëllimi e ideje të vetme, të diktuar nga kërkeshat e një familjeje, por u nënshtronhet tërësisht kërkeshave të familjeve të veçanta.

Nga sa parashtruan del e qartë se në të dy variantet e banesës me qoshk, kur jeta ka diktuar nevojat e saj, janë bërë ose *modifikime* ose *shtesa*. Me modifikime kuptojmë në rastin tonë kryesisht transformime të brendshme, siç janë ndarje të ndryshme apo hapje e mbyllje dyersh. Një fazë të mëtejshme në këtë proces përbën rritja e numrit të hyrjeve nga jashtë. Kjo e fundit ndodh kur familja i është nënshtruar procesit të ndarjes dhe nuk ka mundësi ekonomike të ndërtojë banesë të re, por shfrytëzon pér një kohë banesën e vjetër. Më tej, faza më me rëndësi është ajo kur kemi shtesë volumi, bashkangjitje njësish të reja në volumin e vjetër nga ajo anë që e favorizon terreni. Mundësitet e shtesave në një banesë dykatëshe, në kushtet e një trualli normal, janë më të mëdha e më të favorshme sesa në një trekatëshe. Sidoqoftë, praktika tregon se pér një normë kategorike nuk mund të flitet. Të gjitha sa thamë tregojnë se banesa, ashtu si familja, nuk rri në vend. Rritja e kësaj së fundit, pér mundësi të caktuara ekonomike, çon në modifikimin apo rritjen e banesës. Proseset e modifikimit apo të rritjes së banesës flasin në një drejtim pér rritjen e familjes, ndërsa në drejtimin tjetër pér praninë e dekompozimit të saj pér periudhën në shqyrtim. Këto fenomene janë të lexueshme në të gjitha ndërtimet popullore të zonës së Çermenikës dhe jo vetëm në këto vendbanime që po shqyrtojmë.

Më poshtë po ndalemi në përshkrimin e ambienteve kryesore të banimit dhe të elementeve arkitektonike më të rëndësishme të tyre dhe të banesës në tërësi.

Shtëpia e zjarrit. Në variantin e parë është e përngjitur me odën e miqve dhe përvëç komunikimit të brendshëm me të, ka edhe hyrje të veçantë nga jashtë. Në variantin e dytë qoftë në fillim kur është ndërtuar banesa, ashtu edhe më vonë, kur janë bërë ndarje të brendshme, ka ngelur kryesisht në katin e mesit. Sipërfaqja e dobishme e saj në të dy variantet lëviz nga 25 m^2 deri në 45 m^2 . Ndërsa raporti i brinjëve lëviz nga $1:1$ deri në $1:1,5$ në variantin e parë, ndërsa nga $1:1$ deri në $1:1,8$ në variantin e dytë. Dyshemeja në të gjitha rastet realizohet me dhe të njëjshur të hedhur mbi *hartosa*²⁷. Jo në pak raste janë përdorur në vend të hartosave edhe lëndë druri e hollë me seksion të rrumbullakët. Kjo është një dukuri e këtyre ambienteve në Çermenikë.

Në këtë ambient mbahen produktet ushqimore, rrinë gjatë ditës kryesisht gratë e fëmijët dhe përgatitet e hahet ushqimi. Pajisjet e orënditë kryesore janë magjja e bukës, hambarë me përmasa jo të mëdha ose arka si dhe enë e pajisje edhe pér mbajtjen e bulmetrave dhe të ujit të pijshëm. Pajisjet pér këtë të fundit, kryesisht prej druri, kanë qenë të domosdoshme, pasi zakonisht uji ka qenë relativisht larg banesës dhe marrja e tij bëhej një ose e shumta dy herë në ditë. Në

27) *Hartosat* janë dërrasa të shkurtra rreth 1 m. të gjata, që dalin nga çarja e trungjeve të holla me sëpatë.

mure dhe në trarët e çatisë ose të dyshemesë së kosit mbi të, ka pasur bishta apo gremça prej druri për varje sendesh të ndryshme. Jorrallë mbi trarët horizontalë të çatisë hidheshin shtresa provizore me dërrasa, lëndë të holla ose trina të thurura me purteka. Mbi një shtrojë të tillë, e cila kishte mundësi ajrimi nga të gjitha anët, depozitoheshin produkte të ndryshme, të cilat liheshin aty në ruajtje, për t'i përdorur gjatë stinës së dimrit. Për ngrënien e ushqimit është përdorur sofra. Të tilla zakonisht ka pasur më shumë se një, me dimensione të ndryshme, në varësi nga numri i personave që do të uleshin për të ngrënë. Në ato raste kur i moshuari i familjes e kishte zakon të hante veçmas, i shërbehej me një sofër të vogël të posaçme për të. Në të gjitha rastet ushqimi për ngrënien servirej në një enë të përbashkët, e cila vendosej në mesin e sofrës.

Në shtëpinë e bukës ndodhej *vatra*, e cila shërbente për ngrohje dhe përgatitjen e bukës dhe të ushqimit. Forma më e vjetër është ajo e hapur, e vendosur në mesin e dyshemesë së ambientit. Vonë ka depërtuar në masë *vatra* me oxhak pranë një faqeje muri. Në të dyja rastet, nën nivelin e trarëve të çatisë vendosej një *shkorsë*, si parandluese e shkëndijave të zjarrit. Mungesa e tavanit lehtësonte largimin e tymrave nëpër çati. Për ndënje rrëth vatrës e ngrënies, përvèç *postiqeve* (lëkurë bagëtish) përdoreshin edhe *shkamba* të vegjël, numri e madhësia e të cilëve ishte edhe në varësi të pjesëtarëve të familjes. *Shkambat* vonë kanë filluar të bëhen edhe prej dërrase, por format më të hershme dhe më karakteristike të tyre janë copa trungjesh prej druri të formave të ndryshme.

Përvèç sa më sipër, ky ambient është shfrytëzuar jorrallë edhe për fjetje. Veçanërisht sipas traditës aty flinte gruaja e moshuar dhe vajzat. Në shumicën e rasteve shtrohej në dysheme, duke shfrytëzuar postiqet, por nuk kanë munguar edhe podiume të ulëta prej dërrase.

Ky ambient merr ndricim të pakët natyral. Për këtë qëllim përdoreshin baxha (në çati) ose dritare me përmasa të vogla (*tab. VII; 2,4*). Nga dritaret e sjella si shembull me interes është tipi nr. 2. Ai formohet me rripa dërrase, të cilët priten në forma të tilla që, kur bashkohen, formojnë një tërësi harmonike dhe nga ana funksionale lejojnë një shikim relativisht të lirshëm nga brenda jashtë dhe jo të lehtë anasjelltas.

Oda e miqve — Është ambienti relativisht më komod në banesë. Dihet se kjo është një veçori që bie në sy në mbarë banesën populllore shqiptare, si një dukuri që lidhet me traditën e lashtë të mikpritjes. Në rastin tonë kujdesi nga pikëpamja ndërtimore pasqyrohet kryesisht në trajtimin dhe përpunimin në tërësi të volumit të brendshëm dhe të elementeve të tij përbërëse. Ky kujdes fillon që me punimet e gurit, vazhdon me ato të drurit dhe arrin deri te pajisjet e lëvizshme si shtrojat e ndryshme rrëth oxhakut etj. Kështu, te *dritaret* vërehet një punë më e kujdeshme në formulimin e jashtëm e të brendshëm të tyre (*tab. VI; 1,3,4*). Përkujdesja duket te dollapët e murit e sidomos te *kompleksi i oxhakut*. Gurët që formojnë niqen e oxhakut janë zgjedhur posaçërisht me përmasa më të mëdha e janë skalitur me kujdes. Dollapët anash niqes vishen me korniza druri dhe pajisen edhe me kapakë të lëvizshëm. Edhe *shkorsa*, (*tab. VIII*), element i kompleksit të oxhakut, konceptohet me përmasa më harmonike në raport me ambientin dhe me një përpunim më të kujdeshëm nga rastet e përdori-

mit të saj në shtëpinë e bukës. Së fundi, këtë ambient e pasuron dukshëm *qoshku*. Ai ka vlerë të dyfishtë funksionale dhe estetike. Shkëputja në lartësi e dyshemësë së tij nga ajo e ambientit, ndërprerja e kujdeshshme e mureve perimetrale në këtë pjesë, përpunimi më i arritur i veshjeve prej druri dhe lënia e dritareve në mënyrë të përqëndruar te ky element, janë disa tregues shumë domethënës, që i tërheqin vëmendjen vizitorit, i cili e ndien se aty ka të bëjë me një kënd komod ndjenjjeje.

Sipërfaqja e qoshkut praktikisht varion nga $3m^2$ deri në $10m^2$; ndërsa sipërfaqjet e ambienteve që kanë qoshk lëvizin nga $25m^2$ deri në $45m^2$. Po të ndjekim raportin e këtyre sipërfaqeve, d.m.th. të sipërfaqes së qoshkut me atë të ambientit korrespondues, rezulton se ky rapport lëviz nga 1:10 deri në 1:4. Kjo luhatje është një tregues me rëndësi i faktit që në arkitekturën popullore, brenda një tipi të caktuar, nuk mund të flitet pér përdorim në formë «modeli» të gatshëm e brenda kanonesh të ngurta të elementeve të tilla arkitektonike. Pra, mjeshtri ndërtues qoftë ose jo i njëjti, as nuk zbatonte «modele» të gatshme dhe as mund të vepronë si të donte. Ai, duke marrë parasysh çdo herë kërkessat e porositësit, ishte njëkohësisht edhe në rolin e krijuesit. Prandaj jo rastësish ndodh që nuk takon dy qoshqe njësoj, por çdo rast paraqitet me individualitetin e tij.

Madhësia e daljes së qoshkut jashtë planit vertikal të mureve ka një luhatje shumë të vogël. Në çdo rast ai nuk del më pak se $1,0m$, dhe jo më shumë se $1,2-1,3m$. Ky nuk është një tregues pa domethënë. Mjeshtri kishte një përvojë të gjatë në fushën e konstruksionit dhe në këto probleme nuk u bënte lëshime dëshirave subjektive të porositësit. Jo rastësisht, kur dalja është më e madhe nga konstantja e zakonshme dhe kur veshja e pareteve të qoshkut është realizuar me mur guri, mjeshtri përvëç jashtëqeve me trarë të dubluar, ka futur në përdorim edhe pajantat (foto 7). Madje këtyre të fundit u ka dhënë edhe njëfarë përkulshmërie nga brenda, gjë që jo vetëm ndihmon konstruksionin mbajtës, por edhe rrit efektin estetik të formulimit të qoshkut dhe të pamjes së banës në tërësi.

Theksuam që funksioni kryesor i odës së miqve është pritja e mikut. Vendet më të nderuara pér ndjenjje kanë qenë pranë oxhakut në dimër dhe pranë qosh-



Foto. 7

kut në verë. Miku, së bashku me burrat e shtëpisë aty han-te ushqimin, i cili servirej në sofër. Vendi i fjetjes për mikun ishte gjithmonë qoshja e majtë e oxhakut, pasi në të djathë, flinte vetë i zoti i shtëpisë. Teshat për fjetjen e mikut mbaheshin në këtë ambient të vendosura mbi një arkë ose podium druri. Oda e miqve ka pasur ambient sanitari të vetin. Si rregull në hyrje të këtij ambienti ose në sheshpushimin e shkallëve të jashtme lihej një avdes-hane, një lloj lavamani prej druri për larjen e duarve dhe të fytyrës.

Në rastet kur nuk vinin miq në këtë ambient kalonte kohën e lirë e flinte më i moshuari dhe meshkujt beqarë të familjes.

Rregullin e përgjithshëm në odën e miqve e vendoste, si në të gjitha ambientet e banesës, gruaja, e cila kujdesej në veçanti për këtë ambient pér ta pasur atë gjithmonë në gatishmëri pér pritje në çdo kohë.

Disa karakteristika të tjera të këtij ambienti janë: Së pari, sipërfaqja e brendshme e muraturës nuk është e suvatuar, ndonëse fugat i ka të punuara relativisht më me kujdes. Kjo i jep ambientit njëfarë ashpërsie e ftohtësie. Së dyti, është pa tavan. Ky fakt, veç të tjerash, e rrit mungesën e dozës së intimititetit të nevojshëm pér një ndenjje komode. Së terti, drita natyrale që hyn në ambient është e pamjaf-tueshme në raport me përmasat e volumin që ka ambienti dhe që-llimin pér të cilin shërben.

Vumë në dukje që ky është ambienti më paraqitës në këtë banesë. Kuptohet se jo në të gjithë shembujt mund të flitet pér arritje të njëjtë. Fakt është që në tërësi banesa e kësaj zone ka një natyrë përgjithësisht të përbajtur ndaj kërkesave estetike si në formulimin e brendshëm, ashtu dhe në atë të jashtëm. Çdo gjë e karakterizon fryma e një utilitarizmi të rreptë dhe ndjenja e përbajtur e racionalitetit. Mandej të mos harrojmë shtresëzimin klasor të shoqërisë. Kjo e fundit tregon se s'mund të flitet pér nivelim e arritje të njëjta nga të gjitha shtresat.

Të dy ambientet që analizuam kanë qenë ata që plotësonin nevojat themelore të jetesës së përditshme. Duke pasur parasysh funksionet që kryejnë në raport me numrin e tyre të vogël, kuptohet përsë këto ambiente kanë qenë me përmasa relativisht të mëdha. Funksionet e shumta kërkonin njëfarë organizimi të brendshëm të këtyre ambienteve. Numri i orendive të lëvizshme nuk është i madh. Kjo duhet parë edhe si shprehje e një koncepti racionaliteti në shfrytëzimin e sipërfaqes së banimit, në kuptimin që funksionet në procesin e plotësimit të tyre të mos pengohen nga njëri-tjetri. Por edhe nga kjo pikëpamje, pra nga shkalla e përpunimit dhe e pajisjes të ambienteve kryesore të banesës dhe e koncepteve udhëheqëse pér këto fenomene, diktonte niveli i zhvillimit ekonomiko-shoqëror e kulturor. Prandaj mund të themi se ashtu si banesa në tërësi, edhe këto ambiente janë pasqyrë e kohës së vet, janë pasqyrë jo vetëm e gjendjes ekonomike, por edhe e asaj sho-qërore e kulturore.

Formulimi i jashtëm i kësaj banese karakterizohet nga volumi i mbyllur, brenda të cilët përfshihen ambientet kryesore pér jetesë. Ash-përsia e lokanizmi i muraturës së gurit thyhet nga brezat e drurit dhe nga volumi i qoshkut, i dalë në formë konsoli. Çatia me strehën e saj të dalë ndihmon së bashku me qoshkun pér thyerjen e volumit prizma-

tik të banesës, duke i dhënë njëfarë dinamizmi me kontrastin e dritëhieve që krijohen.

Dihet se ky karakter i mbyllur dhe sidomos ngritja në lartësi e banesës duke i futur ambientet një mbi një nën një çati të vetme shpreh në vetvete edhe idenë e mbrojtjes.

Problemit të forcimit të karakterit mbrojtës në ndërtimet e banimit të Çermenikës, i është dalë përpara në forma të ndryshme. Gjatë gjurmimeve kemi konstatuar se rruga e mësipërme është njëra prej tyre. Në banesa të vjetra, që nuk shkojnë më shumë se dy kate dhe që karakterizohen nga ambiente me përmasa relativisht të mëdha e një shtrirje më shumë horizontale e banesës, vërehet ngritja e «kullëzave» në një qoshe të banesës. Këtë e tregon një banesë e gjetur në Kostenjë të Çermenikës (foto 8). «Kullëza» ngrihet në lartësinë e dy kateve, duke shfrytëzuar pjerrësinë e terrenit. Ambienti i sipërm i saj i ka muret perimetrale të mbushura me frëngji në pozicione të ndryshme e me lartësi të manovrushme në qëndrime të ndryshme në dysheme. Ky ambient ka përmasa të vogla dhe mund të shfrytëzohet për banim vetëm në raste të rralla²⁸.



Foto. 8

Përveç dy rrugëve të mësipërme, një rrugë tjetër ka qenë ndërtimi i banesave të pajisura vetëm me çikma e me frëngji (foto 9). Veçse këto të fundit nuk arritën as në teknikën e ndërtimit dhe as në formulin tërësor atë përkryerje si në krahinën e Matit. Të gjitha këto rrugë

28) Në favor të një shfrytëzimi të tillë flet edhe prania e oxhakut me dollapët e kafes anash dhe e një vatre me përmasa të vogla.

tregojnë se edhe në këtë zonë pasiguria diktonte si fenomen shoqëror kërkesat e veta dhe banesa me gjuhën e saj është përpjekur t'i materializojë.



Foto. 9

Tipi në shqyrtim nuk i ka përkitur një shtrese të vetme shoqërore. Edhe pse është një zonë relativisht e vogël, materiali faktik flet për ekzistencën e diferencimeve ekonomike e shoqërore të shtresave të ndryshme të fshatarësë. Këto diferencime në mënyrë të veçantë lexohen në ndryshimet që vërehen në trajtimin arkitektonik e pajisjen e brendshme të ambienteve. Duke qenë po ai tip në planin e kompozimit planimetriko-volumor, konstatohet se në mënyrën e të jetuarit shtresat e ndryshme, pavarësisht diferencimeve ekonomike, i karakterizonte po e njëjta forcë zakoni në vijat themelore.

Banesa me «qoshk» nuk është një fenomen i izoluar i përhapur vetëm në zonën që shqyrtuan. Një përhapje të gjërë ajo ka pasur në disa zona të Shqipërisë së Veriut, në pellgun që përfshihet ndërmjet katër grykave të mëdha²⁹, ndërsa konstatohet se është ndërtuar edhe në Malësinë e Tiranës, por me një përdorim të kufizuar³⁰. Duke bërë krasimet me shembujt e përhapur në këto zona, rezulton se në kompozimin planimetriko-volumor dhe në emërtimin e zgjidhjen e ambienteve me funksion të njëjtë, kemi ngjashmëri të dukshme. Pra, nuk mund të flitet për asnjë veçori dalluese themelore. Ndërsa si dallime jothelbësore

29) P. Thomo, art. cit.

30) A. Muka, *Banesa fshatare në Malësinë e Tiranës gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX*, në «Etnografia shqiptare» IX, Tiranë 1978, f. 267-268.

mund të konsiderohen: *Së pari*, qoshku në fshatrat që shqyrtuanë eشتë vetëm element i odës së miqve, qoftë në banesat me tri kate, ashtu edhe në ato me dy kate: *Së dyti*, oda e miqve në këto fshatra nuk ka asnjëherë më shumë se një qoshk, fenomen që ka ndodhur në zonën e Shqipërisë së Veriut. *Së treti*, banesa me qoshk në zonën midis katër grykave të mëdha përdorej edhe si ndërtim i dytë në oborr, në funksionin e odës së miqve. Ky fenomen nuk ka ndodhur në fshatrat e Librazhdit. *Së katërti*, zgjidhet kompozicionale me bashkangjitje njësish të njëjta, që vërehen sidomos në zonën e Milotit³¹, nuk i takojmë asnjëherë në fshatrat që shqyrtuanë këtë artikull.

Kemi vënë në dukje se në Çermenikë tipi mbizotëruesh ka qenë *banesa me telize*. Më poshtë le të shikojmë se ku qëndrojnë veçoritë midis kësaj banese dhe *banesës me qoshk*, si dhe çfarë i bashkon ato. Eشتë vënë në dukje³² se banesa me telize eشتë ndërtuar me dy ose me tri kate. Ajo karakterizohet nga ndarja e qartë funksionale e kateve. Në zhvillimin kompozicional karakterizohet nga dy variante themelore. Veçori dalluese në zhvillimin kompozicional paraqesin ato raste kur kemi bashkangjitje njësish të njëjta, që të lënë përshtypjen e një zhvillimi të moduluar. Edhe nga sa parashtruam shkurtazi, kuptohet se këta dy tipa kanë ngjashmëri në vijat themelore. Kjo ngjashmëri shtrihet deri në materialet e teknikën e ndërtimit, apo në gjuhën e njëjtë të përpunimit të elementeve të ndryshme funksionale e arkitekturore. Dhe një gjë e tillë eشتë e kuptueshme. Kemi të bëjmë me ndërtime banimi të një zone me tradita e zakone të njëjta e me zhvillim ekonomiko-shoqëror pa diferencime të thella në masën e fshatarësisë. Për rrjedhim, ka ekzistuar i njëjti program në vijat themelore. Këta faktorë përbëjnë bazën e emëruesh të përbashkët të këtyre ndërtimeve. Për sa u përket diferencimeve midis tyre, duke marrë dy shembuj (nga një për secilin variant brenda secilit tip) vërehet sa më poshtë: *Së pari*, banesa me qoshk karakterizohet nga prania e një qoshku të veçuar në formulimin e jashtëm, ndërsa banesa me telize karakterizohet nga shtjellimi i një galerie të mbyllur prej druri (foto 10), që shpesh përfshin të katër faqet e mureve, deri edhe kafazin e shkallëve (foto 11). Me telizinë në aspektin funksional zgjidhen probleme të tillë si: nevojat për ambiente ndihmëse (depozite), për ambiente shërbimi (nyjet sanitare) dhe problemet e ndërlidhjes së ambienteve të banimit. Njëkohësisht me të arrihet një zgjidhje më kompakte, një diferencim volumesh të mbyllura me karakter më masiv e më organik. Të gjitha këto tregojnë se prania e telizit apo e qoshkut mund të shihet thjesht si një diferençim në formulimin e jashtëm, ndonëse në shikimin e parë atje duket e lexueshme. *Së dyti*, banesa me telize ka si veçori tjetër dalluese praninë e qepenit, një qoshk i hapur nga brenda, por i mbyllur nga jashtë në një plan me telizin. Ky element në shembujt më të përkryer të banesës me telize, arrin deri në gjysmën e mureve perimetrale të katit³³, ndërsa *qoshku* në banesën me qoshk, kap gjithmonë vetëm një pjesë relativisht të kufizuar të njërit mur perimetral. Nga këto dy

31) P. Thomo, art. cit.


32) A. Muka, *Arkitektura populllore e Shqipërisë së Mesme (banesa me telize)* në Monumentet 11, Tiranë 1976, f. 201-224.

33) Po aty, faqe 201 dhe tab. I.



Foto. 10

Foto. 11



zgjidhje, të krijohet përshtypja se e para është një arritje më e avancuar dhe një lidhje më e mirë e ambientit me natyrën, duke i dhënë më shumë ajër e dritë. Nga sa parashtruan kuptohet se **qepenin** edhe **qoshkun** i bashkon në thelb i njëjtë koncept ndërtimor e funksional, si dy elemente arkitektonike, që marrin pjesë aktive në formulimin e brendshëm të banesës. Por ata kanë edhe nuancat e individualitetin e tyre, si brenda secilit variant banese, ashtu edhe brenda tipave në tërësi. Mjafton të kujtojmë shembujt me bashkangjitje bërthamash të njëjta në banesën me telize, ku kemi një përsëritje ritmike të qepenit që nuk lexohet fare në formulimin e jashtëm, pasi i lidh në një të

tërë unike telizi³⁴. **Së treti** dihet se një funksion me rëndësi i telizit është edhe mbrojtja e mureve perimetrale në ato anë ku shiu përplaset me erë. Duke qenë po e njëjtë teknikë ndërtimi e mureve edhe në banesat me qoshk, problemi të mësipërm i është dalë përparrë duke ndërtuar strehë më të gjera se të zakonshmet (tab. X). Në një banesë me telize konstatohet se për realizimin e telizit është e nevojshme një sasi e madhe lënde druri, deri edhe e sharruar. Pamundësia praktike për ta siguruar atë në çdo kohë e nga çdo familje, ndoshta ka qenë një faktor që e ka shtyrë mjeshtrin ndërtues që të përshtasë skema të njoitura e të pëlqyeshme për banorët, sipas mundësive e rrëthanave. Me këtë kuptohet nga një anë trualli i favorshëm i përdorimit të dy tipave në Çermenikë dhe nga ana tjetër prania gjithnjë e forcës krijuese dhe adaptuese e mjeshtrit ndërtues sipas rrëthanave, si shprehje e një përvoje të gjatë.

Si konkluzion për banesën me qoshk mund të themi se, ndonëse zona e përhapjes është e kufizuar, larmia e zgjidhjeve si shprehje zhvillimi ka qenë e pranishme. Përdorimi i të njëjtë tip nga shtresa të ndryshme shoqërore, tregon se ato shtresa në thelb i karakterizonin të njëjtat tradita e zakone në preferencën për tipin e banesës. Njëkohësisht teknika e njëjtë e ndërtimit nga shembujt më të thjeshtë e deri tek ato më të zhvilluar, formulimi e konceptimi në tërësi me ndryshime jothelbësore, stabiliteti relativisht i dukshëm në skemën kompozicionale tregojnë: **Së pari**, se këto ndërtime janë realizime të një kohe relativisht të njëjtë ose të afërt. **Së dyti**, se zhvillimi kompozisional me stabilitetin e tij i ka kaluar provat dhe prandaj është bërë i preferueshëm. **Së treti**, është ky stabilitet në kompozim dhe në formulimet kryesore që e bashkon këtë tip me tipa të tjerë banesash³⁵. **Së fundi**, qëndrueshmëria relative që bie në sy brenda vetë tipit të banesës me qoshk, është shfaqje kuptimplotë e asaj qëndrueshmërie që ka pasur në tërësi mënyra e të jetuarit. Kështu që zhvillimi ka ekzistuar. Ai ka qenë i ngadaltë, i kuptuar brenda kuadrit të një zhvillimi ekonomik e shoqëror të dhënë në të gjitha shfaqjet e tij.

2. Banesa me çardak

Shembuj të këtij tipi kemi gjetur kryesisht në Librazhd-Katund, në Letém dhe në Kuturman. Mungesa e shembujve të shumtë dhe mosnjohja e gjerë në popull, të bëjnë të dyshosh se nuk ka qenë e preferuar në këtë zonë. Ndoshta e ka penguar përhapjen edhe klima dhe terreni i thyer. Në këto rrëthana shembujt që do të sjellim, tregojnë se banesat me çardak ndonëse janë të vjetra si ndërtime, ka të ngjarë të jenë sjellë edhe nën ndikimin e mjeshtrit ndërtues. Sidoqoftë dhënia e materialit ka si synim kryesor të japë se çfarë e karakterizon këtë tip banese në këtë zonë dhe për tu shërbypet njëkohësisht studi-

34) Për këtë shembujt më me interes i kemi takuar në banesën e Malësisë së Tiranës, *art. cit.*

35) Në mënyrë të veçantë, varianti me tri kate, me nga një ambient në çdo kat i kësaj banese, ka ngjashmëri të dukshme në kompozime me *Kullën e Matit*. Për sa më sipër shih edhe P. Thomo, *Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe Mirditë* në «Etnografia shqiptare» IV, Tiranë 1972, f. 202-241.

meve përgjithësuese lidhur me shkallën e shtrirjes e të dendësisë së përhapjes së këtij tipi brenda vendit tonë. Aq më tepër, kur dihet se kjo banesë ka pasur përhapje edhe në luginën e Shkumbinit³⁶. Nisur nga qëllimet e mësipërme më poshtë po analizojmë tre shembuj karakteristikë.

Në shembullin e parë (*tab. XI*) kemi një banesë me çardak në të gjithë ballin³⁷. Është dykatëshe me nga dy ambiente në çdo kat. Kati i sipërm ka shérbyer pér banim, ndërsa përdhesi pér strehimin e bagëtisë. Secili nga ambientet e banimit ka derën e tij të hyrjes. Ato paraprihen me nga një galeri prej druri. Ambientet e banimit komunikojnë me çardakun. Çardaku, në raport me të dy këto ambiente, ka një sipërfaqe sa $3/4$ e sipërfaqes së tyre. Është i shtruar me dysheme dërrase dhe nuk ka tavan. Nga të dy ambientet e banimit, i majti ka qenë *odë miqsh*, ndërsa i djathti, shtëpi buke. Të dy marrin ndriçim natyral nëpërmjet baxhove të lëna në çati. Ojhaku i shtëpisë së bukës, sipas disa shenjave, ka qenë në mesin e dyshemesë, ndërsa më vonë është spostuar pranë një faqeje muri.

Banesa është vendosur paralel me vijat e terrenit. Muratura është realizuar me gurë e llaç balte dhe ndërpritet në lartësi të caktuara nga breza druri. Struktura mbajtëse e çatisë është realizuar me lëndë druri të rrumbullakët, ndërsa mbulimi është kryer me tjegulla të lugta. Ambientet e katin përdhesh janë përdorur pér strehimin e bagëtisë, ndërsa hajati para tyre si vend depozite. Duhet të jetë ndërtuar si banesë nga fundi i shekullit të kaluar. Vëtëm në Librazhd-Katund mbahen mend tri banesa të tilla dy prej të cilave janë rrënuar me kohë. Në banesën që jepet në *tab. XII* çardaku nuk shtrihet në të gjithë ballin. Në botimet tona një variant i tillë është quajtur «*me një krah*». Edhe kjo banesë është dykatëshe, ku kati i sipërm ka shérbyer pér banim, ndërsa përdhesi pér strehimin e bagëtisë. Çardaku është i mbyllur me dërrasa, duke lënë pér ndriçim disa hapësira me përmasa të vogla. Në murin pérballë perdes me dërrasa ndodhet një ojhak dhe vatra me përmasa të vogla. Aty i zoti i shtëpisë u «piqte kafe miqve në periudhën e verës». Pér sa u pérket materialeve të ndërtimit, teknikës së ndërtimit e formulimit të ambienteve me destinacion të njëjtë, nuk vërehet ndonjë ndryshim thelbësor në krasim me shembullin e parë. Dy ambientet e vogla, (majtas vrojtuesit) kanë shérbyer pér fjetje, ndërsa ai ndërmjet tyre si shtëpi buke. Një pjesë e dyshemesë së këtij të fundit është bërë me dërrasa, ndërsa pjesa tjetër me dhë të ngjeshur. Sipas pohimeve pjesa me dërrasa përdorej si *qur bulmeti*. Me të komunikohej nëpërmjet një kapaku dërrase. Një tip të tillë quri e kemi takuar në Malësinë e Tiranës³⁸, ndërsa në zonën që po shqyrtojmë nuk e kemi takuar herë tjetër. Ambienti pérballë hyrjes nga jashtë ka qenë oda e miqve. Men-dohet se edhe kjo banesë është ndërtuar nga fundi i shekullit të kaluar.

Në *tab. XIII* kemi sjellë një banesë, në të cilën çardaku ndodhet në qendër. Nga sa shihet në skemat planimetrike të kësaj banese, ajo në

36) P. Thomo, *Arkitektura e banesave fshatare shqiptare (Tipa dhe përhapja e tyre)*, në «*Studime historike*», Nr. 3, Tiranë 1974, f. 123-154.

37) Më shumë në këtë zonë përdoret fjala *divanhane* në vend të fjalës *çardak*.

38) A. Muka, *art. cit.*

pjesën qendrore éshtë dy kate, ndërsa në të dy krahët me tri kate. Lartësia e katit përdhes éshtë më e madhe se e katit sipër dhe kjo ka ndihmuar që në të dy krahët, nën nivelin e katit të sipërm, të krijuhen nga dy ambiente. Kjo ka bërë që në të dy krahët të kemi gjashtë ambiente të vogla, nga dy në çdo kat. Në katin e sipërm janë shfrytëzuar përfjetje dhe në katin përdhes *si burgje* përfjetje bagëtinë apo vendepozite. Dy ambientet e katit ndërmjetës ka të ngjarë të jenë përdorur edhe përfjetje. Pamundësia ekonomike përfjetje shtuar banesën ka çuar në një zgjidhje të tillë. Veçse fakti që hyrja përfjetje realizohet me shkallë portative nga sipër ose nga poshtë dhe sidomos prania e drifteve në formë frëngjje, na bën të dyshojmë që këto ambiente të jenë përdorur edhe përfjetje qëndrim të përkohshëm të meshkujve në raste reziku a ndonjë hasmërie. Nuk kemi takuar tjetër zgjidhje të tillë në këtë zonë. Dy ambientet kryesore në katin e sipërm kanë qenë *oda e miqve* dhe *shtëpia e bukës*. Fillimisht oda e miqve (djathtas vrojtuesit) e ka pasur hyrjen në anën lindore. Vonë në të dy ambientet janë bërë modifikime. Secili nga këto ambiente ka pasur qoshk, i cili éshtë myllur më vonë. Në çardak hyhej vetëm nëpërmjet odës së miqve. Ai ka pasur oxhakun e tij. Faqja e jashtme e çardakut ka qenë e myllur komplekt me dërrasa, ndërsa vonë éshtë modifikuar. Në rastin e parë, kur çardaku ishte i myllur, kishte dy rreshta dritaresh. Në rreshtin e poshtëm ato ishin me përmasa relativisht më të mëdha dhe mybille-shin me kapakë, ndërsa në rreshtin e sipërm kishte dy dritare me përmasa të vogla, që nuk mybilleshin asnjëherë. Dritare të këtij karakteri takohen shpesh në zonën e Çermenikës, si në banesën me telize ashtu dhe në atë me qoshk. Ato mund të kenë shërbyer edhe si pika vrojtimi, por pozicioni i tyre, përmasat, lënia vazhdimit hapur, indirekt të kujtojnë që ambienti korrespondues duhet të ketë shërbyer përfjetje. Duke qenë të hapura, ato në afërsi të mëngjesit sinjalizonin ardhjen e agimit. Pra, lozni rolin e paralajmërueshit të ditës së re përfshatarin.

Këto ishin tre shembujt më karakteristikë të tipit të banesës në shqyrtim.

Ato i bashkojnë midis tyre, përveç teknikës së ndërtimit, elementeve të njëjtë arkitektonike e funksionale edhe ideja e njëjtë në vijat themelore e zgjidhjes kompozicionale. Dihet se banesa me çardak e hajat në vendin tonë ka pasur përhapje të gjerë, sidomos në zonat e ulëta fshatore dhe qendrat qytetare të Shqipërisë së Mesme, e konkretisht edhe në luginën e Shkumbinit. E theksuar faktin e fundit, pasi fshatrat në shqyrtim shtrihen në krahun e dritët e rrjedhjes së mesme të këtij lumi.

3. «Shpia me telize» e Qarrishtës

Qarrishta është një fshat kufitar, në ekstremin Verilindor të Librazhdit. Është i vendosur kryesisht në rrëzën e shpatit të Krastës së Larë, siç i thonë vendasit. Përfund fshatit kalon një përrua malor, i njojur me emrin «Zalli i Qarrishtës». Në të majtë të rrjedhës së përroit ndodhen Malet e Kuqe, me gjelbërim të plotë e të përhershëm. Në të djathtë të rrjedhjes së përroit është vendosur pjesa më e madhe e

fshatit. Tradita thekson se Qarrishta është formuar vonë si vendbanim. Fillimisht përdorej si vend stanesh verore nga fshatrat Letëm e Kosho-riشت.

Tipi karakteristik i banesës që takojmë në këtë fshat ka një shkëputje, sidomos në kompozim, nga banesat e tjera të ndërtuara në të gjithë zonën e Çermenikës. Të moshuarit vënë në dukje se ndërtimet e vjetra në shumicën e tyre ose u dogjën gjatë luftërave, ose u rrënuan. Prej tyre ka ngelur vetëm një banesë me qoshk (tab. VI), të cilën e analizuam. Për të, thuhet se është ndërtuar «qysh në kohën e Turqisë». Ndërsa pjesa dërrmuese e ndërtimeve që takojmë sot në këtë fshat janë të vona. Pohohet se një pjesë e këtyre ndërtimeve janë ngritur mbi troje të vjetra banimi, dhe në pikëpamje të kompozimit planimetriko-vumor ruajnë tiparet e banesave të vjetra. Ky fenomen të terti-heq vëmendjen si një praktikë gjerësish e njohur në ndërtimet popullore. Nga ndërtimet e paraçlirimit të këtij fshati, përvèç banesës së dhënë në tab. VI, kemi sjellë edhe dy shembuj të tjerë (tab. XIV dhe tab. XVI). Ndërsa në tab. XV kemi riprodhuar planimetritë e kateve të banuara të tri banesave të ndërtuara pak kohë pas Çlirimit.

Shembulli i sjellë në tab. XIV, fillimisht ka qenë përdorur si kasolle³⁹, ndërsa më vonë, me modifikime, është përshtatur si banesë. Ndërtimi është dykatësh. Kati i sipërm përdorej për banim, ndërsa përdhesi për strehimin e bagëtisë. Jashtë mureve perimetrale ka dalë një galeri prej druri me gjerësi 2m. Struktura mbajtëse e kësaj galerie mbështetet nga një anë mbi shtylla druri që ngulen në tokë, ndërsa nga ana tjetër në muraturën e gurit. Prania e shtyllave të drurit që shkojnë nga niveli i tokës e deri në nivelin e brezit të poshtëm të çatisë, ka lehtesar veshjen e jashtme të kësaj galerie në të dy katet. Mbyllja në katin e sipërm është bërë me gardh, ndërsa në katin e poshtëm është bërë me dërrasa të ngushta sëpate. Kjo galeri, që nga forma e struktura më shumë të kujton një çardak të mbyllur, njihet nga vendasit me emrin «teliz». Vëmë në dukje se edhe për banesën që e ka këtë element, vendasit thonë: «e kam shpi me telize».

Theksuam që ndërtimi i mësipërm fillimisht ka qenë përdorur si kasolle bari. Më vonë i janë bërë në katin e sipërm dy ndarje të brendshme, duke krijuar një korridor në mes dhe dy ambiente banimi anash. Secili nga ambientet ka hyrje të pavarur nga jashtë, ndërsa korridori ndihmon komunikimin ndërmjet tyre. Ambientet për banim kanë qenë shtëpia e bukës dhe oda e mique.

Interesi i analizës kompozicionale të këtij shembulli qëndron në faktin se pikërisht këtë skemë e takojmë në banesa të tjera të ndërtuara edhe më vonë se ajo. Kjo duket e qartë në shembujt e sjellë në tab. XV; 1,2,3, ku kemi riprodhuar katin e sipërm të tri banesave të ndryshme. Në shembullin nr. I (tab. XV), «telizi» në krahun verior, duke qenë thjesht element komunikimi e ndërlidhjeje, është bërë më i ngushtë se ai jugori. Ky i fundit me gjerësinë e madhe që ka (mbi 2 m), ofron mundësi më të madhe shfrytëzimi për nevoja të ndryshme, përfshirë edhe ndenjjen në periudhën e ngrrohtë të vitit. Në shembullin

39) Para se të përshtatej për banesë, në katin përdhes strehoej bagëtia, ndërsa në katin e sipërm depozitohej bar.

nr. 2 (tab. XV) ambientet janë ndarë me një perde dërrase. «Telizi» edhe në këtë shembull është realizuar me po ato principe si në shembullin e tab. XIV. Ndërsa në shembullin nr. 3 (tab. XV) ambientet e banimit ndahen me mur masiv guri. Terreni ka favorizuar mbylljen me lehtësi të anës së ngushtë lindore të «telizit» me mur. Në atë kënd më vonë është krijuar një vend depozite.

Nga materiali që parashtruan shkurtimisht, kuptohet se në përgjithësi kemi të bëjmë me ndërtime solide dhe zgjidhje racionale. Banesa nuk i kalon të dy katet. Në formulimin e përgjithshëm të saj, përveç pranisë së telizit, karakterizohet nga një raport i ekuilibruar ndërmjet shtrirjes horizontale dhe ngritjes në lartësi. Banesa zakonisht është vendosur paralel me vijat e terrenit. Kjo ka çuar në mjaft raste në eleminimin e shkallëve të shumta. Nuk mungojnë edhe ndërtime të vendosura normal me vijat e terrenit që kanë çuar në realizime ndërtimesh me gjysmëkat.

Në katin përdhes strehohej bagëtia, ndërsa kati i sipërm ka shërbyer për banim. Vetë struktura e banesës flet për familje me përbërje numerike të zakonshme. Në tab. XVI kemi sjellë një rast të rritjes së mëtejshme të kësaj banese. Shembulli i sjellë, ndonëse i transformuar me kohë, ruan në kompozimin planimetriko-vumor po atë princip të shembujve që pamë më lart. Kompleksi karakterizohet nga dy faza ndërtimi. Faza e parë përbën edhe bërthamën më të vjetër të banesës. Pasi është shtuar në një fazë të dytë blloku dykatësh në anën verilindore, është shtuar edhe «telizi», duke e rrrethuar në tri anë banesën. Ky shembull tregon se në procesin e rritjes së kësaj banese, «telizi» ngelet përsëri element i domosdoshëm i saj. Ndonëse shërbën për të ndërtuar në të ambiente ndihmëse e shërbimi, ky teliz asnjëherë nuk merret si bazë nisjeje për të krijuar ambiente të përhershme banimi. Kjo veçori ndoshta duhet të lidhet me klimën e ashpër malore e terrenin e thyer. Klima diktonte mure masive guri për ambientet e banimit. Gurin si material rrethanor tradita e njinte dhe e përdorte më natyrshëm. Përmasat e kufizuara të shtrirjes së banesës të dikuara edhe nga terreni, pamundësia për të krijuar oborr dhe rrjedhimisht edhe ndërtime ndihmëse në të, kanë bërë ndoshta që këto probleme të zgjidheshin me përdorimin e këtij telizi. Lidhur me klimën, duhet parë edhe domosdoshmëria funksionale e këtij elementi për ruajtjen e mureve nga lagështia. Njëkohësisht, me formulimin e tij, ai nuk pengon ndriçimin direkt të ambienteve nga jashtë. Duke dalë në një mësë të madhe jashtë mureve perimetrale, struktura mbajtëse e tij është zgjidhur me shtylla druri.

I krahasuar me telizin e njojur të banesës së Çermenikës, kuptohet qartë që ai ndryshon në mënyrë thelbësore si për sa i përket konceptit konstruktiv ndërtimor, ashtu edhe mundësive shumë më të mëdha që të ofron telizi i Qarrishtës për shfrytëzim. Kështu, telizi në banesën e Çermenikës nuk del më shumë se rreth 1 m. nga plani vertikal i mureve, është i veshur plotësisht me dërrasa dhe shërbën kryesisht si element komunikimi e ndërlidhjeje midis ambienteve. Ndërsa «telizi» i banesës së Qarrishtës përveç këtyre funksioneve që i kryen në mënyrë të padishimtë, ai merr rëndësi të madhe shfrytëzimi edhe për qëllime të tjera ndihmëse si depozitim, përpunim produktesh apo dhe ndenjje të përkohshme. Për këtë flasin përmasat e tij dhe mënyra e komunikimit.

mit me ambientet e banimit, ku spikat përpjekja pér të mos e copëzuar sipërfaqen e tij. Po kështu raporti i sipërfaqes së dobishme të këtij telizi me sipërfaqen e ambienteve të banimit në tërësi, lëviz në kufijtë nga 1 : 1,2 deri në 1 : 2 në favor të ambienteve të banimit. Mandej ky teliz mbyllët vetëm pjesërisht nga jashtë. Kjo gjë ndihmon që ambientet e banimit të marrin më shumë ndriçim direkt nga jashtë.


Nga sa parashtruam, kuptohet se «telizi» i Qarrishtës si element arkitektonik, ka individualitetin e tij të qartë si nga ana konstruktive, ashtu dhe nga ana funksionale dhe estetike. Prania e tij sikur e bën më transparente pamjen e jashtme të banesës, duke e thyer në mënyrë të dukshme volumin e saj të mbyllur. Po kështu edhe mundësia pér shfrytëzim të hapësirave, si në katin përdhes ashtu edhe në katin e sipërm, të ndihmon që të mos e shikosh këtë banesë si një gjë të shkëputur në planin kombëtar. Pa vështirësi të shkon mendja se ajo ka diçka të përbashkët me banesën me hajat e çardak, të përhapur gjerësisht në zonat e ulëta të Shqipërisë së Mesme, në fshatra të luginës së Shkumbinit etj. Në gjurmimet që kemi bërë pér banesën në zonat fshatare të Shqipërisë së Mesme malore, kemi konstatuar se struktura kompozicionale e kësaj banese ka diçka të përbashkët me banesën e përhapur në Strebleve të Peshkopisë. Veçse në shkallën e zhvillimit planimetrik e sidomos në një element të veçantë arkitektonik siç është *telizi*, sécila banesë ka individualitetin e saj.

Përdorimi i këtij elementi edhe në ndërtime të tilla si kasollet e barit, na shtyn të supozojmë që familjarizimi me të nuk ka si të ndodhë brenda një kohe të shkurtër. Duke gjetur truall të favorshëm, ai është përdorur gjerësisht në banesën e këtij fshati.

U vu re që pér emërtimin e banesës ne mbajtëm atë popullor, duke i shtuar cilësorin «*e Qarrishtës*». Emërtimin «*banesë me telize*», dihet që e ka një tip tjetër, i cili ka genë mbizotëruar në Çermenikë, Martanesh etj. Të nisur nga qëllimi pér të mos sjellë anomali në klasifikimin tipologjik, mendojmë se emërtimi «*banesa e Qarrishtes*» sot pér sot është më i qëndrueshmi, pa pretenduar që ky të jetë emërtimi i saj përfundimtar*.


* Skicat janë punuar nga Gj. Papavasili (student i degës së arkitekturës), nën drejtimin e autorit, ndërsa fotografitë janë të autorit.

Tab. I




Tab. I (1,2) — 1 — Banesë 2 kat me një ambient në gdo kat (Fshati Zgoghd).
2. Banesë 2 kat me një ambient në çdo kat (Fshati Kutrumani).

Tab. II




Tab. II — Banesë 2 kat me nga dy ambiente në çdo kat (Fshati Letëm).




Tab. III; 1, 2 — Banesa me 3 kate në fshatin Zgozhd.

Tab. IV




Tab. IV. — Banesé ně Fshatin Letém

Tab. V.




Tab. V. — Banesë me 3 kate me nga dy ambiente në çdo kat (Fshati Zgozhd).




Tab. VI — Banesé né Fshatin Qorrişté.

Tab. VII




Tab. VII — Tipa dritharesh të përdorura në «Odën e mique» dhe në «Shtëpinë e Zjarrit»


Tab. VIII



Tab. VIII — Oxhak karakteristik i odës së miqe.




Tab. IX — Fragment «qoshku» (interier).




Tab. X — Strehe banese me qoshk — Fragment.

Tab XI




Tab. XI — Banesë me çardak në të gjithë ballin (Fshati Librazhd Katund)






Tab. XII — Banesë me çardak (Fshati Letërm).

Tab. XIII




Tab. XIII – Banesë me çardak (Fshati Kutruaman).

Tab. XIV

*Kale perothe**Kali i dylë*


Tab. XIV. — Banesë në Qarrishtë.

Tab. XV



Tab. XV (1, 2, 3) Tre banesa në Qarrishtë — Për secilën vetëm
planimetria e katit të dytë.

Tab. XVI



Tab. XVI — Banesë në Qarrishtë.

Yllka SELIMI

ZEJA E PUNIMIT TË PIPAVE

Punimi i pipave ka qënë një nga mjeshtëritë e zhvilluara në vendin tonë. Ndonëse zanafilla e saj është e vonë (rreth fundit të shek. XVII), ajo mori një zhvillim të madh, veçanërisht në fundin e shek. XIX dhe në fillim të shek. XX.

Në këtë punim jemi munduar të japim një tablo të qartë të zhvillimit të kësaj zejeje në fillim të shekullit tonë.

Për hartimin e këtij punimi jemi bazuar kryesisht në të dhënat gjore të disa mjeshtërve pipapunes, të cilët e kanë ushtruar zanatin në qytetin e Tiranës. Janë konsultuar, gjithashtu, objektet e fondeve etnografike, ku gjenden lloje të ndryshme pipash prej druri, prej argjendi, prej guri e prej balte.

Material me vlerë për këtë zeje, veçanërisht në drejtim të pasurimit të fondeve etnografike me vegla pune dhe objekte, ka dhënë shoku Hasan Qatipi.

*
* * *

Nga të dhënat e literaturës rezulton se duhani filloi të përdorej në vendet e Evropës Perëndimore në gjysmën e dytë të shekullit XVI¹, kur u soll për herë të parë nga spanjollët dhe portugezët prej Amerikës së Jugut. Pirja e duhanit, nga Spanja e Portugalia, u përhap gradualisht në vendet e Evropës Perëndimore e pastaj në ato të Evropës Lindore, derisa në gjysmën e dytë të shekullit XVII filloi të përdorej edhe në Perandorinë Turke, duke përfshirë këtu edhe vendin tonë.

Lidhur ngushtë me përhapjen e duhanit u zhvillua edhe zeja e punimit të pipave. Sigurisht që zhvillimi i kësaj zeje mori hov vetëm atëherë kur pirja e duhanit u bë masive dhe nuk ishte më «një privileg» i shtresave më të pasura të popullsisë.

Në fillim duhani është përdorur nga shtresat e larta të shoqërisë shqiptare, prej të cilave u përhap dhe në shtresat e tjera të popullsisë.

1) Duhani është rritur në fillim në vendet tropikale. Ai u soll nga Amerika. Në Evropë u fut së pari në Spanjë dhe Portugali në fillim të shek. XVI, në Francë më 1556, në Angli më 1616, në Itali më 1628, në Rusi më 1650, në Turqi nga fillimi shek. XVII. (Shih për këtë *La grande encyclopédie, Paris, 1839 vol. 30, f. 821.*)

Ai nuk pihej nga të gjithë; më shumë preferohej nga burrat, sidomos nga të moshuarit. Duhani, si dhe kafeja, zunë një vend të rëndësishëm, duke shprehur kështu mikpritjen e familjes shqiptare. Gjithashtu, kutia e duhanit dhe shkëmbimi i saj midis burrash u bë gjithnjë e më shumë i pranishëm në kuvende e besëlidhje dhe në aktivitete të tjera.

Duhani pihej nga burrat e shtresave të pasura me pipa druri të skalitura, si dhe me pipa argjendi me kokë qelibari. Ndërsa shtresat e gjera të popullsisë së qytetit dhe të fshatit kanë përdorur pipa të thjeshta, të bëra me material rrëthanor (drurë të ndryshëm që puno-puncne lloje të ndryshme pipash, prej dru shëtgu dhe pishe (foto 1, 2, 3, 4). Gjithashtu, janë përdorur edhe çibukë të punuar prej guri të butë² dhe llulla prej balte.

Rritja dhe zhvillimi i qyteteve tona në shekullin XIX e depërtimi më në thellësi i marrëdhënieve kapitaliste, krahas të tjerash, çuan në rritjen e kërkesave për një jetë më luksoze nga shtresat e pasura e të mesme të popullsisë. Në këto kushte të reja prodhimi i pipave dhe llullave nga ekonomia fshatare nuk mund të kënaqte kërkesat estetike. Gjithnjë në rritje të kësaj popullsie ishte kërkesa e vazhdueshme e tregut për pipa e llulla që çoi jo vetëm në lindjen e kësaj zejeje të organituar në disa prej qyteteve tona, por edhe në ngritjen e nivelit artistik të prodhimeve të saj.

Nga të dhënët e ndryshme na rezulton, se kjo zeje në fillim të shek. XX ishte e zhvilluar në disa qytete të vendit tonë si: në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Gjakovë, Prishtinë, Vuçitern, Prizren e Gjilan. Por qendrat më të rëndësishme ishin Tirana dhe Elbasani. Për këtë dëshmojnë disa të dhëna si: 1. Numri i dyqaneve, i cili për Tiranën që 20-25 dhe për Elbasanin 10-12³, ndërsa qendrat e tjera kishin një numër më të vogël⁴, 2. Tregjet e shumta në të cilat shiteshin prodhimet; 3. Cilësia më e mirë e pipave.

Sic e përmendëm edhe më lart, lulëzimin më të madh kjo zeje e arriti në fund të shek. XIX dhe në fillim të shekullit tonë.

Më vonë, si rezultat i përdorimit të letrave të cigareve⁵, i importimit të llullave të fabrikuara, i vendosjes së një vije kufiri shtetëror me shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, gjë që pakësoi shkëmbimin me vendet e huaja, zeja e punimit të pipave filloi të binte. Prandaj disa mjeshtër pipapunues, për të përballuar mjetet e jetesës, filluan ta linin zanatin dhe të merreshin me mjeshtëri të

2. Në panairin e Kabashit (Pukë), krahas mallrave të tjera, tregtoheshin dhe çibukë prej druri si dhe prej guri të butë me pipa druri. Shih: Xhemal Meçë, *Panairi i Kabashit*, «Etnografia Shqiptare», nr. IX (në botim).

3) Deri në Luftën Ballkanike, bile deri në Luftën e Parë Botërore, në rrugën e Maxharrit numëroheshin dhjetëra dyqane që punonin me çarqe primitive ciganishtë e çibukë me ornamente të ndryshme. (Shih: Abedin Çauhi, *Shënimë etnografike-folklorikë për Elbasanin*, Arkivi Etnografik, dok. nr. 67/30, f. 15.)

4) Në Gjakovë, Prishtinë, Prizren, Vuçitern e Gjilan numri i çibukpunuesve dhe i punishteve të çibukpunuesve nuk ka qenë i madh. Në këto qytete ka pasur shumta tri punishte. (Shih: Kadri Halimi, *Zeja e çibukpunuesave në Kosovë e Metohi* (në «Glasnik Muzeja Kosova i Metohije»), 1958, nr. 3, f. 131).

5) Rr. Zojzi, *Tirana në gojëdhënët dhe traditat etnografike* (AE, dok. nr. 300/30, f. 25.)

ndryshme. Ndërsa të tjerë, kahas pipave, filluan të punonin edhe objekte të tjera zbulurimi, si: pjata, kupacë, lugë, vazo lulesh e lodra për fëmijë, të cilat kërkoeshin më shumë në treg. Megjithatë, të ardhurat nga kjo mjeshtëri ishin aq të vogla, saqë, sipas fjalëve të vetë mjeshtërve, kjo u bë «zanat i vogël», «zanat pa bereqet», «zanat me të cilin nuk mund të mbaje as pulat».

Pas Çlirimt, nën kujdesin e Partisë dhe të pushtetit popullor, trashëgimisë kulturore dhe artistike të popullit tonë iu kushtua një kujdes i vecantë. Në shumë qytete të vendit, u krijuan kooperativat e para të artizanatit, të cilat kishin edhe reparte të specializuara për punime artistike.

Në këtë kuadër më 1947 u ngrit në Tiranë një repart i vogël, për punimin e pipave. Dora-dorës ky repart u rrit; e që më 1956 bën pjesë në ndërmarrjen artistike «Migjeni», dhe është zgjeruar në 6 reparte të tjera, në të cilat, kahas pipave, sot punohen dhe objekte të tjera zbulurimi.

Në këto reparte filluan të punonin mjeshtër të vjetër të kësaj zeje. Kahas tyre punonin edhe të reja dhe të rinj të cilët, duke përvetësuar mjeshtërinë dhe përvojën e zanatçinjve të vjetër, nxjerrin nga duart e tyre prodhime me cilësi mjaft të mirë, të punuara artistikisht, që pëlqehen jo vetëm në tregun e brendshëm, por dhe në atë të jashtëm.

Veç pipave, vëmendje e vecantë iu kushtua edhe punimit të llullave, të cilat u bënë mjaft të kërkuar, veçanërisht në tregun e jashtëm. Më 1958 u ngrit reparti i llullave, i cili nga viti 1962 u quajt fabrika e punimit të llullave.

*

* * *

Meqë zeja e pipapunuesve nuk kishte ndonjë peshë të madhe ekonomike në krashtësim me zeje të tjera mjaft të zhvilluara e nuk kishte dyqane të shumta dhe konkurrencë për tregje shitjeje, nuk kemi asnjë të dhënë për organizimin e tyre në një esnf më vete. Në përgjithësi ata ishin të bashkuar me esnafin e drupunuesve.

Në shumicën e rasteve, zanati kalonte nga babai tek i biri ose nga xhaxhai tek i nipi, pra që një zanat i trashëguar brenda familjes. Duke qenë i tillë, në dyqan rrallë janë marrë shegertë të jashtëm; punët e dorës së dytë i kryenin bijtë e shtëpisë. Këta në fillim bënin proceset më të thjeshta, prerjen e druve, birimin dhe modelimin. Kur ata arrinin të bënin vetë edhe skalitjen, u jepej e drejta të ushtronin zanatin në mënyrë të pavavarur.

Duhet thënë se zeja nuk ushtrohej njëlloj në të gjitha stirët e vitit; kjo kushtëzohej nga sigurimi i lëndës së parë. Puna më intensive ushtrohej në muajt nëntor deri në shkurt, kur drurët mund të priteshin, pasi e kishin mbaruar periudhën e vegjetacionit të tyre.

Një mjeshtër pipapunues prodhonte mesatarisht 15-20 copë pipa të thjeshta dhe 2-3 copë çibukë shumëpjesësh të skalitur në ditë. Por, duke marrë parasysh se zeja nuk ushtrohej njëlloj gjatë gjithë vitit, mesatarja vjetore për pipat e thjeshta shkonte 2500-3000 copë, për të skaliaturat 400-500 copë.




Fig. 1

Proceset e punës kryheshin në seri, duke bërë për të gjitha pipat në fillim tornimin, pastaj birimin dhe në fund skalitjen.

Dyqanet e pipapunuesve ishin të vendosura në pazarin e qytetit, zakonisht në sokakun e marangozëve ose të qeleshepunuesve. Pronarë të dyqaneve nuk ishin prodhuesit e pipave, por tregtarë të tjerë, të cilëve u paguhen një qira mujore. Gjithashtu, për të fituar të drejtën e ushtrimit të zejës, si për çdo mjeshtëri tjetër, i paguhen takse vjetore edhe neverisë.

Në përgjithësi, dyqanet ishin ndërtesa të vogla prej qerpiçi dhe rrallë me tulla, të mbuluara me tjegulla dhe të shtruara me dhë të ngjeshur. Ato kishin dritare mesatare, të mbuluara me qepena.

Në mes të punishtes, në vendin ku kishte më shumë dritë, mbi një dërrasë e cila quhej tezgë, vendoseshin tezgjahu dhe çarku (vegla përmel), më tutje një tavolinë e vogël, mbi të cilën bëhej zbukurimi. Pranë tezgjahut dhe çarkut vendosej një arkë (fig. 1) me disa ndarje, për të mbajtur mjetet më të imëta të punës dhe objektet që përdoreshin për zbukurim, bojërat, alkoolin, gumallakun etj.

Në një kthinë të vogël, që thirrej «qur», vendosej lënda e parë dhe veglat përpunimin e saj.

Pranë murit, në disa rafte prej dërrase të ndarë në kate, ekspozo-heshin prodhimet më të bukura dhe më me vlerë. Objektet e tjera vendoseshin në dritaret.

TEKNIKA E PUNIMIT

Për punimin e pipave përdorëshin një numër i konsiderueshëm vëglash, nga të cilat më të rëndësishme janë tezgjahu dhe çarku.

1. *Tezgjahu*. (fig. 2) Është një vegël e thjeshtë, e cila shërben për modelimin e pipave. Pjesët përbërëse të tezgjahut janë:




Fig. 2

a) *Mbështetësja* prej dërrase të trashë ahu, me gjatësi 77 cm. dhe gjerësi 35 cm. Për të qenë tezgjahu sa më pak i lëvizshëm, mbi mbështetësen vendosej një dërrasë tjetër, vertikalisht me pjesën e sipërme të lakuar, me gjatësi 77 cm dhe lartësi 18 cm, që quhej balli i tezgjahut (a_1).

b) *Trungjet* ishin dy drunj të trashë në formë trekëndëshi, me bazë 31 cm, trashësi 10 cm dhe lartësi 21 cm, mbi të cilët vendoseshin dy grepa metalikë (b_1) që shërbenin për të mbajtur pipën gjatë tornimit. Trungu i djathjtë ishte i palëvizshëm, ndërsa i majti mund të lëvizte lirisht, sipas gjatësisë së pipës.

c) *Boshti* përbëhej nga një rrip dërrase me gjatësi 77 cm. Njëri skaj i tij fiksohej në trungun e palëvizshëm, ndërsa skaji tjetër futej në trungun e lëvizshëm. Për së gjati, mbi dy trungjet, vendosej një rrip i hollë dërrase, që i shërbente mjeshtrit për të mbështetur dorën gjatë kohës që punonte me daltë.

2) *Çarku* (fig. 3) përdorej për shpimin e pipave dhe përbëhej nga këto pjesë:

a) *Mbështetësja* prej dërrase ahu, me gjatësi 58 cm dhe gjerësi 28 cm, mbi të cilën vendosej një trung i gjerryer prej dru arre me lartësi 38 cm dhe gjerësi 10 cm, në të cilin shpohej një vrimë për të futur boshtin.

b) *Boshti* prej druri, në formën e cilindrit, me lartësi 37 cm. Dy skajet e tij ishin më të gjera dhe në mes ngushtoheshin.

Zakonisht druri i zgjedhur për të bërë boshtin duhet të ishte i stahionuar, që të mos jepte lëkundje gjatë rrotullimit. Në krye të boshit vendosej një unazë, që më parë bëhej prej briri, dhe më vonë prej alumini, e cila shërben për të shtrënguar matkapët gjatë shpimit të pipës.

Pjesët metalike, si të tezgjahut dhe të çarkut, punoheshin te kovaçi, të drunjtat te marangozi.





Fig. 3

Gjatë modelimit në tezgjah përdoreshin dalta të formave e përmasive të ndryshme (fig. 4), të njoitura me emërtime të ndryshme si:






Fig. 5

a) *Kalema* prej çeliku, në formë cilindrike. Maja e tyre, që shërbente për të tornuar, kishte formën e një katërkëndëshi, e mprehur në të dy anët. Gjatësia e tyre kalonte nga 15-18 cm. Këto përdoreshin përti dhënë formën fillestare pipës.

b) *Gjerbat*, shërbenin për të bërë rrathë në pipë dhe për të sheshuar pjesët e ngritura. Përbëheshin prej dorezash druri, me gjatësi




Fig. 6

10 — 12 cm, mbi të cilat viheshin presa metalike në formë trekëndëshi, me gjerësi 2-4 mm.

Për hapjen e kanalit të tymit dhe grykave të pipave përdoreshin thumba metalikë të madhësive të ndryshme, që quhen matkapë (fig. 5). Këta vendoseshin mbi boshtin e çarkut dhe ishin dy llojesh:

a) Matkapë të tubit të tymit, me gjatësi të ndryshme, nga 7-24 cm, që varej nga gjatësia e pipës dhe me gjerësi të presave nga 2-5 mm.

b) Matkapë grykash, me trupin në formë drejkëndëshi, me gjatësi më të vogël (8,5 — 14,5) cm, me majë në formë rombi, me gjerësi 5 — 7 mm, që përkon me trashësinë e grykës. Matkapët punoheshin nga kovaçët dhe herë pas here duhej të mpriheshin.

Për të rrotulluar pipën gjatë tornimit dhe birimit shërbente një vegël e vogël dhe e thjeshtë, e quajtur *hark*, e përbërë nga një dru i hollë, por i fortë, në njërin skaj të cilat shërbente është lidhur një spango. Më parë në vend të spangos përdoreshin zorrë të përdredhura bagëtish, të quajtura *kordhë*. Gjatë punës, skaji i lirë sillej rrith pipës duke e rrotulluar atë. (fig. 2, e).

Në repertorin e veglave dhe mjeteve të mjeshtërve pipapunues gjejmë dhe çekicët, gërshterët me dy doreza, njëra prej të cilave ishte e kthyer nga jashtë dhe shërbente për të mprehur matkapët dhe dalat. Për të përpunuuar lëndën e parë, përdoreshin sharrat, sqeparët, thika të mprehta dhe një trung i trashë, i gjerryer nga brenda, për të vendosur drutë gjatë shkurtimit dhe hollimit (fig. 6).

Një ndër proçeset më të vështira dhe më delikate të punës ishte ai i zbukurimit. Ky bëhej në disa mënyra: me pikturnim dhe me gdhenje. Për këtë përdoreshin: dalta të vogla me presa të holla katrore dhe trekëndëshe, si dhe bojëra të ndryshme, të cilat trazoheshin me alkool dhe gumallak.

Pas Luftës së Parë Botërore disa nga mjeshtërit pipapunues filluan të sillnin nga jashtë shtetit torno që viheshin në lëvizje me anë të forcës mekanike, me të cilat, krahas pipave, punoheshin dhe objekte të tjera prej druri me sipërfaqe më të madhe. Po në këtë periudhë, ndër veglat e punës së kësaj mjeshtërie, hyjnë dhe morsat metalike të fabrikuara, që shërbën përmes mbajtjen e pipave gjatë lëmimit dhe ngjyrësjes.

SIGURIMI I LËNDËS SË PARË DHE PËRPUNIMI I SAJ

Materiali kryesor që shërbente përmes punimin e pipave ishte druri, por krahës tij u përdor briri dhe kockat, përmes kokës dhe gojën e pipës. Rrallë përdorej dhe qelibari, zakonisht përmes pipave me veshje argjendi. Pipat punoheshin me lloje të ndryshme drurësh por më dendur është përdorur shqopa, mareja, bushi dhe më rrallë pisha, arra, ahu, thana, kulumbrria, qershia etj.

Në Tiranë përdorej më shumë shqopa, që gjendej në afërsi të fshatrave Babru, Linxë, Zall-Herr, Kryezi, Baldushk. Është një dru i fortë, nuk e ha krimbi, punohet dhe gdhendet lehtë e nuk deformohet.

Në Elbasan, përmes bërë pipa të thjeshta, ndërmjet drurëve të tje-

rë, vend të rëndësishëm zinte zemra e drurit të thanës, që është me ngjyrë të kuqërremptë.

Në Prishtinë e Gjakovë preferohej më shumë ulëza⁶⁾.

Lëndët që shërbenin për të ngjyrosur pipat, si bojën, gumallakun, alkoolin i importonin nga Italia e Austria. Në mungesë të bojës së zezë përdorej bloza, të cilën e përgatisnin gratë e shtëpisë. Mbi një kandil me vajguri të ndezur vendosej një enë e vogël, gjysmësferike, jo e thellë, ku mblidhej bloza e tymit, e cila shkrihej me akoolin dhe guma-llakun, duke formuar kështu bojën për ngjyrosje.

Lëndën e parë mjeshtrit pipapunues nuk e nxirrin vetë, atë e blinin nga fshatarë të specializuar në zgjedhjen e drurit. Druri i shqopës shitej me «barrë» dhe (pas Luftës së Parë Botërore) kushtonte 10 lekë, ndërsa ai i bushit me okë (1,228 g.) kushtonte 0,5 lekë.

Përpara se të përdoreshin, drutë duhet të vendoseshin në një vend të errët, me lagështi dhe, për të mos u tharë, herë pas here spërkateshın me ujë. Më pas bëhej prerja në copa me përmasa të ndryshme, sipas madhësive të pipave. Kështu, të stivuara, liheshin për njëfarë kohe për t'u staxhionuar.

MODELIMI

Puna për të bërë pipa fillonte në mëngjes herët, me përgatitjen e lëndës për punë. Së pari, gdhendeshin copat e drurëve mbi trung; drutë priteshin me sqepar kur ishin të trasha, ose me thikë kur ishin më të holla. Ky veprim quhej nga mjeshtrit procesi i «dhënies», «i latimit». Pastaj copat e gdhendura vendoseshin në mes të dy grepave metalikë të tezgjahut, në pozicion horizontal dhe rrrotulloheshin me anë të harkut, i cili mbahej nga mjeshtri në dorën e djathë. Me të majtën mjeshtri mbante kalemin, me anë të të cilit bëhej tornimi, për t'i dhënë pipës formën e dëshiruar. Më pas, me një gjerbë gjërryhesin pjesët e ngritura. Gjatë tornimit, mbi pipë mbetej një push i hollë, i cili largohej me anë të një letre zmerilje, duke e lëmuar sipërfaqen. Pastaj pipat e përgatitura në këtë mënyrë mbuloheshin për disa orë me tallashin e nxjerrë gjatë tornimit, për t'iu thithur lagështia.

Pasdite fillonte hapja e kanalit të tymit dhe e grykave të pipave; ky quhej procesi «i birimit» ose «i shpimit» dhe bëhej me çark, në boshtin e të cilit vendosej matkapi, në fillim i gjatë e i hollë për të hapur kanalin. Mbi matkap qëndronte pipa, e cila mbahej me dorën e majtë, ndërsa me të djaththën harku, me anë të të cilit vërtitej boshti dhe bashkë me të edhe pipa. Më pas, me anë të matkapëve më të shkurtër dhe më të trashë, hapej folejë për t'u vendosur cigarja; kjo bëhej në formë konike. Kur bëheshin çibukë ose llulla, tubi i tymit dhe vendi për cigaren punoheshin njëri pas tjetrit; më pas koka dhe trupi i llullës apo çibukut montoheshin menjëherë që kur ishin të njomë, që të mos shkaktoheshin plasaritje. Në vrimën konike, të zgjeruar, për të vënë cigaren, vendosej një veshje teneqeje, e cila quhej «zivone» ose «tapë» për të mbrojtur drurin nga djegia.

6) K. Halimi, *art. cit*, f. 141.

Për të filluar zburimin e pipës më parë përgatitej ngjyra. Për këtë shërbenin: boja (anilina), alkooli dhe gumallaku. Për të pasur një përzierje sa më të mirë, në 1/4 litër alkool shkrihej 100 gr gumallak, trazohej sa të tretej mirë, pastaj solucionit i shtohej ngjyra. Përparrëngjyrosjes pipat duhej të fërkoheshin me një copë të leshtë. Me një shtupë të bërë prej garze dhe të mbushur me pambuk, bëhej ngjyrosja, në fillim me ngjyra më të çelura, si: të bardhë, të verdhë, të kuqe, më pas jeshile, kafe dhe në fund të zezë. Pipat që nuk do të skaliteshin, lustroheshin me një përzierje alkooli dhe gumallaku.

Faza e fundit e punës, sa delikate aq edhe e vështirë, ishte ajo e skalitjes. Kjo kërkonte një mjeshtëri të vërtetë dhe një shije të hollë artistike. Për këtë përdoreshin dalta me presa mjافت të holla. Në fillim me daltat «qoka», me presë në formë trekëndëshi, bëhej gdhendja, duke hequr nga pipa copëza të vogla, për të formuar motive të thjeshta gjometrike. Më pas, me dalta më të holla, formoheshin vija rrethore për të ndarë motivet nga njëri-tjetri.

LLOJET E PRODHIMIT

Mjeshtrit pipapunues në repertorin e prodhimeve të tyre patën lloje të ndryshme pipash. Për të bërë njëfarë rreshtimi, duhet të trajomë se cilat qenë pjesët përbërëse të tyre. Vendku vendosej duhani ose cigarja, quhet «kokë», «krye», pjesa që futej në gojë thirrej «gojë», «gojëzë», ndërsa gjithë pjesa tjetër «trupi» ose «tubi». Duke u nisur nga mënëra se si pihej duhani, pipat i ndajmë në:

a) Llulla (foto 5, 6), në të cilat duhani pihej i grirë. Këto ishin të thjeshta, me gojë cilindrike, të ilustruara; punoheshin nga rrënjet e drurit të shqopës.

b) Pipa (foto 7, 8, 9, 10); në to duhani pihej i mbështjellë në letër të hollë. Sipas përmasave dhe formave të trupit dhe të kokës këto mund t'i ndajmë në disa lloje me emërtime të veçanta. Pipat e vogla pa skalitje quhen «kunja», «cigarishte». Pipa të tjera që ishin në formë peshku, të paskalitura, quhen «pipa peshk». Pipa të skalitura me gjatësi një pëllëmbë, «plloomare»; kur këto kishin koka sferike quhen «plloomare me poç».

c) Çibukë (foto 11, 12, 13, 14); quhen të tillë në rastin kur koka punohej veçan nga trupi dhe montoheshin më pas. Në to duhani pihej si te pipat në formë cigareje. Çibukët ndaheshin në çibukë të thjeshtë, pa skalitje, dypjesësh, me koka konike, që quhen «çibukë me kokë». Kur poshtë kokës kishin dy rrota dhe ishin të skalitur, quhen «çibukë me qerre», kur ishin të skalitur me më shumë se tri pjesë, i quanin «çibukë të gjatë». Këta kishin një përdorim të gjerë te shtresat e larta të shoqërisë. Në shtresat e mesme mbaheshin nga i pari i shtëpisë, sepse qenë më të kushtueshëm.

Çibukët punoheshin dhe me dru jasemini, dhe (përgjithësisht) u vihej kokë qelibari. Këta quhen çibukë «me erë», sepse jasemini është dru aromatik. Sipas të dhënave gojore, pëlgjeheshin shumë nga burrat e ish-besimit mysliman, sidomos në periudhën e ramazanit, që i mbanin për t'u marrë erë.

Një përdorim shumë të gjerë kanë pasur pipat me veshje argjendi

(foto 15, 16), të cilat punoheshin nga mjeshtrit pipapunues në bashkëpunim me argjendarët. Ato ishin më të shtrenjta dhe përdoreshin nga shtresat më të kamura të shoqërisë. Nga të dhënrat gojore mësojmë se mjaft të mërguar përpinqeshin të blinin pipa të tillë, që me to dhe me pajisje të tjera të kushtueshme të kishin mundësi për tu varrosur, po të vdisnin në dhe të huaj.

Pipat dhe çibukët e skalitur janë shumëngjyrësh. Në vendosjen e ngjyrave të bie në sy një shije e hollë. Të térheq vëmendjen kombinimi i tyre me aq mjeshtëri. Kështu kombinoheshin e zeza me të kuqen, jeshilja me kafen e me të zezën etj. Gjatë skalitjes me anë të një dalte formoheshin motive gjeometrike mjaft të thjeshta, gjë që kushtëzohej nga sipërfaqja e vogël e pipës. Në këtë mënyrë janë formuar përreth pjesëve më të gjera, radhë trekëndëshash me bordurë të zezë në sfond të kuq, ose rreshta rombesh, me ngjyrë jeshile, në sfondin me ngjyrë natyrale të drurit. Gjithash tu, bëheshin rreshta trapezësh, të cilët futeshin te njëri-tjetri, duke u vendosur në vijë të drejtë, formonin një si kurriz peshku me ngjyrë të zezë në sfond të kuq, të ndara në mes me vija paralele të verdha. Çibukët më të gjatë, me gojë sferike të madhe, lejonin formimin e disa motiveve të thjeshta bimore.

Disa pipa, përvèç zbukurimeve të zakonshme, në trupin e tyre kishin rrathë të vegjël druri, të vendosur në pjesët më të ngushta. Rrathët formoheshin gjatë procesit të tornimit. Me anë të daltave, në një rrëth të vizatuar më parë në pipë, shkëputeshin copa djathtas e majtas derisa ai ndahej fare nga pipa. Mjeshtëria e pipapunuesve qëndronte në atë që të mund të formonin sa më shumë rrathë në një sipërfaqe të vogël. Këto pipa me sa më shumë rrathë vlerësohen edhe me një çmim më të shtrenjtë.

SHPËRNDARJA E PRODHIMIT

Dygani në shumiçën e rasteve ishte vendi i prodhimit dhe i shitjes së pipave. Por jo rrallë me shitjen e tyre merreshin edhe disa ndërmjetës (çikrrimtarë), të cilët i dërgonin pipat në tregjet e qyteteve të tjera, si: në Shkodër, Dibër, Korçë, Berat, Peqin, Kavajë, Durrës etj. Këtyre u duhej të udhëtonin për ditë të tëra me kuaj nga njëri qytet në tjetrin. Ndërmjetësit i merrnin pipat nga mjeshtrit, në fillim paguanin një shumë të hollash dhe, pasi i shisnin, pjesën tjetër.

Përvèç tregut të brendshëm, pipat tona, për bukurinë dhe fortësinë e tyre, kërkoheshin dhe në tregjet e jashtme. Disa nga mjeshtrit, që kishin mundësi financiare, blinin nga të tjerët pipa të modeleve të ndryshme, të cilat i dërgonin në Stamboll, Izmir, (Turqi), Selanik (Greqi), Boston (SH B A) etj.

Në dyqan shitja bëhej me para në dorë. Ne nuk kemi të dhëna të sakta për çmimin e pipave para Luftës së Parë Botërore, vetëm se pas saj ai ndryshoi shumë, duke pasur një ngritje të ndieshme, gjë që kushtëzohej nga pakësimi i sasisë së pipave, që erdhi si rezultat i rënies së kësaj zejeje. Ky proces vazhdoi edhe pas Çlirimtit të vendit, por pipat, sidomos ato të zbukuruara e shumëpjesëshe, e kanë humbur funksionin e tyre dhe sot përdoren si mjete për të zbukuar ambientet tona familjare.




Foto 1,2 — Pipa të punuara nga fshatarët





Foto 3, 4 — Pipa të punuara nga fshatarët




Foto 5, 6 — Llulla




Foto 7, 8 — Pipa të punuar nga mjeshtërit qytetarë




Foto 9, 10 — Pipa të punuar nga mjeshtërit qytetarë





Foto 11, 12 — Çibukë




Foto 13, 14 — Çibukë





Foto 15, 16 — Pipa argjëndi

Kahreman ULQINI

DY DORËSHKRIME TË SHTJEFËN GJEÇOVIT — KRYEZIUT

Mbledhësi dhe studiuesi i zellshëm i kulturës populllore shqiptare, Shtjefën Gjeçovi, u vra më 14 tetor 1929 nga shovinistët serbë pranë fshatit Zym (Has). Vetëm një pjesë nga veprat e tij të shumta panë drithën e botimit. Studiuesit janë të informuar për dorëshkrimet e Shtjefën Gjeçovit që ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror të RPSSH në Tirana dhe ndonjë tjetër që gjendet në Kreshevë të Bosnjës (Jugosllavi).

Me rastin e 50-vjetorit të vrasjes së pabesë të patriotit e hulumtuesit të palodhur, po paraqesim për herë të parë dy nga dorëshkrimet e Shtjefën Gjeçovit të lëna në Zym, që më vonë u sollën në Shkodër e që tani ruhen në Arkivin e Muzeut Popullor, në fondin «Shtjefën Gjeçov». Të dy dorëshkrimet, në radhë të parë, kanë vlerë si burime për studiuesit tanë, kur tanimë në terren nuk mund të mblidhen të dhëna të tillë, qoftë për kanunin, qoftë për bestytnitë e ndryshme. Ndryshime të pakrahasueshme kanë ndodhur në malësi, ku në jetën e përditshme po u vihet fshesa edhe gjurmëve më të vogla të mbeturinave negative të së kaluarës.

I. «Kokrra kanujet t'Kanunit t'Lekë Dukagjinit ose t'Lekës Gjin Dukës që prej vitit 1898-1928».

Dorëshkrimi është në masat 10 x 16 cm. Kapakët i mungojnë dhe Janë 176 faqe të numruara nga autori, disa prej të cilave të pashkruara. Mungojnë fajet 77 e 78, që, sipas përbajtjes së shënuar në fund të dorëshkrimit, janë norma të regjistruara për dëmet. Autori gjatë punës për rënditjen e lëndës kanunore ka përdorur bojën e zezë dhe, në kohë të ndryshme, janë bërë plotësimë të reja, që duken në llojet e bojës së shkrimit dhe të lapsave. Vula «Gomsiqe-zyra famullitare», e vënë në fund të dorëshkrimit, na jep të drejtën të mendojmë se pjesa kryesore e lëndës (ajo që është me bojë të zezë) u shkrua në Gomsiqe. Viti 1928 tregon vazhdimin e punës. Tashti për tashti nuk mund t'i përgjigjemi pyetjes nëse këtë dorëshkrim e kanë pasur në dorë ata që bënë botimin e KLD.

Në veprën e botuar KLD lënda është ndarë në libra, artikuj, krerë, nyja e paragrafë, kurse në dorëshkrim ndiqet një ndarje tjetër¹.

Pas një pune paraprake krahasuese me lëndën e botuar të Kanunit të Lekë Dukagjinit, mendojmë se vlerat e dorëshkrimit qëndron kryesisht:

1) Rreshthimi e ndarja e lëndës në dorëshkrim është kjo: I. Kisha, II. Martesa, III. Deka, IV. Beja, V. Porota, VI. Miku, VII. Ndera, VIII. Ndërmjetësi, IX. Vija e katundit, X. Puna, XI. Mullini, XII. Bulgu, XIII. Bariu, XIV. Rrogtari, XV. Trashigjime, XVI. Leçia, XVII. Prone, XVIII. Kufini, XIX. Tregtia, XX. Dorza-

1. Në plotësimë dhe formulime të ndryshme në krahasim me ato që përmban KLD. Kështu p.sh., «Dorë e beje» (f. 14 e doarëshkrimit) është më e plotë se ajo e paragrafëve 536 e 1078 të KLD; «çmimet sipas k-anunit» (fq. 42, 43 e dorëshkrimit) jepen me disa ndryshime në veprën e botuar (KLD, f. 53, 54). Plotësimë të tjera shihen te «Kapucaria» (f. 109 e dor.), te «Gjoba» (f. 131 e 133 e dorësh.), te «Beja», për të cilën në faqen 16 të dorëshkrimit thuhet: «Beja mund të shtyhet edhe më tepër se një vit.»² Po kështu te «Miku» (f. 22 e dor.) jepen këto plotësimë.

- a) Për çfarëdo mik duhet bukë;
 - b) Për mik, çdo mik, kafe e bukë;
 - c) Për mik të mirë, kafe, raki e bukë;
 - d) Për mik të mirë fort, duhan, kafe e ambël, raki, bukë e mish.
- a) Epja bukë ne thatë;
 - b) Epja si të hashë vetë: shllinë, pshesh;
 - c) Shtoja ndonjëfarë sendit, voe, tlyen;
 - d) Përpushu e shkëpurdhu bukur fort, në don me u da me nder me te.³

Për marrëdhëni e bujkut me zotërinë, ndryshe nga sa parashikohet në paragrafin 301 të KLD «me cilë çerme i përket vetëm zotnisë», në f. 45 të dorëshkrimit ka një formulim më të plotë: «me cilë çermet i përket zontisë e bulkut për gjysmë». Për derrin (thiun) që kapet në dëm, në paragrafin 755 të KLD, thuhet: «po hini në dam thiut me verza, ka damin e jo pushkën. Po e vrave len thiut»; në f. 76 të dorëshkrimit është regjistruar: «Thiu me krrabza (verza) edhe në hiftë në dam nuk vritet as dami s'i çmohet, toka do të thuret. «Për gjakmarrjen», në paragrafin 900 të KLD, thuhet se në gjak bie e gjithë shtëpia me kushërinjtë e dorasit. Në dorëshkrim, ngjitur me këtë, gjendet një shtesë (f. 104): «Në Gjakovë ndiqet vetëm dorasi, se mashkulli tjetër i shtëpisë së dorasit nuk mshehet (kjo ndër myslimaj). Po kështu edhe për damet⁴. Në ndonjë rast dallojmë edhe formulime që ndryshojnë me tekstin e botuar⁵.

nia, XXI, Dame, XXII. Vathi, XXIII. E rrafshja XXIV. Arma, XXV. Una e spata XXVI. Shpifa, XXVII. Vjedhsia, XXVIII. Vrasa (gjaqe), XXXI. Kapucaria-XXX. Pleqsi, opinga, XXXI. Me shtue pleq, XXXII. Pengu, XXXIII. Gjoba, XXXIV. Daja (dasa), XXXV. Fitime uhanash, XXXVI. Kapari, XXXVII. E folmja, XXXVIII. Doke (bidate), XXXIX. Preja, XL. Prija, XLI. Krushqia, XLII. Simahori, XLIII. Gjateria, XLIV. Vathi i bletve, XLV. Rrethi i Spahisë, XLVI. Lirime kanujet, appellatio-

Në dorëshkrim, jashtë rreshtimit të mësipërm, janë vënë dhe këto çështje: Familja, vaditja, pabesia, besa e gjasë e cobanit, farkëtarë. Me shifra romake janë rënditur çështjet dhe brenda tyre lënda paraqitet e ndarë në paragrafë. Në krye të çdo paragrafi ka dy numra. Shifra arabe tregon numrin progresiv (vazhdues), kurse ajo romake sasinë e paragrafëve për çdo çështje të numëruar nga autori dhe disa të tjerë që nuk kanë numër.

2) Krahaso KLD, paragrafi 1064.

3) Krahaso KLD, paragrafët 611-613.

4) KLD ka të shënuar se ndahet «kallamoqi për gojë» (par. 74) në dorëshkrim «me grunë lahen detyrët (Has)» (f. 135-136). Për seleinin, në par. 69 të «fitime të posaçta (tash vonë) e paja e grues nuk ndahen e preken».

5) Porota s'jet pa e ba benë, si të ketë bukë e mish» (f. 17 e dor.), shih par. 1068 të KLD. «Beja lanë gjaqe, por porota s'shkron m'bëtë pa ju lidhë (f. 13 e dor.), shih KLD, par. 1047. «Mohimi» (hasha) e ka benë (fq. 13 e dor.).

2. Në dhënen e disa normave të papërfshtira në KLD. Këto norma kanë rëndësi të madhe si material që tregon gjendjen e rëndë, në të cilën jetonte populli i malësisë dhe veçanërisht hedhin dritë mbi pozitën poshtëruese, në të cilën e kishte çuar gruan malësore kanuni, feja e klasat sunduese. Ja disa prej tyre: «Nuse pa shkuesi, gjaku e toka pa pleqni (opanga) nuk bahan.» (f. 5), «Pjella ke i zoti, gruaja ashtu zhabë». fjalë ka kurrën e huej» (f. 6).

ashtu zhabë». Grusia e dame a e marrme me fjalë ka barrën e huej» (f. 6).

«Be bleve në terr. të tjerët ta çmojnë me gjyq» (f. 69).

«Po bleve ne terr, te
«Kapucari hjek benë.»

«Ma mirë gjasa se kapucari.»

«Kapucari veç marrohet se képucët i merr» (f. 109, III),
«Kapucari gjasa se kapucari...» (f. 110, III),
«Kapucari mund të xehet kryet e i pa

«Punët e fortë ndreqi faqë dy vete, se d

faj mundesh me ra nën barrë» (f. 116).
«Punet e fortë ndrejtë raje... faj mundesh me ra nën barrë» (f. 117)⁶

«Plaku i pa grosh si qeni barosh» (f. 117)

«Plak e marrës kanuja s'banë» (f. 117).
«Plak e marrës kanuja s'banë» (f. 117).

«Kah tē shkojnë katër shokë, mikut

«Preja pér borxh s'merret» (f. 153).
«...Wid, l'ü flainö nü pienin brry]» (f. 69).

«Tregtari e mullisi do tē flejnë nē njenin brryl» (f. 69).
«Tregtari e mullisi do tē flejnë nē njenin brryl» (f. 73).

«Dorëzanë e bestar heret s'ka hi kush me pare» (f. 73).
«Dorëzanë e bestar heret s'ka hi kush me pare» (f. 73).

«Shkrola ban omën (amen).»

«Dorezëndje e shkrimit»
«Shkrola ban omën (amen).»

Vepra e Sh. Gjeçovit është kritikuar, se nuk paraqet administratën e bajrakut, organet e tij e se i ngatërron me ato të fisit. Pleqtë e më- dhenj që ishin të njohur në Mirditë nuk përmenden në KLD, kurse në f. 118 të dorëshkrimit lexojmë: «Pleqtë e mëdhenj të bajrakëve janë me derë ose me plang brez mbas brezi. Me ba me u gjetë në punë të ligë e në tradhti ndonji prej këtyne pleqve e krenve, atbotë Dera e Gjon Markut bashkë me krenë të mdhenj të bajraqeve e hjeq nji krye a plak e në vend të tij shënojnë nji derë tjetër, për tregim: Lleshi i Zi Ka- pidani, për droje të tradhtimit, e hoq njanin prej krenve të Dibrit e në vend të këtij emnoin derën e Gjon Ndocës në Kashnjet» (f. 118). Po kështu, në KLD nuk përmendet as zabiti, as qatipi⁷ dhe as detyrimet ushtarake⁸.

Për apelimin e çështjeve në dorëshkrim gjejmë të dhëna me interes:

„Me grosh se me grosh, merre plakun n  Orosh.»

«Në mos të pëlqeftë gjyqi, tek asht Shpalit.»

«Në mos të pelqetë gjyqi, tek asht Shpall...
Në lypsh pleqtë e hollë, i gjen në Rekë edhe në

«Në lypsh pleqtë e holle, i gjeli ne teke e sene.
Mes të pëlqeftë giyqi, tek asht gryka e Oroshit.»

6) Shih KLD, par. 1028.

6) Shih KLD, par. 1028.
7) «...i shpifet kujt: 24 vetë poronikë, po u diktue mbas bejet, 24 qese poronikve, gjaku gjak, 100 deshë e nji ka, shtëpinë e djegme e 500 grosh zabitit, 25 vetepër Dorasi i qitun prej bairakut» (f. 104 e dor.).

25 qatipit. Dorasi i qitun prej bajrakut» (f. 104 e dor.).
Kan ulci Mirdita në luftë Zadrima do t'i bate gati një haje bukë:

8) «Kur ulej Mirdita nē luftē, Zadrima do
Fudit; Treshani, Fishta, Blinishti, Krajni.

I. Fandit: Troshani, Fishta, Blinishti, Krajni.
II. Fandit: Haimeli, Naraci, Kaca, Shelgeti, Laci, Mjetja.

II. Dibrit: Hajmeli, Naraçi, Kaça, Shelqeti, Laçlı, Mj. III. Gacılı: Kallmeti, Mërgijja, Braboshta.

II. Oroshti: Kallmeti, Mérqija, Rraboshta.
II. Kukhenit: Baba, Bistulli, Pacrami, Shkjezi, Kullzi.

V. Kushnenit: Baba, Pistulli, Paçrami, Shkjezi, Kullzi.
G. Saiti: Nençhati, Kadbeli, Bacli, Daici, Gjadri, Grashi (f. 119).

Në dorëshkrim gjejmë të saktësuara edhe rregulla si ai nga Zhupa (Malësia e Lezhës) që kishin vlerë lokale: «U rraf kush e i ndreqi bajraku pa u vra:

- 3 qese të rrashunit për nder
- 1000 grosh gjobë bajrakut» (f. 85).

Huaja me interes (kamatë) ka qenë e përhapur në malësi dhe ka rrënuar ekonominë e malësorëve. Sh. Gjeçovi këtë plagë të rëndë e kallon në KLD, kur thotë: «Kanuja e maleve nuk njeh hua me shtojca fitimesh (fajde)» (KLD, par. 499). Në dorëshkrim pohohet e kundërta: «Kanuja të çon mje në vargue të zjarrit për borxh», «Uhajsit (borxhlisë) të keq (prej skamit) merrja dhinë pa edh», «Fajde mbi 10% kanuja nuk banë» (f. 49 e 137 e dor.).

3. Në dorëshkrim jepen mjafë emra informuesish, vendet ku janë regjistruar normat kanunore si dhe koha. Botimi KLD në këtë drejtësim ka një mungesë të theksuar.⁹⁾

4) Në terminologjinë e përdorur. Në dorëshkrim njihemi me termat kanuni që nuk janë paraqitur në KLD, si «benë e randë», «pricët», «dorëzania e gjaqeve», «dorëzania e huanave», «mik çdo mik», «bir në shpirt», «lecia e gjakut», «copali», «qatip» etj.

5. Në përdorimin e folklorit juridik. Këtu e kemi fjalën për proverba që kanë përmbytje kanunore e që marrin ndonjëherë vlerën e maksimave. Të tilla janë:

«Djalit që s'ka le, s'ja njet emnin kush» (f. 36).

«Ma i zi asht gërgasi se dorasi» (f. 115).

«Kush vjedh strajcën e mikut e shpinë e vet, asht ma i poshtmi në botë.»

«Ke shkon pshtjellaku, atje ve edhe gjaku» (f. 102-103).

«Knuesi (gjeli) asht heratori i të vorfnit» (f. 102).

«Prej kalit të huej, zdryp në ujë» (f. 89).

«Shka t'hajë uku s'e xen gjarpni» (f. 66).

Krahas ndonjë shënim i tjeter, në dorëshkrim, kemi disa shënime e shkurttime të autorit, që nuk janë zhvilluar më tej¹⁰⁾.

9) Laç, Gojan, Gomsiqe, Shalë, Shosh, Nikaj, Mertur, Gash, Krasniqe, Kaçinar, Mirditë, Pukë, Malësi e Lezhës, Kthellë, Spaç, Shelqet, etj.

Në faqen 23 të dorëshkrimit është shënuar «herët në Shalë» që mungon në rëshkrimit, par. 267 e 268 plotësohet me «Shalë, 1917» të do «Laç-Sebaste-Kurbi, 1900» (f. 76), par. 74 me Has (f. 135, 186), par. 267 plotësohet ka shënuar (Kaçinar), Shtermend (Elbasan) 1924.

10) «Me martue me fyshek në shpindë.»

«Me martue me fjalë.»

«Turra e druve.»

«Gjaku që ruhet kur vlon.»

«A në bukë a për udhë prija i shkon:

a) a ma të moçmit,

b) a ma rodit,

c) a plakut të katundit

d) a djalit të fisit» (f. 157).

II. «Bestytje shqipëtarësh» — «Sa sjellje e besime shqipëtarësh — «Arbanaska prazno», «21-IV-1927 Gjakovë»-I.

Dorëshkrimi është një fletore në masat 22x14 cm me kapakë kartoni të fortë dhe ka 100 fletë të numruara, të gjitha të shkruara në të dyja faqet. Sh. Gjeçovi shkruan: «Këtu i përmblodha sa punë e doke që i kam pasë shkaravatë nëpër copa letrash, me qëllim që të mos hupin e ashtu të më shkojë mue mundi dam e ta gjejë dami literaturën shqipe.»

«E shuma e landës ku â mbledhë asht shkrue (sidomos në Mirditë). Porse do të rreshtohen datat».

«Gjakovë, 21.IV.1927»

Lënda e rregjistruar në fletore është kjo:

I. Në faqen e parë, «Kujtime», mësuesi veteran kosovar Ibrahim Fehmiu shkruan tërë pikëllim: «A ka ma zi e mjerim se me hanxharue (heshtue) zemrën e atdheut. «Kujtimi» është lënë në Zym me 4 nëntor 1928. Nga kjo kuptojmë se Sh. Gjeçovi mbante lidhje me patriotë të tjerë kosovarë.

II. «Numri magjik i shqiptarëve», që sipas autorit është treshi (I faqe).

III. «Sa sjellje shqiptarësh në ndërtesë shpijash», përshkruan bestytnitë që praktikoheshin me rastin e ndërtimit të banesave në krahina të ndryshme të vendit, Mirditë, 1907, Shalë, 1917, Zhubë, 1921, Dibër e Mbishkodër, 1925 (13 faqe).

IV. «Sjellje besimtare të Hetrusqve të vjetër në të ngrehun të qyteteve», Vlonë, 1921 (7 faqe).

V. «Buzmi bujar», janë regjistruar përshkrimë të asaj festë me origjinë të lashtë, që Sh. Gjeçovi i ka mbledhur në Mirditë (Gomsiqe, 24.XII.1908), Dukagjin (Theth, 24.XII.1916), Shkodër, (3.XI.1925), Podrimë, (13.VIII.1926) e Zym të Hasit, (12.XII.1926) (13 faqe).

VI. «Bestytje shqiptarësh», që sipas shënimit të vënë janë mbledhur në Kurbi, Kthellë, Zhubë, Mirditë, Dukagjin, Zadrimë, Pukë e Kosovë që prej vitit 1900 e të mbartura në këtë fletore më 23.IV.1927 (13 faqe).

Në faqen 184 Shtjefën Gjeçovi ka lënë një shënim për vitet e vendet e shërbimit, për shtegtimet e shumta, për punën e palodhur si gjurmues i kulturës popullore shqiptare dhe si arkeolog.

1886-Troshan

1896-1897-Troshan, Rrëbig (Malësia e Lezhës)

1897-1899-Pejë (Metohija).

1899-1905-Laç, Sebaste, Durrës (Kurbi).

1905-1906-Tushan, Zara (Dalmacije)

1906-1907-Shkodër

1907-1915-Gomsiqe (Mirditë)

1915-1917-Theth, Shalë.

1917-1918-Shosh (Dukagjin)

1919-1920-Pejë, Trashan

1920-1921-Vlorë, Rrëbig
 1921-1926-Shkodër, Elbasan, Pejë, Gjakovë
 1928 (30-V-1928) erdha në Zym (Has).

Fletorja është mbushur me shënime deri më 12 mars 1928, por aty-këtu u plotësua më vonë siç shihet nga datat që ka vënë mbledhësi. Në një copëz flete të shkëputur nga fletorja Sh. Gjeçovi ka bërë planin, sipas të cilët do të renditet lënda e bestytnive, dhe prapa saj ka shënuar disa fjalë të mbledhura dhe në Zym, më 2.X.1929, d.m.th. 12 ditë përra para vrasjes së tij. Në fletore ka të shënuar edhe vargje populllore që lidhen me bestytnitë, fjalor, toponime, mjekësi populllore etj.

Na duket me rëndësi që etnografi ynë, pas llagapit Gjeçov, shënon «Kryeziu», Ndre Mjeda më 1935 shkruante se arqipeshkvi i Shkupit Carev dhe fretërit boshnjakë Shishkoviq e Brkiq përhapën sa mundën gjuhën sllovene me anë të predikimit e të shkollës jo vetëm në Janjevë, ku humbi gjuha shqipe, por edhe në Prizren, Shkup, Letnicë e Gjakovë. Shtjefën Gjeçovi i përkiste vëllazërisë Përgjeçaj të Janjevës, një degë e fisit të vjetër Kryezez, mjaft i përhapur në Kosovë, Pukë, Lezhë e gjetkë. Autoritetet fetare e regjistruan në shkollë me llagapin Gjeçoviq. Kur ai u bë i vetëdijshëm për këtë falsifikim, s'qe në gjendje të bënte më tepër, veç të hiqte atë-iq e të mbetej Gjeçov. Këmbëngulja e Shtjefën Gjeçovit për të përdorë llagapin Kryeziu, që e shohim në disa dorë-vrasjes, tregon shqetësimin e tij për të çuar në vend një të vërtetë, që ka të bëjë me kombësinë e tij thjesht shqiptare. Jemi të mendimit se, sa herë që të përmendet emri i etnografit tonë, duhet ta përdorim në formën Shtjefën Gjeçov-Kryeziu, ashtu si që dëshira e tij.

Në këtë numër të përbledhësit po batojmë bibliografinë e artikujve studimorë dhe materialeve të botuar në «Etnografia Shqiptare», nr. 1-10. Si do të shikohet nga bibliografia e paraqitur më poshtë, në këta numra, janë botuar gjithsej 112 studime e materiale, me afro 3870 faqe. Në këto studime e materiale një kontribut me vlerë kanë dhënë bashkëpunëtorët e jashtëm, firmën e të cilëve mbajnë 54 artikuj, me afro 1810 f.

BIBLIOGRAFI E ARTIKUJVE TË BOTUAR NË PËRMBLEDHËSIN «ETNOGRAFIA SHQIPTARE» (nr. 1 – 10)

- Alushi, Qamil** — *Dasma në Mat*, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f.262-284).
- Bihiku, Ikbale** — *Për një shfrytëzim më të drejtë të motiveve tona popullore në tekstilet e artizanatit*, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 75-82).
- Bihiku, Ikbale** — *Pour une utilisation plus judicieuse de nos motifs populaires dans les tissages de l'artisanat*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 277-281).
- Bushati, Enver** — *Lojnat popullore të rrëthit të Shkodrës*, («Etnografia shqiptare» III, Tiranë, 1966, f. 119-177).
- Çaushi, Abedin** — *Dyfekçinjtë dhe armët në Elbasan në shek. e XIX-të*, («Etnografia shqiptare» I, Tiranë, 1962, f. 251-276).
- Çaushi, Abedin** — *Transporti në Elbasan gjatë shekujsh*, («Etnografia shqiptare» II, Tiranë, 1962, f. 144-175).
- Çaushi, Abedin** — *Martesa në qytetin e Elbasanit*, («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 231-257).
- Dojaka, Abaz** — *Enët dhe orenditë e Dukagjinit*, («Etnografia shqiptare» I, Tiranë, 1962, f. 105-137).
- Dojaka, Abaz** — *Enë e orendi të Labërisë*, («Etnografia shqiptare» II, Tiranë, 1963, f. 50-81).
- Dojaka, Abaz** — *Mjetet e peshkimit në Bregun e Bunës*, («Etnografia shqiptare» III, Tiranë, 1966, f. 66-78).
- Dojaka, Abaz** — *Disa ndryshime në lidhjet martesore pas Çlirimt*, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 53-61).
- Dojaka A., Gjergji A.** — *Rezultatet e punës në fushën e Etnografisë gjatë 25 vjetëve*, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 3-18).
- Dojaka, Abaz** — *Ekzogamia tek shqiptarët*, («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 43-59).
- Dojaka, Abaz** — *L'exogamie chez les Albanais*, («Ethnographie Albanaise» VIII, Edition en français, Tiranë, 1979, p.).

- Dojaka, Abaz** — *Disa udhëzime për mbledhjen, sistemimin dhe studimin e materialeve etnografike*, («Etnografia shqiptare VII, Tiranë, 1976, f 279-285).
- Dojaka, Abaz** — *Ceremoniali i dasmës shqiptare*, («Etnografia shqiptare» IX, Tiranë, 1980, f. 115-155).
- Dojaka, Abaz** — Le cérémoniel nuptial en Albanie, («Ethnographie Albanaise» IX, Edition en français, Tiranë, 1979, p. 113).
- Dojaka, Abaz** — *Zgjidhja e martesës në Shqipëri*, («Etnografia shqiptare» X, Tiranë, 1980, f. 3.)
- Dojaka, Abaz** — *La rupture du mariage*, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tiranë, 1980 p....).
- Dojaka, Abaz** — *La position de la femme en famille et en société dans la contrée de Zagorie*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 113-121).
- Dhima, Aleksandër** — *Të dhëna antropologjike nga rrethi i Pukës*, («Etnografia shqiptare» VIII, Tiranë, 1976, f. 239-268).
- Elezi, Ismet** — *Le caractère du droit coutumier albanaise durant l'occupation turque*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 41-49).
- Gëço, Pandi** — *L'accroissement de la population urbaine dans la République Populaire d'Albanie et sa nouvelle répartition géographique*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tiranë, 1976, p. 19-41).
- Guxho, Naim** — *La décomposition physique de la famille patriarcale à la campagne et l'influence de ce processus dans les relations familiales*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tiranë, 1976, p. 103-113).
- Gjergji, Andromaqi** — *Provë për një studim etnografik të fshatit Rëmbec (Korçë)*, («Etnografia shqiptare» I, Tiranë, 1962, f. 193-251).
- Gjergji, Andromaqi** — *Provë për një studim etnografik në kooperativën «Shkëndia»*, («Etnografia shqiptare» II, Tiranë 1963, f. 81-110).
- Gjergji, Andromaqi** — *Veshja e vllëhëre të rrëthit të Korçës*, («Etnografia shqiptare III, Tiranë, 1966, f. 45-66).
- Gjergji, Andromaqi** — *Dy variante të veshjes së grave në rrjedhën e sipërme të Shkumbinit*, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 138-202).
- Gjergji, A. — Dojaka, A.** — *Rezultatet e punës në fushën e etnografisë gjatë 25 vjetëve*, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 3-18).
- Gjergji, Andromaqi** — *Të dhëna mbi bujqësinë tradicionale në fshatin Pojan (Fier)*, («Etnografia shqiptare V, Tiranë, 1974, f. 131-155).
- Gjergji, Andromaqi** — *Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri*, («Etnografia shqiptare» VII, Tiranë 1976, f. 89-135).
- Gjergji, Andromaqi** — *Ndryshime morfollogjike e artistike të veshjeve popullore simbas funksionit të tyre*, («Etnografia shqiptare» VIII, Tiranë, 1976, f. 3-33).
- Gjergji, Andromaqi** — *Différences morphologiques et artistiques des costumes populaires d'après leur fonction*, («Ethnographie Albanaise» VIII, Edition en français, Tirana, 1979, p. 3-33).
- Gjergji, Andromaqi** — *Klasifikimi i veshjeve popullore*, («Etnografia shqiptare» IX, Tiranë, 1980, f. 3-57).
- Gjergji, Andromaqi** — *La classification des costumes populaires albanais*, («Ethnographie Albanaise» IX Edition en français, Tirana, 1979, p. 3-55).
- Gjergji, Andromaqi** — *De l'évolution de la famille rurale contemporaine*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 91-103).
- Gjergji, Andromaqi** — *Art paysan et métier d'art en Albanie*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 257-277).

- Haxhiu, Fiqiri** — Kooperativa blegtoreale-bujqësore «Asim Zeneli», («Etnografia shqiptare» II, Tiranë, 1963, f. 3-50).
- Haxhiu, Fiqiri** — Mbi ekonominë blegtoreale të Kurveleshit gjatë shek. XIX e fillimit të shek. XX, («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 185-195).
- Haxhiu, Fiqiri** — L'élevage à Kurvelesh au cours du XIX^e siècle et au début du XX^e, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tiranë, 1976, p. 235-245).
- Kostallari, Androkli** — Mbi shtrirjen e shtresëzimin e së drejtës kanunore në Shqipëri dhe mbi disa çështje që lidhen me studimin e saj e me organizimin e luftës kundër mbeturinave të së vjetrës, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 18-28).
- Krasniqi, Mark** (Prishtinë) — Familja e madhe patriarchale në Kosovë, («Etnografia shqiptare» X, Tiranë, 1979, f. 23).
- Krasniqi, Mark** (Prishtinë) — La grande famille albanaise patriarchale à Kosove, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tiranë, 1980, p.).
- Kurti, Dilaver** — Zeja e punimit të barotit në krahinën e Matit, («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 213-231).
- Kurti, Dilaver** — Les poudreries de Mat, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tiranë, 1976, p. 245-257).
- Luka, Kolë** — Kërkime mbi «Viletin» si institucion i hershëm mesjetar në vendin tonë, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 82-106).
- Luka, Kolë** — Sprovë për një shqyrtim etnografik folkloristik të baladës së Lule Frangut, («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 59-131).
- Luka, Kolë** — Gjurmime të toponomastikës mesjetare në trevën e Sopotit, («Etnografia shqiptare» VIII, Tiranë, 1976, f. 159-177).
- Luka, Kolë** — Recherches de toponymie médiévale dans la contrée de Sopot, («Ethnographie Albanaise», VIII, Edition en français, Tiranë, 1979, p.).
- Meçi, Xhemal** — Panairi i Kabashit, («Etnografia shqiptare» IX, Tiranë, 1980, f. 367-375).
- Meçi, Xhemal** — La foire de Kabash (Pukë), («Ethnographie Albanaise» IX, Edition en français, Tiranë, 1979 p.).
- Mehmeti, Fadil** — Zakone, rite e besime vdekjeje në Kelmend, («Etnografia shqiptare» IX, Tiranë, 1980, f. 333-359).
- Mejdiaj, Bajram** — Disa tipare të lidhjes së martesës në ditët tona në Labëri, («Etnografia shqiptare», VII, Tiranë, 1976, f. 249-274).
- Mejdiaj, Bajram** — Disa tipare të martesës paraçlirimt, («Etnografia shqiptare» VIII, Tiranë, 1976, f. 33-111).
- Mejdiaj, Bajram** — Du droit de la femme à demander la rupture du mariage, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tiranë 1976, p. 121-133).
- Memia, Myftar** — Dasma e Malësisë së Gjakovës, («Etnografia shqiptare» I, Tiranë, 1962, f. 276-306).
- Memia, Myftar** — Lindja dhe kumbaria në Malësinë e Gjakovës («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1963, f. 254-275).
- Memia, Myftar** — Martesa në Nikaj-Mertur të Malësisë së Gjakovës («Etnografia shqiptare», X, Tiranë, 1980, f. 97).
- Memia, Myftar** — Les mariages à Nikaj-Mertur de la Malessie de Gjakova, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tiranë, 1980, p.).

- Mitrushi, Llambrini** — *Dasma në lalët e Myzeqesë*, («Etnografia shqiptare» II, Tiranë, 1963, f. 175-219).
- Mitrushi, Llambrini** — *Kodiku i Manastirit të Shën Kozmait për kontratat e fjesave*, («Etnografia shqiptare» II, Tiranë, 1966, f. 177-243).
- Mitrushi, Llambrini** — *Zakone mbi lindjen e fëmijës në lalët e Myzeqesë*, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 106-138).
- Mitrushi, Llambrini** — *Zakonet dhe ritet e ceremonialit të vdekjes në Myzeqë*, («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 257-285).
- Mitrushi, Llambrini** — *Veshje myzeqare të shekullit XIX dhe të fillimit të shek. XX*, («Etnografia shqiptare» VII, Tiranë 1976, f. 135-181).
- Mitrushi, Llambrini** — *Fiançailles et mariage chez les lales de la Myzeqe*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tiranë, 1976, f. 133-171).
- Muka, Ali** — *Arkitektura e banesës fshatare në Martanesh*, («Etnografia shqiptare» VII, Tiranë, 1976, f. 201-249).
- Muka, Ali** — *L'architecture de l'habitation rurale à Martanesh*, («Ethnographie Albanaise» VIII, Edition en français, Tiranë, 1979, p. ...).
- Muka, Ali** — *Banesa fshatare në Malësinë e Tiranës*, («Etnografia shqiptare» IX, Tiranë, 1980, f. 209-313).
- Muka, Ali** — *L'Habitation rurale dans la Malessie de Tirana*, «Ethnographie Albanaise» IX, Edition en français, Tiranë, 1979, p.).
- Muka, Ali** — *Tipe baneshash në disa fshatra të Librazhdit*, («Etnografia shqiptare» X, Tiranë 1979, f. 172).
- Muka, Ali** — *Types d'habitations dans quelques villages de Librazhd*, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tiranë, 1980, p. ...),
- Nova, Koço** — *Pozita e gruas sipas të drejtës zakonore të Labërisë*, («Etnografia shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 37-53).
- Nushi, Jani** — *Mitologji e besime në Myzeqe*, («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 285-336).
- Onuzi, Afërdita** — *Një qendër e punimit të enëve prej dhei pa çark*, («Etnografia shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 195-213).
- Onuzi, Afërdita** — *Tradita e poçerisë në fshatin Gojan*, («Etnografia shqiptare» VII, Tiranë, 1976, f. 135-181).
- Onuzi, Afërdita** — *Mjeshtria e punimit të enëve prej balte në fshatin Farkë — Tiranë*, («Etnografia shqiptare» VIII, Tiranë, 1976, f. 177-191).
- Onuzi, Afërdita** — *Le métier de poterie à Farke de Tirana*, («Ethnographie Albanaise» VIII, Edition en français, Tiranë, 1979, p...).
- Onuzi, Afërdita** — *Disa të dhëna mbi punimin e baltës në fshatin Bradvicë dhe në qytetin e Kavajës*, («Etnografia shqiptare» IX, Tiranë 1980, f. 313-333).
- Onuzi, Afërdita** — *La poterie traditionnelle à Bradvice de Korçe et à Kavaje*, («Ethnographie Albanaise» IX, Edition en français, Tirana, 1979, p....).
- Onuzi, Afërdita** — *Mjeshtëria shtëpiake e punimit të enëve prej balte*, («Etnografia shqiptare» Tiranë, 1980, f. 23).
- Onuzi, Afërdita** — *Le métier domestique du travail de la poterie*, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tiranë, 1980, p....).
- Pollo, Stefanaq** — *Fjala e hapjes (Seminar për Atlassin Etnografik)*, («Etnografia shqiptare» VII, Tiranë, 1976, f. 275-279).
- Prenushi, Mikel** — *Vështrim etnografik mbi krahinën e Kallmetit*, («Etnografia shqiptare» II, Tiranë, 1963, f. 219-254).

- Qatipi, Hasan** — *Prodhimi i drurit me anë të sharrës së ujit në krahinat e Elbasanit nga shek. XVIII deri në ditët tona*, («Etnografia shqiptare» I, Tirana, 1962, f. 137-193).
- Riza, Emin** — *L'habitation type Gjirokastrite (XVIII — XIXes.)*, («Etnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 171-193).
- Sadiku, Hilmi** — Mataj, Bajram — *Tradita dibrane në gdhendjen e drurit*, («Etnografia shqiptare» IX, Tirana, 1980, f. 359-367).
- Selimi, Yllka** — *Zeja e punimit të pipave*, («Etnografia shqiptare» X, Tirana, 1979, f.).
- *Le métier de fabrication des pipes*, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tirana, 1980, p....).
- Shala, Luigj** — *Lojra popullore*, (copë 277), («Etnografia shqiptare» VI, Tirana, 1975, f. 7-235).
- Shkurti, Spiro** — *Kultura dhe përpunimi i ullirit në fshatin Pijeras (Sarandë)*, («Etnografia shqiptare» V, Tirana, 1974, f. 155-185).
- Shkurti, Spiro** — *Korrja e drithërave (Provë për Atasin Etnografik shqiptar)*, («Etnografia shqiptare» VII, Tirana, 1976, f. 47-89).
- Shkurti, Spiro** — *Les moissons (Un essai pour l'Atlas Ethnographique albanais)*, («Ethnographie Albanaise» VIII, Edition en français, Tirana, 1979, p....).
- Shkurti, Spiro** — *Shënime për materialet e dërguara nga bashkëpunëtorët e jashtëm*, («Etnografia shqiptare» VII, Tirana, 1976, f. 285-291).
- Shkurti, Spiro** — *Vështrim etnografik mbi zonën e Vurgut*, («Etnografia shqiptare» VIII, Tirana, 1976, f. 111-159).
- Shkurti, Spiro** — *Shirja e drithërave*, («Entografia shqiptare» Tirana, 1980, f.57-115).
- Shkurti, Spiro** — *Një vështrim mbi veshjet popullore të zonës së Vurgut në fund të shek. XIX e fillim të shek. XX*, («Etnografia shqiptare» X, Tirana, 1980, f.).
- Shkurti, Spiro** — *Un aperçu sur les costumes populaires de la contrée de Vurga à la fin du XIX^e siècle, commencement du XX^e*, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tirana, 1980, p.).
- Shkurti, Spiro** — *Aspects économiques des laboureurs — çifçis à Vurg de Sarande (1900-1944)*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 71-91).
- Shkurti, Spiro** — *Le battage des céréales*, («Ethnographie Albanaise» IX, Edition en français, Tirana, 1979, p.).
- Shtjefni, Kolë** — *Doke mirditore*, («Etnografia shqiptare» II, Tirana, 1963, f. 275-309).
- Tirta, Mark** — *Mbi martesat e bëra pas Çlirimt midis personash nga besime të ndryshme*, («Etnografia shqiptare» IV, Tirana, 1972, f. 61-75).
- Tirta, Mark** — *Mariages mixtes de religion différente après la Libération du pays*, («Ethnographie Albanaise» VIII, Edition en français, Tirana, 1979, p.).
- Tirta, Mark** — *Elemente të kulturës ilire tek shqiptarët*, («Etnografia shqiptare» V, Tirana, 1974, f. 31-43).
- Tirta, Mark** — *Fushat etnografiike, elementët kulturorë dhe probleme të punës kërkimore*, («Etnografia shqiptare», VII, Tirana, 1976, f. 291-296).
- Tirta, Mark** — *Kultë të bujqësisë e të blegtorisë*, («Etnografia shqiptare» IX, Tirana, 1980, f. 155-209).
- Tirta, Mark** — *Aspekte të kultit të të parëve e të të vdekurve ndër shqiptarët*, («Etnografia shqiptare» X, Tirana, 1980).

- Tirta, Mark** — *Survivances religieuses du passé dans la vie du peuple (objets et lieux de culte)*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 49-71).
- Tirta, Mark** — *Les cultes de l'agriculture et de l'élevage chez le peuple albanaise*, («Ethnographie Albanaise» IX, Edition en français, Tirana, 1979, p.).
- Tirta, Mark** — *Aspects du culte des ancêtres et des morts chez les Albanais*, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tirana, 1980).
- Thomo, Pirro** — *Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë*, («Etnografia shqiptare» IV, Tirana, 1972, f. 202-242).
- Thomo, Pirro** — *Banesat me «qoshk» në Shqipërinë e Veriut*, («Etnografia shqiptare» VIII, Tirana, 1976, f. 191-239).
- Thomo, Pirro** — *Les habitations à «qoshk» en Albanie du Nord*, («Ethnographie Albanaise» VIII, Edition en français, Tirana, 1979).
- Thomo, Pirro** — *L'architecture des habitations paysannes à Has et à la Malessi de Gjakove*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 193-223).
- Ulqini, Kahreman** — *Dy dorëshkrime të Shtjefën Gjeçovit Kryeziut*, («Etnografia shqiptare» X, Tirana, 1980, f. 239).
- Ulqini, Kahreman** — *Deux manuscrits de Shtjefën Gjeçov-Kryeziu*, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tirana, 1980).
- Zojzi, Rrok** — *Etnografia shqiptare dhe puna e zhvilluar në këtë fushë*, («Etnografia shqiptare» I, Tirana, 1962, f. 3-16).
- Zojzi, Rrok** — *Ndamja krahinore e popullit shqiptar*, («Etnografia shqiptare» I, Tirana, 1962, f. 16-65).
- Zojzi, Rrok** — *Guna në veshjet tradicionale të popullit shqiptar dhe të popujve të tjerë të Ballkanit*, («Etnografia shqiptare» III, Tirana, 1966, f. 3-43).
- Zojzi, Rrok** — *Aspekte të kalimit nga familja patriarkale në familjen e re socialist*, («Etnografia shqiptare» IV, Tirana, 1972, f. 28-37).
- Zojzi, Rrok** — *Atlasi etnografik shqiptar dhe problemet e tij*, («Etnografia shqiptare» V, Tirana, 1974, f. 3-31).
- Zojzi, Rrok** — *Parmenda shqiptarë dhë procesi historik i zhvillimit të saj*, («Etnografia shqiptare» VII, Tirana, 1976, f. 3-47).
- Zojzi, Rrok** — *L'ancienne division régionale ethnographique du peuple albanaise*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 7-19).
- Zojzi, Rrok** — *Des costumes traditionnels albanais*, («Ethnographie Albanaise», Edition spéciale, Tirana, 1976, p. 223-235).
- Zhekut, Koço** — *Shtëpia e banimit në fshatin Mullet dhe zhvillimi i saj*, («Etnografia shqiptare» I, Tirana, 1962, f. 65-105).
- Zhekut, Koço** — *Tipare karakteristike të arkitekturës së fshatit Linzë*, («Etnografia shqiptare» II, Tirana, 1963, f. 110-144).
- Zhekut, Koço** — *Shtëpitë e banimit në fshatin e Pojanit (Myzeqe)*, («Etnografia shqiptare» III, Tirana, 1966, f. 88-110).
- Zhekut, Koço** — *Disa shtëpi banimi karakteristike në fshatrat Farkë e Lundër*, («Etnografia shqiptare» IV, Tirana, 1972, f. 242-262).
- *Pyetësor mbi problemet e familjes*, («Etnografia shqiptare» IV, Tirana, 1972, f. 284-306).
 - *Bibliographie des dix premier numéros de l'«Ethnographie Albanaise» (n° 1 — 10)*, («Ethnographie Albanaise» X, Edition en français, Tirana, 1960, p.).

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|---------------------------------|------|
| 1. ABAZ DOJAKA | 3 |
| 2. MARK KRASNIQI (PRISHTINË) | 23 |
| 3. MARK TIRTA | 51 |
| 4. MYFTAR MEMIA | 97 |
| 5. AFËRDITA ONUZI | 123 |
| 6. SPIRO SHKURTI | 137 |
| 7. ALI MUKA | 177 |
| 8. YLLKA SELIMI | 219 |
| 9. KAHREMAN ULQINI | 239 |
| 10. — | 245 |